



# FUQIZIMI I GRAVE PËR PARTI POLITIKE MË TË FORTA

UDHËZUES PËR PROMOVIMIN  
E PJESËMARRJES SË GRAVE  
NË POLITIKË

Përshtatja në shqip dhe botimi i këtij manuali u mundësua me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Shqipëri me fonde të Qeverisë Suedeze.

**Përktheu:** Majlinda Nishku



Empowered lives.  
Resilient nations.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet  
Ndërkombëtare

# FUQIZIMI I GRAVE PËR PARTI POLITIKE MË TË FORTA

UDHËZUES PËR PROMOVIMIN E  
PJESËMARRJES SË GRAVE  
NË POLITIKË



## FUQIZIMI I GRAVE PËR PARTI POLITIKE MË TË FORTA

UDHËZUES PËR PROMOVIMIN  
E PJESËMARRJES SË GRAVE  
NË POLITIKË

### AUTORJA KRYESORE

Julie Ballington

### KONTRIBUESE DHE AUTORE TË RASTEVE TË STUDIMIT

Randi Davis

Mireya Reith

Lincoln Mitchell

Carole Njoki

Alyson Kozma

Elizabeth Powley

### REDAKTOR

Manuela Popovici

### FAQOSJA

Suazion, Ltd.

### FOTOJA NË FAQEN E PARË

UNCDF Adam Rogers

### PRODHIMI



### FALËNDERIME

PNUD-i dhe NDI-ja dëshirojnë të falënderojnë të gjithë ata që dhanë ndihmesën e tyre për realizimin e këtij dokumenti.

Ky botim u nis fillimisht nga Winnie Byanyiam, Randi Davis dhe Kristin Haffert dhe kontributet e tyre të paçmueshme ndihmuan për ta kthyer këtë botim në realitet.

Rastet studimore origjinale dhe tekstet përmbledhëse që ofruan informacione për këtë dokument u hartuan dhe/ose hulumtuan nga Lincoln Mitchell, me kontribute nga Mireya Reith, Elizabeth Powley, Carole Njoki dhe Marilyn Achiron. Julie Ballington dhe Manuela Popovici kanë drejtuar botimin drejt mbylljes me sukses së tij.

Falenderojmë Suki Beavers, Shari Bryan, Drude Dahlerup, Randi Davis, Kevin Deveaux, Aleida Ferreyra, Simon Alexis Finley, Geraldine Fraser-Moleketi, Kristin Haffert, Oren Ipp, Linda Maguire, Susan Markham, Mireylla Reith, Carmina Sanchis Ruescas, Kristen Sample, Louise Sperl dhe Ken Wollack për mendimet dhe komentet e tyre që na i kanë ofruar me aq dashamirësi.

Falenderimet tona i shkojnë gjithashtu edhe shumë të intervistuarve që kontribuan me kohën dhe njohuritë e tyre në hartimin e rasteve studimore dhe të gjithë personelit vendor dhe rajonal të NDI-së, të cilët ndihmuan në lehtësimin e hulumtimit në terren. Gjithashtu u jemi mirënjohës PNUD-it dhe zyrës vendore të NDI-së, përpjekjet e të cilëve ndihmuan në përfundimin e rasteve studimore.

Shkurt 2012

ISBN: 978-09848059-5-2

E drejta e autorit: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky botim dhe pjesë të tij nuk mund të riprodhohen, ruhen me anë të çfarëdo sistemi, apo të transmetohen në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjim, apo çdo lloj tjetër, pa marrë paraprakisht leje nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara.

Mendimet, analizat dhe rekomandimet që përmbahen në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, apo të Bordit të tij Ekzekutiv, apo të Vendeve Anëtare të tij. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

# PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE – PNUD</b>	<b>II</b>	<b>PJESA B: RASTE STUDIIMI</b>	<b>51</b>
<b>PARATHËNIE – NDI</b>	<b>III</b>	<b>LISTA E RASTEVE TË STUDIIMIT</b>	<b>53</b>
<b>SHKURTESA</b>	<b>IV</b>	<b>AFRIKA E JUGUT:</b> Mobilizimi i grave dhe shndërrimi i agjendës politike	54
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>1</b>	<b>AFRIKA JUGORE (KUTI):</b> Mësimet rajonale për të shfrytëzuar mundësitë që ofrojnë periudhat tranzitore dhe institucionalizimi i praktikave partiake të barazisë gjinore	58
<b>HYRJE</b>	<b>7</b>	<b>ARMENIA:</b> Ndërtimi i koalicioneve për të nxitur zbatimin e kuotave	60
<b>PJESA A. PËRMBLEDHJE E PRAKTIKAVE TË MIRA</b>	<b>13</b>	<b>AUSTRALIA:</b> Kuotat e brendshme partiake dhe rrjetet për ngritjen e fondeve për promovimin e përparimit të grave në politikë	63
<b>I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PARTISË</b>	<b>15</b>	<b>BURKINA FASO:</b> Kuotat vullnetare dhe të caktuara me ligj për partitë politike	67
KRIJIMI I THEMELEVE ORGANIZATIVE PËR BARAZINË GJINORE	15	<b>INDIA (KUTI):</b> Kuotat, vendet e rezervuara dhe partitë politike	71
Çështje kyçe	15	<b>INDONEZIA (KUTI):</b> Rekrutimi i kandidatëve dhe kuotat e partive politike	73
Strategjitë e përdorura	17	<b>KAMBOXHIA:</b> Organizatat e forumeve partiake të grave për promovimin e grave brenda partisë dhe në poste të zgjedhura	75
<b>II. PERIUDHA PARA ZGJEDHJEVE</b>	<b>21</b>	<b>KANADA:</b> Mbështetja e grave kandidate përmes rrjeteve financuese dhe rregullave për emërimin e kandidatëve	79
REKRUTIMI DHE EMËRIMI I KANDIDATËVE	21	<b>KROACIA:</b> Mbështetja e forumit të grave të partisë për kuotat për kandidatët dhe trajnimet për ngritjen e kapaciteteve	85
Çështje kyçe	21	<b>MAROKU:</b> Aktivizmi ndër-sektorial për promovimin e kuotave për kandidatet e partive	89
Strategjitë e përdorura	25	<b>MBRETËRIA E BASHKUAR:</b> Vënia e kandidaturave të grave në vende "të fitueshme"	93
FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE	28	<b>MEKSIKA:</b> Mbështetja e përfaqësimit të grave përmes kuotave dhe fondeve shtetërore për trajnime	97
Çështje kyçe	28	<b>PERU (KUTI):</b> Veprimtari avokacie për kuotat nga forumi i grave	102
Strategjitë e përdorura	29	<b>RUANDA:</b> Përdorimi i kushtetutës për të institucionalizuar arritjet e grave në periudhën pas konfliktit	103
<b>III. PERIUDHA ZGJEDHORE</b>	<b>33</b>	<b>SALVADORI:</b> Strategji për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë pas çlirimit të vendit	107
ZHVILLIMI I FUSHATËS DHE PËRGATITJA E ZGJEDHJEVE	33	<b>SERBIA:</b> Mobilizimi i forumit të grave për ndryshime politike	111
Çështje kyçe	33	<b>SPANJA:</b> Puna në partneritet me burrat për transformimin e mjedisit politik për gratë	113
Strategjitë e përdorura	34	<b>SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS:</b> Rrjetet për mbledhjen e fondeve dhe politika e barazisë gjinore për konventat partiake	117
<b>IV. PERIUDHA PAS ZGJEDHJEVE</b>	<b>39</b>	<b>TIMORI LINDOR:</b> Krijimi i stimujve për avancimin e rekrutimit të grave kandidate	122
QEVERISJE QË I PËRGJIGJET KËRKESAVE GJINORE	39		
Çështje kyçe	39		
Strategjitë e përdorura	40		
<b>PËRFUNDIM</b>	<b>45</b>		
<b>SHËNIME</b>	<b>47</b>		

# PARATHËNIE PNUD

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta njerëzore; ato janë gjithashtu të domosdoshme edhe për arritjen e një zhvillimi përfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Pjesëmarrja politike e grave është kyç për këto qëllime dhe partitë politike janë ndër institucionet më të rëndësishme për promovimin dhe zhvillimin e një pjesëmarrjeje të tillë. Duke qenë se gratë zënë më pak se 20 për qind e vendeve parlamentare të botës, është e qartë se partitë politike duhet të bëjnë më shumë – dhe duhen ndihmuar në këtë përpjekje – për ta mbështetur fuqizimin politik të grave.

Megjithëse 40 deri në 50 për qind e anëtarëve të partive në botë janë gra, gratë kanë vetëm 10 për qind të posteve udhëheqëse brenda këtyre partive. Për të garantuar pjesëmarrjen e barabartë të grave në strukturat vendimmarrëse të partive është e domosdoshme për të promovuar barazinë gjinore brenda tyre – si dhe brenda të gjithë shoqërisë në tërësi.

Gjatë një periudhe prej 18 muajsh, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) mblodhën 20 raste studimore të veprimtarive të partive për të promovuar fuqizimin politik të grave. Duke u bazuar në ata shembuj dhe shembuj të tjerë, PNUD-i dhe NDI-ja identifikuan hapa konkretë që mund të ndërmerren nga partitë politike për të promovuar gratë në jetën politike. Ky botim, *Fuqizimi i grave për parti më të forta politike: Një udhëzues për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë*, është fryt i këtij hulumtimi dhe ofron alternativa të sakta dhe të përcaktuara mirë për reforma të partive politike.

Ky udhëzues është i pari në llojin e tij që identifikon dhe

kategorizon gamën e veprimeve që mund të ndërmarrin partitë politike për të mbështetur pjesëmarrjen e grave gjatë fazave të ndryshme të ciklit zgjedhor, përfshirë fazat para- dhe pas-zgjedhore.

Udhëzuesi ka si objekt anëtarët dhe anëtarët e partive politike, veçanërisht ata në role udhëheqëse, si dhe organizatat e shoqërisë civile dhe veprimtarët e veprimtarët për barazi gjinore. Ai ka synim gjithashtu të nxisë bazat dhe aleancat e partive politike në botë që ta përfshijnë barazinë gjinore si një normë në statutet dhe punën e tyre.

Së fundi, ky Udhëzuesi shërben si një udhërrëfyes i vyer për ato organizata ndërkombëtare dhe agjenci zhvillimi që u ofrojnë mbështetje programore partive politike në lidhje me pjesëmarrjen politike të grave.

Kur të kenë një zë të vërtetë në të gjitha institucionet qeverisëse, nga ato politike në ato të shërbimit civil, sektorit privat, dhe shoqërisë civile, gratë do të jenë të afta të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me burrat në dialogun publik dhe të ndikojnë në vendimet që përcaktojnë të ardhmen e tyre, si dhe të familjeve, komuniteteve dhe kombeve të tyre.



Helen Clark  
Administratore

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

# PARATHËNIE NDI

Partitë politike janë instrumentet parësore dhe më të drejtpërdrejta nëpërmjet të cilave gratë mund të kenë qasje në postet e zgjedhura dhe udhëheqjen politike, prandaj strukturat, politikat, praktikat dhe vlerat e partive politike ushtrojnë një ndikim të thellë tek niveli i pjesëmarrjes së grave në jetën politike të vendit të tyre.

Partitë që e marrin seriozisht pjesëmarrjen e grave në politikë përfitojnë nga pozicione më të forta zgjedhore, krijojnë kontakte me grupe të reja votuesish, dhe marrëdhënie më të forta me zgjedhësit e tyre. Përveç kësaj, partitë që janë në gjendje të sjellin njerëz të rinj dhe ide të reja ruajnë një imazh të gjallë dhe energjik në një kohë kur pjesëmarrja në zgjedhje është në rënie. Disa nga rezultatet janë tejet mbresëlënëse, disa janë më pak të dukshme, dhe disa arrihen në mënyrë graduale, por rezultati i përgjithshëm për partitë politike është në çdo rast një përfitim neto për to.

Partitë politike kanë përfitim kur gratë jo vetëm marrin pjesë në proceset zgjedhore dhe qeverisëse, por edhe ndikojnë në to. Përpjekjet sipërfaqësore për rritjen e numrit të grave të përfshira në politikë, që nuk ofrojnë ndonjë ndikim të vërtetë cilësor apo kompetenca vendimmarrëse, kanë pak gjasa të sjellin ndonjë përfitim të ri ose të menjëhershëm. Shembuj tipikë të përpjekjeve të tilla janë forumet e grave që nuk kanë autoritet apo ndikim statutor; përzgjedhja e të ashtuquajturave vende për femrat në listat e kandidatëve; marginalizimi i grave zyrtare ose funksionare pas zgjedhjes së tyre; caktimi i grave si candidate në zona ku nuk mund të zgjidhen; ose heqja e grave nga numri i tyre rendor në listë në minutën e fundit, kur shihet se ai numër rendor ka shanse për sukses.

Tendenca e përgjithshme universal është drejt një

qeverisjeje demokratike të bazuar në paritetin dhe barazinë midis sekseve. Përpjekjet për të përfshirë edhe grupet tradicionalisht të nën-përfaqësuar, si gratë, tani konsiderohen si standard minimal për funksionimin demokratik të partive politike dhe për organet legjislativë brenda të cilave ato veprojnë.

Ky botim, Fuqizimi i grave për parti më të forta politike: Një udhëzues për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, është organizuar në mënyrë të tillë që partitë politike dhe kushdo që punon me partitë për të rritur përfshirjen e grave në politikë, të mund të gjejnë aty strategji për t'i përdorur gjatë të gjithë ciklit zgjedhor dhe në një gamë të gjerë rolesh të tjera në partitë politike. Pjesëmarrja e grave mund të promovohet jo vetëm si candidate, por edhe si anëtare, udhëheqëse, dhe funksionare të partisë.

Për më shumë se 25 vjet, Instituti Demokratik Kombëtar ka punuar me më shumë se 720 parti dhe organizata politike në më se 80 vende për të krijuar hapësira më të mëdha politike në të cilat burrat dhe gratë të mund të marrin pjesë aktivisht në procesin demokratik. Ne shpresojmë se ky Udhëzues do të ndihmojë për të kontribuar në këto përpjekje.



Ken Wollack

President

Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet  
Ndërkombëtare

## SHKURTESA

ANC	Kongresi Kombëtar Afrikan, Afrika e Jugut	IPU	Bashkimi Ndër-Parlamentar
ANCWL	Liga e Grave e Kongresit Kombëtar Afrikan, Afrika e Jugut	IRI	Instituti Republikan Kombëtar
ASPARLEXSAL	Shoqata e Grave Parlamentare dhe ish-Parlamentare Salvadoriane, Salvador	KDP	Kongresi për Demokraci dhe Progres, Burkina Faso
BBGD	Bordi i Bashkërendimit të Grave në Drejtim, Armeni	NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
BE	Bashkimi Evropian	NDP	Partia e Re Demokratike, Kanada
BJP	Partia Bhatariya Janata, Indi	NFDW	Federata Kombëtare e Grave Demokratike, SHBA
BPFA	Platforma e Pekinit për Veprim	NLWN	Rrjeti Kombëtar i Grave Laburiste, Australi
BSFP	Bashkimi Socialist i Forcave Popullore, Marok	NOW	Organizata Kombëtare për Gratë, SHBA
CDU	Bashkimi Kristian-Demokrat, Gjermani	NWPC	Grupi Politik Kombëtar i grave, SHBA
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	OAS	Organizata e Shteteve Amerikane
COFIPE	Kodi Federal për Institucionet dhe Procedurat Zgjedhore, Meksikë	ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
CSV	Partia Popullore Kristian-Sociale, Luksemburg	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DAW	Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Përparimin e Grave	OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
EMB	Organi i Menaxhimit të Zgjedhjeve	PVQ	Partia e Veprimit Qytetar, Kosta Rika
EMILY'S LIST	Lista EMILY (EMILY është një shkurtesë në gjuhën angleze për <i>Early Money Is Like Yeast</i> që përkthehet "Fondet e hershme janë si majaja")	PDIP	Partia Demokratike e Përpjekjes, Indonezi
ERA	Amendamenti i të Drejtave të Barabarta, SHBA	PLAP	Partia Laburiste Australiane
FGD	Forumi i Grave në Drejtim, Armeni	PPC	Partia Popullore Kristiane, Peru
FMÇK	Fronti Farabundo Marti për Çlirim Kombëtar, Salvador	PPK	Partia Popullore Kamboxhiane
FPR	Fronti Patriotik i Ruandës	PPS	Partia e Progresit dhe Socializmit, Marok
FRELIMO	Fronti i Çlirimit të Mozambikut	PR	Partia e Republikës, Brazil
FSDG	Forumi Social Demokratik i Grave, Kroaci	PRD	Partia e Revolucionit Demokratik, Meksikë
IDEA	Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore	PRI	Partia Revolucionare Institucionale, Meksikë
		PSD	Partia Social Demokratike, Kroaci
		PSOE	Partia Socialiste e Punëtorëve, Spanjë
		PUSC	Partia Kristian-Sociale e Unitetit, Kosta Rika
		PVN	Partia e Veprimit Kombëtar, Meksikë
		SADC	Komuniteti Jug-Afrikan i Zhvillimit
		SIW	Gratë e Internacionales Socialiste
		SRP	Partia Sam Rainsy, Kamboxhia
		UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
		UNTAET	Administrata Kalimtare e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor
		WNC	Koalicioni Kombëtar i Grave, Afrika e Jugut



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



PNUD PAKISTAN

E drejta e grave për të marrë pjesë në jetën politike garantohet nga disa konventa ndërkombëtare. Por transformimi i një të drejte abstrakte në realitet kërkon punë të madhe në terren. Partitë politike janë kyçi për pjesëmarrjen e grave në politikë, sepse janë partitë politike ato që rekrutojnë dhe përzgjedhin kandidatët për zgjedhje dhe përcaktojnë agjendën e politikave të vendit. Megjithatë, brenda partive politike, është e zakonshme që gratë të jenë të mbi-përfaqësuara në nivelin e organizatës bazë ose në role mbështetëse dhe të nën-përfaqësuara në postet me pushtet. Duke pasur parasysh mungesën e qasjes në rrjetet ekzistuese të ndikimit, burimet shumë të kufizuara, numrin e vogël të shembujve për të ndjekur dhe mentorëve për t'i udhëzuar, madje ndonjëherë edhe mbështetjen e kufizuar nga familja dhe komuniteti, është e kuptueshme se pjesëmarrja e grave në partitë politike ka mbetur shumë më e ulët se ajo e burrave.

Mënyra se si marrin pjesë gratë në partitë politike – dhe se si partitë politike e

nxisin dhe ushqejnë përfshirjen e grave dhe i bëjnë pjesë të programit të tyre çështjet e barazisë gjinore – janë faktorë përcaktues kyç të fuqizimit politik të grave. Ato janë gjithashtu kyç për të garantuar që çështjet e barazisë gjinore të trajtohen në shoqërinë më të gjerë. Në mënyrë që strategjitë për promovimin e përfshirjes së grave në procesin politik të jenë efektive, ato duhet të lidhen me hapat që partitë mund të ndërmarrin gjatë fazave specifike të ciklit zgjedhor – fazat para-zgjedhore, zgjedhore dhe pas-zgjedhore – dhe me organizimin dhe financimin e vetë partive.


Strategjitë më efektive për të rritur pjesëmarrjen e grave në partitë politike kombinojnë reforma të institucioneve politike me një mbështetje të fokusuar tek gratë aktiviste të partisë, brenda dhe jashtë strukturave të partisë, për kandidatet, dhe gratë e zgjedhura në funksione të ndryshme. Këto strategji kërkojnë bashkëpunimin e një numri të madh aktorësh dhe partish politike në të gjithë spektrin politik.

Pjesa A e këtij botimi, **UDHËZIMI PËRMBLEDHËS I PRAKTIKAVE TË MIRA**, identifikon ndërhyrje të fokusuara që mund të bëjnë partitë politike për të fuqizuar gratë. Ajo është e strukturuar sipas katër fazave duke ndjekur një qasje që përkon me ciklin zgjedhor (parashtruar në Figurën 1):



Këtu përmbledhen veprimet specifike që mund të ndër-marrin partitë politike brenda secilës nga këto faza.

**FIGURA 1: PËRMBLEDHJA E PIKAVE HYRËSE PËR PROMOVIMIN E Pjesëmarrjes së GRAVE NË PARTI POLITIKE**



Forumi ose seksionet e grave që janë krijuar, janë të përfshira në mënyrë strategjike brenda partisë

Përcaktohen objektiva për pjesëmarrjen e grave në konventat e partisë

Perspektiva e barazisë gjinore bëhet pjesë përbërëse e hartimit të politikave



PNUD KENIA

### III. PERIUDHA ZGJEDHORE

### IV. PERIUDHA PAS-ZGJEDHORE

#### PERIUDHA E FUSHATËS

Ndërtoni kapacitetet e grave për të bërë fushatë dhe konsideroni skema binjakëzimi ose këshillimi për kandidatet që venë kandidaturën për herë të parë

Siguroni dukshmërinë e grave në fushatën zgjedhore dhe që ato të kenë qasje në media

Siguroni që manifesti i partisë të përfshijë shprehimisht politika për barazinë gjinore dhe ua shpërndani atë votuesve

Mobilizoni gratë që të regjistrohen dhe të votojnë; jepini burrave dhe grave informacione votimi me ndjeshmëri gjinore

Garantoni sigurinë e grave kandidate gjatë fushatës dhe mbajini simpatizantë e partisë nën kontroll atje ku ka potencial për dhunë

Garantoni koordinim midis OSHC-ve dhe organizatave që ofrojnë mbështetje për gratë kandidate

#### DITA E ZGJEDHJEVE

Siguroni që gratë të trajnohen dhe të përfshihen si përfaqësuese të partisë në qendrat e votimit

Siguroni që vëzhgimi të përfshijë një perspektivë gjinore dhe të garantojë sigurinë e grave

Gratë trajnohen dhe përfshihen si vëzhguese të zgjedhjeve



PNUD PAKISTAN

#### GRATË E ZGJEDHURA

Ndërmerrni një vlerësim të barazisë gjinore; zhvilloni plan për veprim gjinor brenda partisë

Ofroni krijim të kapaciteteve dhe forconi aftësitë legjislativë të grave të zgjedhura

Promovoni reforma politike me ndjeshmëri gjinore të institucioneve, veçanërisht në parlament

Promovoni pjesëmarrjen e grave në bërjen e politikave të partisë; garantoni përfshirjen gjinore në politikat e partisë

Nxisni formimin e një grupi ndër-partiak dhe mbështesni funksionimin e tij

Ndërgjegjësoni anëtarët e partisë për barazinë gjinore dhe punoni me burrat

**ORGANIZIMI I BRENDSHËM** i partive politike ndikon në mënyrën se si përfaqësohen në shoqëri nevojat, interesat dhe kërkesat shoqërore. Dokumentet dhe deklaratat zyrtare të një partie politike janë të rëndësishme për të ofruar një kuadër të barazisë gjinore – ato ofrojnë një vizion të partisë, por gjithashtu rrënjosin rregullat për arritjen e atij vizioni. Strategjitë e Organizimit të Brendshëm të Partisë përfshijnë:

- Trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore në kuadrin ligjor të partisë. Kjo mund të përfshijë miratimin e një deklaratë për barazinë gjinore në dokumentet themeluese të partisë;

- Miratimin e masave, përfshirë kuotat e brendshme, që garantojnë pjesëmarrjen e grave në bordet drejtuese;

- Vendosjen e objektivave për pjesëmarrje në konventat e partisë. Kjo mund të përfshijë mbajtjen e forumeve të veçanta për gratë delegate në konventa e kongrese;

- Krijimin e forumeve dhe seksioneve të grave brenda partive, të cilat duhet të integrohen zyrtarisht në strukturën e partisë me role dhe përgjegjësi të përcaktuara dhe fondet e duhura nëse nevojitet;

- Garantimin e përfshirjes së gjinisë në politikat partiake.

Në **FAZËN PARA-ZGJEDHORE**, **rekrutimi dhe nominimi i kandidatëve** është ndoshta procesi më i rëndësishëm për të garantuar që gratë të marrin pjesë në politikë. Hendeku gjinor zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme kur kandidatët për funksione politike kalojnë nga të qenit të persona që plotësojnë kriteret, në aspirantë, dhe në fund kur marrin nominimin nga partia. Është e rëndësishme që partitë të përfshijnë rregulla që garantojnë përfaqësimin e grave. Kur angazhimi për këtë është i pashkruar dhe jo zyrtar, është shumë më e vështirë të krijohen strategji që u mundësojnë grave të çajnë dhe të bëhen pjesë e rrethit “të brendshëm” të pushtetit; po kështu është më e vështirë për ta vënë partinë para përgjegjësisë kur ky angazhim nuk plotësohet. Kur organizimi i brendshëm është i dobët dhe rregullat e rekrutimit janë të paqarta, ndodh rëndom që vendimet merren nga një numër i kufizuar anëtarësh elitare, zakonisht burra.

Vitet e fundit, **kuotat zgjedhore** janë bërë një politikë mjaft e përhapur për të sjellë më shumë gra në politikë. Kuotat janë një mënyrë për të garantuar që pjesëtarët e një grupi të elektoratit, si gratë, të përfshihen në një nivel të paracaktuar minimal në institucionet përfaqësuese, qoftë si delegate, kandidatë apo zyrtarë të zgjedhura. Rreth 50 vende kanë miratuar ligje në lidhje me kuotat e kandidatëve, të cilat garantojnë që një pjesë e caktuar e kandidatëve për detyrë politike të jenë gra. Qindra parti politike në 30 vende të tjera kanë miratuar vullnetarisht kuotat e tyre për gratë. Por kuotat e kandidatëve do të kenë sukses vetëm nëse pozicioni i grave (renditja e tyre) në listat partiake është i tillë që ato të kenë mundësi të vërteta për të fituar, dhe nëse kuotat përfshijnë edhe dënime në rast të moszbatimit të tyre.

Veprimet që mund të ndër marrin partitë politike për të trajtuar pabarazinë gjinore në **procesin e rekrutimit të kandidatëve** përfshijnë:

**SYNIMI PËR TË PASUR MË SHUMË GRA NË POLITIKË**

**NUK ËSHTË QË TË KETË MË PAK BURRA NË POLITIKË,**

**POR QË TË KETË NJË SHOQËRI MË TË BARABARTË PËR TË GJITHË.**

- Galvanizimin e mbështetjes së partisë për kuotat e kandidatëve dhe përfshirjen e këtyre kuotave në statutet e partive;

- Përcaktimin e direktivave për rekrutimin e kandidatëve në komisionet partiake për nominimin e kandidatëve;

- Garantimin e zbatimit si dhe të vendosjes së grave kandidatë në zona të fitueshme ose të sigurta;

- Punën me organizatat e shoqërisë civile për të mbikëqyrur zbatimin e kuotave;

- Zhvillimin e aleancave strategjike me burrat, sepse burrat luajnë një rol kyç në krijimin e mbështetjes së brendshme të partisë për këto lloj politikash;

- Zgjerimin e grupit të grave kandidatë dhe trajnimin e këtyre kandidatëve;

- Nxitjen e marrëdhënieve shumëpalëshe dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet vendeve dhe rajoneve.

Gratë në politikë thonë shpesh se **mungesa** e financimit është një nga pengesat kryesore për futjen e tyre në politikë. Gratë jo vetëm e kanë të vështirë të mbledhin fondet e nevojshme për të bërë fushatë, por shpesh marrin shumë pak, ose aspak, ndihmë financiare nga partitë e tyre politike. Është veçanërisht e vështirë për gratë të mbledhin “fondet e hershme”, pra fondet e kërkuara për të filluar fushatën për një post të zgjedhur. Veprimet që partitë dhe organizatat e shoqërisë civile mund të ndërmarrin për t’i ndihmuar gratë të mbledhin fondet e nevojshme për të bërë fushatë politike përfshijnë: ngritjen e rrjeteve për mbledhjen e fondeve, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme atje ku nuk ka fonde publike dhe kandidatët duhet të mbledhin vetë fonde për të konkurruar në zgjedhje; krijimin e fondeve brenda par-

tisë, të caktuara vetëm për të mbështetur gratë kandidatë; dhënien e subvencioneve për gratë kandidatë; kufizimin e shpenzimeve të nominimit dhe fushatës; dhënien e fondeve publike për partitë politike, sidomos nëse ato janë të rregulluara me ligj në mënyrë të tillë që i nxisin partitë që të trajtojnë çështjen e fuqizimit politik të grave; ndarjen e fondeve posaçërisht për trajnimin e grave kandidatë; dhe shqyrtimin në mënyrë se si janë përdorur fondet partiake për të mbështetur gratë kandidatë dhe çështjet e grave.

Gjatë **PERIUdhës ZGJEDHORE** kandidatët duhet të jenë të vetëdijshëm për teknikat efektive **të kryerjes së fushatës dhe të komunikimit** me zonat e tyre zgjedhore. Partitë politike mund të ndihmojnë në edukimin e votuesve për të drejtat e grave për të marrë pjesë në politikë dhe për rëndësinë që ka nxitja e barazisë gjinore për të gjithë shoqërinë. Veprimet që mund të ndërmarrin partitë gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

- Ofrimin e trajnimit për gratë kandidatë për zhvillimin e aftësive të tilla si mbledhja e fondeve, hartimi i mesazheve, marrëdhëniet me median dhe komunikimin me votuesit;

- Trajnimin dhe promovimin e grave në pozicione udhëheqëse në fushatë (p.sh. në menaxhimin e fushatës, daljen për të votuar, kontaktin me votuesin dhe komunikimet);

- Garantimin e dukshmërisë së grave në fushatë, duke u ofruar atyre më shumë ekspozim para mediave;

- Identifikimin dhe shpërndarjen e posteve partiake që janë përparësi për gratë, gjë që mund të tërheqë edhe më shumë vota nga gratë për partinë e tyre;

- Vëzhgimin e zgjedhjeve, përfshirë edhe përmes rekrutimit të grave si përfaqësuese të partisë që të jenë të pranishme në qendrat e votimit, veçanërisht nëse ato qendra votimi janë paracaktuar vetëm për gratë;



■ Dhënien e informacioneve për votuesit, ku përfshihen mesazhe specifike që nxjerrin në pah rëndësinë e votave të grave dhe të drejtën e grave për të votuar si pjesëtare të barabarta të shoqërisë.

Edhe pas përfundimit të zgjedhjeve, partitë politike vazhdojnë të luajnë një rol qendror në nxitjen e pjesëmarrjes së grave në politikë. Veprimet që mund të ndërmerren partitë në **PERIUHDHËN PAS-ZGJEDHORE** për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në qeverisje përfshijnë:

■ Kryerjen e një vlerësimi të shkallës së barazisë gjinore brenda partisë, me synim identifikimin dhe, me synim përfundimtar eliminimin e ndonjë praktike apo rregulli që mund të dëmtojë gratë në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë;

■ Promovimin e reformave me ndjeshmëri gjinore në institucionet politike, si për shembull ndryshimi i orarit të punimeve të parlamentit dhe i kalendarit parlamentar për të ndihmuar deputetët dhe deputetet që kanë detyrime familjare;

■ Sigurimin e përfshirjes së çështjeve gjinore dhe të fuqizimit të grave në politikën e partisë, përfshirë mbështetjen e reformave për politika të posaçme gjinore, si lufta kundër dhunës me bazë gjinore ose fokusimi tek çështje si leja e prindërve (leje lindjeje ose perkujdesi për fëmijët) ose të drejtat riprodhuese, si dhe promovimi i barazisë gjinore në fusha si qasja në drejtësi, shëndetësi, shtetësi, punë, të drejtat e pronësisë mbi tokën, sigurimet shoqërore dhe trashëgimia;

■ Mbështetjen e rrjeteve ndërpartiake të grave dhe të grupeve parlamentare të grave, sepse këto mund të ndihmojnë për të kanalizuar interesat e shtetësimet e grave dhe në përfshirjen e gjinisë në hartimin e politikave dhe ushtrimin e kontrollit mbi qeverinë;

■ Garantimin që grave të zgjedhura në një institucion politik t'u ofrohen role udhëheqëse në grupet parlamentare (p.sh. kryetare të grupit) dhe në komisionet parlamentare (p.sh. kryetare ose pika fokale të grupit);

■ Formimin e partneriteteve strategjike me organizatat e shoqërisë civile.

Lista e veprimeve të sugjeruara më lar nuk është shteruese; këto sugjerime ofrohen si udhëzime, bazuar në praktikën më të mirë, dhe jo si receta të gatshme. Kur ndërmerret ndonjë veprim për të nxitur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe promovimin e agjendës së barazisë gjinore në përgjithësi, është e rëndësishme të përfshihen edhe burrat. Burrat janë partnerë kyçë për arritjen e ndryshimeve të qëndrueshme. Synimi për të pasur më shumë gra në politikë nuk është që të ketë më pak burra në politikë, por që të ketë një shoqëri më të barabartë për të gjithë.

Pjesa B e këtij botimi përbëhet nga 20 **RASTE STUDIMORE** nga të cilat janë nxjerrë praktikën e mira të parashtruara në pjesën e parë. Rastet studimore përqendrohen në parti politike, organizata civile të caktuara, ose aktorë të tjerë në secilin nga vendet, dhe shqyrtojnë veprimet konkrete e ndërmarra prej tyre që synojnë promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë. Rastet studimore ofrojnë një informacion të përgjithshëm për arsyet pse u përzgjedhën strategji të caktuara partiake, si u zbatuan ato, si përpiqen të përshkruajnë ndikimet që ka pasur ajo reformë. Gjithashtu, secili rast studimi përpriqet të ofrojë mësim që janë nxjerrë apo praktika të mira që janë krijuar, për t'i ndihmuar partitë politike dhe organizatat që i ofrojnë ndihmë partive politike të zhvillojnë dhe të çojnë përpara strategji reformash.

Shumë nga shembujt e përdorur në Pjesën A janë nxjerrë nga rastet studimore që tani janë përfshirë në Pjesën B. Në fillim të tetorit 2011 u krijua një botim i veçantë, më i shkurtër, që përmbante vetëm Pjesën A me titullin Udhëzues i praktikave të mira për promovimin e pjesëmarrjes politike të grave, i cili tani ofrohet në pesë gjuhë të ndryshme.

# HYRJJE



UNCDF/ADAMI ROGERS

## FUQIZIMI POLITIK I GRAVE: NJË DOMOSDOSHMËRI DEMOKRATIKE

Zhvillimi dhe forcimi i qeverisjes demokratike kërkon krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi procesesh përfshirëse dhe reaguese politike dhe promovimin e fuqizimit të grave. Përfshirja e këndvështrimit të grave dhe pjesëmarrja e tyre në politikë janë parakushte për zhvillimin demokratik dhe kontribuojnë në një qeverisje të mirë.

Partitë politike janë institucionet më të rëndësishme që ndikojnë në pjesëmarrjen politike të grave. Në shumicën e vendeve ato janë të ngarkuara me rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve dhe vendosin se çfarë çështjesh do të përfshihen në agjendën politike. Mënyra se si marrin pjesë gratë në partitë politike – dhe se si partitë politike e nxisin dhe ushqejnë përfshirjen

e grave dhe i bëjnë pjesë të programit të tyre çështjet e barazisë gjinore – janë faktorë përcaktues kyç të fuqizimit politik të grave. Duke pasur parasysh këtë ndikim të madh që kanë partitë politike në fuqizimin politik të grave, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), organizatat ndërkombëtare dhe ato që ofrojnë ndihmë për zhvillim, e kanë rritur fokusin e tyre mbi rolin e partive politike.

Në nivel global, gratë vazhdojnë të jenë të shmangura nga strukturat e qeverisjes që përcaktojnë prioritetet politike dhe legjislative. Gratë zënë 19 për qind të vendeve në parlamentet e botës – një rritje nga 16 për qind në vitin 2005.<sup>1</sup> Për qindja e grave ministre është edhe më e ulët, mesatarisht 16 për qind.<sup>2</sup> Më tej, për qindja e grave si kryetare shteti dhe qeverie është edhe më e ulët se dy shifrat e para dhe ka pësuar rënie vitet e fundit – në vitin 2011 kjo shifër ishte më pak se 5 për qind.<sup>3</sup>

Numri vazhdon të mbetet i ulët, me gjithë tre dhjetëvjeçarë ushtrimi ndikimi dhe përpjekjesh nga bashkësia ndërkombëtare për të eliminuar diskriminimin dhe për të fuqizuar gratë. Në vitin 2000 Kombet e Bashkuara njohën rolin qendror të grave në zhvillim duke e përfshirë fuqizimin e grave si një prej Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, megjithatë asnjë rajon në botë nuk është në rrugën e duhur për të arritur objektivin prej 30 për qind të grave në pozita vendimmarrëse. Megjithëse shihen qartë disa përjashtime të rëndësishme dhe praktika të mira në këtë fushë, ende ka disa pengesa ndaj pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave si konkurrencte.

Në të gjitha vendet e botës mbizotërojnë stereotipizime, ndonëse në shkallë të ndryshme, i roleve dhe paragjykimeve gjinore, të cilat pasqyrohen në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike. Në shumë vende gratë vazhdojnë të

dekurajohen të hyjnë në garë të drejtpërdrejtë me burrat, apo që të dalin dhe ndërveprojnë publikisht; në vend të kësaj atyre u jepen role që i largojnë nga vendim-marrja dhe i çojnë drejt roleve mbështetëse, si kujdesi ndaj fëmijëve e familjes, apo në përgjithësi menaxhimi i familjes në sferën private. Ndonëse mbështetja zyrtare e partive politike nuk është kurrësi faktori i vetëm që ndikon në pjesëmarrjen e grave në politikë, duke marrë parasysh këto role dhe paragjykime të shumëfishta dhe shumë-shtresore gjinore, një mbështetje e tillë është e nevojshme për të kapërcyer pengesat që i vihen pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në jetën politike partiake.

Studimet tregojnë se numri i grave në parlament ka rëndësi; më e pakta, sa më shumë gra të ketë në parlament aq më shumë mundësi ka që parlamenti të trajtojë çështje të grave dhe të ndryshojë dinamikën gjinore në sallë.<sup>4</sup> Për qindja e grave deputete në parlament ka ndikim të madh në natyrën e debatit që zhvillohet në politikë. Duke pasur parasysh nivelin e ulët të pranisë së grave në parlamente dhe organe të tjera vendimmarrëse, partitë duhet të jenë pro-aktive që të garantojnë trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore.

Partitë kanë ndikim në përcaktimin se cilat çështje duhet të bëhen pjesë e debatit publik: ato formulojnë politika, vendosin përparësi të qeverisjes dhe, si rrjedhim, janë në një pozitë të favorshme strategjike për të trajtuar çështjet që i shqetësojnë gratë. Në praktikë, partitë politike kanë pasur nivele të ndryshme arritjesh në trajtimin e çështjeve gjinore në qeverisje dhe në proceset zgjedhore. Proceset që ekzistojnë nuk janë të kodifikuara dhe dokumentuara mirë. Synimi i këtij udhëzuesi është pikërisht që të mbushë këtë boshllëk.

**PËRQINDJA E GRAVE DEPUTETE NË PARLAMENT**

**KA NJË NDIKIM TË MADH NË NATYRËN E DEBATIT QË ZHVILLOHET NË POLITIKË.**



## QËLLIMI

Pjesa A – Përmbledhje e Praktikave të Mira – identifikon pikat kryesore hyrëse dhe veprimet specifike që mund të ndërmerren për të promovuar një prani dhe ndikim më të fuqishëm të grave në partitë politike. Përmbledhja e Praktikave të Mira ofron disa parime të përgjithshme dhe përshkruan praktikatat e mira që mund t'i ndihmojnë palët e interesuara të hartojnë dhe zbatojnë projekte. Ajo nuk jep një formulë të caktuar të vetme, por ofron alternativa për reforma që rrjedhin nga strategji të zbatuara nga parti politike në të gjithë botën. Pjesa B – Rastet Studimore – ofron shembuj të thelluar dhe të detajuar të veprimeve të caktuara të ndërmarra nga partitë apo organizatat në disa vende të caktuara.

Pikat kryesore hyrëse dhe rastet studimore të identifikuar kanë si qëllim kryesor t'u ofrojnë udhëzime partive politike si dhe të ofrojnë ide për veprim dhe t'u japin informacion drejtuesve të programeve në organizatat që ofrojnë asistencë për zhvillim, fondacioneve partiake, dhe OSHC-ve në punën e tyre për mbështetjen e partive politike. Secili rast studimi synon të japë mësimet që nxirren apo praktikatat e mira që mund t'i ndihmojnë partitë politike dhe organizatat që u ofrojnë asistencë partive politike të zhvillojnë dhe të çojnë përpara strategjitë e reformës.

Udhëzuesi shtjellon në imtësi se pse janë të rëndësishme ndërhyrjet e mundshme, por nuk jep domosdoshmërisht receta se si duhen zbatuar këto ndërhyrje. Duke marrë parasysh lexuesit dhe përdoruesit e shumtë të këtij Udhëzuesi, vendimet se si duhen vënë në jetë strategjitë është më mirë t'u lihen palëve përkatëse. Mbështetja për programet që ofrohet nga një agjenci ndërkombëtare e asistencës për zhvillim është shumë më e ndryshme nga veprimet që mund të zbatohen nga një fondacion partiak, apo nga vetë partia politike drejtpërsëdrejti.

Rrjedhimisht, ky Udhëzues ka si qëllim të jetë një burim për t'u përdorur në mënyrë të barabartë nga të gjitha palët e interesuara në procesin zgjedhor, dhe përmendja specifike e individëve, partive apo organizatave nuk tregon ndonjë



miratim të veçantë të tyre nga autorët, PNUD-i apo NDI-ja, por janë vetëm një evidentim shembujsh të strategjive për të cilat janë informuar dhe kanë dijeni studiuesit.

## METODOLOGJIA

Strategjitë e paraqitura në Pjesën A janë nxjerrë kryesisht nga një grup 20 rastesh studimore që u porositën nga PNUD-i dhe u kryen nga NDI-ja gjatë viteve 2009–2010. Rastet studimore paraqiten në renditje alfabetike në Pjesën B të këtij Udhëzuesi. Ka edhe shumë shembuj të tjerë që mund të ishin përfshirë. Megjithatë, ky Udhëzues nuk ka si qëllim t'i paraqesë ato të gjitha në mënyrë shteruese. Në vend të kësaj, Udhëzuesi e kufizon sferën e tij duke paraqitur praktikatat kyçe të nxjerra nga rastet studimore të porositura nga PNUD-i dhe të kryera nga NDI-ja. Në një numër të vogël rastesh, paraqiten disa shembuj jashtë sferës së atij studimi, për të ilustruar një çështje të caktuar.

Studimi parësor i kryer nga NDI-ja kombinoi hulumtimet e literaturës me një numër të përgjithshëm prej 64 intervistash të detajuara me udhëheqës të tanishëm dhe të mëparshëm partish politike, anëtare të partive, dhe pjesëtarë e pjesëtarë të shoqërisë civile, gjatë një periudhe prej 18 muajsh në vitet 2009 dhe 2010. Personat e intervistuar ishin nga të gjitha rajonet dhe u përkisnin

partive politike me tendenca të ndryshme ideologjike dhe nga kontekste të ndryshme, si nga vende të sapo dala nga konflikti, vende në zhvillim dhe vende të zhvilluara. Ka gjithashtu një numër të vogël shembujsh të marrë nga nismat e shoqërisë civile që fokusohen tek reformat e partive politike.

Qëllimi i studimit të rasteve studimore nuk ishte thjesht të merrte në shqyrtim nisma të ndërmarra nga të gjitha partitë politike në secilin vend, por për të shqyrtuar dhe ofruar një shumëllojshmëri shembujsh për veprime, si pjesë e një tabloje të përgjithshme të mbështetjes për pjesëmarrjen e grave në politikë. U bënë të gjitha përpjekjet për të përfshirë shembuj të ndryshëm për sa i përket gjeografisë, ideologjisë partiake, llojit të sistemit politik dhe strategjive të zbatuara, megjithatë, disa parti kishin boshllëqe në dokumentimin e përpjekjeve të tyre për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave dhe të barazisë gjinore. Ndërsa shembujt e partive të qendrës dhe qendrës së majtë janë më të shumta se ato të partive të qendrës së djathtë, në këtë vëllim përfshihen gjithashtu edhe shembuj të masave pro-aktive të ndërmarra nga parti të krahut të djathtë.

## STRUKTURA

Pjesa e A e këtij Udhëzuesi sintetizon dhe paraqet gjetje të rëndësishme bazuar në rastet studimore të përfshira (dhe të renditura në rend alfabetik) në Pjesën B. Gjetjet dhe përfundimet e nxjerra në Pjesën A paraqiten sipas një kornize të ciklit zgjedhor dhe nuk pretendojnë të ofrojnë një listë shteruese të veprimeve që mund të ndërmerren nga partitë politike. Këto gjetje janë grupuar së bashku me veprime specifike, duke përdorur si kriter fazat dhe etapat kohore të ciklit zgjedhor. Në secilën nga këto faza, ofrohet një tablo e përgjithshme e dhe paraqiten disa pika kryesore strategjike që mund t'i zbatohen partitë politike për të promovuar fuqizimin e grave. Katër komponentët kryesore, bazuar në ciklin zgjedhor, janë si më poshtë:

### I. Strategjitë për

#### ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË PARTISË

### II. Pikat kryesore hyrëse në

#### PERIUdhËN PARA-ZGJEDHORE

### III. Pikat kryesore hyrëse në

#### PERIUdhËN ZGJEDHORE

### IV. Pikat kryesore hyrëse në

#### PERIUdhËN PAS-ZGJEDHORE

FAZAT E CIKLIT ZGJEDHOR

Qasja e ciklit zgjedhor ka dy elementë: ndarjen kohore dhe palët e përfshira në proces. Së pari, ajo i nxit organizatat që ofrojnë asistencë ndërkombëtare dhe palët e përfshira në proces në vendet përkatëse që të bëjnë planifikim afatgjatë dhe ta zbatojnë programin zgjedhor brenda kuadrit të qeverisjes demokratike. Së dyti, ajo i drejtohet disa aktorëve të përfshirë në proces, dhe jo vetëm personave që merren me menaxhimin e zgjedhjeve, në masën e mundshme dhe të dëshirueshme. Kjo qasje bazohet në idenë se mbështetja zgjedhore duhet të jetë afatgjatë dhe duhet të ketë si synim të trajtojë në një mënyrë të qëndrueshme çështje të tilla si zhvillimi i kapaciteteve dhe reforma institucionale e ligjore, me mendimin që, me kalimin e kohës, të zvogëlohet asistencja ndërkombëtare dhe të rritet kapaciteti dhe pronësia vendore mbi procesin. Ndarja e qasjes së ciklit zgjedhor në faza është e rëndësishme; duke punuar brenda një agjende më të gjerë të qeverisjes demokratike, ajo lejon një identifikim më të mirë të nevojave dhe planifikim paraprak, dhe jo përqendrim të përpjekjeve vetëm rreth ngjarjes zgjedhore.<sup>5</sup>

Qasja ciklike është jashtëzakonisht e dobishme kur identifikohen strategjitë për partitë politike dhe fuqizimin e grave. Deri më sot, pjesa më e madhe e mbështetjes në këtë fushë është përqendruar në fazën para-zgjedhore deri në ngjarjen zgjedhore, d.m.th. krijimi i kapaciteteve të grave kandidate, ndikimi dhe mbështetja për kuotat


zgjedhore, mbështetja për fushatën dhe zhvillimin e mesazheve.

Këto ndërhyrje janë të rëndësishme dhe duhet të vazhdojnë, por qasja e ciklit zgjedhor kërkon që ndërhyrjet afatshkurtra të jenë vetëm një pjesë e një qasjeje më të gjerë të programimit. Ajo kërkon një përqendrim më të madh në periudhën pas-zgjedhore (faza më e gjatë në ciklin zgjedhor) dhe në mundësitë e zbatimit të reformave dhe zhvillimit të kapaciteteve ndërmjet zgjedhjeve. Faza ku gjendet një vend në ciklin zgjedhor ka gjithashtu ndikim të rëndësishëm mbi llojet e ndërhyrjeve që janë më të përshtatshme në atë fazë të caktuar.

Koha është një faktor shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh. Për shembull, nëse procesi i përzgjedhjes

së kandidatëve për zgjedhje kalon pa asnjë lloj mbikëqyrjeje dhe numri i grave të caktuara si kandidatë është i vogël, atëherë sigurisht që objektivat numerike nuk do të arrihen kur të vijnë zgjedhjet. Po kështu, partitë politike mund të mos jenë të gatshme të ndërmarrin reforma për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve gjatë vitit kur bëhen zgjedhjet, dhe nxitja e reformave të tilla mund të ketë më shumë sukses nëse kryhet ndërmjet zgjedhjeve. Strategjitë duhet të përfitojnë nga qasje, bashkërendime dhe ndarje më sistematike në faza. Periudhat para dhe pas zgjedhore janë të rëndësishme për zbatimin e reformave jashtë fazës së mobilizimit për vetë zgjedhjet. Për të qenë më të suksesshme, tërheqja e kandidatëve të mundshme dhe mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve të tyre duhet të bëhen gjatë të gjitha periudhave të ciklit zgjedhor.

FIGURA 2: CIKLI ZGJEDHOR<sup>6</sup>



## PËRFITIMET PËR PARTITË

Megjithëse lidhja shkakore midis promovimit të pjesëmarrjes së grave dhe suksesit zgjedhor të partisë nuk është e dokumentuar mirë, konstatimet dhe përfundimet e nxjerra nga rastet studimore sugjerojnë se partitë kanë arritur ta rrisin bazën e simpatizantëve të tyre dhe kanë pasur përfitime zgjedhore kur kanë zbatuar reforma për promovimin e fuqizimit të grave.

Partitë politike që zbatojnë reforma të tilla mund të kenë shumë rrjedhoja pozitive, si:

- Mund të ndryshojnë perceptimet publike dhe mund të ringjallet interesi tek partitë politike mbështetja për të cilat ka qenë në rënie.

- Ndërmarrja e nismave për fuqizimin e grave mund të krijojë baza të reja mbështetjeje për partinë dhe të tërheqë anëtarë të rinj në parti.

- Rritja e numrit të grave kandidate për poste të zgjedhura mund të shtojë sasinë e fondeve publike që merr partia. Nëse elementët nxitës të ligjeve të financimit publik i lidhin akordimet e fondeve për partitë me numrin e grave të paraqitura si kandidate prej tyre, atëherë partitë politike mund të përfitojnë nga ana financiare. Këto reforma mund të tërheqin gjithashtu edhe mbështetjen e partive simotra, internacionaleve të partive dhe bashkësisë

ndërkombëtare për zbatimin e nismave të reja, si programe trajnimi dhe këshillimi.

- Gratë kandidate ka më shumë gjasa të vijnë nga shoqëria civile se sa burrat dhe, si rrjedhim, të kenë partneritete më të fuqishme me OSHC-të. Këto lidhje mund t'u sjellin përfitime kandidateve, por mund të kenë ndikim pozitiv edhe tek partia për të cilën kjo kandidate bën fushatë, përmes krijimit të marrëdhënieve me bazën dhe zonat zgjedhore.

- Në fund, krijimi dhe zbatimi i strategjive për promovimin e fuqizimit të grave mund sjellë si rezultat parti politike më demokratike dhe transparente. Strategji të tilla mund të çojnë gjithashtu në përfshirjen e grupeve të tjera të marginalizuara dhe të nën-përfaqësuar.

Ky Udhëzues është përpjekur të eksplorojë një gamë të gjerë dhe të ndryshme strategjish që po zbatohen për të mbështetur fuqizimin e grave. Megjithatë, ai e pranon se ka edhe praktika novatore të tjera që po eksperimentohen dhe testohen nga parti politike reformiste. Ai e pranon gjithashtu se ajo që vepron me sukses për një parti politike apo organizatë, mund të mos ketë sukses për një tjetër. Kur projektohen strategjitë duhen konsideruar kontekstet kombëtare, përfshirë edhe natyrën e sistemeve partiake, sistemin zgjedhor që përdoret, dhe konsiderata të tjera shoqëro-kulturore. Pjesa B jep më shumë hollësi të tilla që lidhen me secilin rast studimi.

**NDËRMARRJA E NISMAVE PËR FUQIZIMIN E GRAVE**

**MUND TË KRIJOJË BAZA TË REJA MBËSHTETJEJE PËR PARTINË**

**DHE TË TËRHEQË ANËTARË TË RINJ NË PARTI.**

# PJESA A: PËRMBLEDHJE E PRAKTIKAVE TË MIRA



PNUD



# I ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PARTISË



UNCDF/ADAMI ROGERS

## KRIJIMI I THEMELEVE ORGANIZATIVE PËR BARAZINË GJINORE

### ÇËSHTJE KYÇE

Mënyra se si veprojnë dhe funksionojnë partitë politike përcaktohet nga rregullat e jashtme dhe normat, proceset dhe kultura e brendshme. Rregullat e jashtme përfshijnë kushtetutën dhe ligjet që lidhen me sistemin zgjedhor, financimin e partive dhe organizimin e partive. Proceset e brendshme varen nga bazat ideologjike të partisë, ndikimet historike, nivelet e rregullave dhe burokracisë së brendshme, niveli i patronazhit, shkalla e ndikimit të udhëheqësve të partisë dhe niveli i decentralizimit. Shkalla e demokracisë së brendshme të partisë përcaktohet nëpërmjet praktikave të tilla si proceset e brendshme të informimit dhe konsultimit, rregullat dhe strukturat (zyrtare

**ZBATIMI I STRATEGJIVE PËR TË PROMOVUAR FUQIZIMIN E GRAVE SHPESH ÇON NË MË SHUMË DEMOKRACI DHE TRANSPARENCË TË BRENDSHME NË PARTITË POLITIKE.**

ose jo zyrtare) e brendshme për organizimin dhe vendimmarrjen brenda partisë, si dhe transparenca e funksionimit të partisë në të gjitha nivelet.<sup>7</sup> Për sa i përket organizimit të partisë, një faktor tjetër që merret parasysh është edhe masa në të cilën partia përfshin grupe të ndryshme shoqërore, veçanërisht për sa i përket rekrutimit të kandidatëve, si afrohet partia tek gratë dhe si i përfshin ato në organizimin e saj të brendshëm.

Gratë mbajnë vetëm një numër të kufizuar postesh udhëheqëse dhe vendimmarrëse në partitë politike, ndërkohë që përgjithësisht mbizotërojnë në poste dhe veprimtari mbështetëse të partive politike në nivelin e bazës ose në mbështetje të udhëheqjes mashkullore partiake. Shpesh postet me pushtet në partitë politike mund të jenë informale, të centralizuara dhe të mbështetura nga marrëdhënie dhe rrjete ndikimi tashmë të kristalizuara, ku personat e rinj dhe të sapoardhur, sidomos gratë, e kanë vështirë të depërtojnë. Duke mos pasur qasje në njohuritë dhe kujtesën institucionale që qëndron në themel të rrjeteve të tilla dhe duke pasur burime shumë të kufizuara, me një numër të vogël shembujsh për t'u ndjekur dhe personash nga të kërkojnë këshilla - ndonjëherë madje edhe pa mbështetje të

mjaftueshme nga familja dhe komuniteti, është e kuptueshme se pjesëmarrja e grave në partitë politike ka mbetur shumë më e ulët se ajo e burrave.

Zbatimi i strategjive për të promovuar fuqizimin e grave në partitë politike mund të çojë në më shumë demokraci dhe transparencë të brendshme. Duke zhvilluar strategji për përfshirjen e grave, pjesëmarrja e anëtarëve të partisë në vendimmarrje mund të bëhet më e institucionalizuar, si për shembull nëpërmjet zgjedhjeve për poste udhëheqëse ose rekrutimit të kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme. Shumë parti punojnë gjithashtu aktivisht për të rritur rolin e grupeve të tjera të marginalizuara dhe të nën-përfaqësuar.<sup>8</sup>

Strategjitë për rritjen e pjesëmarrjes së grave që zbatohen nga partitë mund të shkojnë që nga reforma ligjore, si miratimi me ligj i kuotave të kandidatëve, deri në reformat e brendshme vullnetare, si për shembull institucionalizimi i forumit të grave si pjesë e strukturës së partisë ose garantimi i pranisë së grave në strukturat vendimmarrëse.

Strategjitë më kuptimplota kombinojnë reforma të institucioneve politike me përfshirjen e dispozitave me një mbështetje të posaçme për aktivistet, kandidatet dhe



UNCDF/ADAM ROGERS

**SHPESH POSTET ME PUSHTET NË PARTITË POLITIKE MUND TË JENË INFORMALE, TË CENTRALIZUARA DHE TË MBËSHTETURA NGA MARRËDHËNIE DHE RRJETE NDIKIMI TASHMË TË KRISTALIZUARA, KU PERSONAT E RINJ DHE TË SAPOARDHUR, SIDOMOS GRATË, E KANË VËSHTIRË TË DEPËRTOJNË.**



funksionaret e zgjedhura partiake. Megjithatë, për të qenë efikase, strategjitë kërkojnë bashkëpunimin e një grupi të gjerë aktorësh dhe partish politike nga i gjithë spektri politik. Ky seksion trajton strategjitë që mund të zbatohen në partitë politike për të përfshirë gratë dhe për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore në funksionimin e brendshëm.

## STRATEGJITË E PËRDORURA

Strategjitë e mëposhtme – që dalin nga mësimet e nxjerra dhe shembujt e praktikës së mirë në rastet studimore (për më shumë hollësi shihni Pjesën B) si dhe studime të tjera – synojnë kryesisht që t’u japin udhëzime partive politike për veprimet që mund të ndër marrin për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore në organizimin e brendshëm të partisë. Këto strategji ofrojnë gjithashtu ide për veprim dhe mund t’u japin informacione të rëndësishme për programet e tyre organizative që ofrojnë asistencë për zhvillim, bazave të partisë, dhe OSHC-ve, në punën e tyre për mbështetjen e partive politike.

### (a) Trajtimi i barazisë gjinore në rregulloret e brendshme të partive

Funksionimi dhe veprimtaritë e brendshme të partive politike rregullohen nga rregulla ligjore, si kushtetuta ose ligji për partitë politike, dhe – çka është edhe më e zakonshme – nga rregullat e brendshme të partisë. Funksionimi i brendshëm i partive politike ndikon tek mënyra se si përfaqësohen në parlament nevojat, interesat dhe kërkesat e ndryshme shoqërore të shoqërisë.<sup>9</sup> Ashtu si kushtetutat dhe kornizat ligjore kombëtare, dokumentet dhe deklaratat zyrtare të një partie politike janë të rëndësishme për të ofruar një kuadër të barazisë gjinore – ato i japin partisë një vizion dhe ngulisin rregullat për arritjen e këtij vizioni.

Miratimi i një deklarate për barazinë gjinore në dokumentet themeluese të partisë është një hap i parë i rëndësishëm që shërben si bazë për ta bërë partinë politike më përfshirëse dhe reaguese. Disa parti politike përfshijnë dispozita të barazisë në deklaratat e vizionit të tyre dhe

### RREGULLA 6 E STATUTIT TË KONGRESIT KOMBËTAR AFRIKAN (AFRIKA E JUGUT) THOTË SE:

Me synimin për një përfaqësim të plotë të grave në strukturat vendimmarrëse, partia do të zbatojë një program të trajtimit me përparësi, përfshirë kuota për jo më pak se 50 për qind gra, në të gjitha strukturat e zgjedhura.

rregulloret e partisë. Për shembull, në **SALVADOR**, deklarata për misionin dhe kodi etik i Frontit Farabundo Marti për Çlirim Kombëtar (FMÇK) përfshijnë edhe një dispozitë për barazinë politike të grave. Paralel me trajtimin e barazisë gjinore në statutet dhe rregulloret e saj, Partia e Veprimit Qytetar (PVQ) në **KOSTA RIKA**, ka ngritur gjithashtu një Zyrë të Prokurorit për Barazinë Gjinore, së cilës i është dhënë mandati të monitorojë, raportojë dhe këshillojë në lidhje me mënyrën e zbatimit të rregullave.<sup>10</sup>

### (b) Miratimi i masave për pjesëmarrjen e grave në strukturat vendimmarrëse

Përveç përfshirjes së një deklarate zyrtare për barazinë gjinore, i rëndësishëm është edhe miratimi i masave për të garantuar pjesëmarrjen e grave në organet drejtuese dhe strukturat vendimmarrëse të partisë. Niveli i përfaqësimit të grave në struktura të tilla jep një tablo të shkallës së përkushtimit të partisë politike ndaj barazisë gjinore. Në shkallë globale gratë kanë nivel të ulët përfaqësimi në poste udhëheqëse brenda partive politike, megjithëse ato zakonisht përbëjnë midis 40 dhe 50 për qind të anëtarëve të partisë. Përqindja e grave në postet udhëheqëse të partisë llogaritet të jetë në rreth 10 për qind, megjithëse ky numër është më i lartë në ato parti që kanë miratuar rregulla që garantojnë pjesëmarrjen e grave brenda strukturave të brendshme vendimmarrëse.<sup>11</sup> Pjesëmarrja



PNUD/ALMAN SAEED

e grave në organet drejtuese është e rëndësishme për disa arsye, veçanërisht për të garantuar që perspektivat e grave të kontribuojnë në krijimin e politikave, prioritetëve, strategjive dhe platformave të partisë.

Po bëhet gjithnjë e më e zakonshme që partitë të miratojnë masa të tilla. Ja disa shembuj:

■ Partia Laburiste e **AUSTRALISË** dhe Partia Sam Rainsy e **KAMBOXHIAS** kanë miratuar kuota të brendshme që garantojnë pjesëmarrjen e grave në disa ose të gjitha organet e tyre drejtuese.

■ **MAROK:** Bashkimi Socialist i Forcave Popullore (USFP) ka kuota të brendshme për secilën degë vendore, gjë që ka ndihmuar për të nxitur përfshirjen e grave në të gjitha nivelet e partisë.

■ **MEKSIKË:** Partia e Revolucionit Demokratik (PRD) ishte një nga partitë e para që miratoi një kuota prej 20 për qind në vitin 1990, që më vonë u ngrit në 30 për qind. Partia e Veprimit Kombëtar (PVN) e ndoqi shembullin e saj duke miratuar një kuota të brendshme partiake për të garantuar

përfaqësimin e grave në komitetin ekzekutiv dhe në organet drejtuese.

■ **INDI:** Komiteti ekzekutiv kombëtar i Partisë Bhatariya Janata (BJP) e ndryshoi statutin e saj në vitin 2008 për t'i rezervuar grave 33 për qind të posteve drejtuese të partisë, si dhe për ta bërë kryetaren e degës kombëtare të grave anëtare të komitetit qendror zgjedhor të partisë.

■ **GJERMANI:** Bashkimi Kristian Demokrat (CDU) miratoi një kuota prej 33 për qind për funksionarët e partisë në vitin 1996. Nëse kuota nuk plotësohet, zgjedhjet e brendshme duhet të përsëriten.<sup>12</sup>

■ **AFRIKA E JUGUT:** Rregulli 6 i Statutit të Kongresit Kombëtar Afrikan (ANC)<sup>13</sup> thotë se, me synimin për një përfaqësim të plotë të grave në strukturat vendimmarrëse partia do të zbatojë një program të trajtimit me përparësi, përfshirë kuota jo më pak se 50 për qind gra në të gjitha strukturat e zgjedhura.



Përveç posteve drejtuese, partitë politike mund të marrin masa që gratë të caktohen në komitete të rëndësishme partiake, task-forca dhe grupe pune. Në disa raste, kryetarja e forumit të grave të partisë bëhet anëtare e komitetit ekzekutiv apo strukturave të tjera që merren me burimet financiare të partisë, përgatitjen e zgjedhjeve dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

Garantimi i pjesëmarrjes së grave në strukturat e brendshme është kyç për të çuar përpara barazinë gjinore në partitë politike. Megjithatë, është e rëndësishme që masave të tilla si kuotat, t'u shtohen edhe nisma të tjera, përfshirë masa më afatgjata për ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive, për të siguruar që gratë të jenë në gjendje të marrin poste udhëheqëse partiake edhe në mungesë të mekanizmave të kuotave. Partitë politike duhet të shqyrtojnë edhe procese të tjera për të përfshirë gra të kualifikuara dhe të motivuara në poste udhëheqëse dhe për t'i ndërgjegjësuar anëtarët e partisë për rëndësinë e krijimit të një hapësire mbështetëse për gratë si në bazën e partisë, ashtu edhe në instancat drejtuese dhe në strukturat e saj të brendshme.<sup>14</sup>

### (c) Vendosja e objektivave për pjesëmarrje në konferencat dhe kongreset e partisë

Në shumë parti politike, kongreset vjetore të tyre janë vendi ku vendoset për politikën dhe merren vendime të rëndësishme partiake. Pothuaj në të gjitha partitë politike, këto mbledhje të partisë ofrojnë mundësi që delegatët të ndërtojnë marrëdhënie politike dhe financiare që janë të nevojshme për karriera të suksesshme politike. Si rrjedhim, partitë politike mund të vendosin objektiva për të garantuar që një pjesë e caktuar e delegatëve pjesëmarrës të jenë gra. Për shembull, në **SHTETET E BASHKUARA**, Partia Demokratike ka miratuar rregulla për pjesëmarrjen e delegatëve gra në konventat kombëtare të partisë ku bëhet shpallja e kandidatëve. Si rezultat i ndikimit të brendshëm nga gratë anëtare të partisë dhe mbështetjes nga udhëheqësit partiakë, Statuti i Partisë kërkon që delegatët në konventën e partisë për shpalljen e kandidatëve, të përmbajnë numër të barabartë grash dhe burrash.

Përveç kësaj, praktika e mbledhjes së forumeve të veçanta për gratë në konventat partiake ofron mundësi të rëndësishme për krijimin e rrjeteve. Në **AUSTRALI**,

Organizata e Grave të Partisë Laboriste mban konferencën e vet çdo vit për t'u dhënë grave rastin që të diskutojnë politika, të ndikojnë për çështje të veçanta, dhe të krijojnë rrjete me njëra-tjetrën. Në **SALVADOR**, Sekretariati i Grave të FMÇK-së organizon një konferencë vjetore të udhëheqëseve gra të partisë, ku marrin pjesë funksionare partiake dhe qeveritare dhe anëtare të organit ekzekutiv të partisë, për të formuluar strategji dhe politika të barazisë gjinore. Është e rëndësishme që rezolutat e ndërmarra në këto forume të grave të miratohen zyrtarisht dhe të përdoren për të udhëhequr partinë në çështjet e politikave.

### (d) Krijimi i forumeve dhe seksioneve të grave brenda partive politike

Përvojat praktike dhe studimet tregojnë se krijimi i forumeve apo seksioneve të grave anëtare të partisë, ku ato të mblidhen, të diskutojnë dhe të rrahin mendime, të shprehin përparësitë e tyre, si dhe të kërkojnë zgjidhje për

#### FORUMET E GRAVE KRYEJNË ZAKONISHT DISA OSE TË GJITHA AKTIVITETET E MËPOSHTME:

- Kontribuojnë në hartimin e politikave, promovojnë interesat e grave në platformat politike dhe këshillojnë udhëheqjen partiake për çështjet gjinore;
- Kontribuojnë në zbatimin e politikave të barazisë gjinore dhe e monitorojnë atë, përfshirë edhe zbatimin e kuotave në procesin e rekrutimit të kandidatëve;
- Koordinojnë veprimtaritë e anëtarëve të partisë;
- Kryejnë funksionin e vendosjes së lidhjeve dhe mobilizimit, veçanërisht për të arritur tek votueset gra gjatë zgjedhjeve dhe për të zgjeruar bazën e partisë;
- Ofrojnë mbështetje dhe trajnim për deputetet e sapo-zgjedhura apo të sapo emëruara në poste të caktuara;
- Kontribuojnë për transformimin e marrëdhënieve të pushtetit brenda partisë dhe për të sensibilizuar e trajnuar anëtarët e partisë për barazinë gjinore;
- Kërkojnë bashkëpunimin e anëtarëve meshkuj të partisë.

probleme të zakonshme, mund të jetë i rëndësishëm për t'i vendosur shqetësimet e grave në rendin e ditës. Forumet e grave janë seksione të brendshme që synojnë të forcojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave brenda partisë, si dhe në procesin politik në përgjithësi.<sup>15</sup>

Është e rëndësishme që forumet e grave të jenë të integruara zyrtarisht në strukturën e partisë, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara dhe, po qe nevoja, edhe me fondet e duhura për të përballuar kostot organizative të tyre. Ka disa shembuj ku forumet e fuqishme të grave kanë qenë një mekanizëm i frytshëm për t'i bërë trysni partisë për miratimin e reformave dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në veprimtaritë e nivelit të lartë të partisë, miratimin e kuotave të brendshme, krijimin e programeve të trajnimit dhe ofrimin e mbështetjes për gratë kandidatë. Megjithatë, duhet bërë kujdes që çështjet gjinore të mos kthehen në çështje të mbyllura që trajtohen ekskluzivisht vetëm në forumin e gruas, si dhe që ky forum të mos kthehet në një instancë të izoluar dhe të mënjanuar në parti. Një mënyrë për ta parandaluar këtë do të ishte duke e bërë sekretaren apo kryetaren e forumit të grave anëtare me të drejtë vote në organin drejtues të partisë. Ja disa shembuj:

■ **AUSTRALI:** Rregulloerja e Partisë Laburiste specifikon rolin, përbërjen dhe kompetencat e Organizatës së Grave Laburiste, si në rang federal, ashtu edhe në degët e secilit shtet.<sup>16</sup>

■ **KAMBOXHIA:** Forumi i grave i Partisë Sam Rainsy (SRP) ka bërë përpjekje për t'i promovuar gratë brenda partisë, ka ndikuar për futjen e kuotave të brendshme në organet drejtuese, ka ofruar trajnime për gratë kandidatet, dhe ka kryer veprimtari edukimi qytetar dhe afrimi tek votuesit.

■ **MEKSIKË:** Partia e Veprimit Kombëtar (PVN) e transformoi forumin e saj të grave nga një organizatë shoqërore, në një bazë efektive për promovimin e posteve udhëheqëse për gratë. Për shembull, gjatë zgjedhjeve, Sekretariati Kombëtar për Promovimin Politik të Grave i PVN-së bëri lobing pranë

udhëheqësve vendorë dhe kombëtarë të partisë për të përfshirë më shumë gra si kandidatë në zgjedhje. Partia garanton gjithashtu që projekt-dokumentet për politikën e partisë t'i dërgohen Degës së Grave të partisë për t'u shqyrtuar nga këndvështrimi gjinor përpara se të finalizohen.

■ **MAROK:** Shumica e partive kryesore politike kanë krijuar seksionet e grave, ose struktura të brendshme të ngjashme që merren me çështjet e grave dhe nevojat e grave anëtare të partisë. Për shembull, Partia për Progres dhe Socializëm (PPS) ka krijuar një këshill të barazisë për të garantuar përfaqësimin e grave në proceset vendimmarrëse të partisë.

■ **SERBI:** Forumi i grave i G17 Plus njihet në rregullore si një strukturë zyrtare e partisë. Ai ka bërë avokaci për marrjen e masave për të promovuar gratë kandidatë në zgjedhje dhe ka bërë lobing pranë udhëheqësve të partisë për të garantuar që grave kandidatë t'u jepen vende në krye të listave. Përveç kësaj, forumi i grave ka kërkuar aktivisht fonde për trajnime dhe seminare për kandidatet dhe aktivistet dhe punon për të fuqizuar gratë që ato të ndikojnë tek politikën në nivel vendor.

### (e) Garantimi i këndvështrimit të barazisë gjinore në zhvillimin e politikave

Siç u përmend më lart, një nga funksionet e forumit të grave është që të punojë për hartimin dhe zhvillimin e politikave brenda partisë. Partitë politike duhet të garantojnë që politikën dhe përparësitë e tyre t'u përgjigjen nevojave të grave dhe burrave, jo vetëm për sa i përket reformave të politikave specifike gjinore, por edhe për të siguruar që gjinia të përfshihet në të gjitha politikën e partisë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një komiteti politikash që merret me çështjen e përfshirjes gjinore i cili shqyrton dhe jep mendim nëse politikën e përmbahen kërkesave së përfshirjes gjinore, ose nëpërmjet krijimit të kapaciteteve të anëtarëve dhe anëtareve të partisë. Kjo çështje diskutohet më tej në seksionin për Qeverisjen, nën nëntitullin Periudha Pas-Zgjedhore.

## II

PERIUDHA  
PARA-ZGJEDHORE


PNUD/CASSANDRA WALDON

REKRUTIMI DHE EMËRIMI I  
KANDIDATURAVE

## ÇËSHTJE KYÇE

Procesi i rekrutimit dhe i caktimit të kandidaturave është ndoshta problemi më i rëndësishëm që duhet të trajtojnë partitë politike nëse duan vërtetë të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë. Partitë janë hallka jetësore për arritjen e barazisë dhe pjesëmarrjen përfshirëse, po të kemi parasysh se ato kanë kontroll të fortë mbi caktimin e kandidatëve për postet e zgjedhura. Partitë politike ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra tjetra për sa i përket mënyrës se si i caktojnë kandidatët, numrit të grave të përzgjedhura, vendit ku renditen gratë në listat partiake, dhe numrit të grave që arrijnë të zgjidhen. Ato kanë dallime me njëra tjetrën edhe për sa i përket shtrirjes së pjesëmarrjes në to dhe shkallës së decentralizimit.

FIGURA 3: FAZAT E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE



Përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhje mund të kuptohet si një proces i ndarë në disa faza. Në përgjithësi, në çdo vend të dhënë ka një grup “kandidatësh që plotësojnë kriteret” (qytetarë që plotësojnë kërkesat ligjore dhe zyrtare që të bëhen legjislatorë), por vetëm një grup i vogël prej tyre do ta shqyrtonin mundësinë e paraqitjes si kandidatë të mundshëm – “aspiruesit”. Kur vlerëson mundësinë e vënies së kandidaturës dhe zhvillimit të fushatës për t’u zgjedhur, një aspirues duhet të marrë parasysh shumë faktorë, ndër të cilët një vlerësim të kohës që duhet, angazhimet financiare, shanset për fitore, ambiciet personale, mbështetja nga familja dhe komuniteti, dhe angazhimet e tjera, qasja në rrjetet politike dhe financuese, paga, statusi dhe pushteti politik.<sup>17</sup> Hendeku më i madh gjinor dhe rënia e numrit të grave ndodh pikërisht në fazat e kalimit nga kandidat që plotëson kriteret, në aspirues, dhe pastaj në kandidat i emëruar nga partia.

Faza kur drejtuesit e partisë caktojnë “aspiruesit” është më e rëndësishmja për t’i futur gratë si kandidate të

mundshme për t’u zgjedhur. Partitë përballen si me trysni të jashtme, ashtu edhe të brendshme, që ndikojnë në vendimet e tyre për caktimin e kandidatëve. Trysnitë e jashtme mbi partitë përfshijnë mënyrën se si do të perceptohen dhe vlerësohen ato nga votuesit, ndaj, për këtë arsye, ato mund të paraqesin kandidatë që besohet se do të marrin numrin maksimal të votave për partinë.<sup>18</sup> Ata kandidatë që “perceptohen” si dobësi e mundshme (shpesh gra) nuk caktohen si kandidate nga partia. Brenda partisë, faktorë të rëndësishëm që merren parasysh janë veprimtaria e një aspiruesi, aktivizimi në parti, dhe qasja në fonde. Kandidatët që janë tashmë të zgjedhur, ata që kanë bërë emër, ose ata që janë të dukshëm në komunitet për shkak të profesionit të tyre apo marrëdhënieve familjare, kanë gjithashtu mundësi më të mëdha për të marrë mbështetjen e partisë.<sup>19</sup>

Përzgjedhja e kandidatëve ndryshon nga partia në parti dhe mund të dallohen nga një numër karakteristikash, si për shembull, niveli i decentralizimit të procesit të përzgjedhjes. Rregullat dhe normat e partisë ndikojnë

në mënyrën se si e kryen faktikisht një parti procesin e caktimit të kandidaturave. Për gratë, sistemet burokratike me rregulla që garantojnë përfaqësimin e grave, janë një avantazh i konsiderueshëm. Kur rregullat janë të pashkruara, është shumë më e vështirë të hartohet dhe zbatohet një strategji për të depërtuar në rrethin e brendshëm të pushtetit, si dhe nuk mund të kërkohet llogari nëse rregullat nuk zbatohen. Kur organizimi i brendshëm është i dobët, kur ka mungesë demokracie të brendshme, apo rregulla të paqarta rekrutimi, vendimet zakonisht merren nga një numër i kufizuar anëtarësh elitare, që zakonisht janë burra. Gratë mbeten zakonisht jashtë këtyre strukturave dhe të përjashtuara nga “klubet vetëm për djem”. Sistemet e patronazhit janë përgjithësisht të mbyllura dhe nuk ka gjasa të promovojnë kandidaturat e grave.<sup>20</sup> Do të ishte ideale që proceset e caktimit të kandidatëve të jenë si të institucionalizuara, ashtu edhe transparente, që të mundësojnë një barazi dhe drejtësi më të madhe në përfaqësim.

Për shkak të pengesave që hasin gratë në procesin zgjedhor dhe vështirësive për t'u caktuar si kandidatë nga partia, partitë politike kanë propozuar - dhe në shumë raste kanë zbatuar - masa të posaçme. Këto masa mund të

jenë që nga përdorimi i elementëve nxitës për të tërhequr gratë në parti (si për shembull ofrimi i financimeve për të bërë fushatë), ofrimi i trajnimeve dhe zhvillimi i aftësive të grave kandidate, deri në vendosjen e objektivave brenda partisë që një numër i caktuar kandidatësh të jenë gra. Këto lloj masash mund të parashikohen edhe me ligj, por shpesh partitë politike i kanë miratuar vullnetarisht këto masa.

### KUOTA PËR KANDIDATURAT E GRAVE

Ndër strategjitë e ndryshme që eksplorohen në këtë Udhëzues, në të gjitha rastet e shqyrtuara vihet re përdorimi i ndonjë lloj forme të kuotës zgjedhore – qoftë kjo e miratuar vullnetarisht nga partitë politike, apo e sanksionuar në ligjin zgjedhor. Ky “emërues i përbashkët” nuk ishte diçka e qëllimshme, sepse synimi i këtij studimi ishte që të paraqiste masa të tjera të posaçme, përveç kuotave zgjedhore, për të ngërthyer shumëllojshmërinë e qasjeve të përdorura nga partitë në të gjithë botën për mbështetjen e grave. Megjithatë, është e qartë se masa e posaçme më e theksuar dhe më e përhapur në përdorim është kuota zgjedhore, qoftë e përdorur më vete, apo në lidhje me veprime të tjera. Në këtë mënyrë, shpeshësia e hasjes së kuotave në rastet e studimit tregon se kuotat vazhdojnë të jenë mjeti më vendimtar, më efikas, dhe më i parapëlqyer për të sjellë një numër më të madh grash në partitë politike dhe në politikë në përgjithësi.

Kuotat e kandidatëve për zgjedhje janë bërë një instrument i rëndësishëm politik për të shtuar qasjen e grave në organet vendimmarrëse. Kur zbatohen si duhet, ato sigurojnë vënien e grave në pozicione vendimmarrëse, në vend që kjo t'i lihet në dorë dashamirësisë dhe drejtësisë së udhëheqësve të partive politike, apo komiteteve për



PNUD/SALMAN SAEED

**KUR ORGANIZIMI I BRENDSHËM ËSHTË I DOBËT, KUR KA MUNGESË DEMOKRACIE TË BRENDSHME, APO RREGULLA TË PAQARTA REKRUTIMI, VENDIMET ZAKONISHT MERREN NGA NJË NUMËR I KUFIZUAR ANËTARËSH ELITARË, QË ZAKONISHT JANË BURRA.**

caktimin e kandidatëve. Zbatimi i kuotave ndikohet në masë të madhe nga udhëzimet dhe rekomandimet që japin organizatat ndërkombëtare. Siç parashtrohet edhe në Platformën e Pekinit për Veprim, kuotat janë një mjet për të garantuar që pjesëtarët e një grupi zgjedhor, siç janë gratë, të përfshihen në një nivel minimal të përcaktuar në institucionet përfaqësuese, qoftë si delegate, kandidatë, apo funksionare të zgjedhura.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se ligjet e kuotave shpesh janë të formuluar në mënyra neutrale gjinore, zakonisht duke dhënë një përqindje minimale të kërkuar për të dyja gjinitë. Megjithatë, për shkak se gratë janë gati pa përjashtim një gjini me nivel të ulët përfaqësimi, kuotave zgjedhore shpesh u referohen si kuotat e grave. Kjo nuk duhet marrë sikur nënkupton se kuotat zgjedhore janë vetëm në përfitim të grave, apo u japin grave një avantazh të padrejtë; përkundrazi, ato nënkuptohen si masa për të ndrequr mungesat e balancave në përfaqësim.

### Llojet e kuotave

Ka dy lloje kryesore kuotash zgjedhore, në varësi të asaj se ku përdoren në procesin zgjedhor: kuotat e kandidatëve dhe vendet e rezervuara.

#### KUOTAT E KANDIDATËVE MUND TË JENË:

- **Vullnetare:** Ato miratohen mbi bazë vullnetare nga partitë politike dhe duhet të pasqyrohen në rregullat e vënies së kandidaturës dhe/ose në statutet e partive.
- **Të sanksionuara në ligj:** Kushtetuta, kodi zgjedhor apo ligji për partitë politike vendosin shifra minimale të përfshirjes së grave si kandidatë zgjedhore.



PNUD/MARIE FRECHON

**Kuotat e kandidatëve** përpiqen të ndikojnë në furnizimin me kandidatë, duke garantuar që një përqindje e caktuar e kandidatëve të paraqitur për zgjedhje të jenë gra. Këto kuota mund të vendosen ose *me ligj*, ku ligji specifikon një përqindje minimale kandidatësh që duhet të jenë gra, ose mund të jenë *vullnetare*, ku një parti politike miraton vullnetarisht një objektiv të caktuar kandidatësh gra për konkurruar në zgjedhje.<sup>21</sup>

**Vendet e rezervuara** parashikojnë që një përqindje e caktuar e vendeve në një legjislaturë apo parlament duhet t'u jepet grave.

### Kuotat e kandidatëve

Sot në botë ka rreth 50 vende që kanë miratuar me ligj kuotat për gratë kandidatë, disa prej tyre po i zbatojnë kuotat e kandidatëve që nga fillimi i viteve 1990. Atje ku kuotat janë të miratuara me ligj, partive politike u është dashur zakonisht të përditësojnë procedurat e caktimit të kandidatëve në partinë e tyre, për të garantuar zbatimin e ligjit. Përveç kuotave të miratuara me ligj, qindra parti politike, në më shumë se 30 vende, kanë miratuar vullnetarisht politikatat e veta të kuotave për gratë. Në raste të tilla, partia vendos një numër apo përqindje të



kandidateve që mendon se duhet të jenë gra.<sup>22</sup>

Më poshtë vijojnë disa shembuj specifikë të partive që i kanë miratuar kuotat vullnetarisht, për të garantuar që gratë të përbëjnë një pjesë të kandidatëve në listat e partive:

■ **BURKINA FASO:** Partia e Kongresit për Demokraci (CDP) miratoi një kuotë të brendshme prej 25 për qind gra në listat e partisë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2007.

■ **LUKSEMBURG:** Partia Popullore Kristian Sociale (CSV) synon një objektiv prej 33 për qind kandidate gra në listat e partisë së tyre.<sup>23</sup>

■ **MAROK:** Bashkimi Socialist i Forcave Popullore (USFP) miratoi një kuotë prej 20 për qind për përfaqësimin e grave në listat zgjedhore të partisë.

■ **AFRIKA E JUGUT:** Procesi i Listës i Miratuar nga ANC-ja për Zgjedhjet Kombëtare të vitit 2003 vendosi një kuotë prej një të tretën për gratë në listat e partisë. Kjo kuotë u ngrit në 50 për qind kandidate gra në kohë për zgjedhjet e vitit 2009.

■ **SPANJË:** Partia Socialiste miratoi një politikë që 40 për qind e të gjithë kandidatëve në listat zgjedhore duhet të jenë gra.

■ **AUSTRALI, KANADA dhe MBRETËRI E BASHKUAR:** Partitë politike janë përpjekur të venë gra kandidate në zona të caktuara “të fitueshme” ose në vende “të sigurta”, si një masë për të rritur përqindjen e grave të zgjedhura.

## Zbatimi

Që kuotat të jenë efektive, është e rëndësishme të përmbushen dy kritere kyçe: kriteri i vendosjes dhe ai zbatimit. Sipas kriterit të parë, gratë do të përfitojnë nga kuotat vetëm nëse renditen në listat e partisë në vende që mund të fitohen, dhe nuk “zhyten” në fund të listës, ku mundësia për t’u zgjedhur është shumë e vogël. Së dyti, kuotat e kandidatëve të vendosura me ligj janë më efektive kur shoqërohen nga sanksione në rast moszbatimi të tyre. Një kuotë indikative, qoftë e vendosur vullnetarisht nga partia ose e miratuar me ligj, mund të caktojë një objektiv numerik të vështirë për t’u zbatuar, ose sepse ligji nuk e përcakton se si duhet arritur objektivi, ose sepse partitë politike nuk ia vënë veshin ngaqë nuk ka mekanizma që sigurojnë zbatimin e tij. Nga ana tjetër, kuotat e detyrueshme jo vetëm që vendosin një objektiv numerik, por edhe parashikojnë se si do të zbatohet ai, zakonisht nëpërmjet një mënyre të përcaktuar e të detyruar të renditjes së kandidatëve në lista. Ligji ose rregullat e partisë mund të përfshijnë masa që gratë të vendosen në pozicione “ku mund të fitojnë” në listat e partive, d.m.th. një grua në çdo dy apo tre vende në listë, dhe të parashikojë që listat zgjedhore të partive nuk do pranohen nga autoritetet zgjedhore apo komitetet për miratimin e kandidatëve deri sa të zbatohen këto kuota të përcaktuara.<sup>24</sup>

## STRATEGJITË E PËRDORURA

Strategjitë e mëposhtme – të nxjerra nga rastet studimore dhe hulumtime të tjera – kanë për qëllim t’u japin udhëzime partive politike për veprimet që mund të ndërmerren për të trajtuar problemin e pabarazisë gjinore në procesin e rekrutimit të kandidatëve. Përveç kësaj, këto strategji ofrojnë ide për veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat që ofrojnë asistencë për zhvillim, fondacionet e partive, dhe OSHC-të që punojnë me partitë politike dhe i mbështesin ato.

### (a) Galvanizimi i mbështetjes së partisë politike për kuotat e kandidatëve dhe institucionalizimi i tyre në statutet e partisë

Rregulloret dhe statutet e partive pasqyrojnë parimet dhe politikat zyrtare të një partie politike. Miratimi i parimeve

të barazisë gjinore në rregulloret dhe ligjet e partisë është i rëndësishëm për të shprehur vizionin e partisë dhe për të ndërmarrë politikën e nevojshme për arritjen e atij vizioni, si kuotat. Disa parti politike në **SALVADOR**, **INDI** dhe **MAROK** kanë përfshirë në vizionin dhe rregulloret e partisë, deklaratat dhe paragrafë që mbështesin barazinë gjinore dhe promovojnë pjesëmarrjen politike të grave.

### **(b) Krijimi i udhëzuesve për rekrutimin e kandidatëve për komitetet e miratimit të kandidatëve në parti**

Rregullat e rekrutimit të kandidatëve ndryshojnë nga partia në parti. Megjithatë, pavarësisht nga procesi, ekzistenca e udhëzimeve të qarta dhe transparente dhe që përfshijnë rregulla që garantojnë pjesëmarrjen e grave, përbën një avantazh të rëndësishëm. Kur rregullat nuk janë të shkruara dhe përzgjedhja e kandidatëve është në duart e një grupi të vogël udhëheqësish të partisë, gratë e kanë shumë të vështirë të konkurrojnë në kushte të barabarta me burrat, sepse ato zakonisht përjashtohen nga klubet “vetëm për djem”. Hapja e këtij procesi, me qëllim që të lejojë një pjesëmarrje më të madhe, mund të luftojë tendencën e drejtuesve të disa partive për t’i përzgjedhur vetë kandidatët e tyre sipas disa kriterëve të papërcaktuara. Rregulloret duhet të vendosin objektiva numerike të qarta për t’u arritur.

Për shembull, në Partinë Liberale të **KANADASË** u ngrit një komitet për rekrutimin e kandidatëve për të garantuar një shumëllojshmëri sa më të madhe në rekrutimin e kandidatëve si dhe zbatimin e rregullave për përfshirjen e grave kandidatë. Në **KROACI**, Partia Social Demokrate miratoi një kuotë vullnetare prej 40 për qind të “gjinisë së nën-përfaqësuar” për të gjitha listat e kandidatëve në zgjedhjet parlamentare dhe kuvendet vendore. Referenca ndaj “gjinisë së nën-përfaqësuar” kishte si qëllim të parandalonte kundërshtimet nga ata që mund të ishin të shqetësuar se një sistem me kuota ishte diskriminues dhe i referohej vetëm zgjedhjes së grave.

### **(c) Garantimi i zbatimit të kuotave dhe vendosja e grave në pozicione që mund të fitohen**

Kuotat më të efektshme për kandidatët janë ato që

përcaktojnë vendosjen e grave në pozicione apo zona zgjedhore “të sigurta” ose “të fitueshme”, si dhe parashikojnë mekanizma zbatimi për të garantuar zbatimin e tyre. Disa parti, jo vetëm që përcaktojnë përqindjen e kandidatëve që duhet të jenë gra, por përcaktojnë gjithashtu edhe se çfarë pozicioni duhet të kenë ato në listat e partisë. Për shembull, për disa vjet me radhë, Partia Social Demokrate në **SUEDI** përpilonte lista të ashtuquajtura “zebra” dhe “zinxhir”, ku burrat dhe gratë vihen “një po, një jo” në listat e kandidatëve. Partia e Betejës Demokratike e **INDONEZISË** (PDIP) u përpoq t’i vendosë gratë në krye të listave të tyre në disa zona, për të garantuar suksesin e tyre në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009. Në **KOSTA RIKË**, Partia e Unitetit Kristian-Social (PUSC) po ashtu hartoi lista kandidatësh të alternuara, një grua, një burrë.<sup>25</sup>

Mënyra më efektive për të zbatuar kuotat e kandidatëve është duke i dhënë kompetenca komitetit ekzekutiv dhe komitetit të përzgjedhjes së kandidatëve të partisë për të kundërshtuar çdo listë partiake ose proces të brendshëm rekrutimi që nuk zbaton rregullat e kuotave. Për shembull, zbatimi i kuotës prej 35 për qind për gratë në partinë FMÇK në **SALVADOR** garantohet nga Sekretariati i Grave. Në **KANADA** komiteti qendror i Partisë Liberale nuk e konfirmon listën e kandidatëve nëse një e treta e të caktuarve nuk janë gra, dhe madje mund të anulojë kandidatë të caktuar duke vendosur kandidatë të përzgjedhur prej tyre. Kuotat e Partisë Laburiste të



**AUSTRALISË** kërkojnë që të ketë 40 për qind kandidatë gra në “vende që mund të fitohen” në parlamentet shtetërore dhe federale; nëse listat e kandidatëve nuk përfshijnë një numër të mjaftueshëm grash, Komitetet Administrative Shtetërore dhe Federale mund të kërkojnë zhvillimin e proceseve të reja për caktimin e kandidaturave ose për para-zgjedhjen e kandidatëve.

Atje ku zbatohen kuotat e vendosura me ligj, një masë shtesë është garantimi që organi i menaxhimit zgjedhor (komisioni zgjedhor) të mbikëqyrë zbatimin e kuotave dhe të ketë fuqinë dhe mjetet për të garantuar zbatimin e ligjit në fuqi. Në disa vende në Amerikën Latine dhe rajone të tjera, organi i menaxhimit zgjedhor nuk pranon ta bëjë regjistrimin e listave të kandidatëve që paraqiten nga partitë deri sa listat të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit.

#### **(d) Puna me OSHC-të për të monitoruar zbatimin**

Përveç organeve të menaxhimit zgjedhor dhe komiteteve të brendshme partiake, OSHC-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në disa vende duke vëzhguar zbatimin e ligjeve të kuotave nga partitë politike. OSHC-të kanë luajtur rol vendimtar, duke u bërë trysni partive politike që të zbatojnë premtimet e bëra, si dhe duke kërkuar që udhëheqësit e partive të japin llogari. Për shembull, Forumi i Grave Drejtuese, një OSHC shumë-partiake në **ARMENI**, hartoi një strategji që kombinonte takimet private, negociatat me udhëheqjen partiake dhe veprimtaritë publike, si konferenca shtypi, për t’u bërë trysni partive që të mbanin premtimet e tyre për kuotat. Në **MEKSIKË**, anëtarët e partisë PVN përdorën aleanca strategjike me parti dhe OSHC të tjera për të nxitur zbatimin e kuotave gjinore.

#### **(e) Kultivimi i aleancave strategjike me burrat**

Në një numër vendesh meshkujt përkrahës të politikave të tilla si kuotat për kandidatët apo vendet e rezervuara, kanë luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e mbështetjes së brendshme partiake për këto politika. Nëse pjesëmarrja e grave duhet të kuptohet nga udhëheqja e partisë si një përfitim për të gjithë partinë, jo vetëm për gratë që janë anëtare të saj, atëherë është e rëndësishme që burrat

të përfshihen në promovimin e reformave. Në Partinë Laburiste në **AUSTRALI**, Partinë Liberale në **KANADA**, dhe Partinë Socialiste në **SPANJË**, gratë kanë punuar me udhëheqësit meshkuj të partisë që kanë promovuar reformat për kuotat. Në **MEKSIKË**, gratë anëtare të PVN-së punuan gjithashtu për të edukuar dhe ndikuar tek kolegët e tyre meshkuj që të mbështesin reformën e kuotave, si dhe për të siguruar mbështetjen e bazës së partisë. Kjo mbështetje ishte thelbësore për miratimin e ligjit në parlament. Qasja e dyfishtë e punës me gratë dhe burrat brenda partisë, së bashku me mbështetjen e OSHC-ve nga jashtë, mund të sjellë rezultate të mëdha.

#### **(f) Zgjerimi i grupit të grave kandidatë dhe ofrimi i trajnimeve për zhvillimin e aftësive**

Disa udhëheqës partish politike argumentojnë se nuk ka një numër grash kandidatë të gatshme dhe të trajnuara, me besimin dhe përvojën e duhur për të konkurruar në zgjedhje, gjë që lë të kuptohet se partia mund të mos e plotësojë numrin e përcaktuar nga kuota. Kjo mund të jetë veçanërisht e theksuar në vendet që sapo kanë dalë nga konflikti, ku prirja është që gratë të mbeten të mënjanuara nga proceset e tranzicionit nëse partitë politike nuk rekrutojnë aktivisht gra në radhët e tyre. Është e rëndësishme që, përveç zbatimit të kuotave të kandidatëve, të nxitin mekanizma të tjerë mbështetës për pjesëmarrjen politike të grave. Në ato vende ku nuk zbatohen kuotat, masa të tilla marrin edhe më shumë rëndësi.

Ndër strategjitë për zgjerimin e grupit të kandidatëve të mundshme dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre politike përfshihen trajnimi dhe mbështetja për veprimtari avokacie në **KAMBOXHIA**, ose këshilla dhe direktiva teknike për strategji avokacie në **MAROK**, ku një koalicion i OSHC-ve të grave dhe aktiviste partiake u mbështetën nga organizatat ndërkombëtare gjatë fushatës për promovimin e kuotave. Në **KANADA**, Partia Liberale emëroi një Drejtore të Kërkimit të Grave Kandidate për të ndihmuar në rekrutimin e grave në parti. Në **INDONEZI**, Departamenti i Fuqizimit të Grave i PDIP-së punon me krahun trajnues të partisë për të zhvilluar dhe

zbatuar një program trajnimi për gratë kandidatë, për të ngritur aftësitë e tyre politike. Partia e Republikës (PR) në **BRAZIL** organizoi një manifestim me autokolona për rritjen e vetëdijes gjinore në disa shtete, me synimin për të nxitur gratë të futen në parti dhe për të identifikuar gra me ndikim në nivelin vendor që mund të bëheshin kandidatë vendore. Grave të interesuara iu ofruan kurse trajnimi për doktrinën, objektivat dhe arritjet e partisë.<sup>26</sup>

Mund të jetë e dobishme që partitë politike të mbështesin një rrjet apo komunitet grash kandidatë që kanë konkurruar në zgjedhje, pavarësisht nëse kanë fituar ose jo. Partitë mund të kërkojnë mbështetjen e tyre për të forcuar lidhjet me zonat zgjedhore dhe për të nxitur gra të tjera për të vënë kandidaturën në të ardhmen. Në **GANA**, një grup politik synon të mbajë një bazë të dhënash të grave që kanë konkurruar në zgjedhje por nuk kanë fituar, për t'i mbajtur ato të angazhuara në veprimtari e poste partiake dhe për të nxitur interesin e tyre për të konkurruar përsëri në të ardhmen.<sup>27</sup>

### **(g) Nxitja e marrëdhënieve shumëpalëshe dhe shkëmbimi i përvojave**

Në shumë vende në tranzicion partitë politike i vlerësojnë marrëdhëniet strategjike me aktorë ndërkombëtarë. Disa

#### **POLITIKA E INTERNACIONALES SOCIALISTE PËR GRATË, 2010:**

Forumi i Grave i Internacionales Socialiste i nxit "partitë anëtare ... që të promovojnë masa për të arritur gradualisht një paritet (50/50) të grave dhe burrave në të gjitha organet vendimmarrëse, duke filluar me një kuotë minimale prej 30 për qind për gratë dhe burrat në të gjitha postet e zgjedhura dhe brenda udhëheqjes së partisë, por duke vendosur objektiva me afate të përcaktuara për të arritur sa më shpejt që të jetë e mundur një përfaqësim 50/50, me synimin e përfshirjes së barabartë të pikëpamjeve të grave në politikë, në përpjekje për të arritur një zhvillim të drejtë, të qëndrueshëm dhe të balancuar shoqëror."<sup>28</sup>

parti i kthejnë sytë nga partitë evropiane-perëndimore dhe amerikano-veriore për të marrë përvojë, si dhe për t'u anëtarësuar në grupimet ndërkombëtare të partive politike (të ashtuquajturat internacionale të partive). Për shembull, miratimi i kuotave nga disa parti jep mesazhin se partia po ecën në drejtimin e duhur, duke u bërë më e hapur dhe përfshirëse. Partive që duan të futen në Internacionales Socialiste, për shembull, u kërkohet të miratojnë masa për promovimin e fuqizimit politik të grave.

## **FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE**

### **ÇËSHTJE KYÇE**

Një anketim me 300 deputetë parlamentarë, i kryer nga Bashkimi Ndër-Parlamentar (*Inter-Parliamentary Union -IPU*), tregoi se një nga faktorët më të rëndësishëm që i pengon gratë të hyjnë në politikë është mungesa e financimeve për të konkurruar në fushata zgjedhore.<sup>29</sup> Jo vetëm që gratë e kanë të vështirë të mbledhin fondet e nevojshme për të kryer fushata të kushtueshme, por ato shpesh marrin fare pak ose aspak asistencë financiare nga partitë e tyre politike. Në veçanti, dy janë fazat më kryesore në të cilat fondet ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek gratë kandidatë: (1) faza e emërimit si kandidatë dhe e rekrutimit nga partia, dhe (2) financimi i fushatës zgjedhore.

Vështirësi në financim kanë edhe burrat, por gratë shpesh përballen me sfida më të mëdha financiare për disa arsye. Në të gjithë botën statusi ekonomik i grave është në përgjithësi më i ulët se ai i burrave. Rolet e shoqërisht gjinor tradicionalisht i pozicionojnë burrat si "fitues të bukës" dhe, si rrjedhim, ata kanë më shumë përvoja për mbledhjen e parave për përdorim vetjak. Atje ku gratë tradicionalisht lihen të angazhohen vetëm në sferën private, ato zakonisht nuk janë të mësuar të mbledhin fonde për veten e tyre. Edhe kur e bëjnë këtë, shumë gra parapëlqejnë t'i shpenzojnë për nevojat e familjes së tyre.

### DY MËNYRA SE SI NDIKOJNË DREJTPËRSËDREJTI FONDET NË POLITIKË TEK GRATË KANDIDATE NË PROCESIN ZGJEDHOR:

(1) Për mbledhjen e fondeve për të siguruar caktimin si kandidatë dhe rekrutimin nga partia

(2) Për mbledhjen e fondeve të mjaftueshme për të financuar fushatën zgjedhore

Burrat janë në gjendje të bëjnë fushatë në mënyrë më efektive edhe jashtë strukturave të partisë, sepse kanë më shumë gjasa të jenë të lidhur me rrjete biznesi dhe profesionale, të cilat mund t'u ofrojnë burime dhe ekspertizë financiare. Ky argument i rrjeteve shtrihet edhe tek "klubet vetëm për djem" brenda partisë, meqë shumica e udhëheqjeve të partive sot vazhdojnë të dominohen nga burrat, ndërsa gratë shpesh përjashtohen nga rrethet e pushtetit.<sup>30</sup> Mungesa e grave në këto rrjete i pengon ato të mbledhin fonde të mjaftueshme për të bërë fushatë efektive, sidomos kur konkurrojnë kundër kandidatëve meshkuj që kanë kohë që merren me atë punë. Përjashtim nga ky rregull bëjnë shpesh bashkëshortet, vajzat dhe motrat e politikanëve të mirënjohur, të cilat në sajë të lidhjeve të tyre me ta, kanë qasje në burimet dhe njohjet familjare.<sup>31</sup>

Në shumë demokraci në zhvillim mungesa e fondeve për të paguar qoftë edhe depozita modeste për kandidatët, mund t'i përjashtojë gratë nga procesi zgjedhor. Mungesa e burimeve shpesh ndihet më shumë tek partitë e reja ose ato që nuk përfaqësohen në parlament, sepse ato zakonisht nuk plotësojnë kushtet për fonde publike. Në këto raste, grave kandidatë u duhet të financojnë vetë kostot e transportit dhe materialeve të fushatës, gjë që mund të jetë veçanërisht problematike në zonat rurale, ku kostoja e transportit për të shkuar tek votuesit është shumë e lartë.<sup>32</sup>

Niveli i fondeve të kërkuara gjatë një cikli zgjedhor ndryshon. Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen gratë në fillim është mbledhja e fondeve fillestare për të siguruar caktimin e tyre si kandidatë nga partia. Paratë

fillestare janë financimi i parë që kërkohet për të filluar një fushatë për kandidaturën, si për shembull për njohjen dhe krijimin e një reputacioni në publik, udhëtimet dhe organizimin e një ekipi për fushatën, dhe në fund për sigurimin e vendit në listën e kandidatëve të partisë. Shumica e parave fillestare të fushatës shpesh vijnë nga vetë kandidati/kandidatja dhe ky vetëfinancim shpesh përbën një pengesë e madhe, sidomos për gratë. Pas sigurimit të nominimit si kandidatë, mbështetja nga partia mund të rritet dhe shfaqja më e madhe në publik mund të sjellë burime financimi shtesë.<sup>33</sup>

## STRATEGJITË E PËRDORURA

Strategjitë e mëposhtme kanë si qëllim parësor t'i udhëzojnë partitë politike për veprimet që mund të ndërmarrin, sidomos për të zgjidhur vështirësitë që hasin gratë për mbledhjen e fondeve për fushatë. Përveç kësaj, këto strategji u ofrojnë edhe ide për veprime organizatave që ofrojnë asistencë për zhvillim, fondacioneve partiake dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e tyre për mbështetjen e partive politike.

### (a) Ngritja e rrjeteve për mbledhjen e fondeve

Rrjetet dhe organizatat e grave për mbledhjen e fondeve kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në kanalizimin e parave tek gratë kandidatë. Studime nga **AUSTRALIA, KANADAJA, KAMBOXHIA, MBRETËRIA E BASHKUAR,** dhe **SHTETET E BASHKUARA** tregojnë se grupet për



mblledhjen e fondeve kanë pasur shumë ndikim në mblledhjen dhe mobilizimin e fondeve për gratë. Këto rrjete për mblledhje fondesh ofrojnë financime të rëndësishme fillestare për gratë në fazat e para kur ato kërkojnë të venë kandidaturën në partinë e tyre. Përveç kësaj, ato janë burime vitale financimi aty ku nuk ka fonde publike dhe kandidatëve u duhet të mblledhin fonde private për të konkurruar në zgjedhje.

Të kuptuarit se grave u duhen fonde fillestare në procesin e fushatës për të fituar caktimin si kandidate nga partia frymëzoi themelimin e Listës EMILY në **SHTETET E BASHKUARA**. Lista EMILY (*Early Money Is Like Yeast* – Paratë fillestare janë si majaja) është një rrjet financimi që rrit mundësitë e grave demokrate dhe progresive për të pasur qasje në politikën amerikane. Duke qenë se gratë nuk po siguronin paratë e nevojshme fillestare për fushatat e tyre, që të konsideroheshin seriozisht si kandidate konkurruese përballë burrave, Lista EMILY u ka ofruar atyre qasje në fonde fillestare, sepse “paratë fillestare e bëjnë brumin (d.m.th. fondet për fushatën) të vijë”. Ky rrjet ka frymëzuar nisma të ngjashme në vende të tjera, si Lista e Dëshirave (*Wish List*) e Partisë Republikane. Këto rrjete mblledhin kontribute nga individët dhe ua shpërndajnë fondet kandidatëve të tyre të preferuar.

### (b) Krijimi i fondit të brendshëm të partisë për të mbështetur gratë kandidate

Disa parti politike kanë krijuar fonde të dedikuara për të ndihmuar gratë kandidate me kostot e fushatës. Në **KANADA**, Partia Liberale krijoi Fondin Judy LaMarsh, që është një mekanizëm partiak për mblledhjen dhe shpenzimin e parave për gratë kandidate, për t'i ndihmuar ato të zgjidhen në parlament. Partia Liberale ka kontroll të drejtpërdrejtë mbi mënyrën se si shpenzohen paratë dhe se cilat kandidate gra kanë përparësi në marrjen e fondeve. Fondi duhet të veprojë brenda rregullave për financimin e partive në Kanada dhe ai mblledh para kryesisht nëpërmjet aktiviteteve për mblledhjen e fondeve, dërgesave të drejtpërdrejta me postë, dhe Internetit. Ky fond ka kontribuar jashtëzakonisht në rritjen e numrit të grave të zgjedhura në grupin parlamentar të partisë.

### SUBVENCIONET PËR GRATË KANDIDATE MUND TË PËRFSHIJNË:

- Rimbursim të shpenzimeve të kujdesit për fëmijët
- Kostot e udhëtimit për fushatë
- Dhënie e një shume parash për të blerë rroba
- Mbulim të shpenzimeve të fushatës, si për shembull materialet e printuara

### (c) Dhënia e subvencioneve për gratë kandidate

Bërja e një fushate aktive kërkon një nivel financimi, kohë dhe fleksibilitet, dhe të paktë janë ata që mund ta përballojnë këtë, aq më pak gratë me familje. Në shumë familje gratë kanë përgjegjësitë kryesore si prindër, që shpesh janë shumë të vështira për t'u kombinuar me orët e gjata të fushatës. Në **KANADA**, Partia Liberale është përpjekur të gjejë zgjidhje për këto vështirësi, duke u ofruar subvencione grave kandidate për shpenzime që lidhen me fushatën. Një program asistence financiare në nivel kombëtar u mundëson grave kandidate dhe pakicave që të marrin rimbursime deri në 500 dollarë kanadezë për shpenzimet e kujdesit për fëmijët gjatë kohës kur kërkojnë të sigurojnë nominim, dhe 500 dollarë kanadezë për kostot e udhëtimit në zona gjeografikisht të mëdha.<sup>34</sup> Po kështu, një shumë tjetër shtesë prej 500 dollarësh kanadezë jepet për të mbuluar kostot e vënies së kandidaturës në zona zgjedhore ku deputeti aktual nuk ka ndërmend të vërë përsëri kandidaturën. Në **KAMBOXHIA**, Partia Sam Rainsy u jep grave kandidate disa sende bazë, si veshje të përshtatshme për të bërë fushatë dhe biçikleta për të udhëtuar. Një alternativë tjetër është që partitë politike t'u ofrojnë grave kandidate asistencë përmes kuotizacioneve të anëtarësisë dhe pagesat për vënien e kandidaturës, që për disa gra mund të përbëjnë vështirësi sepse janë të larta.

### (d) Kufizimi i kostos së vënies së kandidaturës dhe fushatës

Edhe atje ku gratë mund të mblledhin fondet e nevojshme për fushatë, ato mund të mos kenë mundësi të mblledhin

nivel të mjaftueshëm fondesh për të qenë të suksesshme dhe për të konkurruar drejtpërdrejtë me burrat. Në disa vende sigurimi i kandidaturës brenda partisë është një ndërmarrje gjithnjë e më e kushtueshme dhe nevoja për të bërë dy fushata të kushtueshme (për të fituar kandidaturën në parti, dhe për të financuar fushatën zgjedhore) brenda një cikli zgjedhor, bën që shumë gra të ngurrojnë t'i futen kësaj pune. Shumë shpesh, kandidati që mbledh më shumë para është ai që fiton kandidaturën brenda partisë. Ky ka qenë problem veçanërisht në **SHTETET E BASHKUARA** dhe në sisteme të tjera zgjedhore që kanë në qendër kandidatin, si në **NIGERI**, ku ndikimi i parave tek përfaqësimi është i jashtëzakonshëm. Kjo i ka bërë sidomos grupet e nën-përfaqësuar që të jenë në pozita të pafavorshme për sa i përket qasjes në politikë. Vendosija e kufizimeve për paratë që shpenzohen në konkurrimet për sigurimin e kandidaturës dhe kufizimi i periudhës së fushatës, janë propozuar si masa përmirësuese për të krijuar një terren më të barabartë për grupet e nën-përfaqësuar.<sup>35</sup>

### (e) Financimi publik i partive politike

Financimi publik është një nga mekanizmat për krijimin e një terreni të barabartë në periudhën zgjedhore, zakonisht për partitë e përfaqësuar në parlament. Financimi publik jepet shpesh pa ndonjë detyrim për marrësit, por ai mund të rregullohet në mënyrë të tillë që t'i nxisë partitë të trajtojnë çështjen e fuqizimit politik të grave.

■ **MEKSIKË:** Neni 78 i kodit zgjedhor përfshin një “Ligj të dy përqindëshit” i cili përcakton me ligj që dy për qind e financimit publik të partive politike të përdoret posaçërisht për krijimin e kapaciteteve tek gratë si kandidatë dhe politikane.

■ **BURKINA FASO:** Një ligj i vitit 2009 vendosi kuota për kandidatët dhe përmbante elemente të konsiderueshme monetare nxitëse për partitë që zgjidhnin kandidatë gra. Partitë marrin 50 për qind më shumë financim publik nëse 30 për qind e kandidatëve të zgjedhur janë gra.<sup>36</sup>

■ **FRANCË:** Një amendament i vitit 1999 përcaktoi me ligj parimin e paritetit në kushtetutë, ku ndër të tjera, 50 për qind e kandidatëve të caktuar për zgjedhje duhet të jenë gra. Për zgjedhjen e kandidatëve në dhomën e ulët, partitë përballen me sanksione financiare nëse nuk paraqesin 50 për qind të kandidatëve nga të dy seksat. Partitë humbasin një pjesë të financimit publik kur diferenca midis numrave të kandidatëve të secilit seks shkon më shumë se 2 për qind e numrit të përgjithshëm të kandidatëve në listë.<sup>37</sup>

Në Irlandë dhe Gana janë bërë disa propozime shtesë. Në **IRLANDË**, Skema e Përgjithshme e Ligjit Zgjedhor (Amendament) (Financimi politik) e vitit 2011 propozoi të shkurronte financimin politik të partive gjysmë për gjysmë nëse 30 për qind e kandidatëve që përfaqësonin këto parti në zgjedhjet e përgjithshme nuk ishin gra.<sup>38</sup> Në **GANA**, një grup partish politike shprehu interesin për të ngritur një Fond të Grave për mbështetjen e grave që aspironin të konkurronin në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Në një deklaratë që hartuan pas një takimi shumë-partiak në vitin 2011, disa parti politike propozuan t'i shpërndanin 10 për qind të financimeve publike të partive politike drejtpërdrejtë tek gratë aspiruese dhe të zvogëlonin në mënyrë të konsiderueshme pagesat apo kuotizacionet që duhet të paguanin gratë konkurrenente.<sup>39</sup>

### FINANCIMET PUBLIKE DHE GRATË KANDIDATE:

■ **Francë:** financimet publike do të reduktohen nëse 50 për qind e kandidatëve të partisë nuk janë gra.

■ **Burkina Faso:** partitë do të marrin shuma më të mëdha financimi publik nëse 30 për qind e kandidatëve të zgjedhur të tyre janë gra.

■ **Meksikë:** Dy për qind e financimeve publike duhen përdorur për të fuqizuar gratë.

Një mënyrë tjetër për të dhënë financime publike në mënyrë të tërthortë është ofrimi i qasjes në mediat shtetërore dhe private. Ky është një komponent i rëndësishëm i fushatës së partive, sepse ndihmon në krijimin e lidhjeve midis kandidatëve dhe votuesve. Koha e transmetimit falas në media është një subvencion “në natyrë” dhe u përdor në **TIMORIN LINDOR** si një mënyrë për të promovuar pjesëmarrjen e grave në zgjedhje: ato parti që kishin gra në pozicione të larta në listat e partisë merrnin kohë shtesë në media.

#### **(f) Caktimi i fondeve të posaçme për trajnimin e grave**

Me qëllim që gratë të përparojnë në partitë politike ato duhet të ngushtojnë dallimet historike që ekzistojnë ndërmjet tyre dhe burrave në përvojën politike. Një shpjegim i zakonshëm i përdorur nga partitë politike për të justifikuar mungesën e kandidaturave të grave apo të promovimit të tyre është se numri i grave që kanë aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në politikë është tepër i vogël.

Partitë mund ta kapërcejnë këtë duke krijuar programe dhe duke caktuar burime që kanë si qëllim të ofrojnë trajnim për gratë, një praktikë shumë e zakonshme në Amerikën Latine:

■ Në **SALVADOR**, gratë aktiviste nga parti të ndryshme kanë bashkuar forcat për të formuar një institut shumë-partiak që u ofron trajnime grave. Duke pasur parasysh se trajnimi është shpesh një sfidë mbarë-partiake, gratë e trajnuara dhe të përgatitura mund të vënë në përdorim aftësitë e tyre

dhe të trajnojnë anëtarë të tjerë të partisë, duke u bërë kështu edhe më të vlefshme për partitë e tyre.

■ Partia PVK e **MEKSIKËS** përpiqet të barazojë aftësitë politike të grave dhe burrave nëpërmjet seminareve, mbledhjeve, forumeve dhe kurseve për gratë candidate. Trajnimet trajtojnë çështje të ndryshme në varësi të nevojave, por zakonisht fokusohen në çështje si motivimi, qëndrimet, puna në ekip, dhe çështje të tjera që i shqetësojnë gratë. Janë ofruar kurse për gratë që janë të interesuara të bëjnë fushatë ose për t'u angazhuar si koordinatorë të fushatës në përpjekje për të rritur pjesëmarrjen e tyre.<sup>40</sup>

#### **(g) Zbatimi i praktikave buxhetore që marrin parasysh çështjet gjinore**

Partitë mund të reflektojnë gjithashtu për mënyrën se si shpenzohen fondet e tyre për gratë, duke zhvilluar analiza të mënyrave se si përfitojnë apo do të përfitojnë aktivistët dhe aktivistet nga fondet e partisë dhe se si caktohen burimet për strukturat e partisë që merren posaçërisht me gratë. Një veprim tjetër me vlerë do të ishte gjithashtu edhe analiza e shpenzimeve të fushatës nga një perspektivë gjinore. Partitë mund të ndërmarrin praktika buxhetore që marrin parasysh çështjet gjinore në qeverisje, siç bëhet në Serbi, ku partitë marrin pjesë në komisione të barazisë gjinore në nivel vendor, të cilat punojnë për të garantuar që gratë të përfitojnë nga fondet publike.



## III

PERIUDHA  
ZGJEDHORE

PNUD/ANALIE FRECHON

FUSHATA DHE PËRGATITJA  
ZGJEDHORE

## ÇËSHTJE KYÇE

Partitë politike dhe kandidatët janë palët kryesore të interesuara për zgjedhjet; ato konkurrojnë për poste zyrtare, kryejnë fushata zgjedhore dhe i bëjnë thirrje elektoratit për vota. Kuadri ligjor dhe administrimi i zgjedhjeve, së bashku me mjedisin politik dhe kulturor, kanë një ndikim të theksuar në rezultatin e zgjedhjeve.<sup>41</sup> Gjatë periudhës zgjedhore, aktivitetet politike të partive janë të angazhuara për kryerjen e fushatave, mbështetjen e kandidatëve dhe kontaktin me votuesit. Përveç kësaj, partitë mund të marrin pjesë dhe të monitorojnë edhe administrimin e zgjedhjeve, përfshirë proceset e votimit dhe numërimit.

Fushatat zgjedhore kanë rol kyç në shanset e partisë për të fituar zgjedhjet.

Rregullat e fushatave ndryshojnë nga vendi në vend, ashtu si edhe strategjitë e fushatave ndryshojnë nga partia në parti. Ato ndikohen nga kuadri legjislativ, normat shoqërore dhe kultura, konteksti ekonomik, nivelet e zhvillimit dhe lloji i sistemit politik. Fushatat e zgjedhjeve kombëtare mund të jenë shumë të kushtueshme dhe në disa vende sasia e fondeve që grumbullohet ka një ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e fushatave. Megjithatë, shumë shpesh gratë kandidatë e kanë të vështirë që të grumbullojnë të njëjtin nivel burimesh si kandidatët burra dhe, rrjedhimisht, të kenë qasje në media. Gratë kandidatë janë shpesh të padukshme në fushata, ndërsa udhëheqësit partiakë dhe deputetët ekzistues (zakonisht burra) dominojnë propagandën partiake, kohën në media, dhe mjetet e tjera propagandistike të fushatës.

Në një anketim të 300 parlamentarëve të kryer nga IPU, gjysma e të anketuarve identifikuan se faktorët më të rëndësishëm në mbështetjen e kandidaturave të tyre zgjedhore ishin krijimi i kapaciteteve që lidhen me teknikat e zhvillimit të fushatës zgjedhore si dhe komunikimi dhe kontakti me zonat zgjedhore.<sup>42</sup> Disa vunë në dukje në veçanti dobinë e trajnimit të kryer nga “parti simotra” në vende të tjera. Ka disa veprime që partitë mund të ndërmarrin për të mbështetur zhvillimin e aftësive të grave për të bërë fushatë dhe për të promovuar përfshirjen e grave në periudhën e fushatës. OSHC-të e grave, fondacionet e partive dhe organizatat e asistencës për zhvillim janë përfshirë në përgatitjen dhe trajnimin e grave për të kryer fushata zgjedhore. Si rrjedhim, partitë politike mund të kërkojnë mbështetje dhe aleanca strategjike me OSHC-të e grave dhe organizatat ndërkombëtare të cilat ofrojnë në shumë vende burime të vlefshme financiare dhe teknike për të

fuqizuar kapacitetet e grave kandidatë gjatë periudhës së fushatës. Partitë duhet të garantojnë gjithashtu që manifesti dhe mesazhet e fushatës së tyre të jenë të piketuara tek votueset gra duke shprehur pozicionet e partisë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

## STRATEGJITË E PËRDORURA

Strategjitë e mëposhtme kanë si qëllim primar t’u japin udhëzime partive politike për veprimet që mund të ndërmerren për të ofruar mbështetje gjatë fushatës dhe periudhës zgjedhore. Përveç kësaj, këto strategji ofrojnë edhe ide për veprime nga organizatat që ofrojnë asistencë për zhvillim, fondacionet partiake dhe organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për të mbështetur partitë politike.

### (a) Ofrimi i trajnimit dhe këshillimi i grave kandidatë

Forcimi i aftësive të grave kandidatë për të bërë fushatë dhe krijimi i mundësive më të mëdha arsimore për gratë janë të rëndësishme për të rritur shanset e grave për t’u zgjedhur. Një trajnim i tillë mund të fokusohet tek mbledhja e fondeve, zhvillimi i mesazheve, puna me median, krijimi i kontakteve me votuesit dhe programet për të pasur qasje tek ata, përpilimi i planeve të fushatës, dhe projektimi i metodave të posaçme për komunikimin me votuesin.<sup>43</sup> Për shembull, OSHC-të dhe organizatat e asistencës për zhvillim mund të jenë aleatë të mirë për programet që synojnë rritjen e aftësive të grave për të bërë fushatë.

Përveç kësaj, gratë që duan të ecin përpara në politikë mund të përfitojnë nga përvoja e grave të tjera që kanë marrë pjesë më parë në fushata zgjedhore. Në

GRATË QË DUAN TË ECIN PËRPARA NË POLITIKË MUND TË PËRFITOJNË

NGA PËRVOJA E GRAVE TË TJERA

QË KANË MARRË PJESË MË PARË NË FUSHATA ZGJEDHORE.

**AUSTRALI**, Partia Laburiste, nëpërmjet Listës së vet EMILY ka ngritur një program këshillimi ku gratë që vënë kandidaturën për herë të parë lidhen në dyshe me politikane më me përvojë pikërisht për këtë qëllim. Në **MBRETËRINË E BASHKUAR**, organizata Women2Win (Gratë për të fituar) e Partisë Konservatore, që ka edhe një faqe interneti me të njëjtin emër, ka luajtur një rol aktiv për rekrutimin e grave si anëtare të reja të partisë si dhe për t'u ofruar atyre trajnimin, këshillimin dhe mbështetjen që u duhet për të pasur sukses brenda partisë.

“Gratë që duan të ecin përpara në politikë mund të përfitojnë nga përvoja e grave të tjera që kanë marrë pjesë më parë në fushata zgjedhore.”

### (b) Garantimi i dukshmërisë së grave në fushatë

Aktivistet dhe gratë candidate të partisë kanë aftësi dhe prirje që mund të përdoren nga partitë politike, por që shpesh kalojnë pa u vënë re dhe nuk përdoren sa duhet në fushata. Gratë shpesh mungojnë në fushatat e partisë, sepse u jepet përparësi udhëheqësve partiakë dhe funksionarëve në detyrë të cilët njihen gjerësisht me emër. Partitë politike mund të promovojnë dukshmërinë dhe njohjen e emrave dhe të figurave të grave candidate, duke promovuar aktivisht përfshirjen e tyre në fushatat e partisë, përfshirë reklamat televizive dhe posterat e fushatës, ose duke caktuar gra si zëdhënese të partisë. Në disa vende gratë anëtare partie i kanë përdorur në mënyrë krijuese teknologjitë e reja për të promovuar kandidatet e tyre gjatë fushatës, përmes mjeteve të reja të mediave sociale, si faqet personale të internetit dhe përdorimi i Facebook-it dhe Twitter-it.<sup>44</sup>

Fushatat pro-aktive publike të informimit mund të luftojnë paragjykimet kulturore dhe shoqërore ndaj grave – veçanërisht ato përforcohen nga mediat – dhe të vënë në dukje përfitimet e pjesëmarrjes politike të grave për shoqërinë në përgjithësi. Partive politike mund t'u ofrohen gjithashtu stimuj për të rritur dukshmërinë e grave në fushata, si ofrimi i një kohe transmetimi falas ose shtesë në media, që partitë të promovojnë gratë candidate në listat e tyre. Në **TIMORIN LINDOR**, siç u vu



PNUD ANGOLA

në dukje më lart, partive u jepet kohë shtesë transmetimi falas në media nëse ato kishin gra candidate, për të garantuar dukshmërinë e tyre në fushatë. Në **SHTETET E BASHKUARA**, Partia Demokratike i nxit kandidatët të përfshijnë pamje të grave në reklamat e tyre televizive të fushatës.

Partitë politike duhet të garantojnë gjithashtu që gratë candidate të kenë qasje në makinerinë e fushatës – të kenë personel për fushatë, siguri personale, mjedise ku të bëjnë takimet me elektoratin, dhe qasje në fonde – të cilat mund t'i rrisin në mënyrë të konsiderueshme shanset e tyre për të fituar.

### (c) Identifikimi dhe bërja publike e qëndrimeve të partisë për çështje që kanë përparësi për gratë

Platformat janë një komponent kyç i pjekurisë së partisë; ato i ndihmojnë partitë të dallohen nga të tjerat mbi bazën e çështjeve që trajtojnë, dhe jo të identitetit apo personalitetit të personave që i drejtojnë. Identifikimi i përparësive politike për gratë mund të jetë një strategji për të fituar mbështetjen e grave votuese dhe për të ndikuar pozitivisht në rezultatet zgjedhore të partive. Për shembull, gratë parlamentare janë në ballë të përpjekjeve për të luftuar dhunën me bazë gjinore, ato përgjithësisht shtrojnë për diskutim çështje që përbëjnë përparësi për gratë, si leja e lindjes për prindërit dhe kujdesi për fëmijën, dhe kanë pasur ndikim vendimtar për të garantuar që agjenda legjislative të përfshijë ligje të

barazisë gjinore dhe reforma zgjedhore që rrisin qasjen e grave në parlament.<sup>45</sup> Përfshirja e shqetësimeve të grave në platformën e partisë mund t'i ndihmojë gratë kandidate, sepse ajo ngre çështje diskutimi konkrete dhe vendos ura lidhjeje me gratë votuese. Partitë që mund të identifikojnë çështje të politikave, arrijnë të paraqiten më mirë para grave zgjedhëse si parti që reagojnë ndaj shqetësimeve të tyre, duke tërhequr, si rrjedhim, më shumë vota nga gratë për kandidatët e tyre.

■ **KANADA:** Partia Liberale zhvilloi dhe shpërndau një seri Librash Rozë që identifikonin dhe shpjegonin qëndrimin e partisë për çështjet prioritare për gratë.

■ **INDI:** Gratë anëtare të partisë BJP tërhoqën një numër të konsiderueshëm votuesesh gra për partinë duke paraqitur një politikë për të hapur llogari kursimi me 10 000 rupi për të gjitha vajzat e lindura në shtetin Madir Pradesh, që të përdoren për arsimin e tyre kur të mbushin moshën 18 vjeç.

■ **PERU:** Partia Popullore Kristiane (PPC) filloi një fushatë para-zgjedhore për të përmirësuar kapitullin



UNCDF/ADAM ROGERS

Gratë dhe Mundësitë e Barabarta të planit të saj qeverisës dhe gjatë këtij procesi të publikonte gjithashtu edhe platformën e saj. Në aleancë dhe me fonde nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), PPC-ja kërkoi mendime nga publiku nëpërmjet seancave të dëgjimit dhe takimeve publike me organizata të piketuara.<sup>46</sup>

#### (d) Monitorim me ndjeshmëri gjinore dhe siguria gjatë zgjedhjeve

Partitë politike kanë detyrën e rëndësishme të kryejnë funksion vëzhgues gjatë periudhës zgjedhore, duke monitoruar nga afër procesin e votimit dhe për të kontrolluar nëse ka parregullsi. Blerja e votës, frikësimi i votuesve, manipulimi i votave dhe organizimi i dobët dëmtojnë integritetin e zgjedhjeve. Mungesa e sigurisë mund të ndikojë tek votueset dhe gratë kandidate në mënyra të ndryshme nga burrat, sidomos në vende ku ka një rrezik të lartë për dhunë me bazë gjinore, që mund të jetë mbizotëruese veçanërisht në zgjedhjet që zhvillohen në vende që sapo kanë dalë na situata konflikti.<sup>47</sup>

Si rrjedhim, partitë politike duhet të jenë vigjilente, gjë që mund të bëjë të nevojshme praninë e përfaqësuesve ose vëzhguesve të partisë gjatë proceseve të regjistrimit dhe votimit, për të garantuar që votuesit të kenë mundësinë ta hedhin votën e tyre pa u frikësuar. Partitë duhet të garantojnë gjithashtu sigurinë e vëzhguesve gjatë numërimit dhe transportimit të kutive të votimit.<sup>48</sup> Është e rëndësishme që partitë të përfshijnë një perspektivë

#### LISTA E KONTROLLIT E PËRDORUR NGA VËZHGUESIT PARTIAKË DUHET TË PËRFSHIJË PYETJE ME FOKUS GJININË SI:

A ka ndonjë problem/faktor në zonën ku jeni caktuar, që mendoni se ndikon në pjesëmarrjen e grave si votuese dhe/ose kandidate, qoftë pozitivisht ose negativisht?

gjinore në praktikat e vëzhgimit që përdorin, si për shembull të garantojnë që listat e kontrollit që do të plotësohen nga vëzhguesit të përfshijnë pyetje të lidhura me votimin si familje, dhunën dhe frikësimin, ose shkelje të tjera që ndikojnë në pjesëmarrjen e lirë të grave në zgjedhje.<sup>49</sup>

Partitë politike kanë përgjegjësinë të rekrutojnë dhe trajnojnë përfaqësuesit e partisë dhe ato mund të përpiqen të rekrutojnë aktivisht gra për ta kryer këtë detyrë vëzhgimi. Kjo është sidomos e rëndësishme në ato vende ku ka qendra votimi të caktuara vetëm për gra. Prania e burrave në qendra të tilla votimi mund të ndalohet, përndryshe gratë votuese mund të frikësohen. Prania e vëzhgueseve të tilla nga partia mund të ketë edhe përfitime të tjera; ato jo vetëm që kontribuojnë me dukshmërinë e tyre për të garantuar sigurinë e grave në votim, por mund t'i mbajnë gjithashtu nën kontroll simpatizantët e partisë së tyre, duke siguruar që ata të mos angazhohen në frikësimin e votuesve, dhe duke bërë raportimin e incidenteve të tilla, nëse ndodhin.

#### **(e) Informacione me ndjeshmëri gjinore për votuesit**

Është në interesin e partive politike që të edukojnë votuesit, për të garantuar që përkrashtit e tyre të regjistronen për të votuar dhe të hedhin votën e tyre legjitime ditën e zgjedhjeve. Partitë politike investojnë shuma të mëdha parash dhe kohë për fushata informimi për votuesit dhe mund t'u drejtojnë në mënyrë aktive mesazhe grave votuese, për të siguruar që ato i kuptojnë proceset e duhura. Fushatat e informimit të votuesve duhet t'u vënë në dukje grave rëndësinë që kanë votat

e tyre për shoqërinë në përgjithësi dhe të theksojnë të drejtën e tyre për të votuar si pjesëtare të barabartë të shoqërisë. Në **AFRIKËN E JUGUT**, për shembull, Lidhja e Grave e Kongresit Kombëtar Afrikan filloi një Fushatë Zgjedhore Pa Ndalim 60-ditore gjatë zgjedhjeve të përgjithshme kombëtare të vitit 2009, në përpjekje për të mobilizuar gratë votuese të ushtronin të drejtën e tyre për të votuar dhe për të konsoliduar demokracinë.<sup>50</sup>

Gratë duhet të jenë pjesë e menaxhimit, planifikimit dhe zbatimit të fushatave të informimit të votuesve. Organizimi i fushatave dhe seminareve të tilla edukuese kërkon jo vetëm përshtatjen e mesazheve dhe përmbajtjes së tyre për mjedisin shoqëroro-kulturor, nivelet arsimore, dhe gjendjen politike në vend, por edhe një përzgjedhje dhe organizim të kujdesshëm të logjistikës. Garantimi i një mjedisi të sigurt mësimor, mësimi ku gratë nuk ndjehen të frikësuara, është i rëndësishëm, dhe nëse është e nevojshme, mund të merret në shqyrtim edhe mundësia e trajnimit më vete të grave. Në komunitetet tradicionale, gratë mund të jenë të ndara nga burrat dhe të kenë nivele të ndryshme lirie të lëvizjes dhe arsimit.<sup>51</sup> Të gjitha ekipet e edukimit të votuesve duhet të përfshijnë gra dhe, nëse është e nevojshme, mund të përbëhen plotësisht nga gra.<sup>52</sup>

Fushatat për informimin e votuesve dhe për publikun në përgjithësi duhet të përfshijnë edhe mesazhe me ndjeshmëri gjinore, që theksojnë sekretin e votës, për të luftuar votimin si familje dhe që nënvizojnë rëndësinë e pjesëmarrjes politike të grave për konsolidimin e demokracisë. Mesazhet mund të përpiqen gjithashtu të nxisin burrat që të shqyrtojnë mundësinë se mund të votojnë për një grua kandidatë.



## IV

PERIUDHA  
PAS-ZGJEDHORE

PNUD/BRAZIL

QEVERISJE QË MERR PARASYSH  
ÇËSHTJET GJINORE

## ÇËSHTJE KYÇE

Forcimi i qeverisjes demokratike kërkon krijimin e një mjedisi procesesh politike përfshirëse e reaguese dhe fuqizimin e grave. Përfshirja e këndvështrimeve të grave dhe pjesëmarrja e tyre në politikë janë parakushte për zhvillimin demokratik dhe kontribuojnë në qeverisje të mirë. Megjithatë, në shkallë botërore, gratë mbeten të nën-përfaqësuar në organet vendimmarrëse. Studimet kanë treguar se numri i grave në parlament ka rëndësi; më e pakta, sa më shumë gra të ketë në parlament aq më shumë mundësi ka që partia t'i trajtojë çështjet e grave dhe të ndryshojë dinamikën gjinore në kuvend.<sup>53</sup> Numri i grave deputete në parlament ka një ndikim të madh mbi natyrën e debatit në politikë.

**“PARTITË MUND TË PËRFITOJNË NGA KRYERJA E NJË ANALIZE SISTEMATIKE TË NEVOJAVE DHE MUNDËSIVE PËR GRATË ANËTARE TË TYRE.”**

Në mungesë të grave deputete në parlament dhe në organet e tjera legjislative, partitë duhet të jenë pro-aktive për të garantuar që barazia gjinore të trajtohet në qeverisje. Partitë ndikojnë në përcaktimin e çështjeve që formojnë debatin politik: ato formulojnë politika, vendosin përparësitë e qeverisjes dhe, si rrjedhim, janë në një pozicion strategjik për të trajtuar çështjet e grave. Në praktikë, partitë politike kanë një histori të përzier në trajtimin e çështjeve gjinore në qeverisje. Shembujt në këtë seksion ofrojnë disa ide për masat që kanë marrë partitë politike për të trajtuar çështjen e barazisë gjinore në qeverisjen pas-zgjedhore.

## STRATEGJITË E PËRDORURA

Strategjitë e mëposhtme kanë si qëllim parësor që t'i udhëzojnë partitë politike për veprimet që mund të ndërmerren për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në qeverisjen pas-zgjedhore. Përveç kësaj, këto strategji ofrojnë ide për veprime nga organizatat e asistencës për zhvillim, fondacionet partiake dhe organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për të mbështetur partitë politike.

### (a) Kryerja e një vlerësimi të barazisë gjinore

Periodha pas-zgjedhore ka rëndësi strategjike për partitë, që ato të kryejnë një vlerësim të barazisë gjinore. Shpesh partitë politike bazohen në prova anekdotale kur hartojnë strategjitë për promovimin e fuqizimit të grave, por në vend të kësaj ato mund të bazohen më shumë në analizat e brendshme. Partitë mund të përfitojnë nga një analizë sistematike e nevojave dhe mundësive të grave anëtare të tyre, pra në të dhëna

të mbledhura nga anketimet, grupet e fokusit, studimet e opinionit publik dhe rezultatet zgjedhore. Përveç kësaj, një analizë e gjendjes së barazisë gjinore brenda partisë politike mund të përfshijë shqyrtimin e rregullave të funksionimit të partisë politike, politikave të saj dhe angazhimeve të manifestit, si dhe të pozitave që kanë nga gratë në parti. Kjo mund të lehtësohet duke mbajtur evidenca të përditësuara të dhënash, të ndara sipas gjinisë.

Pas zgjedhjeve partitë politike mund të përfitojnë nga kryerja e një vlerësimit të performancës së tyre dhe të shkallës së vëmendjes që i kanë kushtuar çështjeve gjinore në fushatë. Partia mund të vlerësojë nëse praktika dhe rregulla të caktuara, si për shembull, financimi i kandidatëve ose rregullat e rekrutimit, kanë krijuar ndonjë disavantazh në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për gratë gjatë zgjedhjeve. Nga ana tjetër, në bazë të gjetjeve të këtyre vlerësimeve, mund të zhvillohen dhe përgatiten veprime ose plane strategjike të posaçme. Në çdo kohë mund të miratohen politika të reja partiake dhe të ndërmerren reforma, por ka një avantazh strategjik nëse kjo bëhet në periudhën pas-zgjedhore. Për shembull, në **KANADA**, Partia e Re Demokratike (PRD) kreu një vlerësim për diversitetin në një nga provincat e saj pas zgjedhjeve, prej të cilit pjesëtarët e grupeve të nën-përfaqësuar mundën të zhvillonin një plan veprimi për të caktuar më shumë gra kandidatë në zona zgjedhore ku mund të fitojnë. Në **KIRGIZISTAN**, organizatat e asistencës për zhvillim dhe OSHC-të kryen një analizë gjinore të manifesteve të partive politike dhe një vlerësim të gjendjes së grave në politikë në nivel kombëtar dhe vendor.

### (b) Ofrimi i trajnimit për anëtarët e sapo-zgjedhura

Për shumicën e anëtareve të sapo-zgjedhura puna në parlament është një përvojë e re. Ndonëse sekretariatet e parlamenteve gjithmonë ofrojnë trajnime informuese për anëtarët e rinj, partitë politike shpesh ofrojnë vetë trajnim për anëtarët e grupit të tyre parlamentar për mënyrën se si funksionon partia në një mjedis parlamentar. Ky trajnim mund të ofrojë zhvillim të përgjithshëm të aftësive dhe



mund të përshtatet për nevojat e grave deputete, për t'i ndihmuar ato të orientohen për sa i përket rregullave dhe procedurave.

### (c) Promovimi i reformave me ndjeshmëri gjinore në parlament

Si grupe politike në parlament, partitë mund të punojnë për ndryshuar kulturën dhe mënyrën e punës në parlamentet. Kur gratë hyjnë në parlamente, ato zakonisht hyjnë në një mjedis që funksionon sipas “vijave të gjinorizuara”, d.m.th. veprojnë në një mjedis politik ku kultura institucionale dhe procedurat e veprimit mund të anojnë kundër tyre. Mund të jetë i nevojshëm një rishikim i klimës politike, për të garantuar që kushtet në të cilat veprojnë gratë të promovojnë pjesëmarrjen e tyre. Shqyrtimi i çështjeve të tilla si oraret e mbledhjeve në parlament, vendndodhja e mjedisëve ndihmëse për gratë deputete, dhe dispozitat për lejen e lindjes, mund të çojnë në reforma pozitive për të promovuar pjesëmarrjen e grave. Si rrjedhim, heqja e barrierave ndaj pjesëmarrjes së grave është vendimtare për të krijuar parlamente që akomodojnë të dyja gjinitë dhe që u përgjigjen nevojave dhe interesave si të burrave ashtu edhe grave.<sup>54</sup>

Në **AFRIKËN E JUGUT**, gratë anëtare të grupit parlamentar të partisë Kongresi Kombëtar Afrikan theksuan nevojën për reformë të institucionit të parlamentit, kur zunë vendet e tyre në vitin 1994. Ato kërkuan që kalendar i parlamentit të ndryshohej për t'u përputhur me kalendarin shkollor,

**NË AFRIKËN E JUGUT GRATË ANËTARE TË PARTISË KËRKUAN NDRYSHIME NË KALENDARIN DHE ORARET E MBLEDHJEVE TË PARLAMENTIT PËR T'I AKOMODUAR DEPUTETET DHE FAMILJET E TYRE, SI DHE PËR TË RRIUR NDJESHMËRINË GJINORE TË PARLAMENTIT.**

PNUDERICK RABEMANORO



me qëllim që deputetët të ishin ose me pushime, ose në periudhën e vizitave në zonën zgjedhore, gjatë kohës së pushimeve të shkollës. Ato kërkuan gjithashtu që debatet të përfundonin më herët në mbrëmje, për të akomoduar nevojat e deputeteve dhe deputetëve dhe të familjeve të tyre, si dhe krijimin e mjedisëve ndihmëse për kujdesin ndaj fëmijëve.<sup>55</sup>

### (d) Garantimi i përfshirjes gjinore dhe fuqizimit të grave në politikën e partisë

Anketimi i 300 parlamentarëve nga IPU-ja tregoi se politikat e partive politike janë faktorë kyç që përcaktojnë përparësitë dhe agjendat legjislative. Organet vendimmarrëse të partive politike, si komitetet ekzekutive, kanë shumë ndikim; megjithatë gratë mbeten të nën-përfaqësuara në këto organe. Në praktikë, jo të gjitha partitë e promovojnë barazinë gjinore apo i përmbahen premtimeve të manifestit të tyre në praktikë, dhe pak gra mbajnë pozicione të larta vendimmarrëse në radhët e tyre. Siç pritet, mbështetja e partisë qeverisëse është një nga faktorët më të rëndësishëm në paraqitjen dhe zbatimin e legjislacionit të lidhur me gjininë.<sup>56</sup>

Partitë politike mund të promovojnë fuqizimin e grave nëpërmjet zhvillimit të politikave në të paktën dy mënyra:

(a) Duke mbështetur reforma të politikave specifike gjinore, si lufta kundër dhunës me bazë gjinore ose fokusimi tek çështje si leja e lindjes apo çështjet e të drejtave riprodhuese;

(b) Duke garantuar që këndvështrimi gjinor të përfshihet në të gjitha debatet politike dhe përparësitë e partisë, përfshirë promovimin e barazisë gjinore në fusha

si qasja në drejtësi, shëndetësi, shtetësi, punë, të drejtat e tokës, sigurimet shoqërore dhe e drejta e trashëgimisë.<sup>57</sup> Parlamentet mund të garantojnë gjithashtu që angazhimet ndërkombëtare, si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), të përkthehen në legjislacion kombëtar dhe të shërbejnë si bazë në veprimet qeverisëse.

Kapacitetet e anëtarëve të grupeve parlamentare, si burra ashtu edhe gra, duhen zhvilluar për të kryer analiza nga një këndvështrim gjinore. Zhvillimi i politikave, rishikimi i legjislacionit dhe ndarjet e burimeve duhet të marrin parasysh ndikimet e tyre tek burrat dhe gratë. Kjo mund të përfshijë gjithashtu edhe mbështetjen e kapaciteteve të komiteteve të posaçme që merren me barazinë gjinore, për të kryer analiza gjinore të buxheteve dhe për të pasur qasje në të dhënat. Një masë organizative e lidhur me këtë është marrja e masave që rezolutat dhe rekomandimet nga forumet e grave, komitetet e politikave të brendshme apo grupi parlamentar i grave, të merren për bazë në zhvillimin e politikave brenda partisë politike.

■ **SPANJË:** Partia Socialiste e Punëtorëve (PSOE) sponsorizoi miratimin e një ligji për barazinë gjinore dhe bëri përpjekje që ta përfshijë gjininë në procesin e bërjes së politikave. Që nga viti 2004, PSOE-ja ka miratuar disa pjesë legjislacioni, përfshirë reformën e bujqësisë, kujdesin ndaj familjarëve, dhe parashikimin me ligj të kuotave të kandidatëve.

■ **MAROK:** USFP-ja ka theksuar çështje si ligji i shtetësisë dhe miratimi i ligjit të barazisë gjinore në parlament.

■ **RUANDA:** Reforma legjislative është përqendruar në ligjin e trashëgimisë dhe lënies së trashëgimisë (1999), ligjin e mbrojtjes së fëmijëve (2009). Gratë kanë ushtruar gjithashtu ndikimin e tyre duke siguruar që edhe pjesë të tjera të legjislacionit të jenë

**PËRFSHIRJA E GJINISË KËRKON QË ZHVILLIMI I POLITIKAVE, RISHIKIMI I LEGJISLACIONIT DHE NDARJA E BURIMEVE TË BAZOHET TEK NDIKIMI QË KANË ATO TEK BURRAT DHE GRATË.**

të ndjeshme ndaj gjinisë dhe nevojave të fëmijëve, si ligji për shtetësinë, dispozitat për klasifikimin e krimeve të gjenocidit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në disa raste deputetët mund të kenë mundësi të kufizuara për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore për shkak të disiplinës partiake. Në përgjithësi, politikat e partive përcaktojnë mënyrën si voton grupi i partisë në parlament për çështje të caktuara. Si rrjedhim, është e nevojshme të shmangen kërkesat jorealiste ndaj grave deputete; atje ku identiteti i partisë është shumë i fortë, hapësira e deputetëve të veçantë për të vepruar ndryshe nga vija e partisë mund të jetë e kufizuar.<sup>58</sup> Kjo përforcon rëndësinë që ka përfshirja e gjinisë në politikat e partisë.

### **(e) Marrja e masave që gratë të kenë qasje në vendet vakante dhe të ruajnë vendet e tyre në parlament**

Numri i grave që kanë vende në parlament mund të rritet ose të ulet gjatë një mandati parlamentar. Gratë deputete mund të japin dorëheqjen apo të marrin një post ministrior dhe, si rrjedhim, u duhet të lënë vendet e tyre parlamentare. Në këto raste (kur nuk zhvillohen zgjedhje të pjesshme) partitë politike mund të garantojnë që në vendet e lëna bosh nga gratë të vihen përsëri gratë. Ndonjë parti mund të vendosë gjithashtu që në çdo vend të lënë bosh të vihet një grua, si një mënyrë për të rritur numrin e grave deputete. Partitë politike mund të konsiderojnë gjithashtu mënyra

të ndryshme për të garantuar ruajtjen e anëtareve gra në zgjedhjet e ardhshme. Zakonisht, numri i grave që largohen nga parlamenti është më i madh se sa i burrave dhe, duke i pyetur vetë gratë se për çfarë stimulsh dhe mbështetjeje kanë nevojë, mund të arrihet ndalimi dhe kthimi mbrapsht i kësaj tendence. Në GANA, për shembull, disa parti politike kanë shpallur se do të përpiqen të ruajnë deputetet ekzistuese në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe të garantojnë që, në rast të lënies së vendit, vendi i një gruaje të zihet përsëri nga një grua.<sup>59</sup>

#### (f) Mbështetja e rrjeteve ndërpartiake të grave dhe e grupeve parlamentare të grave

Gratë në të gjithë botën e kanë kuptuar se, duke qenë pakicë në parlament, do të kenë avantazhe strategjike nëse formojnë aleanca dhe koalicione për të ndikuar në ndryshimin e politikave. Grupet parlamentare të grave mund të shërbejnë si forume efektive për të bashkuar gratë nga parti të ndryshme politike për t'i kanalizuar interesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe për ta përfshirë gjininë në zhvillimin e politikave dhe monitorimin e veprimtarisë së qeverisë.<sup>60</sup> Më konkretisht, ndër veprimtaritë e grupit parlamentar të grave mund të përfshihen ofrimi i mbështetjes për krijimin e kapaciteteve të grave parlamentare, analizimi i projekt-ligjeve, mbajtja e seancave dëgjimore me OSHC-të, organizimi i seminarëve publike për çështje me interes, përcaktimi i pozicioneve të përbashkëta për çështje të ndryshme me qëllim që gratë deputete të përpiqen të ndikojnë mbi udhëheqësit e partisë së tyre dhe të monitorojnë veprimet e qeverisë për përfshirjen e gjinisë dhe fuqizimin e grave.

Mbështetja e partive për grupet e grave mund të sjellë rezultate pozitive:

- **MEKSIKË:** Ligji i kuotave u realizua sepse gratë nga të gjitha partitë kryesore politike punuan së bashku, si brenda ashtu edhe jashtë kongresit, për t'i bërë trysni kolegëve të tyre burra që të mbështetnin kuotat.

- **ARMENI:** Një koalicion shumë-partiak arriti ta bindë shumicën e partive kryesore të pranojnë një kuotë për parlamentin; gratë anëtare të partisë i morën mesazhet për të cilat ishte rënë dakord bashkërisht dhe i përshtatën ato në përpjekjet e tyre të brendshme të avokacisë brenda secilës prej partive të tyre.

- **SALVADOR:** Shoqata e Grave Deputete dhe Ish Deputete të Salvadorit përpiqet të forcojë zërin politik të grave si brenda ashtu edhe jashtë parlamentit. Shoqata ofron trajnime dhe seminare për aftësitë komunikuese dhe organizuese që i ndihmojnë gratë të bëhen më efektive në punën e tyre politike.

- **KIRGIZSTAN:** Shoqata për Nismat Ligjore të Grave, ku marrin pjesë gra deputete, eksperte gjinore dhe veprimtare të organizatave jo-qeveritare të grave ka qenë një faktor vendimtar në forcimin e grupeve të grave, në fusha si zhvillimi i kapaciteteve për kryerjen e analizave të projekt-ligjeve.<sup>61</sup>

#### (g) Formimi i partneriteteve strategjike me organizatat e shoqërisë civile

Krijimi i koalicioneve midis grave politike dhe shoqërisë civile mund të jetë një mënyrë efikase për të avancuar agjendat politike. Në shumë raste, veçanërisht kur partitë politike kërkojnë të ndryshojnë kushtetutën dhe



të miratojnë legjislacion për të promovuar fuqizimin politik të grave, veprimtarët brenda partive politike kanë punuar ngushtësisht me organizatat e shoqërisë civile për të arritur objektivat e tyre. Në raste të tjera, OSHC-të dhe organizatat e grave piketojnë në mënyrë strategjike veprimtarët partiakë gra për të bërë propagandë për ndryshimet që ato dëshirojnë të bëhen në politika. Në të dy skenarët, OSHC-të mundet t'i bëjnë presion qeverive dhe të mobilizojnë kërkesën publike për reformë.

■ **MAROK:** OSHC-të vendore dhe ato ndërkombëtare kanë punuar së bashku për të mbledhur gra nga disa parti politike për t'i dhënë shtysë krijimit të grupit të grave parlamentare dhe për të hartuar se si të mbështesin një ligj për kuotat.

■ **PERU:** Duke u mbështetur tek vendosja e kuotave të reja gjinore në Amerikën Latine, një koalicion i organizatave të grave punoi me gratë brenda partive për të promovuar miratimin e një ligji për kuotat e kandidatëve.

■ **SLLOVENI:** Një koalicion shumë-partiak grash drejtuese dhe figurash të tjera politike bënë avokaci të suksesshme për një amendament kushtetues për përfshirjen e disa garancive të përkohshme për përfaqësim të barabartë të grave në politikë, d.m.th. një kuotë prej 40 për qind për të gjitha listat zgjedhore në zgjedhjet për Parlamentin Evropian të vitit 2004.<sup>62</sup>

## (h) Sensibilizimi i anëtarëve të partisë dhe puna në partneritet me burrat

Institucionalizimi i barazisë gjinore do të thotë që politikën dhe procedurat e miratuara nga një parti të vihen në praktikë nga anëtarët e partisë, veçanërisht anëtarët e grupit në parlament. Ambiciet e partisë, si vendosja e objektivave konkrete dhe shprehja e angazhimeve politike, nuk kanë shumë kuptim nëse nuk shoqërohen nga mbështetja dhe pranimi i anëtarëve të partisë, burra dhe gra. Duke qenë se burrat përbëjnë shumicën në pjesën më të madhe të parlamenteve dhe dominojnë strukturat udhëheqëse të partive, ata janë partnerë të rëndësishëm për të vënë në jetë ndryshimin. Kjo mund të kërkojë procese të brendshme trajnimi për të sensibilizuar anëtarët e partisë, veçanërisht burrat, në lidhje me barazinë gjinore. Trajnimet orientuese, që zakonisht u ofrohen deputetëve të rinj në parlament, duhet të përfshijnë dispozita mbi barazinë gjinore.

Në këtë pikëpamje, mbështetja dhe vizioni i udhëheqjes së partisë është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Në SPANJË, udhëheqësi i PSOE-së, Zapatero, deklaroi se është një mbrojtës i përkushtuar i feminizmit, duke bërë që të ndryshonin mendimet për feminizmin në politikën spanjolle. Kjo pati ndikim në të gjitha nivelet e strukturave të partisë, duke bërë që gratë trajtohen si të barabarta me burrat në parti dhe pikëpamjet e tyre të konsiderohen njëjloj si edhe të kolegëve të tyre burra.

# PËRFUNDIMI



Përfshirja e këndvështrimeve të grave dhe pjesëmarrja e tyre në politikë janë parakushte për zhvillimin demokratik dhe kontribuojnë në qeverisjen e mirë, dhe partitë politike janë mjetet primare për pjesëmarrje politike. Partitë politike mund të kenë avantazhe politike dhe financiare nëse promovojnë aktivisht nisma për fuqizimin e grave gjatë ciklit zgjedhor. Duke mbështetur hapur dhe zyrtarisht pjesëmarrjen e grave nëpërmjet reformave, partitë politike mund të ndryshojnë opinionin publik, të krijojnë baza të reja mbështetjeje, të tërheqin anëtarë të rinj, të rrisin derdhjen e fondeve publike për partinë dhe të përmirësojnë pozicionin e tyre në raport me vendet e tjera, që janë disa prej përfitimeve politike dhe praktike.

Mbështetja zyrtare e partive politike është e nevojshme për të kapërcyer pengesat ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë. Paragjykimet gjinore janë mbizotëruese në të gjitha vendet e botës dhe pasqyrohen në jetën shoqërore,

ekonomike dhe politike. Në shumë vende gratë vazhdojnë të dekurajohen nga konkurrimi drejtpërdrejt me burrat dhe nga dalja dhe ndërveprimi në publik; në vend të kësaj atyre u jepen role që i mbajnë larg vendimarrjes.

Paragjykime të tilla nxisin dhe përforcojnë statusin më të ulët ekonomik të grave dhe varfërinë e tyre relative në të gjithë botën, që janë ndër pengesat më të rëndësishme dhe të menjëhershme që e bëjnë pjesëmarrjen politike të grave gati të pamundur në çdo fazë të ciklit zgjedhor. Për shembull, gratë kanë ose më pak, ose aspak, burime nën kontrollin e tyre dhe, si rrjedhim, nuk janë në gjendje t'i financojnë fushatat e tyre për të konkurruar në zgjedhje. Ato kanë gjithashtu qasje më të vogël në burime sesa burrat për t'i mbështetur fushatat e tyre, si për shembull financime të jashtme, produkte informimi, rrjete ndikimi, shembuj model për të ndjekur, apo mentorë me përvojë. Brenda partive politike, paragjykime të tilla pasqyrohen dukshëm në numrin e kufizuar të grave në poste udhëheqëse dhe vendimarrëse.

Në vend të kësaj, gratë janë të mbi-përfaqësuara në pozicione dhe veprimtari mbështetëse të partive politike në nivelin e bazës, ose në mbështetje të udhëheqjes mashkullore të partisë. Postet me pushtet në partitë politike shpesh mund të jenë jozyrtare, të centralizuara dhe të mbështetura nga marrëdhënie dhe rrjete ndikimi të rrënjësura me kohë, ku të sapo-ardhurit, sidomos gratë, nuk e kanë të lehtë të hyjnë. Duke pasur parasysh këtë mungesë qasjeje në njohuritë dhe memorien institucionale të rrënjësuar në rrjete të tilla, burimet shumë të kufizuara, numrin e vogël të shembujve model për të ndjekur dhe të mentorëve për t'i këshilluar, e ndonjëherë madje edhe mbështetjen e pakët nga familja dhe komuniteti, është e kuptueshme se pjesëmarrja e grave në partitë politike ka mbetur shumë më e ulët se e burrave.

Morisë së vështirësive me të cilat përballen gratë që dëshirojnë të futen në politikë dhe në partitë politike mund ti jepet zgjidhje nëpërmjet një shumëllojshmërie masash në nivele dhe pika të ndryshme hyrëse të ciklit

zgjedhor. Ky Udhëzues ka ilustruar se si mund të kenë sukses strategjitë e fokusuara për të sjellë më shumë gra në poste udhëheqëse dhe për të garantuar që ato të mbeten në poste të tilla. Strategjitë e suksesshme shkojnë nga ndryshimet në shkallë të gjerë në mbarë sistemin politik, deri tek reformat e brendshme në parti dhe zhvillimi i kapaciteteve të grave. Një numër i madh rastesh tregojnë se reformat për të rritur pjesëmarrjen e grave në partitë politike kanë ecur krah për krah me nismat për përmirësimin e reagimeve ndaj çështjeve gjinore në platformat partiake. Strategjitë më kuptimplota kombinonin në të njëjtën kohë reforma të institucioneve politike dhe ofrimin e mbështetjes së fokusuar për gratë veprimtare, kandidatë dhe funksionare të zgjedhura të partive, që trajtonin sfidat shoqëro-ekonomike dhe ato për ndërtimin e kapaciteteve me të cilat përballen gratë.

Partitë politike në të gjithë botën kanë treguar se nuk ka ndonjë pikë fillimi që të jetë më e mirë se një tjetër, në qoftë se ekziston përkushtimi ndaj barazisë gjinore. Partitë e suksesshme kanë qenë krijuese në qasjet e tyre ndaj fuqizimit të grave dhe i kanë përputhur këto qasje me historinë dhe kontekstet e tyre përkatëse. Megjithatë, me gjithë shumëllojshmërinë e strategjive dhe qasjeve, është e rëndësishme të vihet në dukje se masat e vendosura, si kuotat, kanë treguar në mënyrë të përsëritur se janë efektive për të sjellë më shumë gra në poste me pushtet.

Ky Udhëzues ka synuar të ofrojë një listë të përmbledhur strategjish të mundshme e të realizueshme, të organizuara sipas fazave të ciklit zgjedhor (Pjesa A), së bashku me shembuj të hollësishëm praktikë nga rastet studimore (Pjesa B). Shpresohet që anëtarët e partive politike, veçanërisht udhëheqja e atyre partive, organizatat e shoqërisë civile dhe veprimtarët e barazisë gjinore, të kenë motivimin të ndërmarrin veprime për të promovuar pjesëmarrjen politike të grave. Shpresohet gjithashtu që Udhëzuesi t'i ndihmojë palët e interesuara që kërkojnë udhëzime se si të ecin përpara në përpjekjet e tyre për të promovuar pjesëmarrjen e grave në partitë politike.

## SHËNIME

1. Bashkimi Ndër-Parlamentar, *Women in Parliaments: World and Regional Averages (Gratë në Parlamente: Mesataret botërore dhe rajonale)*, gjendet në <http://www.ipu.org/wmn-e/world-arc.htm>, 2011.
2. Bashkimi Ndër-Parlamentar, *Beijing Goals Still Unmet: Press Release (Objektivat e Pekinit ende të paplotësuara: Deklaratë për shtyp)*, gjendet në <http://www.ipu.org/press-e/gen336.htm>, 3 mars 2010.
3. Shërbimi i Protokollit dhe Lidhjeve të Kombeve të Bashkuara, *Kryetarët e Shteteve dhe Kryetarët e Qeverive, Lista publike*, 9 gusht 2011.
4. Ballington, Julie, *Equality in Politics: A Survey of Women and Men in Parliaments (Barazia në politikë: Një anketë e grave dhe burrave në parlamente)*, Bashkimi Ndër-Parlamentar, Gjenevë, Zvicër, 2008.
5. ACE, *The Electoral Cycle Approach (Qasja e ciklit zgjedhor)*, gjendet në <http://aceproject.org/ace-en/focus/focus-on-effective-electoralassistance/the-electoral-cycle-approach>.
6. Adaptuar nga Maguire, Linda, *Electoral Cycle Approach: Session III, presented at UNDP Global Practice Meeting on Electoral Cycle Support (Qasja e cilit zgjedhor: Sesioni III, paraqitur në takimin e praktikës globale për mbështetjen në ciklin zgjedhor të PNUD-it)*, Gaborone, Botsvanë, 2 mars 2011.
7. ACE, *Roles and Definition of Political Parties (Rolet dhe përcaktimet e partive politike)*, Rrjeti i njohurive zgjedhore i ACE-s, gjendet në <http://aceproject.org/ace-en/topics/pc/pca/pca01/pca01a>.
8. ACE, *Guiding Principles of Parties and Candidates (Parimet drejtuese të partive dhe kandidatëve)*, Rrjeti i njohurive zgjedhore i ACE-s, gjendet në <http://aceproject.org/ace-en/topics/pc/pc20?toc>.
9. ACE, *Internal Functioning of Political Parties (Funksionimi i brendshëm i partive politike)*, Rrjeti i njohurive zgjedhore i ACE-s, gjendet në <http://aceproject.org/ace-en/topics/pc/pc20?toc>.
10. Llanos, Beatriz, & Kristen Sample, *From Words to Action: Best Practices for Women's Participation in Latin American Political Parties (Nga fjalët në veprime: Praktikant më të mira të pjesëmarrjes së grave në partitë politike të Amerikës Latine)*, IDEA, gjendet në [http://www.idea.int/publications/from\\_rhetoric\\_to\\_practice/en.cfm](http://www.idea.int/publications/from_rhetoric_to_practice/en.cfm), 2009.
11. Sacchet, Teresa, *Political Parties: When Do They Work for Women? (Partitë politike: Kur punojnë ato për gratë?)*, nga takimi i grupit të ekspertëve për pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në proceset vendim-marrëse, me theks të veçantë në pjesëmarrjen dhe udhëheqjen politike, Departamenti i Kombeve të Bashkuara për çështjet ekonomike dhe shoqërore (DESA), Seksioni për përparimin e grave (DAW), Komisioni ekonomik për Afrikën (ECA), Adis Abeba, Etiopi, gjendet në [http://www.un.org/womenwatch/daw/egm/eq1-men/docs/EP.10\\_rev.pdf](http://www.un.org/womenwatch/daw/egm/eq1-men/docs/EP.10_rev.pdf), 2005.
12. Statutet e Partisë CDU, Neni 15, shihni International IDEA, IPU, & Stockholm University, *Global Database of Electoral Quotas for Women (Baza globale e të dhënave të kuotave zgjedhore për gratë)*, gjendet në [www.quotaproject.org/systemParty.cfm](http://www.quotaproject.org/systemParty.cfm)
13. Statuti i Kongresit Kombëtar Afrikan, gjendet në <http://www.anc.org.za/show.php?id=207/>.
14. Llanos & Sample, 2009, vepër e cituar., f. 32.
15. Politikant iKNOW, *Consolidated Response on Establishing Women's Party Sections (Përgjigja e konsoliduar për ngritjen e seksioneve partiake të grave)*, gjendet në <http://www.iknowpolitics.org/node/3527>, 2007.
16. Po aty.
17. Matland, Richard E., & Kathleen A. Montgomery (2003), 'Recruiting Women to National Legislatures: A General Framework with Applications to Post-Communist Democracies,' (Rekrutimi i grave në legjislaturat kombëtare: Një kuadër i përgjithshëm me aplikime në demokracitë pas-komuniste) në Richard E. Matland & Kathleen A. Montgomery (eds.), *Women's Access to Political Power in Post-Communist Europe (Qasja e grave në pushtetin politik në Evropën pas-komuniste)*, Oxford University Press, Oxford, f. 21, 2003, dhe Ballington, Julie, & Richard Matland, 'Enhancing Women's Participation in Electoral Processes in Post-conflict Countries,' (Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore në vendet pas-komuniste) nga OSAGI & DPA Expert Group Meeting, Nju Jork, SHBA, 2004.
18. Matland, Richard, 'Enhancing Women's Political Participation: Legislative Recruitment and Electoral Systems,' (Rritja e pjesëmarrjes politike të grave: Rekrutimi legjislativ dhe sistemet zgjedhore) në International IDEA, *Women in Parliament: Beyond Numbers (Gratë në parlament: Përtej numrave)*, IDEA: Stokholm, Suedi, 1998, f. 70.
19. Ballington & Matland, 2004, vepër e cituar.
20. Ballington, Julie, 'Strengthening Internal Political Party Democracy: Candidate Recruitment from a Gender Perspective,' (Forcimi i demokracisë së brendshme në partitë politike: Rekrutimi i kandidatëve nga perspektiva gjinore) nga *How to Strengthen Internal Party Democracy? World Movement for Democracy (Si të formojmë demokracinë*

- e brendshme në partitë politike? Lëvizja botërore për Demokraci), Durban, Afrika e Jugut, 2004.
21. Ballington, Julie, 'Implementing Affirmative Action: Global Trends,' (Zbatimi i veprimit afirmativ: Tendencat globale) *IDS Bulletin Special Issue: Quotas: Add Women and Stir? (Buletini i posaçëm i IDS: Kuotat: Shtoni gratë dhe përzieni?)* Volumi 41, Botimi 5, Shtator 2010, f. 11–16.
  22. International IDEA, IPU, & Stockholm University, *Global Database of Electoral Quotas for Women (Baza globale e të dhënave të kuotave zgjedhore të grave)*, gjendet në [www.quotaproject.org](http://www.quotaproject.org).
  23. Po aty.
  24. Ballington, 2010, vepër e cituar.
  25. International IDEA, IPU, & Stockholm University, *Global Database of Electoral Quotas for Women (Baza globale e të dhënave të kuotave zgjedhore të grave)*, gjendet në [www.quotaproject.org](http://www.quotaproject.org)
  26. Llanos & Sample, 2009, vepër e cituar.
  27. Ghana Web, *Parties Issue Recommendations in Favour of Women in Governance (Rekomandimet për çështjet e partive në favor të grave në qeverisje)*, gjendet në <http://www.ghanaweb.com>, 14 shkurt 2011.
  28. Internacionalja Socialiste e Grave, *Policies on Gender Equality – the Driving Force for Social and Economic Development (Politikat për barazinë gjinore – forca shtytëse për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror)*, gjendet në <http://www.socintwomen.org.uk/en/resolutions/20100618-andorra-pgedfsed.html>, 2010.
  29. Ballington, Julie, *Equality in Politics: A Survey of Women and Men in Parliaments (Barazia në politikë: Një anketë e grave dhe burrave në parlamente)*, Bashkimi Ndër-Parlamentar, Gjenevë, Zvicër, 2008, f. 18.
  30. Ballington & Matland, 2004, vepër e cituar.
  31. International IDEA, *Funding of Political Parties and Election Campaigns (Financimi i partive politike dhe fushatat zgjedhore)*, Stokholm, Suedi, 2003, f. 83.
  32. Ballington & Matland, 2004, vepër e cituar.
  33. Luchsinger, Gretchen, & Ruth Meena, *Electoral Financing to Advance Women's Political Participation: A Guide for UNDP Support (Financimi zgjedhor për të avancuar pjesëmarrjen politike të grave: Një udhëzues për mbështetje nga PNUD-i)*, UNDP, Nju Jork, SHBA, 2007, f. 11.
  34. Munroe, Susan, 'Riding,' *About.com: Canada Guide (Udhëzuesi i Kanadasë)*, gjendet në <http://canadaonline.about.com/cs/elections/g/riding.htm>.
  35. Ballington, 2003, vepër e cituar., f. 163.
  36. Instituti Demokratik Kombëtar, *Women Gain Political Ground in Burkina Faso (Gratë fitojnë terren politik në Burkina Faso)*, gjendet në <http://www.ndi.org/node/15464>, 19 maj 2009.
  37. Ballington, Julie, 'Gender Equality in Political Party Funding,' (Barazia gjinore në financimin e partive politike) paraqitur në seminarin *Is Financing an Obstacle to the Political Participation of Women? (Është financimi një pengesë ndaj pjesëmarrjes politike të grave?)*, Forumi Ndër-Amerikan për Partitë Politike, OAS, Uashington DC, SHBA, 16 dhjetor 2003.
  38. Projekt-ligji po debatohej kur u botua ky raport. *Shihni Ministri Hogan boton Skemën e përgjithshme të projekt-ligjit zgjedhor 2011 (Amendament) (Financimi politik)*, Merriion Street, qershor 2011, gjendet në <http://www.merriionstreet.ie>.
  39. Ghana Web, 2011, vepër e cituar. Propozimet u bënë gjatë një seminari, *Women's Manual Towards Increased Women's Parliamentary Representation (Manuali i grave drejt rritjes së përfaqësimit në parlament të grave)*, mbajtur në Akra, Ganë, shkurt 2011.
  40. Llanos & Sample, 2009, vepër e cituar., f. 35.
  41. ACE, *Roles and Definition of Political Parties (Rolet dhe përkufizimi i partive politike)*.
  42. Ballington, 2008, vepër e cituar.
  43. Politikat iKNOW, 'Consolidated Response on Working With Women Candidates and Women Voters During Elections,' (Përgjigja e konsoliduar për ngritjen e seksioneve partiake të grave) gjendet në <http://www.iknowpolitics.org/node/6490>, 2008.
  44. Intervistat me kandidatë dhe politikane të ndryshme gra për përvojat e tyre personale gjenden në Rrjetin Ndërkombëtar të Njohurive për Gratë në Politikë, gjendet në <http://www.iknowpolitics.org/news/interviews>.
  45. IPU, *Survey on Equality in Politics: Summary Overview (Anketim për barazinë në politikë: Përmbledhje)*, IPU, Gjenevë, Zvicër, 2008.
  46. Llanos & Sample, 2009, vepër e cituar.
  47. United Nations DPKO/DFS, *Joint Guidelines on Enhancing the Role of Women in Post-Conflict Electoral Processes (Udhëzime të përbashkëta për rritjen e rolit të grave në proceset zgjedhore pas konflikteve)*, DPKO/DFS, Nju Jork, SHBA, 2007, f. 31.
  48. ACE, 'Parties as Election Monitors,' (Partitë si vëzhgues të zgjedhjeve) Rrjeti i njohurive zgjedhore i ACE-s, gjendet në <http://aceproject.org/ace-en/topics/pc/pcc/pcc11/?searchterm=partyagents>.
  49. OSCE/ODIHR, *Handbook for Monitoring Women's Participation in Elections (Doracak për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje)*, OSCE/ODIHR, Varshavë, Poloni, 2004, f. 40.



50. Lidhja e Grave e ANC-së, *ANCWL outreach empowerment programme in full swing (Programi i fuqizimit në terren i ANCWL-së në kulmin e tij)*, gjendet në <http://www.anc.org.za/wl/show.php?id=8194>, 28 prill 2011.
51. United Nations DPKO/DFS, *Joint Guidelines on Enhancing the Role of Women in Post-Conflict Electoral Processes (Udhëzime të përbashkëta për rritjen e rolit të grave në proceset zgjedhore pas konflikteve)*, DPKO/DFS, Nju Jork , SHBA, 2007, f. 28.
52. Po aty.
53. Ballington, 2008, vepër e cituar.
54. Po aty.
55. Po aty.
56. Po aty.
57. Hijab, Nadia, *Quick Entry Points to Women's Empowerment and Gender Equality in Democratic Governance Clusters (Pika të shpejta hyrëse për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në grupet qeverisëse demokratike)*, UNDP, Nju Jork, SHBA, 2007, f. 20.
58. Ballington, 2008, vepër e cituar., f. 50.
59. Ghana Web, vepër e cituar.
60. Ballington, 2008, vepër e cituar.
61. Shihni <http://www.awli-kg.org/en/> për më shumë informacion.
62. Lokar, Sonja, 'A Short History of Quotas in Slovenia,' (Një histori e shkurtër e kuotave në Slloveni) paraqitur në *The Implementation of Quotas: European Experiences Conference (Zbatimi i kuotave: konferencë për përvojat evropiane)*, Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë për Demokracinë (International Institute for Democracy and Electoral Assistance - IDEA)/Central Eastern European (CEE) Network for Gender Issues (Rrjeti Evropian Qendror dhe Lindor për Çështjet Gjinore), Budapest, Hungari, 22-23 tetor 2004.



## PJESA B: RASTE STUDIIMI

UNFOTO/PTICIA ESTEVE



## PAK INFORMACION

Kjo pjesë përmban raste studimi të veprimeve të ndërmarra nga partitë politike për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë. Shumë prej shembujve të përdorur në të gjithë Pjesën A, janë marrë nga rastet e studimit të përfshira në Pjesën B. Këto janë studime nismash të ndryshme partiake ose të organizatave të shoqërisë civile, dhe jo analiza gjithëpërfshirëse të gjendjes së të gjitha partive në vendet nën shqyrtim. Ishte e pamundur që të mund të paraqisnim të gjitha nismat e partive në këtë fushë, ndaj edhe ky studim duhet të ishte përzgjedhës. Rastet e studimit të partive politike janë marrë nga këto vende: Armenia, Australia, Burkina Faso, Kamboxhia, Kanadaja, Kroacia, Salvadori, Meksika, Maroku, Ruanda, Afrika e Jugut, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç këtyre, janë paraqitur edhe një numër rastesh studimi më të shkurtra, që jepen nëpër Kuti, ku bëhen përmbledhje informacioni për çështjet kyçe, nga vende si India, Indonezia, vendet e Afrikës Jugore (Mauricius, Mozambiku, Namibia), Peruja, Serbia dhe Timori Lindor.

Rastet e studimit janë organizuar në rend alfabetik. Ato bëjnë një kombinim të studimit të literaturës dhe intervistave të thelluara me drejtues të tanishëm dhe të mëparshëm të partive politike, përfaqësues partish, dhe anëtarë të shoqërisë civile që kanë njohuri për partitë dhe për nismat e paraqitura këtu. Janë bërë përpjekje për të përfshirë shembuj të shumëllojshëm nga pikëpamja gjeografike, të ideologjisë partiake, të llojit të sistemit politik dhe strategjive të përdorura. Rastet e studimit japin një informacion për zgjedhjen dhe zbatimin e strategjive të caktuara, si dhe përshkruajnë ndikimin që kanë pasur ato. Secili rast studimi përpiqet të ofrojë mësimet e nxjerra ose praktikatat e mira që do t'i ndihmojnë partitë politike dhe ata që punojnë me partitë politike në krijimin dhe çuarjen përpara të strategjive reformuese.

## RASTE STUDIMI

Më poshtë vijon një listë me njëzet shembuj rastesh studimi që kanë shërbyer si bazë për shumë nga shembujt e dhënë në Pjesën A – Përmbledhje e **PRAKTIKAVE TË MIRA** (në disa raste, në Pjesën A janë paraqitur edhe disa shembuj jashtë gamës së këtij studimi, për të ilustruar çështje të caktuara). Në faqet në vijim jepen më shumë hollësi për këto raste studimi.

Vendi	Titulli	Shembull	Fjalë kyçe
<b>Afrika e Jugut</b>	Mobilizimi i grave dhe transformimi i agjendës politike	Kongresi Kombëtar Afrikan	Mobilizimi i grave Kuota vullnetare partiake
<b>Afrika Jugore (kuti)</b>	Mësime rajonale për shtyrjen përpara të periudhave kalimtare dhe institucionalizimin e praktikave partiake për barazi gjinore	Mozambik (Fronti Çlirimtar i Mozambikut) Namibia Mauricius	Politikat partiake
<b>Armenia</b>	Ndërtimi i koalicioneve për ushtrimin e trysnisë për zbatimin e kuotave	Forumi për Gratë në Drejtim (Organizatë e Shoqërisë Civile)	Mobilizimi i grave Kuota të parashikuara me ligj
<b>Australia</b>	Kuota dhe rrjete për ngritjen e fondeve brenda partive	Partia Laburiste e Australisë	Kuota brenda partive Rrjete për ngritjen e fondeve
<b>Burkina Faso</b>	Kuota vullnetare dhe të parashikuara me ligj në partitë politike	Kongresi për Demokraci dhe Përparim	Kuota vullnetare në parti Kuota të parashikuara me ligj Mekanizma financimi
<b>India (kuti)</b>	Kuotat, rezervimet dhe partie politike	Të përgjithshëm Partia Bharatiya Janata	Vende të rezervuara në parlament
<b>Indonezia (kuti)</b>	Rekrutimi i kandidatëve dhe kuotat e partive politike	Partia Demokratike Indoneziane e Betejës	Rekrutimi i kandidatëve
<b>Kamboxhia</b>	Mbështetje nga forumi i grave për promovimin e grave brenda partisë dhe për zgjedhjen e tyre në poste	Partia Sam Rainsy	Mobilizimi i grave Mbështetje për fushatën e grave kandidatë
<b>Kanadaja</b>	Mbështetja e kandidateve gra përmes rrjeteve të financimit dhe rregullave për emërimin e kandidatëve	Partia liberale	Rrjetet e financimit Rregullat për emërimin e kandidatëve Platformat partiake
	Rekrutimi i kandidatëve të shumëllojshëm dhe subvencionime për shpenzimet e fushatës	Partia e Re Demokratike (kuti)	Emërimi i kandidatëve Shpenzimet e fushatës
<b>Kroacia</b>	Mbështetje nga forumi i grave për kuotat e kandidatëve dhe trajnime për ndërtim kapacitetesh	Partia Socialdemokrate	Mobilizimi i grave Forumi i grave të partisë Kuotat e brendshme të partisë
<b>Maroku</b>	Aktivizmi ndër-sektoral për promovimin e kuotave të kandidatëve të partive	Organizatat e Shoqërisë Civile	Mobilizimi i grave Kuotat e kandidatëve Kuotat e brendshme të partive
<b>Mbretëria e Bashkuar</b>	Emërimi i kandidateve gra në zona zgjedhore të sigurta	Të përgjithshme Partia Konservatore	Emërimi i kandidatëve Reforma politike në parti
<b>Meksika</b>	Mbështetja e përfaqësimit të grave përmes kuotave dhe fondeve shtetërore për trajnim	Partia e Veprimit Kombëtar	Mobilizimi i grave Financimi i kandidatëve Kuotat e brendshme të partive
<b>Peruja (kuti)</b>	Forumi i grave avokaci për kuotat	Të përgjithshme	Kuotat
<b>Ruanda</b>	Përdorimi i kushtetutës për të institucionalizuar përfitimet e grave pas konflikteve	Fronti Patriotik i Ruandës	Kuotat vullnetare dhe të parashikuara me ligj Mobilizimi i grave
<b>Salvador</b>	Strategji për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikat pas çlirimit	Fronti Farabundo Marti për Çlirim Kombëtar Shoqata e Deputeteve dhe Ish-Deputeteve Salvadoriane	Organizimi i brendshëm i partisë Kuota vullnetare Grupi i grave
<b>Serbia (kuti)</b>	Mobilizimi i forumit të grave të partisë për arritjen e ndryshimeve politike	G17 Plus	Mobilizimi i grave Forumi i grave
<b>Spanja</b>	Puna në partneritet me burrat për të transformuar mjedisin politik për gratë	Partia Socialiste e Punëtorëve	Partneriteti me burrat Kuotat e brendshme të partive Mobilizimi i grave
<b>Shtetet e Bashkuara të Amerikës</b>	Rrjete për mbledhje fondesh dhe politika të barazisë gjinore për konventat partiake	Partia Demokratike	Mobilizimi i grave Rrjetet e financimit Organizata partiake
<b>Timori Lindor (kuti)</b>	Krijimi i shtysave për të nxitur rekrutimin e kandidateve gra	Administrata Kalimtare e Kombeve të Bashkuara për Timorin Lindor	Kuotat Kohë transmetimi në media

## AFRIKA E JUGUT: MOBILIZIMI I GRAVE DHE SHNDËRRIMI I AGJENDËS POLITIKE<sup>1</sup>



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave  
Kuota vullnetare në parti

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Kongresi Kombëtar Afrikan

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: AFRIKA E JUGUT

Emri i parlamentit	Parlamenti i Afrikës së Jugut
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Asambleja Kombëtare dhe Këshilli Kombëtar i Krahinave)
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional (Dhoma e ulët)
Zgjedhjet legjislative	Prill 2009
Numri i grave të zgjedhura	174 nga 400 (44%)

### Pak informacion

Afrika e Jugut filloi tranzicionin drejt demokracisë pas një historie të gjatë segregimi racor nën sistemin e aparteidit. Në vitin 1993 parlamenti miratoi një kushtetutë të përkohshme, që hyri në fuqi më 27 prill 1994. Më vonë, Asambleja Kushtetuese, e përbërë nga të dyja dhomat e parlamentit së bashku, hartoi kushtetutën e vitit 1996. Në vitin 1994 për herë të parë në historinë e Afrikës së Jugut u mbajtën zgjedhje të përgjithshme të lira, duke bërë të mundur zgjedhjen e Nelson Mandelës si presidenti i parë me ngjyrë të vendit. Në vitet që nga rënia e aparteidit, vendi ka bërë përparim të konsiderueshëm demokratik. Demokracia e Afrikës së Jugut karakterizohet nga zgjedhje të rregullta e të besueshme, liria e mjeteve të informacionit, dhe një shtet ligjor relativisht i fuqishëm.

Kongresi Kombëtar Afrikan (ANC) dhe partnerët e tij aletë (Kongresi i Sindikatave të Afrikës së Jugut dhe Partia Komuniste e Afrikës së Jugut) janë partitë kryesore që dominojnë jetën politike të vendit. Asambleja kombëtare

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Kombëtar Afrikan Australiane për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve. Ai nënvizon se si mobilizimi i grave brenda ANC-së ka ndikuar në miratimin e kuotave vullnetare në parti. Ky rast studimi fokusohet në pjesëmarrjen e grave në Asambleenë Kombëtare, ndonëse duhet të vihet në dukje se janë bërë përparime të rëndësishme në pjesëmarrjen e grave edhe në Këshillin Kombëtar të Krahinave dhe në nivelet e krahinave dhe ato vendore.

me 400 anëtarë zgjidhet përmes një sistemi zgjedhor me lista përfaqësimi proporcional, me lista të mbyllura partiake. ANC ka 65 për qind të vendeve në Asambleenë Kombëtare. Vendet e tjera ndahen ndërmjet 12 partive, ndër të cilat Aleanca Demokratike, Kongresi i Popullit, Demokratët e Pavarur, dhe Partia Inkatha e Lirisë. Gratë kanë 44 për qind të vendeve në parlament.<sup>2</sup>

### Baza arsyetuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave

Pas një lufte të gjatë kundër një sistemi qeverisjeje shtypëse, të karakterizuar nga racizmi institucional, patriarkalizmi dhe shtypja, në vitin 1994, një demokraci e re solli mandatin e përparimit të vendit drejt një shoqërie demokratike, jo-racistike dhe jo-seksiste.<sup>3</sup> Përkushtimi i Afrikës së Jugut ndaj barazisë gjinore është i mishëruar në Kushtetutë, nën Kartën e të drejtave, që përfshin pranimin e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha grave dhe të gjithë burrave, si dhe pranimin e mungesës së seksizmit.<sup>4</sup>

Vullneti i fuqishëm politik në radhët e udhëheqësve të Afrikës së Jugut, për të çuar përpara pjesëmarrjen e grave, ka qenë një faktor kyç në themelimin e një makinerie gjithëpërfshirëse kombëtare për përparimin e barazisë gjinore, ku u përfshinë edhe struktura si Zyra e Statusit të Grave dhe Komisioni për Barazi Gjinore. Qeveria e Afrikës së Jugut e ka forcuar edhe më tej përkushtimin e saj duke u bërë anëtare e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale që promovojnë barazinë gjinore; duke nxitur kështu integrimin e grave në politikën dhe programet qeveritare; duke paraqitur ligje të reja që kanë për qëllim promovimin e fuqizimit të grave, përfshirë edhe gratë që përballen me varfërinë, në fusha si shërbimet shëndetësore, mirëqenia sociale, strehimi, furnizimi me ujë dhe arsimit; si dhe duke përfshirë një numër më të madh grash në poste të larta në qeverisje.

### Strategjitë e përdorura

Ngritja e grave që në fillim në poste kyçe drejtuese në strukturat e partisë ndihmoi që të garantohet se gratë aktiviste të ANC-së do të kishin një vend në tryezën e diskutimeve gjatë transformimeve që po kalonte vendi dhe partia. Këto vende ato i përdorën për të institucionalizuar një kornizë të barazisë gjinore përmes dokumenteve të

rëndësishme të partisë. Mobilizimi i grave të ANC-së luajti një rol qendror për sigurimin e pjesëmarrjes së grave në udhëheqjen e partisë dhe në proceset kyçe të negociatave në vitet 1990.

#### A. MOBILIZIMI I GRAVE

Gratë e Afrikës së Jugut luajtën një rol qendror në luftën kundër regjimit të aparteidit, duke dalë shpesh në protesta në rrugë. Më 9 gusht 1956, 20 mijë gra marshuan për në Pretoria, në protestë kundër ligjeve të sapo-propozuara që do të bënin të detyruar mbajtjen me vete të dokumenteve të lejkalimit.<sup>5</sup> Gratë anëtare të ANC-së edhe sot e përmendin këtë marshim historik si momentin kyç kur gratë e të gjitha racave dhanë prova për fuqinë e tyre si katalizatore të ndryshimit. Ajo ditë tani festohet si festë kombëtare dhe njihet me emrin Dita Kombëtare e Grave. Refreni i këngës së atij marshimi: “Keni prekur gratë, keni goditur gurin, keni lëvizur shkëmbin, do të shtypeni nën peshën e tij! – ende përdoret në lëvizjen e grave, që nënvizon rëndësinë e kësaj ngjarjeje historike për gratë dhe për politikën e vendit sot.

Gjatë negociatave kushtetuese që u zhvilluan nga viti 1992 deri në 1994, organizatat e grave luajtën rol kyç për të siguruar që nevojat dhe interesat e grave të bëheshin pjesë e debatit për të drejtat. U krijua Koalicioni Kombëtar i Grave (WNC) që kapërcente ndarjet racore dhe ideologjike, me synimin për të ushtruar ndikim në proceset kushtetuese.<sup>6</sup> Pas një fushate dy vjeçare kombëtare ku u përfshinë më shumë se 2 milion gra, WCN nxori një Kartë të Barazinë Efektive të Grave, që shprehte shpresat e grave jug-afrikane dhe theksonte rëndësinë e objektivit të barazisë gjinore. Në WCN u angazhuan gra anëtare të të gjitha partive politike, të cilat arritën një konsensus midis tyre që të ushtronin trysni për fuqizimin e grave dhe përfshirjen e grave kandidatë në zgjedhjet parlamentare. WCN-ja propozoi që shteti i ri duhet të përfshinte një “paketë” institucionesh për promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore: në parlament të krijohet një grup parlamentar i grave; në qeveri të kishte një Zyrë të Statusit të Grave; si dhe një Komision të Pavarur për Barazinë Gjinore.<sup>7</sup>

Gjatë periudhës së rezistencës aktive, gratë ose u zgjedhën, ose u caktuan në strukturat drejtuese të ANC-së, gjë që

krijoi një prani të dukshme të grave brenda lëvizjes, por edhe një ndërgjegjësim për gjërat që i shqetësonin gratë dhe rolin e tyre në politikë, ndër udhëheqësit e partisë. Përveç kësaj, lëvizja nacional-çlirimtare ndoqi një politikë të barazisë dhe të mungesës së seksizmit, mbi bazën e një agjende të fuqishme të të drejtave të njeriut. Presidenti i vendit, Thabo Mbeki, në Konferencën Ndërkombëtare të Solidaritetit, në vitin 1993, tha “Vizioni ynë i përbashkët për një shoqëri me të vërtetë jo-raciste, jo-seksiste, dhe demokratike nuk mund të realizohet nëse nuk zgjidhim me sukses çështjen e zhvillimit, në kuptimin më të plotë të kësaj fjale.”<sup>8</sup>

Organizimi i grave gjatë periudhës së tranzicionit do të thoshte që ato qenë në gjendje të hynin në epokën demokratike të përgatitura me agjenda të reja. Gratë morën pjesë në strukturat që u ndërtuan për tranzicionin, si për shembull në organet për hartimin e kushtetutës, organet për ri-hartimin e rregullave partiake për sistemin e ri, dhe në qeverinë e parë. Karta e Grave, një dokument i brendshëm i ANC-së, që bënte thirrje për barazi të grave në të gjitha nivelet partiake dhe racore, më vonë u bë pjesë e kushtetutës së vendit. Organizatat e grave në nivelin e bazës luajtën një rol të rëndësishëm për hartimin dhe ushtrimin e trysnisë për miratimin e të gjitha këtyre nismave. Struktura e Lidhjes së Grave të ANC-së, forumi i grave i ANC-së (ANCWL) bëri të mundur që gratë në nivelin e bazës në të gjithë vendin të kishin lidhje me atë që po ndodhte në nivel kombëtar, duke i hapur kështu rrugën një udhëheqjeje të re dhe më dinamike, me një përfaqësim më të gjerë të grave të klasës punëtore, që ato të kishin rol të dukshëm brenda partisë. Debatet e organizuara në nivelin e bazës ndihmuan që të nxirreshin në pah çështjet e grave, dhe u përdor një gazetë për të ndihmuar në mobilizimin e fondeve për gratë.<sup>9</sup>

## B. KUOTA VULLNETARE BRENDA PARTISË

Përpjekjet e fuqishme të avokacisë nga ana e grave aktiviste të partisë, bënë që ANC të krijonte disa mekanizma dhe politika vullnetare për të siguruar përfaqësimin e grave në arenën politike të Afrikës së Jugut. ANCWL-ja vazhdimisht e ngrinte çështjen e barazisë gjinore brenda strukturave të partisë. Përpara zgjedhjeve të vitit 1994, gratë në ANC kërkuan dhe fituan një kuotë që siguronte se të paktën 30 për qind e kandidatëve në listat e partisë do të ishin gra. Ndonëse nuk u bë asnjëherë pjesë e një ligji,

kuota u pasqyrua në Procesin për Miratimin e Listave të ANC-së për zgjedhjet kombëtare, që u finalizua në tetor të vitit 1993. Kuota prej 30 për qind u zbatua në zgjedhjet që u zhvilluan në periudhën nga 1994 deri në 2004. Kuota u rrit në 50 për qind gra kandidatë përpara zgjedhjeve të vitit 2009 dhe, si rezultat, 40 për qind e anëtarëve të grupit parlamentar të ANC-së janë gra.

Një strategjitë zakonshme që kanë përdorur gratë e ANC-së në të gjitha përpjekjet e tyre për të realizuar synimet e tyre brenda partisë, ka qenë ushtrimi i trysnisë ndërkombëtare. Brenda rajonit të Afrikës Jugore, ANCWL-ja, në bashkëpunim me aktivistet e shoqërisë civile kanë bërë fushatë mjaft energjike për anëtarësimin e Afrikës së Jugut në Komunitetin për Zhvillimin e Afrikës Jugore (SADC, 1997) dhe në Protokollin për Gjininë dhe Zhvillimin të SADC-së (2008), që parashikonte barazi të grave në postet vendimmarrëse. Përmes anëtarësimit të saj në Internacionalen Socialiste, ANCWL ruan lidhje të ngushta me organizata politike me pikëpamje të njëjta, ndër të cilat edhe forumet e grave të 157 partive në të gjithë botën.<sup>10</sup>

## Rezultatet

Përpara miratimit të kuotave të ANC-së, përfaqësimi i grave në parlament nuk e kishte kaluar asnjëherë 4 përqindëshin. Në zgjedhjet e vitit 2009, Afrika e Jugut iu afrua shumë barazisë, duke zgjedhur 44 për qind gra deputete në parlamentin e vet, që e vë atë në vendin e tretë në listën globale të vendeve me më shumë gra në parlament. Megjithatë, gratë në ANC ushtrojnë ndikim jo vetëm për shkak të numrit të tyre në parlament. Ato kanë poste zyrtare në pothuaj çdo nivel qeverisjeje, dhe kanë qenë në poste si zëvendës presidente, ministre, kryetare parlamenti dhe kryetare grupi parlamentar. Gratë po përfaqësohen gjithnjë e më shumë edhe në strukturat dhe këshillat bashkiake. Me këto arritje, gratë në parti mendojnë se barazia gjinore është e mishëruar plotësisht në vizionin dhe parimet e ANC-së. Prania e grave në poste dhe funksione kyçe ka kontribuar gjithashtu edhe në miratimin e një numri ligjesh në parlament, ndër të cilat Ligji për Mbështetjen Financiare të Fëmijëve, Ligji për Barazi në Punësim Ligji për Dhunën në Familje, dhe Ligji për Abortin.



Ndërkohë, edhe shumë parti të tjera e kanë pranuar se është e rëndësishme t'u përgjigjen nevojave të grave votuese. Aleanca Demokratike dhe Demokratët e pavarur, që të dyja udhëhiqen nga gra dhe kanë ndërmarrë nisma për të miratuar një platformë që merr parasysh çështjet gjinore.

Suksesi i lëvizjes së grave në Afrikën e Jugut në tranzicionin e vendit në demokraci, është i njohur për studiuesit dhe aktivistët. Tranzicioni pas betejave nacionaliste çoi në përfshirjen e çështjeve të barazisë gjinore në zemër të debateve demokratike. Pjesëmarrja e grave në politikë u shtri edhe në arenën e qeverisjes përfaqësuese dhe u krijuan një numër institucioneesh për të mbrojtur interesat e grave gjatë hartimit të politikave

### Sfidat dhe rruga përpara

Një mësim kryesor është se kur gjendemi përballë momenteve kyçe të tranzicionit, qoftë për shkak të përfundimit të një konflikti, ndryshimit të regjimit politik, apo për shkak të faktorëve të tjerë, roli i grave në sistemin e ri duhet të institucionalizohet. Në Afrikën e Jugut, gratë që kishin një vend në tryezën e bisedimeve gjatë periudhës së tranzicionit punuan për të siguruar që kolegët e tyre burra të zbatonin strategji gjithëpërfshirëse që do të forconin angazhimin e ANC-së ndaj grave në parti, kushtetutës, dhe institucioneve politike. Siç u vu në dukje nga një anëtare partie që intervistua, ligjet me ndjeshmëri gjinore “janë të domosdoshme për të mos lejuar rrëshqitjen mbrapa ose ndonjë kundërvënie të brezave të ardhshëm ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë, të cilët mund të mos e kuptojnë ose të mos jenë në dijeni të kontekstit se pse është e rëndësishme pjesëmarrja e grave në politikë; në qoftë se kuotat nuk sanksionohen në kushtetutë, apo nuk përfshihen në normat ligjore, nuk ka garanci.”

Ndonëse gratë e Afrikës së Jugut kanë arritur rezultate të prekshme përmes miratimit të masave dhe politikave të veçanta, Afrika e Jugut vazhdon të mbetet thellësisht e ndikuar nga e kaluara e saj e aparteidit, dhe zhvillimet në epokën pas aparteidit kanë qenë të pabarabarta. Vendi përjeton një nga hendeqet më të mëdhenj ndërmjet të varfërve dhe të pasurve në botë. Gratë mbajnë barrën dhe pasojat kryesore të këtij zhvillimi të pabarabartë dhe varfërie të pandërprerë, dhe vazhdojnë të jenë shumë më tepër të

prekura nga HIV/SIDA. Pabarazia gjinore vazhdon të jetë e ngulitur thellë në strukturat dhe qëndrimet e shtetit dhe të institucioneve civile. Në një fjalim që mbajti para ANC-së në vitin 2008, Kryetarja e atëhershme e Lidhjes së Grave Nosiviwe Mapisa-Nqakula vuri në dukje se “shumica e grave të Afrikës së Jugut nuk i kanë provuar ende frutat e lirisë, sidomos gratë e klasës punëtore, ato rurale dhe gratë e varfra.” Ndërkohë që Afrika e Jugut bën përpjekje për të konsoliduar demokracinë e vet, ajo do të përballet gjithnjë e më shumë me trysinë për të siguruar që gratë e të gjitha racave dhe origjinave sociale duhet të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga politikat e saj dhe duhet të marrin pjesë në mënyrë efektive në qeverisjen e institucioneve të saj politike.

### Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU) dhe UNDAW. (2010). Map on Women in Politics: 2010. (Hartë për gratë në politikë) Gjetet në [http://www.ipu.org/pdf/publications/wmnmap10\\_en.pdf](http://www.ipu.org/pdf/publications/wmnmap10_en.pdf), parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Constitution of the Republic of South Africa, Bill of Rights, Act 108 of 1996. (Kushtetuta e Republikës së Afrikës së Jugut. Karta e të Drejtave, Ligji 108 i vitit 1996) Gjetet në <http://www.info.gov.za/documents/constitution/1996/a108-96.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> South African History Online (Historia e Afrikës së Jugut në Internet). “20 000 women march to the Union Buildings in protest of Pass Laws.” (20 mijë gra marshojnë për tek ndërtesat e Bashkimit për të protestuar kundër ligjeve të miratuara). Gjetet në <http://www.sahistory.org.za/dated-event/20-000-women-march-union-buildingsprotest-pass-laws>, parë në janar 2012.

<sup>6</sup> Meintjes, S. (2004). “South Africa: Beyond Numbers.” (Afrika e Jugut: Përtej Numrave). Në Julie Ballington dhe Azza Karam, redaktorë (2005). Women in Parliament: Beyond Numbers, (Gratë në parlament: përtej numrave) Stockholm, Suedi: International IDEA, f. 230. Gjetet në <http://www.idea.int/publications/wip2/>, parë në janar 2012.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Thabo Mbeki. (1993). “Fjala e hapjes” mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare të Solidaritetit për temën “Nga aparteidi në paqe, demokraci dhe zhvillim”, 19 shkurt, Johannesburg. Gjetet në <http://www.anc.org.za/show.php?id=4570>, parë në janar 2012.

<sup>9</sup> Intervistë me një aktiviste të partisë ANC, tetor 2009.

<sup>10</sup> Gratë e Internacionales Socialiste është organizata ndërkombëtare e forumeve dhe lidhjeve të grave të partive socialiste, socialdemokrate dhe punëtore që janë anëtare të Internacionales socialiste. Aktualisht ka 157 organizata nga e gjithë bota. Më shumë informacion gjetet në <http://www.socintwomen.org.uk/>, parë në janar 2012.

## AFRIKA JUGORE: MËSIMET RAJONALE PËR TË SHFRYTËZUAR MUNDËSITË QË OFROJNË PERIUDHAT TRANZITORE DHE INSTITUCIONALIZIMI I PRAKTIKAVE PARTIAKE TË BARAZISË GJINORE<sup>1</sup>

Aktorët politikë në Mozambik dhe Namibi, shumë prej të cilëve dolën nga lëvizjet e luftës për pavarësi, i përdorën periudhat e tranzicionit për ta vendosur barazinë gjinore si në strukturat politike partiake ashtu edhe në kushtetutat e vendeve të tyre gjegjëse. Të dyja vendet krenohen tani me nivele të fuqishme të përfaqësimit politik të grave dhe demonstrojnë rëndësinë e shfrytëzimit të mundësive që lindin nga ndryshimet e mëdha qeverisëse për të avancuar gratë në politikë.

Në **Mozambik**, partia e Frontit të Çlirimit të Mozambikut (FRELIMO) filloi si një lëvizje anti-kolonialiste në vitin 1962 dhe, që në ato vite të para, i përfshiu gratë në luftën për pavarësi. Në vitin 1977, kur FRELIMO u shndërrua në një parti politike, përfshirja e grave mbeti një element kyç i misionit të partisë dhe gratë u përfshinë qëllimisht në strukturat e partisë në të gjitha nivelet, si dhe u krijua një forum i grave. Në vitin 1992, FRELIMO e institucionalizoi barazinë gjinore brenda partisë nëpërmjet zbatimit të një sistemi kuotash për të garantuar përfaqësimin e grave në të gjitha organet dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në janar të vitit 2010 gratë përbënin 42 për qind të parlamentit të Mozambikut dhe parlamenti zgjodhi Veronica Macamon si kryetare të tij, e para grua në këtë post.<sup>2</sup>

Në **Namibi**, kushtetuta e vitit 1990 u miratua pas fitimit të pavarësisë nga sundimi kolonial dhe aparteidi jug-afrikan. Duke ndërtuar mbi arritjet e luftës së vendit për pavarësi, kushtetuta vlerëson shumë rivendosjen e dinjitetit, barazisë dhe të drejtave të

“

MOZAMBIKU DHE NAMIBIA TREGOJNË SE PARTITË POLITIKE DHE QEVERITË QË KANË NDËRMARRË STRATEGJI PËRPARIMTARE PËR TË PËRMIRËSUAR PJESËMARRJEN E GRAVE NË POLITIKË MUND TË NDIKOJNË TEK NJËRA-TJETRA PËR TË NDËRMARRË NISMA TË NGJASHME OSE PLOTËSUESE.

”

”

njeriut.<sup>3</sup> Veçanërisht, Neni 23 lejon marrjen e masave dhe politikave të posaçme për të korigjuar “faktin që gratë në Namibi tradicionalisht kanë vuajtur nga një diskriminim i veçantë dhe se ato kanë nevojë të nxiten për të luajtur një rol të plotë, të barabartë dhe efektiv në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të kombit”. Mbi bazën e kushtetutës, parlamenti namibian miratoi Ligjin e Autoriteteve Lokale të vitit 1992, i cili parashikonte me ligj që zgjedhjet lokale të zhvilloheshin duke përdorur një sistem të listës partiake, ku të kishte të paktën dy gra për çdo këshill me 10 ose më pak anëtarë, dhe tre gra për çdo këshill me më shumë se 11 anëtarë. Ky ligj u forcua më tej në vitin 1997 dhe, si rezultat, 42 për qind e këshilltarëve të qeverisjes vendore dhe 40 për qind e kryetarëve të bashkive në Namibi tani janë gra.<sup>4</sup>

### INSTITUCIONALIZIMI I PRAKTIKAVE TË BARAZISË GJINORE TË PARTIVE POLITIKE

Mozambiku dhe Namibia tregojnë se partitë politike dhe qeveritë që kanë ndërmarrë strategji përparimtare





për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në politikë mund të ndikojnë tek njëra-tjetra për të ndërmarrë nisma të ngjashme ose plotësuese.

Para miratimit të legjislacionit për rritjen e kuotave të grave në parlamentin namibian në vitin 1997, udhëheqësit politikë në qeveri dhe Rrjeti Namibian i Manifestit të Grave punuan së bashku për të bindur partinë Swapo dhe partinë e opozitës, Aleanca Demokratike Turnhalle, që t'u bënin thirrje degëve të partisë të alternonin kandidatët burra dhe gra në listat partiake në nivel vendor.<sup>5</sup> Në zgjedhjet që vijuan, përqindja e përgjithshme e grave kandidate u rrit në 47 për qind.

Në **Mozambik**, disa ministri të qeverisë, të inkurajuar nga politika e FRELIMO-s për kuotat, filluan të zbatonin programe të përfshirjes gjinore në zhvillimin e politikave, gjë që çoi në shtimin e nismave qeveritare që përfshinin konsiderata gjinore.<sup>6</sup> Nën udhëheqjen e partisë FRELIMO, krahu ekzekutiv ka krijuar një mekanizëm të ri për t'u dhënë një platformë grave dhe çështjeve që janë përparësi për to, përmes krijimit të komiteve dhe komisioneve të posaçme të grave. Në mënyrë të ngjashme, në parlament u ngrit një komision për të trajtuar çështjet shoqërore, gjinore dhe të mjedisit. Sistemi gjyqësor ka ndërmarrë gjithashtu hapa për të përfshirë gratë në procesin legjislativ.

Këta shembuj ilustrojnë mënyrat në të cilat marrëdhëniet strategjike midis partive dhe qeverisë mund të zgjerojnë përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes politike të grave.

### PRANIMI I GJINISË DHE ETNISË

Në Mauricius, debati zgjedhor historikisht ka theksuar më shumë ndarjet etnike në dëm të konsideratave gjinore, ndaj edhe përfaqësimi i grave në Mauricius mbetet një nga më të ulëtët në vendet e Komunitetit Jug-Afrikan për Zhvillim (South African Development Community –SADC) me vetëm 18 për qind gra në parlament. Partitë politike të Mauriciusit kanë zhvilluar

më tej një sistem specifik për të garantuar që të gjitha grupet etnike të jenë të përfshira në politikë, që njihet si “Sistemi i humbësit më të mirë”, por për gratë nuk janë ndërmarrë iniciativa të ngjashme. Vëmendja që i jepet ndarjeve etnike në Mauricius ka dekurajuar daljen e organizatave të suksesshme ndërpartiake apo të ndonjë lëvizjeje të organizuar që të ndikojnë në qeveri për të trajtuar mungesën e balancës gjinore në politikë.<sup>7</sup> Mauriciusi tregon se në demokracitë që kanë një hapësirë të kufizuar veprimi për debatet e përfshirjes, përpjekjet e grupeve etnike dhe grave për të kërkuar pjesëmarrje të barabartë mund të përfundojnë që të konkurrojnë kundër njëra-tjetrës për të fituar njohje.

### SHËNIME

<sup>1</sup> Kjo kuti nuk paraqet një analizë të gjithanshme të të gjitha iniciativave apo të gjitha palëve të interesuara në vend që synojnë të promovojnë pjesëmarrjen politike të grave, por paraqet disa në hollësi veprimet konkrete të një partie.

<sup>2</sup> Sapa. (2010). “Mozambique’s First Woman Speaker.” (Kryetarja e parë e parlamentit të Mozambikut) Times Live. Gjetur në <http://www.timeslive.co.za/news/africa/article257512.ece>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Bauer, G. (2004). “The hand that stirs the pot can also run the country: electing women to parliament in Namibia” (Dora që përzie tenxheren mund të drejtojë gjithashtu edhe vendin: zgjedhja e grave në parlament në Namibi). *Journal of Modern African Studies*, 42(4): 479-509.

<sup>4</sup> Gender Links (Lidhjet gjinore). (2009). “Namibia: Women in Parliament likely to decline despite regional commitments (2009)” (Namibi: Numri i grave në parlament mund të bjerë me gjithë angazhimet rajonale) Gjetur në <http://www.genderlinks.org.za/article/forimmediate-release-namibia-women-in-parliament-likely-to-decline-despite-regional-commitments-2009-11-04>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> Bauer, 2004.

<sup>6</sup> Leigh Disney, J. (2008) “Women’s activism and feminist agency in Mozambique and Nicaragua” (Aktivizmi i grave dhe ndikimi feminist në Mozambik dhe Nikaragua). Temple University Press: Philadelphia, PA.

<sup>7</sup> Chiroro, B. (2005). “Engendering Democracy Through the Ballot Box in the Mauritius 2005 Elections” (Futja e demokracisë nëpërmjet kutisë së votimit në zgjedhjet e vitit 2005 në Mauricius) EISA Occasional Paper, Nr. 57. Gjetur në <http://www.eisa.org.za/PDF/OP37.pdf>, parë në janar 2012.

## ARMENIA: NDËRTIMI I KOALICIONEVE PËR TË NXITUR ZBATIMIN E KUOTAVE<sup>1</sup>

“

RASTI I ARMENISË SUGJERON SE KUOTAT MUND TË KENË TË RËNDËSISHME SI PJESË E NJË STRATEGJIE MË AFATGJATË, SI PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË, ASHTU EDHE PËR TË SJELLË MË SHUMË GRA NË POLITIKË.

”

### FJALË KYÇE

**Mobilizimi i grave**

**Kuota të parashikuara me ligj**

### SHEMBULL

**Forumi për Gratë në Drejtim (Organizatë e Shoqërisë Civile)**

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: ARMENIA

Emri i parlamentit	Asambleja Kombëtare
Struktura e parlamentit	Një-dhomëshe
Lloji i sistemit zgjedhor	Me anëtarë të përzier Proporcional
Zgjedhjet legjislativ	Maj 2007
Numri i grave të zgjedhura	12 nga 131 (9%)

### Pak informacion

Që kur fitoi pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991, zhvillimi demokratik i Armenisë ka qenë i ngadalhtë dhe ka hasur në disa vështirësi e sfida. Legjislativa e Armenisë përbëhet nga 131 anëtarë të zgjedhur me anë të një sistem zgjedhor i përzier, që kombinon listat partiake me zonat zgjedhore me një deputet. Në Armeni janë të regjistruara më shumë se 50 parti, nga të cilat pesë janë të përfaqësuara në parlament, ku shumicën e vendeve i ka Partia Republikane. Shumica e partive politike në Armeni dominohen nga personalitetet e udhëheqësve të tyre, gjë që pasqyrohet edhe në karakterin tejet të centralizuar të organizatave politike, i cili, nga ana e tij ka ndikuar në mundësitë dhe perspektivat e pjesëmarrjes së grave në politikë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, asnjë nga pesë gratë që hynë në garë për deputete në zonat zgjedhore me një deputet nuk arriti të fitonte; kurse nga ana tjetër, dymbëdhjetë gratë që u zgjodhën si deputete, u futën në parlament përmes listave të partive politike.<sup>2</sup> Në tërësi, vetëm 12 nga 131 vendet në parlament u fituan nga gratë.

Ky rast studimi fokusohet tek Forumi për Gratë në Drejtim, një organizatë e shoqërisë civile që ka punuar për të ngritur aksesin e grave në politikë në Armeni. Ndonëse nuk është rast studimi për një parti politike, ai është një shembull i dobishëm për bashkimin e grave nga i gjithë spektri politik për të krijuar ndërtim kapacitetesh dhe për të hartuar programe të përbashkëta për ushtrimin e ndikimit në partitë politike.

## Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Nga ana historike dhe kulturore, roli i grave në shoqërinë armene ka qenë i përqendruar në sferën private, ndërsa sfera publike dominohet kryesisht nga burrat.<sup>3</sup> Ndonëse politikat e kohës sovjetike bënë që gratë të ishin në gjendje të arsimoheshin dhe të hynin në forcat punonjëse në numër të paparë ndonjëherë, këto politika nuk u shoqëruan me ndryshime të ngjashme edhe në normat e ngurta gjinore, dhe si pasojë gratë mbanin barrën e dyfishtë të ngarkesës së plotë si brenda ashtu edhe jashtë shtëpisë. Ashtu si edhe në vendet e tjera ish sovjetike, tranzicioni për në ekonomitë e tregut në Armeni ishte një proces i gjinorizuar, nga i cili gratë humbën shumë prej avantazheve shoqërore dhe ekonomike që i kishin fituar gjatë kohës sovjetike, sado të vogla që kishin qenë ato. Këtu u përfshi edhe eliminimi i të gjitha kuotave sovjetike për pjesëmarrjen politike të grave pas pavarësisë së vitit 1991, që solli një rënie dramatike në aksesin e grave në sferën publike. Në vitin 1999 u fut përsëri një kuotë minimale e modifikuar, që përcaktonte se në parlament duhet të kishte minimumi 5 për qind gra.<sup>4</sup> Politika vazhdon të perceptohet si një sferë kryesisht mashkullore dhe që ka të bëjë me luftë dhe grindje për pushtet, perceptime që dekurajojnë angazhimin e grave.<sup>5</sup>

Në vitin 2005, Forumi për Gratë në Drejtëm (FGD) filloi të mobilizohej për të rritur përfaqësimin e grave në parlament dhe në politikë në përgjithësi. FGD-ja është një organizatë e shoqërisë civile (OSHC) kombëtare që ka punuar për të sjellë së bashku gra nga fusha të ndryshme profesionale dhe politike. FGD-ja u krijua si rezultat i një vargu mbledhjesh që u organizuan fillimisht në vitin 2005 nga organizata ndërkombëtare që donin të promovonin pjesëmarrjen e grave në politikë në Armeni. Gratë që morën pjesë në këto diskutime ishin dakord se një OSHC shumë-partiake, që do të kishte lidhje me të gjitha partisë, do të ishte instrumenti më i mirë për të çuar përpara interesat politike të rave. Kjo qasje u konsiderua si më e mundshme për të pasur sukses, sepse, përballë udhëheqjeve partiake të dominuara nga meshkujt, shpresa ishte që mobilizimi kolektiv do të sillte rezultatet më të mëdha për sa i përket strategjive të brendshme të partive. Rreth 400 gra nga e gjithë Armenia morën pjesë në mbledhjet e FGD-së, ndër të cilat edhe përfaqësueset nga të gjitha partitë e mëdha politike. FGD-ja udhëhoq nga një organ qeverisës i përbërë nga 16 gra, që u quajt Bordi i Bashkërendimit për Gratë në Drejtëm (BBGD).

## Strategjitë e përdorura

Duke pasur parasysh vështirësitë për arritjen e një reforme të institucionalizuar ligjore brenda mjedisit politik të Armenisë, FGD në fillim punoi që të merrte premtime nga partitë politike që të zbatonin një kuotë. Strategjia e FGD-së kishte në bosht të saj një fushatë avokacie që iu përshtat secilës prej partive dhe shfrytëzoi aleancat strategjike si me organizatat e shoqërisë civile, ashtu edhe me ato ndërkombëtare, për të demonstruar një mesazh të përbashkët për ndryshim.

### A. NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Përpjekjet e para të FGD-së kishin për qëllim gjithashtu që të ngrinin kapacitetet politike të anëtarëve të saj në Armeni dhe këto përpjekje u mbështetën nga organizata ndërkombëtare. Vendimet fillestare për formën dhe drejtimin që do të merrte FGD-ja u mbështetën tek disa formularë vlerësimi që u plotësuan nga anëtarët e FGD -së në lidhje me sfidat politike me të cilat përballen gratë armene. Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, anëtarët e FGD-së bënë trajnime për udhëheqjen, komunikimin, planifikimin strategjik, dhe fusha të tjera të li-dhura me to, dhe u mblodhën së bashku edhe për krijuar rrjete dhe për të hartuar strategji. Organizata gjithashtu hartoi një Deklaratë Synimi, që tregonte vizionin e saj për të pasur më shumë gra të zgjedhura në parlament në zgjedhjet e vitit 2007.

### B. KUOTAT

Duke ndërtuar mbi debatet e drejtuara nga organizatat e grave, deputetet në parlament dhe partitë politike, FGD-ja u bë pjesë e një lëvizjeje më të gjerë që kërkonte një reformim të kuotave të parashikuara me ligj për zgjedhjet. FGD-ja, së bashku me aktorë të tjerë të brendshëm civilë dhe politikë, argumentuan se kuotat ishin strategjia më e drejtpërdrejtë për të shtuar pjesëmarrjen e grave në politikë. Kuotat ekzistuese ligjore të Armenisë për gratë në listat partiake ishin përcaktuar në një përqindje shumë të ulët prej 5 për qind, dhe u zbatua për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2007. Duke qenë se reforma ligjore për ngritjen e përqindjeve të kuotave ishte shumë e vështirë, BBGD-ja u bëri gjithashtu thirrje drejtpërsëdrejti partive politike që të binin dakord të zbatonin një kuotë vullnetare partiake prej 25 për qind për gratë në listat e tyre partiake. BBGD-ja e konsideronte kuotën prej 25 për qind si një objektiv ambicioz, por ishte e mendimit se kjo ishte përqindja minimale e nevojshme që gratë të arrinin të kishin

ndikim. Synimi ishte që partitë kryesore të firmosnin një zotim solemn që do t'i përmbaheshin kësaj kuote e cila, ndonëse nuk ishte e detyrueshme me ligj, do të kishte përfaqësuar një përkushtim të konsiderueshëm për këtë synim.

Për shkak të karakterit shumë-partiak të udhëheqjes së FGD-së dhe natyrës së paanshme të organizatës, FGD-ja arriti të kontaktonte edhe me të gjitha partitë e tjera për mbështetjen e tyre për këtë nismë, duke shfrytëzuar për këtë anëtarët e BBGD-së që ishin drejtuese aktive në shumë prej partive politike. Në fillim, shumë nga udhëheqësit e partive i rezistuan trysnisë për ta nënshkruar zotimin, duke thënë se do të ishte e vështirë të gjendeshin gra të kualifikuara për të mbushur listat. Strategjia e FGD-së përfshinte një kombinim të takimeve dhe bisedimeve private me udhëheqësit e partive, si dhe veprimtari publike si konferenca shtypi dhe diskutime në tryeza të rrumbullakëta, që kishin për qëllim t'i bindnin partitë që të binin dakord me zotimin.

BBGD-ja kërkoi gjithashtu ndihmën e organizatave ndërkombëtare dhe OSHC-ve të tjera të grave, që ato të përdornin ndikimin e tyre tek partitë politike. BBGD-ja dhe organizata ndërkombëtare argumentuan se nënshkrimi i zotimit nga partitë do të tregonte përkushtimin e tyre për reformën demokratike dhe do t'u jepte atyre njohje si brenda edhe jashtë Armenisë. Me kalimin e kohës, disa parti u bindën nga argumente të ndryshme. Disa nga partitë e perceptonin shtimin e numrit të grave në listat e tyre si një mënyrë për të shtuar elektoratin e tyre, ndërsa të tjera kishin frikë se mos mbeteshin mbrapa ndërkohë që partitë e tjera fitonin terren tek elektorati femëror.

Në vitin 2006, FGD-ja arriti të siguronte zotime nga shumica e partive politike më të mëdha. Ndonëse Partia Republikane që ishte në pushtet nuk e nënshkroi zotimin, ajo la të kuptohet se partia do t'i ofronte mbështetjen e saj rritjes së pjesëmarrjes së grave në proceset politike. Ajo që ka shumë rëndësi është se të gjitha partitë që e nënshkruan zotimin, iu përmbajtën atij, megjithëse nuk kishte ndonjë sanksion ligjor të zbatueshëm nëse shkelnin zotimin.

Si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të FGD-së, OSHC-ve të grave dhe grave parlamentare, Asambleja Kombëtare e rishikoi edhe një herë ligjin zgjedhor, duke e shtuar kuotën nga 5 për qind në 15 për qind, si dhe duke përcaktuar se duhet të kishte të paktën një grua në çdo vend të dhjetë të listave të partive. Kuotat e reja treguan se konsensusi

që ndërtoi FGD-ja ndërmjet partive e kishte tërhequr me sukses vëmendjen tek problemi i nën-përfaqësimit të grave në Asambleshën Kombëtare.

FGD-ja ka treguar se ka për synim të punojë për të forcuar edhe më tej kuotat duke bërë avokaci për një sistem të ashtuquajtur "zebra" që do t'u siguronte grave të paktën një katër vende në listat e partive, si dhe zëvendësimin e grave me gra në listat partiake.

### Sfidat dhe rruga përpara

Rasti i Armenisë sugjeron se kuotat mund të jenë shumë të rëndësishme si pjesë e një strategjie më afatgjatë, si për forcimin e demokracisë, ashtu edhe për futjen e më shumë grave në politikë. Megjithatë, perceptimet negative për politikën vazhdojnë të jenë të fuqishme dhe ato shërbejnë si faktorë pengues për hyrjen në politikë, sidomos ndër gratë. Sukseset e FGD-së ishin një hap i parë i vlefshëm për të çuar përpara pjesëmarrjen e grave në një kontekst të vështirë politik, dhe tregojnë vlerën e bashkëpunimit strategjik midis partive dhe shoqërisë civile, si dhe potencialin e rrjeteve ndër-partiake të grave. Gratë armene mund të jenë pjesë e sjelljes së ndryshimeve demokratike në vendin e tyre, dhe strategjitë partiake, që u japin mundësi grave të zhvillohen si udhëheqëse politike dhe civile dhe të organizohen në rrjete, mund të hedhin themele të rëndësishme për gratë që ato të bëhen agjente ndryshimi.

### Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por shërben si një shembull i hollësishëm i veprimeve konkrete të një organizate. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). "Azgayin Zhoghov (Asambleja Kombëtare) e Armenisë." PARLINE Database. Gjetet në [http://www.ipu.org/parline/reports/2013\\_E.htm](http://www.ipu.org/parline/reports/2013_E.htm), parë në internet në janar 2012.

<sup>3</sup> Ohanian, A. (2009). "State-society nexus and gender: Armenian women in postcommunist context." (Nyja shtet-shoqëri dhe gjinia: gratë armene në kontekstin pas-komunist) Në S. J. Gelb dhe M. L. Palley (red.), *Women and Politics Around the World: A Comparative History and Survey (Gratë dhe Politika Anembanë Botës: Vështrim historik dhe sondazh krahasues)* Kaliforni, SHBA: ABC-CLIO, Inc., faqe 231-245.

<sup>4</sup> Dahlerup, D. dhe L. Freidenvall. (2003). "Quotas as a "Fast Track" to equal political representation for women: Why Scandinavia is no longer the model." (Kuotat si "rrugë e shpejtë" drejt përfaqësimit politik për gratë: Pse Skandinavia nuk është më shembulli model). Ligjëratë e paraqitur në Takimin Vjetor të APSA-s në Filadelfia, SHBA, 28-31 gusht. Gjetet në <http://www.avoixegales.ca/pdf/APSA5.pdf>; parë në internet në janar 2012.

<sup>5</sup> Ohanian, 2009.

## AUSTRALIA: KUOTAT E BRENDSHME PARTIAKE DHE RRJETET PËR NGRITJEN E FONDEVE PËR PROMOVIMIN E PËRPARIMIT TË GRAVE NË POLITIKË<sup>1</sup>

### Pak informacion

Australia është një demokraci e konsoliduar me dy parti kryesore, Partia Laburiste dhe ajo Liberale, dhe disa parti të tjera më të vogla të përfaqësuara në parlament. Dhoma e Ulët e parlamentit australian, ose Dhoma e Përfaqësuesve, i zgjedh anëtarët përmes votimit maxhoritar preferencial në zona elektorale me një deputet. I njëjti sistem ekziston edhe në parlamentet e disa shteteve të veçanta australiane. Për shkak të mbizotërimit të sistemit zgjedhor me një deputet për zonë zgjedhore, Partia Laburiste (e njohur me shkurtesën ALP), ka përdorur strategji të përfshirjes dhe mbështetjes së grave anëtare të saj, si dhe ka zbatuar kuota të brendshme partiake.

Pas zgjedhjes së saj si kryetare e Partisë Laburiste, Julia Gillard bë e para kryeministre grua e Australisë në qershor të vitit 2010, pasi kryeministri i mëparshëm, Kevin Rudd, vendosi të mos e kontestonte votimin që ishte bërë për zgjedhjen e kryetarit të partisë. Si kryetare e partisë ajo e udhëhoqi partinë e saj në zgjedhjet e gushtit të vitit 2010. Zgjedhjet nxorën parlamentin e parë të ashtuquajtur “të

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Laburiste Australiane për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve. Ai fokusohet në pjesëmarrjen e grave në Dhomën e Përfaqësuesve, ndonëse duhet të vihet në dukje se janë bërë përpertime të rëndësishme në pjesëmarrjen e grave në politikë edhe në Senat si dhe në disa legjislatura të shteteve të veçanta.



### FJALË KYÇE

**Kuota të brendshme në parti**

**Rrjetet për ngritjen e fondeve**

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

**Partia Laburiste Australiane**

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: AUSTRALIA

<b>Emri i parlamentit</b>	Parlamenti i Australisë
<b>Struktura e parlamentit</b>	Dy-dhomëshe (Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve)
<b>Lloji i sistemit zgjedhor</b>	Pluralist/Maxhoritar Dhoma e Përfaqësuesve
<b>Zgjedhjet legjislative</b>	Gusht 2010
<b>Numri i grave të zgjedhura</b>	35 nga 150 (24%)

varur” që prej vitit 1940, term që përdoret kur asnjëra prej partive nuk siguron shumicën në parlament. Pas shumë negociatash politike, Gillard shpalli se Partia Laburiste do të krijonte një qeveri pakice, me mbështetjen e të Gjellbërve dhe tre deputetëve të pavarur.<sup>2</sup> Kjo ishte një ngjarje e pa precedent në nivel federal në Australi, ndonëse në nivelet e shteteve dhe territoreve të veçanta kishte pasur rëndom qeveri të pakicës.

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Strategjitë e Partisë Laburiste për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë e kanë zanafillën tek lëvizja dhe lëvizjet aktiviste dhe progresive shoqërore të viteve 1060 dhe 1970, si dhe tek arritjet zgjedhore të qeverisë laburistë të Gough Whitlam (1972-1975), i cili u hoq me anë të një “grushti shteti konstitucional” nga Guvernatori i Përgjithshëm në vitin 1975. Si një parti që përfaqëson australianët dhe australianet përparimtare, ALP gjithmonë ka tërhequr dhe thithur rrymat e reja përparimtare në Australi. Ndonjëherë këtyre u është bërë rezistencë përpara se sa të përfshiheshin në strukturat dhe praktikën e ALP-së. Kështu ndodhi për shembull me lëvizjen e grave në Australi, që luftoi në disa fushata, si publike ashtu edhe brenda Partisë Laburiste, për më shumë të drejta shoqërore dhe për më shumë përfaqësim brenda Partisë Laburiste.

Fitoret që arritën gratë nën qeverinë Whitlam ishin të rëndësishme dhe mjaft të mëdha. Ndër to ishin: paga e barabartë për gratë, modernizimi i ligjeve të vjetruara të Australisë për shkurorezimin, dhe emërimi i Këshilltares së parë të Kryeministrit për Çështjet e Grave. Me rënien e qeverisë Whitlam dhe humbjet e tjera elektorale të viteve 1977 dhe 1980, gratë në ALP kërkuan shpjegime për humbjen dhe mënyra të reja për t’i çimentuar arritjet e lëvizjes së grave. Mbi bazën e kësaj, partia krijoi disa komisione për të identifikuar fushat se ku duhet të bënte reformë partia, ndër të cilët ishte edhe një komision për statusin e grave. Gratë stratege politike brenda Partisë Laburiste që ishin edhe anëtare të këtij komisioni shfrytëzuan hulumtimet e opinionit publik dhe argumentuan se partia vuante sepse shihej nga njerëzit si e dominuar nga burrat. Komisioni i Statusit të Grave sugjeroi që partia të rriste numrin e

grave anëtare të saj si një strategji konkrete për të zgjeruar ndikimin tek elektorati.

## Strategjitë e përdorura

### A. KUOTAT E BRENDSHME PARTIAKE

Në fundin e viteve 1970, Komisioni për Statusin e Grave në Partinë Laburiste rekomandoi krijimin e një politike **masash të posaçme gjithëpërfshirëse**, e quajtur “Veprim Afirmativ” në zhargonin politik australian, që do të ndryshonte pamjen e partisë dhe proceset e saj vendimmarrëse. Megjithatë, për shkak të rezistencës nga udhëheqja e partisë e dominuar nga meshkujt, të cilët ishin kundër këtyre masave të posaçme, kjo politikë nuk u pranua në konferencën e Partisë Laburiste të vitit 1981. Konferenca e partisë ra dakord që të zbatonte një kuotë gjinore prej 40% për të gjithë komisionet e partisë dhe për strukturat e tjera vendimmarrëse të saj. Në vitin 1982, numri i grave të zgjedhura në parlament nga Partia Laburiste u shtua.

Megjithatë, kjo tendencë nuk u vazhdua, dhe në vitin 1994, në parlament kishte më pak deputete laburistë se përpara vitit 1982. Ndonëse kuotat brenda partisë kishin vite që ishin përcaktuar, partia mbeti e dominuar nga burrat. Për më tepër, pak gra po paraqiteshin si kandidatë dhe gratë në përgjithësi konsideroheshin si më pak “të zgjedhshme” se burrat. Shqetësimet e burrave në lidhje me aftësitë konkurruese elektorale të grave çuan në një farë niveli rezistence ndaj masave të posaçme të propozuara për kandidatet e Partisë Laburiste, si veprimi afirmativ.

Gratë aktiviste në Partinë Laburiste u përpoqën t’u kundërviheshin perceptimeve negative për gratë kandidatë, duke ngritur ndërgjegjësimin për rëndësinë dhe vlerën e pjesëmarrjes së grave brenda partisë. Ky grup i organizuar grash, ndër të cilat edhe disa funksionare të larta të zgjedhura, fillimisht i përqendruan forcat e tyre tek shtetet e Viktorias, Kuinzlendit, dhe Australisë Perëndimore. Në këto shtete, gratë drejtuese dhe komisionet partiake të grave, organizuan një sërë veprimtarish nën sloganin **“Gjysma deri në vitin 2000”**. Profili i spikatur publik i këtyre veprimtarive ushtroi një trysni mjaft të madhe mbi udhëheqjen e Partisë Laburiste që t’u jepte përgjigje kërkesave të anëtareve të saj. Aktivistet vunë në shënjestër kry-



eministrin e atëhershëm laburist, Paul Keating për ta bërë atë aleat në fushatën e tyre, duke vënë në dukje angazhimet e tij gojore për zgjerimin e rolit të grave në udhëheqjen e partisë. Mëshëtetja e Keating që me të vërtetë me shumë vlerë, sepse ai i kishte rrënjët tek krahu konservator i partisë, ku edhe kundërshtimi i masave të posaçme dhe i politikave që kërkonin rritjen e rolit dhe ndikimit të grave kishte qenë më i fuqishëm.<sup>3</sup>

Politika e masave të posaçme e bazuar tek kuotat u bë shtylla kurrizore e përpjekjeve të Partisë Laburiste për ta shndërruar imazhin e saj. Aktivistet e partisë bënë lobing për miratimin e **kuotave të brendshme** si dhe për një vlerësim nëse ishin vënë gra si kandidatë në zona zgjedhore “të sigurta”. Ato gjithashtu kryen një vlerësim të përparimit të përpjekjeve të para për zbatimin e kuotave, me qëllim që t’i jepnin partisë rekomandime konkrete për s i përket zbatimit të kuotave. Ndërkohë, drejtueset brenda Partisë Laburiste krijuan njësi partiake dhe jo-partiake për të ndihmuar me trajnimin, mbledhjen e fondeve dhe mentorimin e grave kandidatë.

## B. KUOTA VULLNETARE PËR KANDIDATËT

Në fillim të vitit 1994, konferenca e grave të Partisë Laburiste, një mbledhje vjetore e të gjitha grave anëtare të Partisë Laburiste, miratoi një rezolutë që mbështeste Programin e Veprimit Afirmativ, e cila kërkonte që partia të emëronte gra në 40% të vendeve të sigurta. Konferenca e grave e quante një vend “të sigurtë”, ose “të fituar” mbështetur mbi një numër faktorësh, si simpatitë partiake të deklaruara në atë zonë apo distrikt elektoral të caktuar. Pjesëmarrëset në konferencë gjithashtu bënë thirrje për sanksione kundër degëve të partisë në shtete dhe territore që nuk caktonin një numër të mjaftueshëm grash kandidatë.<sup>4</sup>

Më vonë atë vit, konferenca e përgjithshme e Partisë Laburiste miratoi rregulla për Veprimin Afirmativ për gratë, që përcaktonte një kuotë 35% deri në vitin 2002, për të gjitha kandidatet që vinin kandidaturën për vende të sigurta në parlamentet shtetërore dhe federale.

Miratimi i politikës së masave të posaçme nuk ishte gjë e lehtë.<sup>5</sup> Disa grupime të Partisë Laburiste e kundërshtuan miratimin e rregullit të masave të posaçme, dhe dy kry-

eministra shtetesh e kundërshtuan këtë politikë privatisht, por pastaj votuan pro kësaj politike si shprehje solidariteti me kryeministrin federal, i cili ishte përkrahës i kësaj nisme.<sup>6</sup> Pjesa më e madhe e anëtarëve me të drejtë vote në konferencë e miratuan politikën, dhe ranë dakord që të viheshin **sanksione** nëse listat e kandidatëve nuk përfshinin një numër të mjaftueshëm grash, si dhe hartimin e listave dhe para-zgjedhjeve të reja. Komisionet Administrative Shtetërore dhe Ekzekutivi Kombëtar i Partisë Laburiste u ngarkuan me detyrën që objektivat e Veprimit Afirmativ të përmbusheshin nga të gjitha degët dhe grupet e partisë. Deri më sot, këto komisione nuk i kanë zbatuar asnjëherë sanksionet e parashikuara.

Në zgjedhjet e vitit 1996, partia nuk qe në gjendje të përmbushte objektivat e sapo-miratuara të Veprimit Afirmativ, dhe nuk u pa ndonjë rritje e madhe në numrin e grave të zgjedhura. Gratë e Partisë Laburiste shumë shpejt e kuptuan se politika e Veprimit Afirmativ, në vetvete, ishte e pamjaftueshme për të ndryshuar përbërjen e institucioneve të ndryshme përfaqësuese në Australi, po trajtuar siç duhet edhe sfidat e tjera, si tradita partiake e dominimit të burrave dhe mungesa e fondeve “të hershme” që duheshin për të kaluar fazën e para-zgjedhjes brenda partisë, për t’u bërë kandidatë.

## C. RRJETET E FINANÇIMIT

Në vitin 1997 u krijua Rrjeti Kombëtar i Grave Laburiste. Ndryshe nga Lista EMILY, rrjeti nuk ishte një organizatë autonome dhe jepte llogari para Ekzekutivit Kombëtar të Partisë Laburiste. Në vitin 2000, si Lista EMILY, ashtu edhe Rrjeti Kombëtar i Grave Laburiste, vunë re se me gjithë përparimin e konsiderueshëm, objektivi i kuotave nuk ishte arritur në të gjitha shtetet, dhe kështu luajtën një rol kyç në kërkimin e një rivlerësimi të politikës së Veprimit Afirmativ të Partisë Laburiste. Konferenca e Rregullave Kombëtare që u zhvillua pak më vonë, në vitin 2002, përcaktoi një kuotë të re prej jo më pak se 40 për qind përfaqësim grash dhe burrash në postet e partisë, përfaqësitë e sindikatave, dhe për para-zgjedhje për poste publike dhe ato në nivel shtetëror dhe federal deri në vitin 2012, kurse 20 përqindëshi që mbetet mund të mbushet çdonjërin nga seksjet.<sup>7</sup>

## Rezultatet

Politika e Veprimit Afirmativ kanë qenë efektive për Partinë Laboriste. Në pesëmbëdhjetë vitet që nga miratimi i kësaj politike, numri i grave parlamentare është rritur me më shumë se dyfishin, nga 66 në vitin 1994 në 159 gra laboristë në maj të vitit 2009, që përfaqësojnë 37.6% të parlamentarëve laboristë në të gjithë Australinë. Në krahasim me të, partia tjetër kryesore australiane, ajo liberale, ka 53 gra që përfaqësojnë 22.7 për qind të parlamentarëve nga Partia Liberale. Partia Laboriste ka arritur sukses gjithashtu edhe në paraqitjen e disa grave të shquara udhëheqëse, ndër të cilat edhe kryeministret e para të shteteve të Kuinlendit, Australisë Perëndimore, Viktorias, Tasmanisë dhe Nju Sauth Uellsit, si dhe dy kryeministret e para të dy territoreve të brendshme australiane. Po Këtij numri i shtohen edhe kryeministria e parë federale si dhe gruaja e parë që u zgjodh me votim të drejtpërdrejtë si kryetare e Partisë Laboriste.<sup>8</sup>

Prania e më shumë grave në poste të fuqishme në parti i ka ndryshuar përparësitë legjislativë të Partisë Laboriste. Partia Laboriste ka arritur të sigurojë miratimin e reformave të të drejtave riprodhuese në disa legjislatura të shteteve. Partia gjithashtu ka luftuar me sukses për programet për shëndetin e grave, arsimimin e grave të moshës pas-shkollore, ligjet kundër dhunës në familje, praktikat e të drejtës për leje nga prindërit kur lindin ose kur sëmuren fëmijët, dhe legjislacionin për pagë të barabartë. Aty ku më parë këto nisma ishin konsideruar si “çështje të grave”, tani ato shihen si politika sociale që kanë rëndësi për të gjithë shoqërinë australiane dhe trajtohen si të tilla.

Në këtë mënyrë, programi i Veprimit Afirmativ dhe puna e bërë nga Lista EMILY e Australisë, së bashku, e kanë ndryshuar fytyrën e Partisë Laboriste. Një drejtuese e vjetër e grave në Partinë Laboriste u shpreh se parlamenti kombëtar dhe ato shtetërore “nuk duken më si klube vetëm për djem”.<sup>9</sup>

## Sfidat dhe rruga përpara

Për të ardhmen, gratë aktiviste në Partinë Laboriste po kërkojnë që gradualisht ta ngrenë objektivin e Veprimit Afirmativ në 50 për qind me qëllim që të rrisin dhe të vazhdojnë të ruajnë ndikimin e grave në proceset vendim-marrëse dhe platformat politikave të partisë.

Për t'i arritur këto objektiva të reja, Partisë Laboriste do t'i duhet t'i japë zgjidhje një hendeku në rritje midis brezave në bazën e simpatizantëve të saj, sepse forca tërheqëse e saj është më e madhe ndër gratë e moshës 30 deri 45 vjeç se ndër ato mbi 45 vjeç. Një nga të anketuarat shprehu mendimin se gratë mbi 45 vjeç ende mund ta konsiderojnë Partinë Laboriste si të dominuar kryesisht nga sindikata mashkullore, ndërsa gratë më të reja nuk e kanë këtë kujtesë institucionale. Politika e Veprimit Afirmativ dhe Lista EMILY në Australi demonstrojnë se si kombinimi i strategjive të përbashkëta mund të t'i sjellë gratë në poste udhëheqëse në politikë dhe politika të ndjeshme gjinore.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por shërben si një shembull i hollësishëm i veprimeve konkrete të një organizate. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). “Australia: Dhoma e Përfaqësuesve.” PARLINE Database. Gjetet në PARLINE Database. Gjetet në [http://www.ipu.org/parline-e/reports/2015\\_E.htm](http://www.ipu.org/parline-e/reports/2015_E.htm), parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Intervistë me ish-zyrtarë të zgjedhur të Partisë Laboriste australiane, gusht 2009.

<sup>4</sup> Partia Laboriste Australiane (2008). “Australian Labor’s Affirmative Action Campaign” (Fushata australiane e Partisë Labursite për Veprim Afirmativ”, Gjetet në [www.ip.alp.org.au](http://www.ip.alp.org.au).

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Intervistë me ish-zyrtarë të zgjedhur të Partisë Laboriste australiane, gusht 2009.

<sup>7</sup> IDEA, Stockholm University dhe IPU. (2011). “Australia: Electoral Quotas for Women (Kuotat zgjedhore për gratë). Gjetet në <http://www.quotaproject.org/uid/countryview.cfm?country=15>, parë në janar 2012.

<sup>8</sup> Intervistë me ish-zyrtarë të zgjedhur të Partisë Laboriste australiane, gusht 2009.

<sup>9</sup> Po aty.

## BURKINA FASO: KUOTAT VULLNETARE DHE TË CAKTUARA ME LIGJ PËR PARTITË POLITIKE<sup>1</sup>

### Pak informacion

Që nga koha e zhvillimit të zgjedhjeve legjislativ të vitit 1992, Burkina Faso ka përdorur një sistem përfaqësimi proporcional për të zgjedhur deputetët në parlamentin e saj. Gjatë kësaj periudhe skenën politike e ka dominuar partia politike Kongresi për Demokraci dhe Progres (KDP). Në vend ekzistojnë më shumë se 140 parti politike, shumica të drejtuara nga udhëheqës të fortë dhe me programe që në përgjithësi fokusohen në promovimin e zhvillimit kombëtar. Si të tilla, shumë nga këto parti mbeten para së gjithash organizata elektorale me nivel të ulët veprimtarie kur nuk ka periudha parazgjedhore, madje disa nga partitë zhduken fare me të mbaruar periudha zgjedhore.

Ashtu si në shumë vende të tjera në Afrikën Perëndimore, gratë kanë pasur një përfshirje shumë të kufizuar në forume vendimmarrëse në Burkina Faso.<sup>2</sup> Që nga zgjedhjet legjislativ të vitit 1997, organizatat e grave kanë ndërmarrë veprime për të bërë thirrje për një rritje në numrin e

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga partitë politike, politikanët dhe aktivistët për të promovuar pjesëmarrjen e grave në Burkina Faso. Ai shqyrton se si përpjekjet e bashkërenduara të grave aktive në politikë, së bashku me mbështetjen e drejtuesve meshkuj, kanë çuar në miratimin e kuotave të përcaktuara me ligj për gratë.



### FJALË KYÇE

Kuotat vullnetare në parti

Kuota të përcaktuara me ligj

Mekanizma financimi

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Kongresi për Demokraci dhe Përparim

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: BURKINA FASO

Emri i parlamentit	Asamble Kombëtare
Struktura e parlamentit	Një-dhomëshe
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional
Zgjedhjet legjislativ	Maj 2007
Numri i grave të zgjedhura	13 nga 111 (12%)

kandidaturave të grave në zgjedhje, përfshirë edhe përmes përdorimit të kuotave. Ndonëse disa parti kanë premtuar se do të mbështesin futjen e një kuote për gratë, ato nuk kanë vazhduar më tej me vënien në jetë të kësaj kuote. Në zgjedhjet e fundit të vitit 2007, gratë fituan vetëm 13 nga 11 vende në parlament.<sup>3</sup>

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Në përputhje me tendencat rajonale, edhe Burkina Faso u ndikua nga përpjekjet për zbatimin e kuotave në vendet fqinje të rajonit dhe në vende të tjera të kontinentit.<sup>4</sup> Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, gra parlamentare dhe përfaqësuese të organizatave të grave shkuan në këto vende për të mësuar për përvojat e këtyre shteteve afrikane me kuotat dhe pastaj u kthyen në Burkina Faso për të bërë avokaci që këto standarde rajonale dhe ndërkombëtare të pjesëmarrjes së grave në politikë të zbatoheshin edhe në vendin e tyre.

Duke e pranuar dinamikën politike në Burkina Faso, lëvizja e grave e kuptoi që herët se, nëse donin që përpjekjet e tyre të avokacisë të përparonin dhe të jepnin rezultat, do të ishte e rëndësishme që të kishin mbështetjen e Presidentit të Burkina Fasos dhe të kryetarit të parlamentit për vendosjen e kuotave me ligj. Ndonëse kishte edhe një rrymë ideologjike në këtë mbështetje të partisë për kuotat, ndërgjegjësimi se përgjithësisht numri i grave që votojnë në zgjedhje është më i madh se ai i burrave<sup>5</sup> do të thoshte që nëse i jepje përgjigje kërkesave të këtyre grupeve të grave, kjo do të çonte në zgjerimin e bazës së përkrahëse të partisë.

Më 16 prill të vitit 2006 u miratua një ligj i cili i bënte kuotat të detyruara për të gjitha partitë politike. Sipas nenit 3 të Ligjit për Kuotat, listat partiake të kandidatëve duhet të përfshinin të paktën 30 për qind nga secila gjini, ose përndryshe do të përballeshin me sanksione. Partitë që nuk e zbatojnë ligjin mund të ndëshkohen me një shkurtim të fondeve të tyre publike elektorale me 50 për qind. Nëse një parti e arrin ose e tejkalon kuotën prej 30 për qind, ajo do të marrë fonde shtesë.<sup>6</sup> Ligji do të zbatohet si për zgjedhjet legjislative ashtu edhe për ato vendore të vitit 2012.

## Strategjitë e përdorura

### A. MOBILIZIMI I GRAVE

Aktivizmi i grave në Burkina Faso për promovimin e kuotave në partitë politike erdhi nga aktivistet e shoqërisë civile si dhe nga gratë brenda partive politike. Në fillim, partitë politike vendosën të zbatonin kuota vullnetare në nivel kombëtar dhe vendor. Aktivistet partiake dhe ato të shoqërisë civile përdorën strategji avokacie për të siguruar përkrahjen e nevojshme të partive politike për zbatimin e këtyre nismave për kuotat.

Në vitin 2003, Burkina faso hodhi bazat për përpjekjet politike për përparimin e grave në politikë, përmes ratifikimit të Protokollit të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njerëzve dhe të Popujve për të Drejtat e Grave në Afrikë, që njihet më shumë si Protokoll i Maputos, që garantonte të drejta gjithëpërfshirëse për gratë, përfshirë edhe të drejtën për të marrë pjesë në procese politike dhe barazi politike me burrat. Në këtë mënyrë, përpjekjet e para të avokacisë nga lëvizja e grave vunë në qendër të tyre zbatimin e Protokollit dhe nevojën për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare dhe rajonale.

Gjatë atyre viteve të para, gratë parlamentare dhe përfaqësueset e shoqërisë civile patën mundësi të vazhdueshme për të bërë trajnime dhe seminare të drejtuara nga organizata ndërkombëtare që shpjegonin anët e mira dhe të këqija të vendosjes së kuotave për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë. Nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të tyre për kuotat në vende të tjera të Afrikës, gratë e Burkina Fasos që ishin aktiviste partiake dhe të shoqërisë civile, arritën në një konsensus që kuotat do të ishin një instrument i mirë për të fituar përfaqësim më të gjerë dhe afatgjatë të grave në poste vendim-marrëse.

### B. KUOTA PËR KANDIDATËT

Nisma e parë e KDP-së për kuotat ishte që të miratohej një kuotë e brendshme vullnetare prej 25 për qind gra në listat e partisë për zgjedhjet parlamentare të viteve 2002 dhe 2007. Përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2006, KDP-ja miratoi gjithashtu një kuotë të shtuar prej 50 për qind, për listat e

kandidatëve për zonat rurale të vendit. Me një përkrahje të fortë nga udhëheqja e partisë, kjo kuotë e fundit u zbatua në zgjedhjet në nivel vendor të vitit 2006, gjë që bëri të zgjidheshin 6500 gra dhe të dyfishohej përfaqësimi i grave në të gjithë vendin, nga 18 për qind në vitin 2002 në 36 për qind në 36 për qind anëtare të këshillave komunale në vitin 2006.<sup>7</sup>

Organizatave civile të grave, të galvanizuara nga suksesi elektoral i grave në zgjedhjet e vitit 2006, filluan një fushatë shumëvjeçare për miratimin e një kuote të përcaktuar me ligj, zbatimi i së cilës do të ishte i detyrueshëm për të gjitha partitë politike. Organizatat e grave në Burkina Faso përdorën një gamë të gjerë strategjish për të nxitur miratimin e ligjit për kuotat - ndër të cilat lobingu pranë udhëheqësve politikë, demonstratat publike, forcimi i lidhjeve me organizatat ndërkombëtare, fushatat në media, dhe ofrimi i seminareve për parlamentarët, si gra ashtu edhe burra, për t'i sensibilizuar ata dhe ato për nevojën e kuotave.

Ashtu si edhe me kuotat e brendshme të partive, ligji i propozuar për kuotat në fillim hasi në rezistencën si të opozitës ashtu edhe të partive të koalicionit presidencial. Ky kundërshtim përqendrohej tek shqetësimi nëse partitë do të mundnin të tërhiqnin një numër të mjaftueshëm grash, si dhe frika se personat që janë tani në poste apo kanë vende në parlament, do t'i humbnin këto vende. Pavarësisht nga këto rezerva të tyre, kur u votua ligji në vitin 2009, shumë përfaqësues të partive opozitare votuan për kuotat, në një linjë me KDP-në. Në favor të projektligjit votuan 87 nga 111 anëtarët e legjislaturës,<sup>8</sup> dhe organizatat e grave u mobilizuan dhe shkuan për ta parë me sytë e tyre seancën e votimit në parlament.

### C. PARTNERITETI ME BURRAT

Presidenti Compaoré e bëri shumë të qartë gjerësisht mbështetjen e tij të fuqishme për kuotat, gjë që nënkuptonte se nëse dikush dilte publikisht kundër kuotave, kjo do të ishte njësoj sikur të dilte publikisht kundër presidentit. Gratë arritën të forconin aleancat me aleatë të tjera kyçe meshkuj në parlament, përfshirë edhe anëtarët e Komitetit *Ad Hoc* të Parlamentit për Kuotat, i cili e shqyrtoi këtë ni-

smë.<sup>9</sup> Këta udhëheqës meshkuj punuan shumë për të shpjeguar dhe për të ngritur ndërgjegjësimin për ligjin e kuotave, me qëllim që t'i bënin të gjithë anëtarët e KDP-së t'i përkrahnin ato, si dhe për të informuar aktivistët në zona të ndryshme elektorale.

### D. GJUHË E PAANSHME GJINORE PËR KUOTAT

Rezistenca e fillimit dhe kërcënimi për kundërshtimin e ligjit të kuotave në parlament u shmangën me anë të riformulimit të legjislacionit, për ta formular atë me një gjuhë "përfshirëse". Ligji i kuotave i Burkina Fasos nuk përmend posaçërisht gratë dhe është i paanshëm nga ana gjinore në formulim: "as njëri seks, as tjetri" nuk do të përbëjë më pak se 30 për qind të listave të partive politike.<sup>10</sup> Kjo gjuhë përdor me qëllim, sepse kushtetuta e Burkina Fasos e ndalon diskriminimin me bazë seksin. **Gjuha asnjansë nga pikëpamja gjinore** e bëri më të lehtë miratimin e kuotave.

Për të promovuar zbatimin e kuotave në zgjedhjet e ardhshme, partitë politike që arrijnë kuotën prej 30 për qind deputetesh të zgjedhura në Asamblenë Kombëtare ose në këshillat komunale, do të shpërblehen me dyfishin e fondeve publike në fushatat e zgjedhjeve. Shtimi i fondeve publike për çdo parti që i përmbush standardet ka për qëllim që të mos i lenë partitë t'i mbajnë gratë në fund të listave të kandidatëve, që do të pakësonte mundësinë e tyre për t'u zgjedhur.<sup>11</sup>

### Rezultatet

Kuotat e vitit 2009 shihen përgjithësisht si një fitore e madhe për gratë në Burkina Faso dhe pritet të kenë një ndikim dramatik në jetën politike të Burkina Fasos.<sup>12</sup> Marrëdhënia midis partive politike dhe organizatave të grave ka qenë me përfitim për të dyja palët. Partitë i përqafulan reformat sepse panë potencialin për të forcuar bazën e përkrahësve të tyre, dhe reformat kanë shtuar mundësitë e grave brenda partive për të ngritur çështje dhe për të dhënë kontributin e tyre.

## Sfidat dhe rruga përpara

Megjithëse miratimi i kuotave si vullnetare ashtu edhe ligjore për kandidatët është një arritje mjaft e rëndësishme, sfida më e madhe do të jetë zbatimi i ligjit në zgjedhjet e ardhshme. Disa nga dispozitat e ligjit janë të paqarta dhe lejojnë mundësi për interpretime të ndryshme. Për shembull, ligji nuk përcakton se si do ta verifikojë komisioni i zgjedhjeve se cilat parti e kanë plotësuar kriterin 30 për qind, çfarë lloj informacioni duhet të dorëzojnë partitë për të vërtetuar zbatimin e kriterit, apo nëse 30 përqindëshi duhet të llogaritet në bazë vendi, apo në bazë rrethi. Ligji do të vihet në provë për herë të parë gjatë zgjedhjeve të ardhshme vendore dhe legislative në vitin 2012.

Numri më i madh i grave të zgjedhura në poste politike dhe zyrtare po sjell dalëngadalë përfitime politike për gratë. Një sfidë e rëndësishme për ecjen përpara do të jetë që funksionareve femra të porsazgjedhura t'u krijohen mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre politike për t'u bërë përfaqësuese më efektive dhe kandidatë më konkurrues, si dhe të punojnë për të ndikuar në politikën e partive të tyre politike. Ndërkohë pengesat tradicionale për gratë në politikë, si mungesa e burimeve financiare, frika nga dhuna politike, besimi i ulët tek vetja, dhe niveli më i ulët arsimor i grave vazhdojnë të ekzistojnë në kontekstin e Burkina Fasos.<sup>13</sup>

Kapërcimi i këtyre vështirësive social-ekonomike, kulturore dhe politike të grave do të varet nga vullneti i vazhdueshëm politik i partive për t'i tejkaluar kuotat. Me më shumë gra të fuqizuara për të drejtuar një debat të hapur për çështje të qytetarëve, për t'i dhënë transparencë proceseve politike, dhe për të ofruar llogaridhënie në platformat partiake, gratë e Burkina Fasos në politikë do të jenë në gjendje të mbështesin një demokraci më të madhe në vendin e tyre.

## Shënime

1 Ky rast studimi përqendrohet kryesisht në zbatimin e kuotave elektorale në Burkina Faso. Analiza dhe rekomandimet nuk reflektojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

2 Compaoré, Nestorine. (2002). "Case Study: Burkina Faso Recruiting Women for Legislative Elections." (Rast Studimi: Rekrutimi i grave për zgjedhje legjislativ në Burkina Faso). Në Julie Ballington dhe Marie-Jose Protais. (2002). *Les Femmes au parlement : Au-Delà du Nombre / Gratë në parlament: përtej numrave* International IDEA, Stockholm, Suedi; dhe Tiendrébéogo-Kaboret (2002), "Burkina Faso: Les obstacles à la participation des femmes au parlement," (Burkina Faso: pengesat për pjesëmarrjen e grave në parlament), në IDEA, Les femmes au parlement. Gjetet në <http://www.idea.int/publications/wip/upload/CS-Burkina-Kaboret.pdf>, parë në janar 2012.

3 Inter-Parliamentary Union (IPU). "PARLINE Database of National Parliaments." Gjetet në <http://www.ipu.org/parline-e/parlinesearch.asp>, parë në janar 2012. Përqindja e grave është shtuar në 177 anëtare që nga zgjedhjet (2010).

4 Tripp, A. (2003) "The Changing Face of Africa's Legislatures: Quotas and Women," (Pamja në ndryshim e legjislativave afrikane: kuotat dhe gratë) një studim i paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare IDEA, *The Implementation of Quotas: African Experiences (Zbatimi i kuotave: përvojat afrikane)*. Pretoria, South Africa.

5 Intervistë me një anëtare partie të KDP, 2010.

6 IDEA, Universiteti i Stokholmit dhe IPU, *Global Database of Electoral Quotas for Women (Bazë të dhënash globale elektorale për gratë)*. Gjetet në [www.quotaproject.org](http://www.quotaproject.org), parë në janar 2012.

7 National Democratic Institute for International Affairs (NDI). (2009). "Gender Quota in Burkina Faso Marks Feats Accomplished, Challenges Ahead." (Kuotat gjinore në Burkina Faso shënojnë arritje të mëdha dhe sfida të mëtejshme përpara) Gjetet në <http://www.ndi.org/node/15464>, parë në janar 2012.

8 NDI. (2009). "Women Gain Political Ground in Burkina Faso." (Gratë fitojnë terren politik në Burkina Faso) Gjetet në <http://www.ndi.org/node/15464>, parë në janar 2012.

9 Powley, E. (2009) "Burkina Faso's Proposed Quota Law: Implications for Implementation." (Projektligji i kuotave në Burkina Faso: rrjedhoja për zbatim) Raport i pabotuar i hartuar për *National Democratic Institute for International Affairs*.

10 Projekt ligji për kuotat, i pabotuar, pa datë. [Përkthim në anglishte.]

11 NDI. (2009). "Women Gain Political Ground in Burkina Faso." (Gratë fitojnë terren politik në Burkina Faso) Gjetet në <http://www.ndi.org/node/15464>, parë në janar 2012.

12 Intervista me aktiviste shoërore në Burkina faso, korrik 2009.

13 Powley, E. (2009) "Burkina Faso's Proposed Quota Law: Implications for Implementation." (Projektligji i kuotave në Burkina Faso: rrjedhoja për zbatim) Raport i pabotuar i hartuar për *National Democratic Institute for International Affairs*.

KUTI

## INDIA: KUOTAT, VENDET E REZERVUARA DHE PARTITË POLITIKE<sup>1</sup>

Me gjithë statusin e saj si demokracia më e madhe e botës, historikisht India ka qenë në 25 për qindëshin e fundit për sa i përket numrit të grave në parlament. Zgjedhjet e vitit 2009 në Lok Sabha sollën si rezultat në një numër rekord prej 58 grash në mesin e 543 anëtarëve të zgjedhur të parlamentit, më i larti që nga pavarësia, duke e rritur përfaqësimin parlamentar të grave në 10,7 për qind.<sup>2</sup> Shtatëmbëdhjetë nga gratë e zgjedhura ishin nën moshën 40 vjeç, duke sugjeruar një perspektivë premtuese për të rejat. Përveç kësaj, gratë kanë fituar qasje në postet më të larta të udhëheqjes politike me zgjedhjen në vitin 2007 të një gruaje, Pratibha Devisingh Patil, si presidente dhe me përfaqësimin e grave në krye të katër partive politike, ndër të cilat edhe Partia Indiane e Kongresit, që ka formuar qeverinë.

Përparimi që vihet re në këto statistika ka ardhur pas përfitimeve më të rëndësishme të arritura nga gratë nëpërmjet sistemit të vendeve të rezervuara me ligj në nivel lokal. Në vitin 1993, Amendamentet 72 dhe 73 të kushtetutës fuqizuan institucionet e *panchayati raj* – sistemi i qeverisjes vendore të Indisë – dhe përcaktuan që një e treta e vendeve në *panchayat* dhe një e treta e të gjitha kryetarëve të *panchayat* do të rezervoheshin për gratë. Vlerësohet se në këto 15 vite që nga amendamenti kushtetues, më shumë se dy milion gra në zonat rurale kanë shërbyer në këto organe vendim-marrëse të qeverisjes lokale.<sup>3</sup> Disa shtete, si Kamataka, i kishin futur gratë në politikën e zonave rurale edhe përpara se kjo të vendosej me ligj në kushtetutë. Disa shtete, përfshirë Madhya Pradesh, Himachal Pradesh, Bihar dhe Uttarkhand e kanë rritur

“

NDONËSE SHUMICA E PARTIVE POLITIKE INDIANE DUKET SE TANI E MBËSHTESIN NJË KUOTË PREJ NJË TË TRETËN GRA, ËSHTË E NEVOJSHME TË NDËRMERREN VEPRIME TË MËTEJSHME NGA PARTITË POLITIKE LIDHUR ME PËRFSHIRJEN KUPTIMPLOTË TË GRAVE NË PROCESET PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATËVE DHE ATO VENDIMMARRËSE.

”

në 50 për qind përqindjen e kërkuar të vendeve për gratë në *panchayat*.

Partitë politike po e pranojnë gjithashtu se kanë përfitime nga hapja e strukturave të tyre dhe tërheqja e grave në parti. Në qershor të vitit 2009, Partia Indiane e Kongresit paraqiti Meira Kumar si grua e parë kandidatë për kryetare të dhomës së ulët të parlamentit. Kjo gjë ka forcuar imazhin e partisë si një parti “pro-grave”, pasi ai luajti një rol të ngjashëm edhe kur ndihmoi Pratibha Patil që të bëhej presidentja e parë grua e vendit.<sup>4</sup> Përveç kësaj, meqë Meira Kumar është anëtare e klasës *dalit*, kjo mund ta ndihmojë partinë që të përforcojë bazën e saj me gra dhe burra nga komuniteti i kastës së ulët *dalit*. Që në vitin 2005, pas zgjedhjes së Sonja Gandhit si kryetare e partisë, Partia e Kongresit ka zbatuar një kuotë prej 33 për qind për gratë në të gjitha nivelet e partisë.

Edhe Partia Bharatiya Janata (BJP) ka punuar gjithashtu për të nxitur një përfaqësim më të madh në udhëheqjen e saj partiake të grave nga kasta të niveleve të ndryshme. Përpjekjet e BJP-së për të promovuar gratë





u ndihmuan edhe nga udhëheqja e një gruaje që ishte ndër anëtarët themelues të partisë në vitin 1981 dhe përqafoi që në fillim një vizion për rolin e grave në parti. Midis strategjive të BJP-së për t'i dhënë grave pozicione më të mira në parti janë një program udhëheqjeje për gratë, një akademi udhëheqjeje për të rejtat e moshës 18 deri në 35 vjeç, seminare të fokusuara për studentet, profesionistët e informatikës dhe gratë në komunitetet rurale; dhe ofrimi i programeve të asistencës financiare dhe mbledhjes së fondeve për kandidatet gra.<sup>5</sup> Në vitin 2008, komiteti ekzekutiv kombëtar i BJP-së ndryshoi gjithashtu statutin e partisë duke rezervuar 33 për qind të posteve udhëheqëse të partisë për gratë dhe duke e bërë kryetaren e degës kombëtare të grave anëtare të komitetit qendror zgjedhor të partisë. Udhëheqëset gra të BJP-së kanë vazhduar të fusin politika novatore, veçanërisht në nivel nën-kombëtar.<sup>6</sup> Në Rajastan, një guvernatore e BJP-së përdori në fushatë taktika që fokusoheshin tek gratë votuese gjë që rriti bazën mbështetëse të saj dhe bëri që ajo të fitonte zgjedhjet e shtetit.

Ndonëse shumica e partive politike indiane duket se tani e mbështesin një kuotë prej një të tretën gra, është e nevojshme të ndërmerren veprime të mëtejshme nga partitë politike lidhur me përfshirjen kuptimplotë të grave në proceset përzgjedhëse të kandidatëve dhe ato vendimmarrëse.<sup>7</sup> Në nivelin vendor, ku gratë janë gjithnjë e më të pranishme në *panchayat-et*, burrat vazhdojnë të mbizotërojnë strukturat vendore të partisë, duke e paraqitur veten si ata që mund të fitojnë zgjedhjet në emër të partisë. Brenda parlamentit,

grupet partiake të mbizotëruara nga burrat vazhdojnë të përcaktojnë se kush mund të flasë dhe cilat çështje politike duhet të trajtohen, dhe kanë penguar përparimin e projektligjit të vitit 1996 për Përfaqësimin e Grave për një kuotë kombëtare, si dhe kontribute të tjera më të gjera nga gratë.

### SHËNIME

<sup>1</sup> Ky rast studimor nuk paraqet një analizë të gjithanshme të iniciativave të të gjitha partive politike në vend, por vetëm paraqet në hollësi veprimet konkrete të disa partive. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e PNUD-it apo NDI-së.

<sup>2</sup> Lok Sabha është dhoma e ulët, e zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, e Parlamentit në Indi. (<http://loksabha.nic.in/>, parë në janar 2012).

<sup>3</sup> The Hunger Project. (2009). "Two Million Women Leaders and Counting: Indian Women Participate in Their Local Government." (Dy milion udhëheqëse gra dhe vazhdojnë të shtohen: Gratë indiane marrin pjesë në qeverisjen lokale). International Museum of Women: Women, Power and Politics Online Exhibition (Muzeu ndërkombëtar i grave: Gratë, Pushteti dhe Politika – ekspozitë në Internet). Gjetur në <http://www.imow.org/wpp/stories/viewStory?storyId=100>, parë në janar 2012.

<sup>4</sup> Pasricha, A. (2009). "India's Parliament Chooses First Woman Speaker." (Parlamenti i Indisë zgjedh kryetaren e parë grua) Lajmet e Zërit të Amerikës. Gjetur në <http://www1.voanews.com/english/news/a-13-2009-06-03-voa11-68826467.html>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> Intervistë me një aktivist partiak të BJP-së, korrik 2009.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Intervistë me presidenten e një organizate indiane të gruas, korrik 2009; Nagpal, S. (2008). "BJP Reserves 33% of Party Posts for Women." (BJP rezervon 33 % të posteve të partisë për gratë) TopNewsIndia. Gjetur në <http://www.topnews.in/bjp-reserves-33-party-posts-women-217313>, parë në janar 2012.



KUTI

## INDONEZIA: REKRUTIMI I KANDIDATËVE DHE KUOTAT E PARTIVE POLITIKE<sup>1</sup>

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Indonezia ka bërë hapa të mëdhenj përpara në tranzicionin e saj demokratik. Gratë mbajnë 18,2 për qind të vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve. Gratë aktiviste të partive dhe të shoqërisë civile gra në Indonezi zhvilluan një fushatë të suksesshme avokacie në favor të një kuote prej 30 për qind gra në listat partiake të kandidatëve për parlament me vende të siguruara, por përpjekjet e tyre u minuan nga futja e një sistemi me listë të hapur në muajt para zgjedhjeve të vitit 2009. Gratë kandidate u detyruan të bëjnë fushatë aktive brenda partive të tyre për të zënë vende me mundësi zgjedhjeje në listat e kandidatëve.

Partia Demokratike e Përpjekjes e Indonezisë (PDIP) dha prova se ishte një nga partitë më të suksesshme në ngritjen e grave në poste të zgjedhura. Gratë përbënin 20 për qind të grupit parlamentar të PDIP-së në vitin 2009. Që në vitin 2000, para se të miratohej për herë të parë kuota zgjedhore, aktivistet gra të PDIP-së ndikuan me sukses për ndryshimin e nënligjeve të partisë për të përfshirë një kuotë prej 20 për qind për gratë në të gjitha strukturat e partisë. Anëtarët gra të PDIP-së vazhduan më tej duke garantuar që kuota e tyre e brendshme të shtrihej deri tek personeli i partisë dhe nivelet nën-kombëtare të partisë. Ato gjithashtu theksuan se çfarë përfitimesh do të kishte partia nëse gratë vendoseshin në poste partiake dhe administrative në parti, në vende që shpesh dominoheshin nga burrat. Deri në vitin 2009 gratë në PDIP mbanin tre nga 47 postet e larta brenda partisë, përfshirë kryetaren dhe zëvendës-kryetaren për çështjet e grave, dhe zëvendës-sekretaren e

GRATË KANDIDATE U DETYRUAN TË BËJNË FUSHATË AKTIVE BRENDA PARTIVE TË TYRE PËR TË ZËNË VENDE ME MUNDËSI ZGJEDHJEJE NË LISTAT E KANDIDATËVE.

përgjithshme; megjithatë, gratë në parti ngritën gjithashtu ndërgjegjësimin për faktin se prania e grave në pozita udhëheqëse nuk ishte e mjaftueshme që gratë të ndikonin në vendimet, strategjitë dhe politikat e rëndësishme. Duke ndërtuar mbi popullaritetin që patën kuotat e brendshme, në vitin 2010 udhëheqja e PDIP-së reformoi rregulloren e saj duke e rritur kuotën e brendshme në 30 për qind, me shpresën se kuota e re do të nxiste më shumë gra që të konkurronin dhe zgjidheshin në zgjedhjet e vitit 2014.

Para zgjedhjeve të vitit 2009, [Departamenti i Fuqizimit të Grave](#), dega e grave të PDIP-së, siguroi mbështetjen e bordit udhëheqës të partisë për të promovuar vendosjen e grave në pozicione ku mund të fitojnë në listat e partisë. Si gratë anëtare të partisë, ashtu edhe udhëheqësit e partisë, e kuptuan se vendosja kishte akoma rëndësi në sistemin me lista të hapura, sepse shumë votues në Indonezi ende nuk kishin përvojë me këtë sistem të posaçëm zgjedhor dhe kishin tendencë të votonin për personin e parë në listë kur zgjidhnin partinë e tyre. Prandaj gratë në udhëheqjen e partisë luajtën një rol kyç, duke bërë avokaci në favor të vendosjes së grave kandidate në vendet e larta në listë. PDIP-ja kishte vendosur një sistem pikësh për përcaktimin e vendit të kandidatit apo kandidates në





listën e partisë, i cili merrte parasysh faktorë si koha në shërbim të partisë, veprimtaritë civile, çmimet e marra dhe trajnimet e bëra, dhe nivelin arsimo. Ky sistem ndihmoi për t'ï treguar partisë se gratë e PDIP-së tashmë i përmbushnin kriteret dhe e meritonin që kandidaturat të merreshin në shqyrtim në një mjedis që një e intervistuar e përshkroi si mjedis politik "shumë patriarkal".<sup>2</sup>

Po ashtu, Departamenti i Fuqizimit të Grave i PDIP-së vendosi lidhje me seksionin trajnues të partisë për të zhvilluar dhe zbatuar një program trajnimi për gratë candidate, i cili u ngrit në vitin 2003. Këto trajnime synonin të rrisnin aftësitë politike të grave në parti dhe mendohet se ia arritën të ndihmojnë gratë për të mësuar që "të mbrojnë interesat e tyre në nivel vendor".<sup>3</sup>

Megjithatë, aktivistet gra vazhdojnë të shprehin shqetësime se disa parti politike në Indonezi po i plotësojnë kuotat e tyre të brendshme duke i vendosur gratë në pozicione ku ato nuk mundet të ushtrojnë ndikim në proceset vendimmarrëse të partisë. Një anëtar i një partie vuri në dukje se shumica e grave shpesh caktoheshin në postin e "sekretares së degës së partisë apo financieres së degës së partisë, ndonjëherë edhe si mbajtëse e inventarit të brendshëm të partisë."<sup>4</sup> Një numër grash politikane komentuan gjithashtu se, ndonëse puna për krijimin e kapaciteteve ishte

me vlerë, aftësitë e reja udhëheqëse të grave nuk kishin ndonjë kuptim të madh në një sistem politik që mbetet nën ndikimin e parave dhe patronazhit. Një e anketuar tha se faktorët më të rëndësishëm për të fituar zgjedhjet vinin sipas këtij rendi: "paratë, pozicioni (i parë) në listën e partisë, lidhjet familjare dhe, në fund, fushata." Mendohet që sistemi me lista të hapura i shton më shumë pengesat e financimit për gratë candidate, sepse i bën anëtarët e të njëjtës parti që të konkurrojnë drejtpërdrejt me njeri-tjetrin.

#### SHËNIME

<sup>1</sup> Kjo kuti nuk paraqet një analizë të gjithanshme të të gjitha iniciativave apo të të gjitha palëve të interesuara në vend që synojnë të promovojnë pjesëmarrjen politike të grave, por paraqet disa në hollësi veprimet konkrete të një partie.

<sup>2</sup> Disa vëzhgues ndërkombëtarë në Indonezi sugjeruan se nuk do të kishte pasur ndonjë ndryshim nëse në zgjedhjet e vitit 2009 listat do të kishin mbetur të mbyllura, sepse asnjë parti nuk do të kishte fituar më shumë se një apo dy vende në secilën provincë, duke qenë se në çdo distrikt konkurrohej mesatarisht për gjashtë vende dhe kishte disa parti që konkurronin për ato vende. Edhe me kuotën e ashtuquajtur "zinxhir" me 30 për qind (d.m.th 2 burra një grua), gratë mund të ishin vendosur në vendin e tretë dhe, si rezultat, prapëseprapë nuk do të ishin zgjedhur. Si rrjedhim, kuota e përcaktuar me ligj, ashtu siç është shkruar, nuk do të kishte garantuar rritjen e përfaqësimit të grave në Parlament.

<sup>3</sup> Intervistë me një aktivist partie, gusht 2009.

<sup>4</sup> Po aty.

## KAMBOXHIA: ORGANIZATAT E FORUMEVE PARTIAKE TË GRAVE PËR PROMOVIMIN E GRAVE BRENDA PARTISË DHE NË POSTE TË ZGJEDHURA<sup>1</sup>

### Pak informacion

Kamboxhia ka një parlament me dy dhoma që përbëhet nga Asambleja Kombëtare dhe Senati. Asambleja Kombëtare zgjidhet me anë të një sistemi të përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura, ndërsa Senati zgjidhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga anëtarët e këshillave të komunave.<sup>2</sup> Në Kamboxhia është në pushtet Partia Popullore e Kamboxhias (PPK), që ka kontroll politik në qeveri dhe në shumicën e organeve të qeverisjes vendore. Megjithëse udhëheqja e PPK-së mbetet e dominuar nga meshkujt, me shumë pak gra në postet vendimmarrëse, përqindja e grave në parlament nën PPK-në është rritu nga 3 për qind në vitin 1993 në 22 për qind në vitin 2009.<sup>3</sup>

Partia e dytë më e madhe e Kamboxhias, si dhe partia kryesore e opozitës, Partia Sam Rainsy (PSR), ka bërë përpjekje të shtojë numrin e grave në grupin e saj të deputetëve parlamentarë. Që nga viti 2006, PSR-ja ka pasur dy sekretare të përgjithshme të partisë njëra mbas

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Sam Rainsy për të promovuar pjesëmarrjen e grave, ndonëse kjo nuk është e vetmja parti që e ka bërë këtë gjë në Kamboxhia. Ai fokusohet në pjesëmarrjen e grave në kontekstin e zgjedhjeve, mbështetjen që i ka dhënë kandidatëve femra, dhe rolin që kanë luajtur forumet e grave në parti.



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave

Mbështetje për fushatën e grave kandidatë

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Partia Sam Rainsy

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: KAMBOXHIA

Emri i parlamentit	Parlamenti i Kamboxhias
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Asambleja Kombëtare dhe Senati)
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional (Asambleja Kombëtare)
Zgjedhjet legjislative	Korrik 2008
Numri i grave të zgjedhura	20 nga 123 (16,3%)

tjetrës, duke e bërë PSR-në të parën parti të madhe ku gratë drejtojnë udhëheqjen e partisë. Pas zgjedhjeve të vitit 2008, gjashtë gra nga PSR u zgjedhën në parlament, numër që përbën 23 për qind të deputetëve të PSR-së. Përveç kësaj, gratë drejtuese përbëjnë 15 për qind të organit më lartë vendimmarrës të partisë.<sup>4</sup>

## Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Udhëheqëset e forta të PSR-së e vlerësonin përfshirjen e grave të tjera në politikë dhe, përmes marrëdhënieve me organizata të ndryshme, arritën të fitonin mbështetje teknike dhe financiare për nismat e tyre për përfshirjen e grave në politikë. Përpjekjet e forumit të grave për mbështetjen e grave u mirëpritën dhe miratuan nga votuesit dhe anëtarët e partisë, dhe udhëheqësit meshkuj dhe femra të PSR-së i identifikuan strategji të tilla si kyç për modernizimin e partisë.

## Strategjitë e përdorura

### A. MOBILIZIMI I FORUMIT TË GRAVE

Forumi i grave të PRS-së luajti një rol të rëndësishëm në përparimin që bënë gratë brenda partisë, dhe ka qenë një burim strategjish novatore për forcimin e rolit të grave në politikë në Kamboxhia. PSR-ja u themelua në vitin 1955 nga punëtorët kamboxhianë, ndër të cilët shumë ishin gra. Anëtarët dhe anëtares themeluese të PSR-së, ndër të cilët edhe figura me shumë influencë si Saumura Tioulong, u bënë të vetëdijshëm për përfitimet që do të kishte partia dhe demokracia kamboxhiane nëse PSR-ja do të hapte dyert për më shumë pjesëmarrje të grave. Si rrjedhojë, forumi i grave ishte një nga strukturat më të para të partisë, që u krijua me **misionin për të angazhuar dhe mbështetur gratë**. Kryetarja e forumit të grave zgjidhet nga anëtarët e këtij forumi.

Forumi i grave i PSR-së solli politika përparimtare në parti për një përfshirje dhe fuqizim më të madh të grave në parti, ndër të cilat një kuotë për bordin drejtues, trajnime për gratë kandidatë, paketa për fushatat e grave kandidatë, një program me karakter edukativ shoqëror në radion (Zërat

e grave-Zgjedhjet e grave), dhe përpjekjet bashkërenduese me gratë deputete të PRS-së për miratimin e ligjeve që trajtojnë politika prioritare për gratë. Forumet e grave gjithashtu ndihmuan në trajtimin me përparësi të nevojave të grave në parti përmes krijimit të marrëdhënieve sinergjike me organizata vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe diasporën kamboxhiane.

Forumi i grave bëri avokaci pranë udhëheqjes së partisë për një **kuotë prej 15 për qind për bordin drejtues të partisë** me qëllim që të sigurohej të paktën një përfaqësimi minimal i grave në organet më të larta vendimmarrëse të partisë. Po kështu, nga forumi i grave e kishin origjinën edhe propozimet politike që i kërkonin partisë t'i jepte përparësi kandidatëve të kualifikuar dhe që nëse do të kishte vota të barabarta për dy kandidatë, vendi t'i jepej kandidatës femër. Këto politika më në fund u miratuan nga partia. Më vonë forumi i grave i PRS-së punoi për të bërë të mundur trajnimin e aktivisteve të partisë dhe të kandidatëve për legjislaturat kombëtare dhe vendore. Këto trajnime i ndihmuan kandidatet që të fitonin aftësitë e nevojshme politike, ndër të cilat kryerja e fushatës derë më derë, puna me mediat, hartimi i mesazheve dhe komunikimi i tyre. Trajnimet e organizuara nga forumi i grave përfaqësonin një burim të vlefshëm informacioni dhe për zhvillimin e kapaciteteve të grave, sidomos duke pasur parasysh nivelet e ulëta të arsimit dhe të aftësive shkrim-leximit në Kamboxhia.

Forumi i grave i PSR-së bëri përpjekje të krijonte marrëdhënie sinergjike me organizata ndërkombëtare për të financuar, hartuar dhe zbatuar programet e tyre për trajnimin e grave. Këto programe u pëlqyen dhe u pritën shumë mirë nga pjesëmarrëset dhe udhëheqja e PRS-së i kërkoi forumit të grave ta vazhdonte dhe zgjeronte punën e vet trajnuese. Drejtueset e forumit të grave dhanë të kuptohet se financimet e ardhshme për programet e tyre do të vareshin nga aftësia e tyre për të treguar rezultate konkrete, pra një pjesëmarrje më të madhe të grave. Kështu, forumi i grave e përdori interesin që tregoi partia për programet e trajnimit për të kërkuar miratimin nga udhëheqja e partisë të kuotës prej 15 për qind brenda partisë.

Drejtuesit meshkuj të PRS-së në përgjithësi i mbështetën veprimtaritë e forumit të grave. Udhëheqësit e PSR-së kishin krijuar lidhje me organizata ndërkombëtare dhe parti politike evropiane dhe shumë prej tyre ishin arsimuar jashtë shtetit, gjë që e dallonte PSR-në nga partitë e tjera kryesore në Kamboxhia, dhe që kontribuoi në krijimin e një kulture partiake që e vlerësonte barazinë gjinore në politikë.

## B. NDIHMË PËR FUSHATAT E GRAVE KANDIDATE

Financimi ka qenë gjithmonë një problem i vazhdueshëm për gratë që venë kandidaturën për një post të zgjedhur zyrtar në Kamboxhia. Në prag të zgjedhjeve të këshillave të komunave të vitit 2007, forumi i grave shpërndau paketa me materiale informative për çdo grua kandidatë për anëtare të këshillit komunal, si edhe nga një kostum të përshtatshëm për fushatë, një biçikletë për të mundësuar udhëtimin nëpër zonën zgjedhore, dhe materiale të tjera. Partia ua dha këto artikuj në vend të parave, me qëllim që t'i përgjigjej drejt për së drejti nevojave elektorale të kandidatëve të tyre, shume nga të cilat ishin të varfra dhe nuk kishin mundësi t'i siguronin këto gjëra vetë. Forumi i grave të PSR-së gjithashtu ka ndërmarrë hapa për të ngritur një **fond brenda partisë** për t'i dhënë ndihmë financiare shtesë kandidatëve të PSR-së.

Me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, forumi i grave i PSR-së ndihmoi të krijohej një **program radiofonik** politikisht asnjës, të quajtur “Zërat e grave – Zgjedhjet e grave” që fokusohet tek çështje si pse dhe si mund të merrnin pjesë gratë në politikë apo të vinin kandidaturën për funksione të zgjedhura. Programi i radios përbëhej nga një radiodramatizim që përshkruante problemet me të cilat përballeshin gratë në jetën e tyre të përditshme dhe paaftësia apo mungesa e gatishmërisë nga ana e zyrtarëve të zgjedhur për t'i zgjidhur ato probleme. Qëllimi ishte që të tregohet nevoja që gratë të përfshiheshin vetë në politikë. Pjesa e dytë e programit të radios ishte një emision me telefonata dhe me të ftuar në studio, ndër të cilat edhe gra të shquara të lidhura me PSR-në. Partia e konsideroi këtë program shumë efektiv dhe shprehu dëshirën për të kërkuar fonde të mëtejshme për ta vazhduar atë.

Forum i grave luajti një **rol kyç për bashkërendimin** ndërmjet disa grave udhëheqëse mjaft të njohura në parlament dhe drejtuesve të PSR-së me qëllim paraqitjen në legjislaturë të çështjeve me përparësi për gratë, si punësimi, inflacioni, dhe shqetësime të tjera ekonomike bazë. Për ta përforcuar pozitën e tyre jashtë partisë, forumi i grave vendosi kontakte dhe kërkoi ndihmën e sindikatave dhe organizatave të punëtorëve nga industria e veshjeve, ku gratë dominonin, dhe punoi për angazhimin e figurave të njohura nga diaspora kamboxhiane në veprimtaritë e tyre.

Forum i grave i PSR-së **ka hartuar një plan strategjik** për të kërkuar kuota më ambicioze në të gjitha organet vendimmarrëse brenda partisë si dhe për përzgjedhjen e kandidatëve. Qëndrimet kundërshtuese ndaj kuotave brenda partisë vazhdojnë të jenë të forta dhe kanë penguar futjen e kuotave të brendshme shtesë. Forumi i grave i ka parashikuar dhe u ka dhënë përgjigje kritikave të brendshme kundër grave kandidatë përmes ngritjes së ndërgjegjësimit për arsyet se pse duhen kuotat de duke investuar në ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e partisë, me qëllim krijimin e një grupi të fuqishëm grash drejtuese të cilat të kërkojnë kuotat dhe të ndihmojnë në plotësimin e tyre.

## Rezultatet

Strategjitë trajnuese të përdorura nga forumi i grave i PSR-së në zgjedhjet vendore të vitit 2007 luajtën një rol shumë të rëndësishëm për t'i ndihmuar gratë që të fitonin vende në poste të zgjedhura: numri i grave anëtare të këshillave të komunave u rrit ndjeshëm nga 46 në 273, që përfaqësonte një rritje prej më shumë se 600 për qind. Programi i radios i forumit të grave po ashtu pati shumë sukses ndër votueset femra, me gjithë ndikimin që kishte qeveria në mediat kryesore të vendit. Në një nivel më të përgjithshëm, veprimtaritë e forumit të grave të PSR-së u është njohur merita që kanë rritur respektin për deputetet e PSR-së dhe kanë shtuar ndikimin e tyre, përmes institucionalizimit të pranisë së grave në nivelet më të larta të udhëheqjes së partisë, dhe ndihmës që i kanë dhënë me qindra grave për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për të konkurruar dhe për

të shërbyer në poste publike.

### Sfidat dhe rruga përpara

PSR-ja ka zbatuar një varg veprimtarish për të mbështetur gratë kamboxhiane në politikë dhe këtë e ka bërë në kontekstin e një mjedisi të kufizuar politik, ku ajo është një parti e pakicës. Hapësira politike në të cilën mund të veprojë forumi i grave i PSR-së, gjë që nga ana e saj kufizon edhe ndikimin e përpjekjeve të tyre. Brenda PSR-së, forumit të grave i është dashur gjithashtu të luftojë me disa pikëpamje tradicionale të rrënjosura thellë, në lidhje me atë se si duhet të ndahet pushteti politik ndërmjet grave dhe burrave, si dhe për pabarazitë në arsim dhe në aftësitë e leximit dhe shkrimit. Megjithatë, forumi i grave i PSR-së ka hedhur themele shumë të rëndësishme për një përfshirje gjithnjë e më të madhe të grave në partitë politike në Kamboxhia. Në periudhën afatshkurtër, gratë në PSR po fitojnë përvojë të vlefshme politike dhe po ndërtojnë rrjetet e tyre, ndërsa partia po krijon një bazë gjithnjë e më të gjerë përkrahësish.

Edhe partitë e tjera kanë pasur suksese për sa i përket pjesëmarrjes së grave. Përfaqësuese nga partia në pushtet,

PPK, kanë një numër më të madh përfaqësuesesh në parlament se sa PSR.<sup>5</sup> PPK gjithashtu është përpjekur të zgjerojë ndikimin e saj tek gratë dhe ka miratuar trajnime dhe programe të tjera, si vende të rezervuara për gratë në komitetet në nivel kombëtar, krahinor dhe komunal të PPK-së. Zëvendës kryeministrja e vendit, e PPK-së, u ngarkua nga partia me detyrën që të krijonte dhe mbante lidhje me të gjitha organizatat kombëtare të grave dhe të nxiste pjesëmarrjen e grave në parti.

### Shënime

1 Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

2 Inter-Parliamentary Union (IPU). *"Cambodia Parliamentary Chamber: Constituent Assembly" (1993). (Dhoma parlamentare e Kamboxhias: Asambleja e përfaqësuesve)*. Gjetet në [http://195.65.105.150/parline-e/reports/arc/2051\\_93.htm](http://195.65.105.150/parline-e/reports/arc/2051_93.htm), parë në janar 2012.

3 Po aty.

4 Intervistë me një drejtuese të Partisë Sam Rainsy në Konferencën e Katërt për Anëtarët e Komisioneve Parlamentare për Statusin e Grave dhe të Komisioneve të tjera që merren me barazinë gjinore. *"Is Parliament Open to Women? An Appraisal" (A është parlamenti i hapur për gratë? Një vlerësim)*, shtator 2009. Materialet e konferencës gjenden në <http://www.ipu.org/splz-e/gender09.htm>, parë në janar 2012.

5 Po aty.

## KANADAJA: MBËSHTETJA E GRAVE KANDIDATE PËRMES RRJETEVE FINANCUESE DHE RREGULLAVE PËR EMËRIMIN E KANDIDATËVE<sup>1</sup>

### Pak informacion

Politika kanadeze funksionon brenda kuadrit të një monarkie kushtetuese dhe një sistemi federal qeverisjeje parlamentare me tradita të forta demokratike. Shumë nga praktikat legjislativë të vendit rrjedhin nga konvencionet e pashkruara dhe nga precedentët e krijuar dhe përcaktuar nga Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar në Westminster. Partitë politike të përfaqësuara në Dhomën e Përfaqësuesve që doli nga zgjedhjet e vitit 2008 janë: *Bloc Québécois* (Partia Nacionaliste e Kebekut); Partia Konservatore e Kanadasë; Partia Liberale e Kanadasë; dhe Partia e Re Demokratike (PRD, një parti socialdemokrate)<sup>2</sup>. Ndryshe nga sistemet e tjera të partive politike, partitë kanadeze në nivel federate nuk kanë lidhje të forta me gjejëset e tyre nëpër provinca, megjithëse mund të kenë emra të ngjashëm. Përrjashtim nga ky rregull bën PRD-ja, që ka anëtarësi të përbashkët dhe është e integruar nga ana organizative në nivelet e ndryshme politike.

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Liberale për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve. Ai i referohet gjithashtu edhe disa prej nismave të ndërmarra nga PRD-ja (që përfshihen në një kuti më vete). Ky rast studimi fokusohet te pjesëmarrja e grave në Dhomën e Përfaqësuesve, ndonëse duhet të vihet në dukje se janë bërë përparime të rëndësishme në pjesëmarrjen e grave në politikë edhe në Senat si dhe në nivelin e provincave.



### FJALË KYÇE

Rrjete financuese

Rregullat për emërimin e kandidatëve

Platformat e partive

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Partia Liberale

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: KANADAJA

Emri i parlamentit	Parlamenti i Kamboxhias
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Pluralist/Maxhoritar (Dhoma e Përfaqësuesve)
Zgjedhjet legjislativë	Tetor 2008
Numri i grave të zgjedhura	68 nga 240 (22,1%) <sup>3</sup>

Në zgjedhjet e vitit 2008, gratë përbënin 22 për qind të deputetëve të zgjedhur në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 23 për qind të deputetëve në legjislaturat e provincave dhe territoreve, si dhe në këshillat e komunave.<sup>4</sup> Ndonëse këto janë shifra rekord për gratë kanadeze, sidomos në nivelin federal, përqindja e grave në politikë ka përparuar vetëm me një pikë përqindjeje gjatë një periudhe prej shtatëmbëdhjetë vjetësh; gratë fituan për herë të parë 21 për qind të vendeve në parlament në vitin 1993.<sup>5</sup> Përveç vështirësive sociale dhe ekonomike për mbledhjen e fondeve të duhura për të konkurruar për poste zyrtare dhe balancimit të nevojave për t'u kujdesur për familjet e tyre, gratë gjithashtu përballen edhe me shumë pengesa strukturore në sistemin elektoral kanadez me zona zgjedhore me një mandat deputeti, si për fitimin e të drejtës për t'u emëruar nga partia, ashtu edhe në konkurrimin gjatë zgjedhjeve të përgjithshme. Si rezultat, gjatë tridhjetë viteve të fundit, Partia Liberale dhe PRD-ja kanë ushtruar trysni për zbatimin e programeve dhe politikave të veçanta për të ndihmuar sjelljen e grave në partitë e tyre dhe për të bërë të mundur zgjedhjen e tyre.

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Aktivistet politike kanadeze janë frymëzuar nga Emili Mërfi (Emily Murphy) dhe katër aktiviste të tjera të shquara për të drejtat e grave, që tani njihen me emrin Pesëshja e Famshme, të cilat luftuan dhe fituan betejën që gratë të pranohen me ligj dhe të kenë të njëjtat të drejta politike dhe ligjore si burrat sipas Ligjit Britanik për Amerikën e Veriut (*British North America Act – BNA, 1867*). Nga viti 1916 deri më 1929, gratë hodhën në gjyq Gjykatën e Lartë të shtetit Alberta, Senatin Federal, Gjykatën e Lartë të Kanadasë dhe Komisionin Gjyqësor të Këshillit Shtetëror në Angli, për ta lejuar Emily Murphy-n të shërbente si gjykatëse në gjykatën e shkallës së parë në Alberta, si dhe për t'u zgjedhur në Senatin Federal. Këshilli Shtetëror u shpreh se “përgjashtimi i grave nga të gjitha postet publike është një relikte e ditëve më barbare se ditët tona. Dhe për ata që bëjnë pyetjen se pse fjala “personat” duhet të përfshijë edhe gratë, përgjigjja e natyrshme është, “pse jo?”<sup>6</sup>

Megjithatë, nga mesi i viteve 1980, po bëhej gjithmonë edhe më e qartë se shtysa që kishte dhënë rasti i Pesëshes së Famshme nuk kishte sjellë atë nivel arritjesh në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave që shiheshin në vende të tjera.<sup>7</sup> Gratë aktiviste kanadeze, si në kuadrin e partive ashtu edhe në atë të shoqërisë civile, u kërkuan drejtuesve të partive politike që të miratonin nisma që do të rrisnin numrin e grave anëtare të tyre dhe të grave të zgjedhura. Drejtuesit e Partisë Liberale dhe të PRD-së u bënë të vetëdijshëm se lëvizja feministe pesëdhjetëvjeçare kishte sjellë si rezultat një pranim më të madh të praktikave të barazisë gjinore dhe kjo krijonte mundësi të tjera për t'u zgjedhur nga elektorati, aq më tepër duke pasur parasysh se konkurrentja e tyre kryesore, Partia Konservatore, njihet si një parti me tregues shumë të dobët në përfshirjen e grave si kandidate dhe në poste të zgjedhura.<sup>8</sup> Për shembull, Gerard Kennedy, këshilltari i posaçëm i udhëheqësit liberal Stephane Dion për zgjedhjet e vitit 2007, u shpreh kështu në përligje të kuotave të brendshme të Partisë Liberale “partia në përgjithësi e pranon se kjo [niveli i ulët i përfaqësimit të grave] është një parregullsi që duhet korrigjuar ... madje në fakt jemi shumë të vonuar.”<sup>9</sup> Teksa filluan të vinin re se përfshirja e grave u jepte një imazh më të favorshëm në shtyp dhe filluan të bënin përpjekje për të mbledhur sa më shumë gra rreth vetes, partitë filluan njëkohësisht të bëheshin edhe më të hapura për eksplorimin e strategjive të tjera që do t'u jepnin grave më shumë ndikim në proceset e hartimit të politikave në nivele të ndryshme.

### Strategjitë e përdorura

Gratë e Partisë Liberale ishin ndër ato aktiviste që në vitet 1980 bënë thirrje për zgjedhjen e një numri më të madh grash në parlament. Duke dashur që të krijonin dhe nxinin një shtysë më të madhe për ndryshim, gratë e Partisë Liberale u organizuan për të krijuar rrjete dhe institucione që kishin për qëllim të kapërcenin pengesat financiare me të cilat përballeshin shumë gra kur donin të fusnin këmbët në arenën politike. Më vonë, gra të shquara të partisë arritën të siguronin mbështetjen e udhëheqjes së partisë për të integruar përparësitë politike të grave në platformën politike të partisë, si dhe të vendosej një kuotë e brendshme për kandidatet.



## A. INSTRUMENTET E FINANÇIMIT: FONDI JUDY LAMARSH (XHUDI LAMARSH)

Duke e pranuar nevojën për të përmirësuar mbështetjen e tyre për gratë kandidate, Partia Liberale i përfshiu ato në strukturat e veta të mbledhjes së fondeve dhe u përpoq të siguronte që gratë të kishin fonde të mjaftueshme për fushatat e tyre. Gratë në Partinë Liberale ndërtuan **rrjete financimi** që kishin funksionin e dyfishtë të afronin në parti gra nga sektorë të tjerë, që kishin pushtet dhe mjete financiare, si dhe t'u bënin të mundur grave të përfshira në parti që ta tregonin vlerën e tyre si aktiviste dhe përkrahëse të partisë.

Në vitin 1984, gratë drejtuese në Partinë Liberale, të cilave u kishte ardhur në majë të hundës me numrin e paktë të grave në poste të zgjedhura dhe mungesën e pushtetit të tyre politik, themeluan **fondin Xhudi Lamarsh**.<sup>10</sup> Fondi mori këtë emër për të përkujtuar rolin udhëheqës të Xhudi Lamarshit, gruaja e parë në këtë parti që ishte bërë ministre e kabinetit federal, e cila punoi pa u lodhur për të futur dhe miratuar ligje përparimtare për gratë, si një sistem gjithëpërfshirës sigurimesh shëndetësore, i financuar me fonde publike, si dhe krijimi i Komisionit Mbretëror për Statusin e Grave. Themelueset e Fondit Xhudi Lamarsh kishin si qëllim të krijonin një mekanizëm partiak për ngritjen dhe shpenzimin e fondeve për gratë kandidate, për t'i ndihmuar ato të zgjidheshin në parlament. Me kalimin e kohës Fondi u bë më i suksesshëm, dhe disa persona në parti filluan ta shohin atë si një instrument për ndërtimin e partisë dhe zgjerimin e bazës së anëtarëve të saj, duke përfshirë më shumë gra në të.

Fondi Xhudi Lamarsh mbledh kryesisht **fonde nga donatorët** me anë të veprimtarive për mbledhjen e fondeve. Fondi duhet të punojë në përputhje me rregulloren e Kanadasë për financimin e partive politike, që përcakton një shumë tavan për donacionet individuale prej 1000 dollarësh kanadezë për çdo parti politike, 1000 dollarë kanadezë për shoqatat e zonave zgjedhore, dhe 1000 dollarë kanadezë për garën elektorale të personave që venë kandidaturën për poste udhëheqëse në një parti politike të regjistruar (këto shuma ndryshojnë nga viti në vit për të reflektuar normën e inflacionit).<sup>11</sup> Programi i Fondit Xhudi Lamarsh është i strukturuar në një mënyrë të tillë që e vë

atë në konkurrencë të drejtpërdrejtë me partinë për marrjen e këtyre kontributeve individuale. Ky faktor e kufizon kapacitetin e tij të përgjithshëm fonde-mbledhës; megjithatë, Fondi ka pasur një sukses të konsiderueshëm në afrimin e më shumë grave donatore në parti dhe mobilizimin e një numri të madh grash si kontributore, vullnetare, dhe aktiviste të partisë.

## B. USHTRIMI I NDIKIMIT NË PLATFORMAT PARTIAKE: LIBRAT ROZË

Përveç përpjekjeve të saj për mbledhjen e fondeve, Partia Liberale ka ndërmarrë edhe strategji të tjera për të mobilizuar gratë brenda partisë. Duke ndërtuar mbi suksesin e Fondit Xhudi Lamarsh dhe në pozicionet kyçe të grave në udhëheqjen e partisë, Liberalët prezantuan edhe një **dokument të ri partiak që e quajtën Libri Rozë**, që paraqiste vizionin e partisë për barazinë gjinore dhe përvijonte propozime për politika publike që fokusoheshin tek çështjet prioritare të grave. Ky Libër Rozë, që doli në fillim në vitin 2006, "rekomandon një varg politikash për t'i dhënë zgjidhje çështjeve më të ngutshme shoqërore dhe ekonomike me të cilat përballen gratë në Kanada, sidomos gratë që punojnë dhe familjet e tyre, ato që kujdesen për të tjerët dhe gratë e moshuara."<sup>12</sup> Politikat e propozuara pasqyronin shqetësimet në rritje për gratë, sidomos ato që lidheshin me arsimin dhe punësimin. Libri Rozë u nis nga Forumi i Grave Liberale, i cili kërkonte të krijonte një platformë që mund të përdorej dhe konsultohet nga partia kur të fliste me elektoratin për çështje të grave. Kandidatet parlamentare që u zgjodhën ishin edhe ato mbështetëse të Librit Rozë dhe e përdorën atë në fushatat e tyre.

Duke parë reagimin pozitiv të grave dhe burrave në parti, në vitin 2007 Partia nxori edhe një vëllim të dytë të Librit Rozë, me një fokus më të zgjeruar politik, që përfshinte çështje si "dhuna ndaj grave, strehimi, gratë aborigjene, gratë emigrante dhe refugjate, dhe gratë e zonave rurale."<sup>13</sup> Në vitin 2009, u publikua botimi i tretë i Librit Rozë. Librat Rozë u shkruan kryesisht nga gratë e Partisë Liberale përmes një procesi përfshirës të përbërë nga konsultime me organizatat e grave dhe eksperte të politikave, me qëllim që të sigurohej që të pasqyroheshin gjerësisht nevojat dhe interesat e grave kanadeze. Në këtë mënyrë, Librat Rozë

e ndihmuan Partinë Liberale të forconte lidhjet e saj me organizatat e grave dhe t'u përgjigjej më mirë shqetësimeve të qytetarëve. Një deputet i mëparshëm liberal i përshkruante Librat Rozë si “një instrument i mrekullueshëm që mundëson krijimin e lidhjeve me organizatat e grave dhe anëtarët e tyre.”<sup>14</sup> Për më tepër thelbi dhe procesi në themel të Librave Rozë u tregoi disa organizatave të shoqërisë civile se Partia Liberale i kishte marrë seriozisht çështjet e grave, gjë që e kishte ndihmuar Partinë Liberale të zgjeronte numrin e anëtarëve të saj femra, dhe të tërhiqte gra të talentuara dhe me mençuri politike në parti.

### C. KUOTAT E BRENDSHME TË KANDIDATËVE

Duke qenë se Partia Liberale ishte një njësi politike me një udhëheqje të fortë, gratë e kuptuan se pranimi dhe mbështetja më e madhe e partisë për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë nuk do të ishte e mundur pa përkrahjen e fuqishme të udhëheqësve të partisë. Gratë liberale më në fund arritën ta kenë këtë mbështetje kyçe në vitin 2007, kur udhëheqësi i partisë, Majkëll Ignatieff (Michael Ignatieff) dhe paraardhësi i tij Stefan Dion (Stephane Dion), bënë thirrje që një e treta e kandidatëve të emëruar nga partia për deputetë në parlament të ishin

### KANADA: PARTIA E RE DEMOKRATIKE (PRD): REKRUTIM I DIVERSIFIKUAR I KANDIDATËVE DHE SUBVENCIONET PËR SHPENZIMET E FUSHATËS

Krahas nismave novatore të Partisë Liberale për mbështetjen e grave, edhe Partia e Re Demokratike në Kanada ka zbatuar një varg politikash të rëndësishme për të shtuar rolin e grave në partinë e tyre. Në vitet 1980, gratë në PRD u organizuan për të bërë një analizë të diversitetit në parti, me qëllim që të tregonin hendekun që ekzistonte ndërmjet misionit të partisë për barazinë gjinore dhe realitetit të përfaqësimit të grave, si dhe për të bërë të mundur miratimin e një politike partiake që të angazhohej t'i vinte gratë si kandidate për vende të sigurta. Po kështu, PRD-ja punoi për të gjetur zgjidhje për vështirësitë që kishin gratë për sigurimin e fondeve përmes subvencioneve për gratë kandidate për shpenzime të lidhura me fushatën.

#### REKRUTIM I DIVERSIFIKUAR I KANDIDATËVE

Pas zgjedhjeve rajonale të vitit 2005, udhëheqja rajonale e partisë për rajonin e Kolumbias Britanike analizoi angazhimin e PDR-së për barazinë politike dhe arriti në përfundimin se rezultatet e zgjedhjeve nuk përputheshin me deklaratat e partisë për mbështetjen e grave. Pas konsultimeve me mijëra anëtarë dhe anëtare të partisë, PRD-ja nxori një raport partiak me rekomandime për hapat praktike për ta bërë më të hapur procesin e emërimit të kandidatëve brenda partisë për një grup më të diversifikuar kandidatësh, ku jepeshin edhe hollësi se si partia do të caktonte dhe përmbushte objektivat për të vënë më shumë gra dhe kandidatë të tjerë nga grupet më pak të përfaqësuara në zona zgjedhore ku mund të fitojnë. U theksua veçanërisht se ekziston nevoja për të njohur dhe për të marrë masa për “disavantazhin e dyfishtë” që kanë gratë me ngjyrë dhe gra të tjera që përfaqësojnë demografi të tjera me mungesa përfaqësimi për arsye të shumëfishta.<sup>1</sup> Raporti, që u njoh me emrin Mandati i Barazisë, përmbante tre rekomandime kryesore:

- Në 30 për qind të të gjitha zonave zgjedhore “të tipit 1”, ku deputeti aktual nuk vë kandidaturën përsëri dhe kandidatët janë të gjithë të rinj, të caktoheshin kandidate gra.
- Në 10 për qind e zonave zgjedhore “të tipit 2”, ku deputeti aktual nuk do të vërë kandidaturën dhe kandidatët janë të gjithë të rinj, do të caktoheshin kandidate nga grupe të tjera demografike me përfaqësim të ulët përtej gjinisë;
- Në ato zona ku deputeti i tanishëm i PRD-së nuk do të kërkojë të rizgjidhet, do të vihehin automatikisht kandidate femra, duke i vënë kështu gratë në “zona zgjedhore të tipit të tretë” ku PRD-ja e kishte provuar se mund të fitonte.<sup>2</sup>

#### SHËNIME

<sup>1</sup> Intervistë me një aktiviste të PRD-së nga Kolumbia Britanike, Shkurt 2010.

<sup>2</sup> Si më lart.

**gra.** Mbështetja që i dhanë ata kuotave të brendshme dhe deklaratat publike për vlerën e pjesëmarrjes së grave në parti, bënë që të rritej mbështetja për këtë nismë. Duke pasur parasysh sistemin elektoral kanadez me një mandat, Partia Liberale bëri përpjekje ta zbatonte këtë kuotë me anë të miratimit të një politike partiake që kërkonte nga secila zonë të bënte “një përpjekje të fuqishme” për të rekrutuar gra kandidatë për garën parlamentare. Nëse organizatat nuk do ta përbushnin këtë kriter, zyra qendrore e partisë nuk do ta certifikonte kandidatin dhe gara e brendshme në parti nuk do të zhvillohej. Për më tepër, zyra qendrore e partisë mund të kishte të drejtën të shfuqizonte emërimet për kandidatë deri në 25 zona zgjedhore parlamentare dhe të vërë atje kandidatë të zgjedhur prej saj.

Ndonëse këto instrumente lehtësuan vënien në jetë të kuotave, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor, zyrat e partisë e patën të vështirë të përcaktonin se çfarë saktësisht donte të thoshte shprehja e mjegullt “përpjekje të fuqishme”. Liberalët caktuan një Drejtore për Kërkimin e Kandidateve Gra për të rekrutuar gra për të qenë kandidatë. Partia krijoi gjithashtu edhe komisione të ashtuquajtura “të dritës së gjelbër” në nivel vendor për t’i ardhur në ndihmë partisë të përbushte objektivin prej 33 për qind që i kishte caktuar vetes. Këto komisione u ngritën me qëllimin për të hartuar informacione personale dhe për të intervistuar, vlerësuar dhe analizuar kandidaturat e kandidatëve të mundshëm.<sup>15</sup> Rekrutimi shpesh kryhej në nivel vendor, dhe sasia e përpjekjeve të bëra nga komisionet partiake për rekrutimin e kandidatëve ishte e ndryshme nga rajoni në rajon.

## Rezultatet

Miratimi i një mekanizmi financues brenda Partisë Liberale e ka rritur përqindjen e grave të zgjedhura. Në kohën kur u themelua Fondi Xhudi Lamarsh, përqindja e grave përfaqësuese të Partisë Liberale në parlament ishte e ulët: shtatë për qind e grupit parlamentar të Partisë Liberale të zgjedhur në vitin 1980 dhe 13 për qind e atyre të zgjedhur në vitin 1984 ishin gra. Nga viti 1993, kjo shifër kishte arritur në 20 për qind. Raporti i kandidatëve gra në grupin parlamentar liberal nuk ka rënë nën 20 për qind që nga ajo

kohë dhe në zgjedhjet kombëtare të vitit 2008 kjo shifër arriti në 25 për qind.<sup>16</sup> Në të njëjtat zgjedhje të vitit 2008, liberalët e zbatuan politikën e tyre të kuotave të brendshme partiake, duke paraqitur 113 kandidatura të grave në 307 zona zgjedhore federale, apo 36,9 për qind të numrit të përgjithshëm të kandidatëve të tyre.<sup>17</sup> Për më tepër, diskutimet publike për mbështetjen e grave kandidatë dhe veprimtaritë për mbledhje fondesh që zhvilluan në Partinë Liberale, iu përgjigjën më së miri tablosë së përgjithshme politike në Kanada, aq sa edhe Partia Përparimtare Konservatore, që tashmë nuk ekziston më, filloi të bënte nismat e saj për mbledhje fondesh për gratë, që e quajti Fondi Elen Feërklo (Ellen Fairclough).

Librat Rozë gjithashtu kanë ndikuar në mënyrë të ngjashme në arenën politike, duke i bërë çështje kyçe, si dhuna në familje, pjesë të platformës së Partisë Liberale. Në vitin 2004 u bënë përpjekje për futjen e një Programi Kombëtar të Kujdesit për Fëmijët, që ishte kërkuar në Librat Rozë.

Në përgjithësi, përmes veprimtarive aktive të grave në parti, mbledhjes së fondeve, mbështetjes së udhëheqjes së partisë, vizionit politik që përfshinte përparësitë e grave, dhe lidhjes së qartë ndërmjet këtyre taktikave dhe strategjisë elektorale, gratë fituan pozita me ndikim në Partinë Liberale, ndër të cilat edhe një grua në postin e këshilltares së lartë për politikë kombëtare.

## Sfidat dhe rruga përpara

Megjithëse Fondi Xhudi Lamarsh i Partisë Liberale dhe kuota e brendshme e partisë për 30 për qind gra kandidatë në listën e partisë e shtuan numrin e grave në institucionet politike, gama dhe ndikimi i mëtejshëm i këtyre nismave në parlament ka qenë i kufizuar. Fondi Xhudi Lamarsh po shqyrton mundësinë për t’u ofruar ndihmë grave kandidatë që venë kandidaturën për poste zyrtare, por zgjerimi i përpjekjeve të tij mund të shtojë më tepër konkurrencën për fondet e kufizuara individuale për fushata elektorale.

Po kështu, realiteti politik i të qenit një parti e pakicës në parlament ka bërë që Partia Liberale të mos jetë në gjendje t’i zbatojë gjërësisht politikë të propozuara në Librat Rozë.

Ndikimi i Librave Rozë në legjislacion ka qenë i vogël; një nga të intervistuarat e përshkroi atë si “jo ndonjë gjë për t’u shënuar”.<sup>18</sup> Ndërkohë, udhëheqja e Partisë Liberale, ndonëse e mbështeti futjen e më shumë grave në politikë, vazhdon të mbetet kryesisht e dominuar nga meshkujt.

Me gjithë përpjekjet e Partisë Liberale dhe të PRD-së për të mbështetur gratë në rrugën e tyre drejt funksioneve të zgjedhura, parlamenti si institucion vazhdon të paraqesë vështirësi për individët që kanë edhe përgjegjësi të tjera të kujdesit për familjen. Kanadaja është një vend shumë i madh dhe shumë nga zonat zgjedhore janë me mijëra kilometra larg nga kryeqyteti, Otava. Për shkak të sasisë së kohës që deputetët duhet të jenë në kryeqytet si dhe seancat dhe votimet që vazhdojnë deri në orët e vona, është e vështirë të arrihet një balancë e jetës familjare me atë politike. Në më të shumtën e rasteve, janë gratë ato që kanë barrën kryesore të kujdesit për familjen, gjë që e bën jetën parlamentare më të vështirë për gratë se sa për burrat. Shumë nga gratë drejtuese që u intervistuan, tanë se partitë e tyre mund të bënin reforma për ta bërë parlamentin më të ndjeshëm për çështjet gjinore, si për shembull, ndryshimi i orareve të seancave parlamentare për t’u përshtatur më mirë kalendarit dhe orareve të shkollave, për të akomoduar kështu parlamentarët me fëmijë të vegjël, përdorimi i video-konferencave në vend të mbledhjeve dhe seancave dëgjimore në komisionet parlamentare, dhe krijimin e programeve kompjuterike të sigurta për t’u mundësuar parlamentarëve të marrin pjesë në votim edhe pa qenë fizikisht të pranishëm. Strategjitë novatore të përdorura tashmë nga Partia Liberale dhe PRD-ja tregojnë se ekziston vullneti dhe kapacitetet për t’u dhënë zgjidhje edhe barrierave të tjera që pengojnë pjesëmarrjen dhe ndikimin e duhur të grave në politikën kanadeze.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Ky rast studimi u shkrua gjatë viteve 2009-2010, dhe informacioni që përmbahet në të i referohet zgjedhjeve të vitit 2008. Në maj të vitit 2011 u mbajtën zgjedhje ku gratë fituan 24,6 për qind të vendeve në parlament

<sup>3</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). “Kanadaja: Dhoma e Përfaqësuesve.” PARLINE Database. Gjetet në [http://www.ipu.org/parline-e/reports/2055\\_E.htm](http://www.ipu.org/parline-e/reports/2055_E.htm), parë në janar 2012.

<sup>4</sup> The Globe and Mail. (2010). “The Hurdle to Leap in the Next Election Year.” (Pengesja për t’u kapërcyer në vitin e ardhshëm zgjedhor) Kryeartikull, 11 janar. Gjetet në <http://www.theglobeandmail.com/news/opinions/editorials/the-hurdle-to-leap-in-the-next-election/article1426310/>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Munroe, S. “The Persons Case: A Milestone in the History of Canadian Women.” (Çështja ligjore e personave: Një gur kilometrik në historinë e grave kanadeze) Udhëzues i About.com. Gjetet në <http://canadaonline.about.com/cs/women/a/personscase.htm>, parë në qershor 2010.

<sup>7</sup> The Globe and Mail, 2010.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Jolly, B. (2007). “Liberals Try to Pick Up More Women.” (Liberalët përpiqen të tërheqin më shumë gra” Capitol News Online. Gjetet në [http://carleton.ca/Capital\\_News/02032007/n5.shtml](http://carleton.ca/Capital_News/02032007/n5.shtml), parë në janar 2012.

<sup>10</sup> Parlamenti i Kanadasë. “Women Candidates in General Elections: 1921 to Date.” (Gratë kandidate në zgjedhjet e përgjithshme: nga viti 1921 deri më sot) Gjetet në <http://www2.parl.gc.ca/Sites/LOP/HFER/hfer.asp?Language=E&Search=WomenElection>, parë në janar 2012.

<sup>11</sup> Marenko, J. (2009). “Federal Campaign Finance Laws in Canada.” (Ligjet financiare për fushatat federale në Kanada) Mapleleafweb. Gjetet në <http://www.mapleleafweb.com/features/federal-campaign-finance-laws-canada#overview>, parë në janar 2012.

<sup>12</sup> Partia Liberale e Kanadasë - Alberta. “A Message from Incoming Alberta Liberal Women’s Commission President Wendy Butler on International Women’s Day.” (Një mesazh nga kryetarja e ardhshme e komisionit të grave liberale të Albertas, Wendy Butler, me rastin e ditës ndërkombëtare të grave.” Gjetet në [http://www.liberalalberta.ca/story\\_15653\\_e.aspx](http://www.liberalalberta.ca/story_15653_e.aspx), parë në janar 2012.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Ish deputete e Partisë Liberale, korrik 2009.

<sup>15</sup> Jolly, 2007.

<sup>16</sup> Dasko, D. (2008). “Open Letter.” (Letër e hapur) Equal Voice (Zë i barabartë). Gjetet në [http://www.equalvoice.ca/pdf/EV\\_per\\_qind20Canada\\_Challenge\\_-\\_Letter\\_to\\_Ignatieff\\_-\\_Liberal\\_leader.pdf](http://www.equalvoice.ca/pdf/EV_per_qind20Canada_Challenge_-_Letter_to_Ignatieff_-_Liberal_leader.pdf), parë në janar 2012.

<sup>17</sup> Barker, J. (2008). “Over one third of liberal candidates are women.” (Mbi një e treta e kandidateve liberale janë gra). National Post, shtator 23. Gjetet në <http://network.nationalpost.com/np/blogs/posted/archive/2008/09/23/over-one-third-ofliberal-candidates-are-women.aspx>, parë në janar 2012

<sup>18</sup> Intervistë me një aktiviste të Partisë Liberale, nëntor 2009.

## KROACIA: MBËSHTETJA E FORUMIT TË GRAVE TË PARTISË PËR KUOTAT PËR KANDIDATËT DHE TRAJNIMET PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE<sup>1</sup>

### Pak informacion

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, Kroacia ka fituar pavarësinë dhe u bë anëtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) si dhe vend anëtar i Bashkimit Evropian. Vitet e para të pavarësisë së Kroacisë përkuan me kontekstin e vështirë të luftërave që shoqëruan ndarjen e Jugosllavisë. Që nga viti 2000, Kroacia ka pasur një sistem shumë-partiak, me dy parti kryesore, Bashkimin Demokratik Kroat dhe Partinë Social Demokrate (PSD), që kanë dominuar shumicën e vendeve në parlament. Anëtarët e parlamentit një-dhomësh të Kroacisë zgjidhen me anë të një sistemi zgjedhor me përfaqësim proporcional me lista partish. Në skenën politike kroate ka të paktën gjashtë parti të tjera, dhe ato zakonisht bashkohen në koalicione me një nga partitë e mëdha.

Trysnia e ushtruar nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) dhe aktivistet që kanë kërkuar legjislacion për barazi gjinore, ka ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në parlament. Në vitin 1990 gratë përbënin vetëm

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Social Demokrate për të promovuar pjesëmarrjen e grave, ndonëse ajo nuk është partia e vetme që e ka bërë këtë në Kroaci. Ai fokusohet tek mobilizimi i grave brenda partisë dhe miratimi i kuotave të brendshme partiake.



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave

Forumi i grave

Kuota të brendshme partiake

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Partia Social Demokrate (PSD)

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: KROACIA

Emri i parlamentit	Parlamenti Kroat
Struktura e parlamentit	Një-dhomëshe
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional
Zgjedhjet legjislative	Nëntor 2007
Numri i grave të zgjedhura	32 nga 153 (20,9%)

4,6 për qind të deputetëve në parlament, një përqindje që u rrit në 7,9 për qind në vitin 1995, dhe 17,8 për qind në vitin 2000. Në vitin 2011, gratë kishin 23,5 për qind të vendeve në parlament.<sup>2</sup> OSHC-të, në partneritet me gra politike në shquara, që nga mesi i viteve 1990 kanë bërë kërkuar që listat e partive për kandidatët për zgjedhje të përfshijnë një minimum prej 30 për qind gra. Ato gjithashtu kanë mbajtur gjallë debatin për të mirat dhe të metat e sistemeve të kuotave.

Pjesërisht si reagim ndaj kësaj trysnie, politikat legislative dhe qeveritare të Kroacisë kanë promovuar pjesëmarrjen e grave. Ligji për Barazinë Gjinore i vitit 2003 kërkon që barazia gjinore të promovohet përmes përdorimit të masave të veçanta në organet legislative dhe ekzekutive, si dhe në sistemin gjyqësor, përfshirë edhe shërbimin civil, në mënyrë që seksi i nën-përfaqësuar të mund të arrijë gradualisht përfaqësimin që i takon në bazë të përqindjes që zë në popullsinë e përgjithshme.<sup>3</sup> Ligji kërkon gjithashtu që partitë e regjistruara politike të miratojnë plane veprimi për arritjen e balancës gjinore ndër kandidatët për zgjedhje.

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Forumi i Grave i Partisë Social Demokrate (FGPSD) u themelua në vitin 1995 si një organizatë e brendshme brenda partisë. Gratë aktiviste në PSD donin të krijonin **një forum të grave** kryesisht për t'i dhënë zgjidhje problemit të shkallës së ulët të pjesëmarrjes së grave në parti. Një anëtare e PSD-së i përshkruante vitet e para të pavarësisë si një kohë gjatë së cilës “nga gratë pritej të rrinin në shtëpi dhe të lindnin foshnja.”<sup>4</sup> Disa nga gratë që themeluan forumin e grave që themeluan FGPSD-në kishin pasur përvojë pune në parti të tjera social demokrate evropiane dhe donin që PSD-ja kroate të ndiqte shembullin e atyre partive për sa i përket barazisë gjinore.

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, FGPSD ka ndihmuar që PSD të bëhej një zë i fuqishëm politik për gratë kroate. Gratë kanë role udhëheqëse në strukturat e partisë si dhe në disa organe të ndryshme legislative në të gjithë vendin. Në vitin 2010, më se 40 për qind e komitetit

ekzekutiv të PSD-së dhe një nga dy nënkryetarët e saj, ishin gra. Ky sukses mund t'i atribuohet futjes së kuotave të brendshme partiake, mbështetjes nga gra të shquara në parti, dhe hartimi i programeve legislative për çështje me përparësi për gratë.

## Strategjitë e përdorura

### A. KRIJIMI I FORUMIT TË GRAVE

Të nxitura nga motivi për të shtuar ndikimin e partisë së tyre tek gratë, aktivistet e PSD-së promovuan krijimin e **një forumi të grave** në parti, me zyra degësh nën-kombëtare në nivele të ndryshme. Pas krijimit të tij në vitin 1995, FG i PSD-së punoi për të zhvilluar marrëdhënie strategjike me OSHC-të dhe sindikatat, për të zbatuar kuota të brendshme në parti, për të ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive të anëtareve femra të partisë, dhe për të hartuar platforma në nivel vendor për përparësitë politike të grave.

Në vitet 1990, PSD-ja ishte një parti e vogël – nga viti 1992 deri 1995 ajo kishte gjashtë deputetë në parlament, nga të cilët dy ishin gra, ndërsa nga viti 1995 deri në vitin 2000, kishte nëntë deputetë, nga të cilët 3 ishin gra. Duke pasur parasysh madhësinë e partisë në atë kohë dhe numrin e vogël të grave që ishin anëtare të saj, aktivistet e partisë e kuptuan se nuk do ta përmbushin dot qëllimin e tyre për krijimin e një forumi të grave nëse nuk e bënë partinë tërheqëse për një numër më të madh grash. Për këtë arsye, FG i PSD-së nuk u kërkonte grave që të ishin anëtare partie përpara se të bëheshin anëtare të forumit, duke bërë kështu të mundur që gra jo-partiake nga sektorët jo-qeveritarë dhe sektorë të tjerë, të merrnin pjesë në veprimtaritë e FG të PSD-së.<sup>5</sup> Kjo qasje jo vetëm i hapi dyert e Forumit të Grave për një numër më të madh grash dhe ndihmoi të rekrutoheshin gra të lëvizjes civile në radhët e partisë, por ajo kaliti edhe lidhje më të forta ndërmjet Forumit të Grave dhe OSHC-ve dhe bashkimeve profesionale të grave. Këto lidhje ishin në përfitim si të Forumit të Grave të SDP-së, ashtu edhe të shoqërisë civile, që kishte enë një aleate e sigurtë e partisë në hartimin e ligjeve të rëndësishme.

## B. KUOTAT E BRENDSHME NË PARTI

Një nga nismat më të para të FG të PSD-së ishte që të miratonte një **kuotë të brendshme partiake prej 40 për qind** “për gjininë më pak të përfaqësuar” në të gjitha strukturat e partisë, përfshirë edhe listat e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet parlamentare dhe ato të organeve të qeverisjes vendore. Përdorimi i termit “gjinia më pak e përfaqësuar” u bë me qëllim që t’i paraprihej çdo kundërshtimi të mundshëm nga burrat që mund të kishin shqetësimin se një sistem kuotash do të ishte diskriminues dhe do të ndikonte në pjesëmarrjen e burrave. Kjo kuotë u promovua fuqishëm nga FG i PSD-së për t’u kundërvënë qëndrimit konservator ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë dhe si një mjet për ta bërë PSD-në të dallohej nga partitë e tjera kroate. Gratë në PSD punuan për ngritjen e ndërgjegjësimit për praktikën më të mira që zbatoheshin në partitë social demokrate evropiane për sa i përket barazisë gjinore. Po kështu, FG i PSD-së përdori shembuj nga parti të tjera evropiane në përpjekjet për të bindur udhëheqjen e partisë për nevojën e kuotave në parti. Më në fund, në vitin 1996, PSD-ja pranoi të vendoste kuota vullnetare brenda saj pa ndonjë kundërshtim të madh nga ndonjë prej grupimeve në parti, dhe kuotat u miratuan njëzëri në konferencën e partisë.

FG i PSD-së i shtoi politikën e kuotave përmes **programeve të gjera të trajnimit për gratë anëtare të partisë**. Gjatë këtyre trajnimeve, FG i PSD-së shfrytëzoi marrëdhëniet dhe lidhjet që kishte me parti politike dhe fondacione evropiane, të cilat ishin në gjendje t’u ofronin asistencë dhe të drejtonin trajnimet. Këto programe trajnimi qenë mjaft të efektshme në mbështetjen e grave, qoftë si kandidate apo si funksionare, që të zhvillonin aftësi të dobishme. Një theks i veçantë iu vu komunikimit politik, një fushë në të cilën shumë pak gra kishin përvojë. Këto programe qenë gjithashtu të frytshme sepse ndihmuan për krijimin e një rrjeti të gjerë grash politikane. Ekzistenca e këtij rrjeti bëri të mundur që vendet në bazë të kuotave të mbusheshin nga gra me përvojë.

Përpara zhvillimit të zgjedhjeve kombëtare të vitit 2007, PSD-ja kishte shprehur **qëndrimet e saj politike** mbi një

numër çështjesh që ishin përparësi për gratë kroate, ndër të cilat dhuna në familje, paga e barabartë, kujdesi për fëmijët dhe të drejtat riprodhuese. Në maj të vitit 2009, FG i PSD-së po ashtu mbështeti hartimin e një platforme programore që u shpërnda në të gjithë vendin dhe u miratua gjerësisht nga kandidatët vendorë të PSD-së. Këto platforma vendore u ndihmuan nga rrjeti i gjerë dhe i përhapur i degëve të forumit të partisë në nivel komune, bashkie dhe qarku, dhe e kishin origjinën tek strategjia e partisë për të krijuar forume grash në të gjitha nivelet nën-kombëtare dhe në të gjitha vendet ku ishin të pranishme degët e partisë. Në një periudhë të caktuar, PSD-ja kishte deri në 200 zyra të degëve të forumit të grave.<sup>6</sup>

## Rezultatet

Numri i vendeve të fituara nga PSD-ja në parlament është rritur vitet e fundit dhe bashkë me të është rritur edhe numri i grave deputete në grupin e saj parlamentar. Kuotat e brendshme kanë kontribuar në arritjen e një përfaqësimi më të madh të grave në parlament: gratë përbënin 32 për qind të grupit parlamentar të PSD-së pas zgjedhjeve të vitit 2007. Disa nga gratë kanë pasur poste me ndikim në parlament, si zëvendës kryetare të grupit parlamentar të PSD-së, si dhe ka pasur disa gra mjaft të fuqishme si kryetare dhe nënkryetare të komisioneve parlamentare të bujqësisë, familjes dhe rinisë, shërbimeve sociale dhe barazisë gjinore. Nga ana e tyre, gratë deputete të PSD-së kanë luajtur një rol kyç në promovimin e disa ligjeve të rëndësishme, si Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji Kundër Diskriminimit, dhe Ligji mbi Dhunën në Familje.

Sipas shumë prej aktivisteve të PSD-së, gratë janë gjithashtu të përfshira realisht në proceset e vendimmarrjes në parti. Gratë që janë anëtare të Bordit Qendror të PSD-së janë të përfshira në miratimin e listave të kandidatëve të partisë dhe bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të kuotave. Në nivelin vendor, gratë përfaqësonin 29 për qind të zyrtarëve të zgjedhur të PSD-së në organet e qeverisjes vendore dhe, në bazë të platformës programatike të vitit 2009 për barazinë gjinore, kanë vazhduar të çojnë përpara edhe politika sociale mjaft kuptimplota, si punësimi i profesionistëve të shëndetësisë, terapistëve të të folurit, dhe psikologëve, si

punonjës me kohë të plotë në çdo shkollë fillore në Kroaci.

### Sfidat dhe rruga përpara

Kuotat e PSD-së mund të forcohen më tej nëse trajtohet çështja e renditjes dhe vendit të grave në listat e partisë. Udhëheqja e partisë vazhdon të ketë fjalën e fundit në hartimin përfundimtar të listave të kandidatëve. FG i PSD-së ka bërë thirrje për një proces që mbështetet më shumë tek mendimet e bazës për zgjedhjen e kandidatëve, që do sillte një përfshirje më të madhe dhe më të drejtpërdrejtë të anëtarëve të partisë në procesin e zgjedhjes së kandidatëve.

PSD-ja ka një bord aktiv të grave që synon të rrisë pjesëmarrjen dhe ndikimin e tyre. Partia është e mendimit se kjo e ka ndihmuar atë të krijojë një emër të mirë tek elektorati si partia që i përfaqëson më së shumti gratë dhe çështjet që janë të rëndësishme për to. Puna legjislative dhe hartimi i programeve nga ana e FG të PSD-së gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e këtij mendimi për partinë. Në rrugën e tyre përpara PSD dhe forumi i saj i grave do të kenë si sfidë punën me partnerët e tyre në koalicion për të ndërtuar mbi përpjekjet e mëparshme për zgjidhur faktorët politikë, shoqërorë dhe ekonomikë që mund të përbëjnë pengesë për pjesëmarrjen e grave në politikë, në mënyrë që të ketë arritje më të mëdha në barazinë gjinore që synon.

### Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). "Women in national parliaments, situation as of 31 July 2011." (Gratë në parlamentet kombëtare; gjendja deri më 3 korrik 2011) Gjetet në <http://www.ipu.org/wmn-e/classif.htm>, parë në shtator. Në dhjetor të vitit 2011 u mbajtën zgjedhje parlamentare në të cilat gratë morën 23,8 për qind të vendeve në parlament.

<sup>3</sup> IWRAW Asia Pacific – CEDAW Knowledge Resource, Gender Equality Laws. (Burime njohurish të CEDAW: Ligjet e Barazisë Gjinore) Gjetet në <http://www.iwraw-ap.org/laws/genderequalitylaws.htm>, parë në shtator 2011. Një ndryshim që iu bë ligjit në vitin 2008 e përkufizon më qartë se çfarë quhet seksi më pak i përfaqësuar – kur pjesëmarrja e një gjinie në organet e vendimmarrjes është më e ulët se 40 për qind.

<sup>4</sup> Intervistë me një anëtare të FG të PSD-së, korrik 2009.

<sup>5</sup> Leakovick, K. (2004). "Political Party Quotas in the Croatian Social Democrat Party." (Kuotat e partive politike në Partinë Social Demokratike Kroate). International IDEA. Gjetet në <http://www.quotaproject.org/CS/Croatia.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>6</sup> Po aty.



## MAROKU: AKTIVIZMI NDËR-SEKTORAL PËR PROMOVIMIN E KUOTAVE PËR KANDIDATET E PARTIVE<sup>1</sup>

### Pak informacion

Maroku ka një sistem politik hibrid, me një monarki relativisht të fuqishme që bashkekziston me politikën parlamentare. Dhoma e ulët zgjidhet me anë të një sistemi të përfaqësimit proporcional, ndërsa dhoma e lartë zgjidhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga këshillat vendorë, organizatat profesionale dhe sindikatat e punëtorëve. Në dhomën e ulët të parlamentit përfaqësohen 18 parti, dhe kjo dhomë është e organizuar në disa grupime parlamentar. Gjashtë nga këto parti kanë 25 ose më shumë vende në parlament.

Në vitin 2002, partitë politike nënshkruan një dokument sipas të cilit 30 vende në dhomën e ulët (1 për qind e numrit të përgjithshëm të deputetëve) rezervoheshin për gratë, të cilat do të zgjidheshin nga listat kombëtare.<sup>2</sup> Si rezultat i kësaj, gratë përbënin 10,7 për qind të deputetëve të zgjedhur në vitin 2002, dhe 10,5 për qind në vitin 2007. Kjo përqindje u shtua në 60 vende për gratë përpara zgjedhjeve të vitit 2011, dhe si rezultat, gratë tani kanë 17 për qind të vendeve në parlament. Në dhomën e lartë,

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partive dhe në kontekstin e zgjedhjeve, ndonëse këto nuk janë të vetmet nisma të tilla në Marok. Ky rasti studimi fokusohet tek pjesëmarrja e grave në nivel kombëtar, që është shumë më e lartë se në nivelet e tjera të qeverisjes.



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave

Kuotat për kandidatët

Politikat partiake

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: MAROKU

Emri i parlamentit	Parlamenti i Marokut
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Dhoma e Këshilltarëve dhe Dhoma e Përfaqësuesve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional Dhoma e Përfaqësuesve
Zgjedhjet legjislative	Nëntor 2001
Numri i grave të zgjedhura	67 nga 395 (17%)

për të cilën nuk ekziston ndonjë marrëveshje e tillë, gratë përbëjnë vetëm dy për qind të anëtarëve.

### Baza arsyetuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave

Në Samitin Arab të vitit 2004, udhëheqësit e shteteve shprehën angazhimin e tyre për "...të zgjeruar pjesëmarrjen e grave në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore dhe forcimin e të drejtave dhe statusit të tyre në shoqëri."<sup>3</sup> Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, perspektivat e grave për t'u caktuar në poste politike dhe për të marrë pjesë në politikë në Marok, janë përmirësuar, ashtu siç janë përmirësuar edhe proceset e reformave të përgjithshme institucionale drejt demokracisë. Qeveria marokene u angazhua të promovonte përfaqësimin e grave në strukturat e zgjedhura dhe për të luftuar të gjitha format e diskriminimit me bazë gjinore.<sup>4</sup> Ndonëse këto angazhime të shprehura ekzistojnë dhe ka pasur përparime gjatë viteve të fundit, pjesëmarrja e grave në jetën politike vazhdon të përballet me vështirësi.<sup>5</sup>

## Strategjitë e përdorura

### A. MOBILIZIMI I GRAVE

Gratë marokene për vite me radhë janë përpjekur të kenë një pjesëmarrje më të madhe në jetën shoqërore dhe politike, përfshirë edhe në seksionet e grave të partive politike, si dhe përmes shoqatave të pavarura të lidhura me partitë. Përpjekjet e tyre të përbashkëta ishin një faktor kyç që çoi në reforma dhe në Kodin e Familjes (Mudawana) të vitit 2003, që trajtonte çështje të diskriminimit kulturor dhe ligjor me të cilin përballeshin gratë për shkak të statusit të tyre më të ulët ligjor sipas kodit të mëparshëm të familjes.<sup>6</sup> Kjo reformë në të njëjtën kohë ndikoi dhe u ndikua nga ndryshime të tjera që ndodhën në statusin social-ekonomik dhe politik të grave.

Koalicionet e OSHC-ve të grave dhe anëtarët e partive punuan për të ngritur **ndërgjegjësimin civil** në lidhje me vlerën që ka pjesëmarrja e grave në politikë dhe për dispozitat mbi të drejtat e barabarta të grave, të parashikuara në kushtetutën e Marokut. Një gamë e gjerë organizatash

të grave, vendore dhe ndërkombëtare, u mobilizuan për të bërë avokaci për vendosjen e një sistemi kuotash në nivel kombëtar, duke ndërtuar gradualisht ndërgjegjësimin publik dhe vëmendjen e mediave për përfaqësimin e grave, përmes fushatave të ndërgjegjësimit, seminareve dhe ligjëratave publike, dhe veprimtarive trajnuese. Filloi të krijohet një debat publik për çështjet e përjashtimit të grave, të drejtës së grave për të marrë pjesë në politikë, dhe rolin e kuotave.<sup>7</sup>

Gjatë gjithë kohës së zhvillimit të fushatës së tyre për kuotat drejtueset e organizatave civile dhe ato politike përdorën protokollet ndërkombëtare, si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe mundësinë për të përmirësuar pozitën e Marokut në komunitetin ndërkombëtar me anë të përpjekjeve të tyre për të fituar përkrahjen e udhëheqjeve të partive kryesore, kryeministrit dhe pallatit mbretëror.

### B. KUOTAT ZGJEDHORE

Lufta për një pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë u harmonizua me një fshatë të përbashkët avokacie nga një koalicion i organizatave të grave. Një komitet kombëtar i përbërë nga njëzet forume të grave të partive politike dhe të organizatave për të drejtat e grave, bënë lobing pranë drejtuesve të partive, ministrave të kabinetit qeveritar, dhe publikut për të krijuar mbështetje për propozimet politike dhe ligjore që parashikonin një pjesëmarrje më të madhe të grave.<sup>8</sup> Në vitin 2002, kjo përpjekje e bashkënduar avokacie çoi në një marrëveshje ndërmjet partive politike për të rezervuar 30 vende në dhomën e ulët të parlamentit për gratë, që do të plotësoheshin me emra nga listat kombëtare. Kuotat nuk u institucionalizuan me ligj, por ekzistonin në formën e një "marrëveshjeje" ndërmjet partive politike.

Duke ndërtuar mbi këtë marrëveshje, në vitin 2008, qeveria miratoi një kuotë gjinore prej 12 për ind për zgjedhjet komunale, që u zbatua vitin në vijim. Si pjesë e këtij kodi zgjedhor të përditësuar, u shtuan edhe vende të tjera në këshillat e ndryshme komunale, duke bërë të mundur që partitë të plotësonin standardet për të cilat ishte rënë dakord. Në zgjedhjet historike të vitit 2009, që shënuan

përparime të mëdha në pjesëmarrjen e grave, u zgjedhën më shumë se 3400 gra në poste vendore, pas miratimit të kuotës që kërkonte një minimum prej 12 për qind të përfaqësimit të grave në organet e zgjedhura vendore<sup>9</sup> e dyfishuan numrin e vendeve të rezervuara për gratë në parlamentin kombëtar nga 30 në 60 nga 395 vendet totale në parlament (15 për qind). Ndryshime u bënë edhe në kodin zgjedhor, për të shtuar numrin e vendeve dhe për të reformuar strukturën e votimit. Si rezultat i këtyre ndryshimeve dhe i rolit aktiv të shoqërisë civile dhe i grupeve të grave, përqindja e grave anëtare të parlamentit u rrit nga 10 në 17 për qind në zgjedhjet e vitit 2011.<sup>10</sup>

### C. POLITIKAT PARTIAKE

Brenda kontekstit politik në zhvillim e sipër të Marokut, Forcat Popullore të Bashkimit Socialist (të njohura me akronimin USFP) ishin partia e parë që vendosi **kuotat e brendshme** në kongresin e saj të gjashtë në vitin 2000, me një kuotë prej për qind për të gjitha bordet partiake dhe organet udhëheqëse në nivel vendor dhe kombëtar. Partia kishte gjithashtu edhe një kuotë prej 20 për qind për përfaqësimin e grave në listat zgjedhore të kandidatëve. Për të ndihmuar që të fitohej më shumë mbështetje për udhëheqjen e partisë së tyre, aktivistet partiake e lidhën fushatën e tyre për zgjerimin e të drejtave të grave dhe pjesëmarrjen e plotë të grave në politikë me diskutime më të gjera që lidheshin me barazinë gjinore, demokratizimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve të jashtme ndërmjet Marokut dhe bashkësisë ndërkombëtare. Përveç USFP-së, edhe Partia Istiklal ka miratuar kriteret e përzgjedhjes, për të siguruar futjen e grave në listat e tyre të kandidatëve në nivel kombëtar.<sup>11</sup>

Shumica e partive të mëdha politike në Marok kanë themeluar **seksionet e grave ose struktura të tjera të ngjashme** që merren me çështje të grave dhe me nevojat e grave anëtare të tyre. Për shembull, Partia e Progresit dhe Socializmit (PPS) krijoi një Këshill të Barazisë, për të siguruar përfaqësimin e grave në proceset e vendimmarrjes së partisë. USFP-ja ka punuar për të pasqyruar të drejtat e grave në platformën e saj, duke trajtuar çështje si ligji i shtetësisë, që garanton të drejtat e fëmijëve të grave

marokene me burra të huaj. Në përgjigje të kërkesave të votuesve të tyre, edhe parti të tjera kanë ndërmarrë strategji të ngjashme promovuese, sepse e kanë kuptuar që është e mirë të shihen si parti që i japin më shumë të drejta dhe pushtet grave.

### Rezultatet dhe rruga përpara

Reformat kushtetuese dhe zgjedhore, si dhe pranimi zyrtar i vendeve të rezervuara për gratë, kanë bërë të mundur pjesëmarrjen e grave në politikë në Marok. Përpara marrëveshjes për vendet e rezervuara për gratë, vetëm dy gra kishin qenë deputete në dhomën e ulët të parlamentit. Ndërkohë, në zgjedhjet komunale të vitit 2009, kuota e vendosur në nivel vendor bëri që numri i grave anëtare të këshillave të komunave të rritej nga 127 në më shumë se 3400, duke i tejkaluar të gjitha pritshmëritë, duke bërë që gratë të merrnin 12,4 për qind të vendeve të përgjithshme në këshillat bashkiake. Në tërësi, kuota ishte njëri nga faktorët që motivuan më se 20 mijë gra që në të gjitha partitë politike që të vinin kandidaturën në zgjedhjet e vitit 2009.<sup>12</sup>

Megjithatë, varësia nga sistemi i kuotave është shumë i madh, pjesërisht për shkak të mungesës së strategjive dhe politikave plotësuese për nxitjen e mëtejshme të pjesëmarrjes së grave në politikë me mënyra të tjera. Për më tepër, pjesa më e madhe e financimeve të partive politike vjen nga një sistem financimi publik. Vendimet se si do të shpenzohen këto fonde publike vazhdojnë të jenë të përqendruara në duart e udhëheqjes mashkullore të partisë, dhe nuk ekzistojnë mekanizma për të siguruar që gratë kandidatë të marrin fondet që u duhen për të zhvilluar fushata të suksesshme zgjedhore.

Përparimi i grave përmes një marrëveshjeje ndërmjet partive politike, ka ndihmuar të krijojë baza për rolin udhëheqës të grave në të gjitha partitë politike të Marokut. Ndërsa Maroku vazhdon evolucionin e vet demokratik, këto struktura partiake do të jenë në një pozicion mjaft të mirë për të çuar përpara zhvillimin e një roli më të gjerë dhe një ndikimi më të madh të grave në politikë. Gratë e zgjedhura tashmë në nivel vendor, që përpunon të punojnë me njëra-tjetrën përtej ndarjeve partiake, mund të drejtojnë

përpjekje avokacie për një përforsim më të madh të kuotave dhe të politikave të tjera që propozohen nga baza.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të gjitha nismave apo të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Tahri, R. (2004). "Women's Political Participation: The Case of Morocco." (Pjesëmarrja e grave në politikë: rasti i Marokut) Në Julie Ballington, ed. (2004). *The Implementation of Quotas: African Experiences* (Zbatimi i kuotave: përvoja afrikane), International IDEA, p. 32. Gjetet në [http://www.idea.int/publications/quotas\\_africa/index.cfm](http://www.idea.int/publications/quotas_africa/index.cfm), parë në janar 2012.

<sup>3</sup> United Nations International Research and Training Institute for the Advancement of Women (UN-INSTRAW). (2009). "North Africa: Women's Political Participation." Gjetet në: *Women Living Under Muslim Laws* (Gratë që jetojnë nën ligjet muslimane), <http://www.wluml.org/node/5231>.

<sup>4</sup> Gribaa, B. (2009). Mapping of the situation of women participation in politics in Algeria, Morocco and Tunisia. (Tablo e situatës së pjesëmarrjes së grave në politikë në Algjeri, Marok dhe Tunizi) UN-INSTRAW dhe Qendra për Studime dhe Trajnime për Gratë Arabe (CAWTAR). Gjetet në <http://www.womenpoliticalparticipation.org/>

[upload/publication/publication2.pdf](#), parë në janar 2012.

<sup>5</sup> UN-INSTRAW, 2009.

<sup>6</sup> Gribaa, 2009.

<sup>7</sup> Tahri, 2003.

<sup>8</sup> Liddell, J. (2009). "Gender Quotas in Clientelist Systems: The Case of Morocco's National List." (Kuotat gjinore në sistemet klienteliste: Rasti i listave kombëtare në Marok) Në al-raida (Pionieri), Numri 126-127, faqe 79-86. Gjetet në <http://inhouse.lau.edu.lb/iwsaw/raida126-127/EN/p001-105.pdf>, parë në janar 2012, f. 82.

<sup>9</sup> National Democratic Institute for International Affairs (NDI). (2009). "Morocco." Gjetet në <http://www.ndi.org/morocco>, parë në janar 2012.

<sup>10</sup> Make Every Woman Count. (Ta bëjmë çdo grua të ketë rëndësi) (2011). "Women Political Participation & Elections Monitoring: MOROCCO Parliamentary Election 2011." (Pjesëmarrja e grave në politikë dhe monitorimi i zgjedhjeve: Zgjedhjet parlamentare të vitit 2011 në Marok) Gjetet në [http://www.makeeverywomancount.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=2124:morocco-parliamentary-elections-2011&catid=69:political-participation-a-electionmonitoring&Itemid=170](http://www.makeeverywomancount.org/index.php?option=com_content&view=article&id=2124:morocco-parliamentary-elections-2011&catid=69:political-participation-a-electionmonitoring&Itemid=170), parë në janar 2012.

<sup>11</sup> Liddell, 2009, f. 83

<sup>12</sup> Morocco News. (2009). "Over 20,000 women to run for 2009 local elections." (Më shumë se 20 mijë gra do të venë kandidaturën në zgjedhjet vendore të vitit 2009). Gjetet në <http://morocco.marweb.ma/politics/womenlocal-elections.txt>, parë në janar 2012

## MBRETËRIA E BASHKUAR: VËNIA E KANDIDATURAVE TË GRAVE NË VENDE “TË FITUESHME”<sup>1</sup>

### Pak informacion

Mbretëria e Bashkuar është një monarki kushtetuese në të cilën Mbretëresha është kryetarja e shtetit dhe Kryeministri është kryetari i qeverisë. Parlamenti, ose Westminster, përbëhet nga dy dhoma legislative, Dhoma e Lordëve dhe Dhoma e Përfaqësuesve. Anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë në zona zgjedhore me një deputet dhe shërbejnë për mandate pesëvjeçare. MB-ja ka një sistem shumë-partiak ku Partia Konservatore dhe Partia Laburiste kanë dominuar në parlament që nga vitet 1920. Në Dhomën e Përfaqësuesve gratë përbëjnë 22 për qind të anëtarëve të zgjedhur të parlamentit, një rritje prej 2,5 për qind në krahasim me parlamentin e mëparshëm të zgjedhur në vitin 2005.<sup>2</sup>

Evolucioni i fuqizimit politik të grave dhe përfshirja në parlament ka qenë i ngadaltë. Partitë politike kanë përdorur strategji të ndryshme për të rritur përqindjen e grave të zgjedhura me sistemin zgjedhor maxhoritar të thjeshtë. Sistemi zgjedhor nuk favorizon në veçanti zgjedhjen e

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga partitë politike për të promovuar pjesëmarrjen e grave në politikë, përfshirë edhe ato të Partisë Konservatore. Ai nënvizon përdorimin e metodave të përzgjedhjes së kandidatëve për të promovuar aktivisht pjesëmarrjen e grave.



### FJALË KYÇE

Emërimi i kandidatëve  
Reformimi i politikave partiake

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: MBRETËRIA E BASHKUAR

Emri i parlamentit	Parlamenti i Uestminsterit (Westminster)
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Dhoma e Përfaqësuesve dhe Dhoma e Lordëve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Pluralist/Maxhoritar (Dhoma e Ulët)
Zgjedhjet legislative	Maj 2010
Numri i grave të zgjedhura	143 nga 650 (22%)

grave, sepse i vë gratë në konkurrim të drejtpërdrejtë me burrat, madje shpesh atyre u duhet të konkurrojnë me kandidatë meshkuj që janë tashmë deputetë në ato zona, që janë të mirënjohur dhe kanë qasje më të madhe në fondet e nevojshme për të kryer fushata të suksesshme. Sistemi zgjedhor ku fituesi merr gjithçka e bën gjithashtu të vështirë zbatimin e kuotave të kandidatëve, kështu që strategjitë janë përqendruar në vënien e kandidaturave të grave për konkurrim në zona ku mund të fitojnë.

### Pjesëmarrja e grave në politikë

Një studim i vitit 2004 nga Komisioni Zgjedhor i MB-së nuk konstatoi ndonjë hendek të konsiderueshëm gjinor për sa i përket pjesëmarrjes së votuesve. Megjithatë, i njëjti studim konstatoi se gratë kishin shumë më pak gjasa se burrat të merrnin pjesë në çështjet politike që lidhen me fushatat, si fushatat e partive politike, anëtarësia, ose donacionet, apo edhe thjesht vendosja e kontaktit me politikanët.<sup>3</sup> Gratë kishin më pak besim se burrat në institucionet politike dhe në aftësinë e vet për të ndikuar në procesin politik, të cilin ato e perceptonin si të dominuar nga meshkujt. Gratë kishin më shumë gjasa të përfshiheshin në fushatat zgjedhore dhe të kishin besim në institucionet e qeverisë në zonat zgjedhore të përfaqësuara nga gra deputete, duke lënë të kuptohet rëndësinë e rritjes së përfaqësimit politik të grave.<sup>4</sup>

Rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1997, kur Laburistët morën kontrollin e qeverisë nga Konservatorët, i atribuohen pjesërisht largimit të grave nga Partia Konservatore për në Partinë Laburiste.<sup>5</sup> Miratimi nga Laburistët i një mase të posaçme brenda partisë, çoi si rezultat në një numër rekord grash të zgjedhura. U zgjodhën gjithsej 120 gra, duke e dyfishuar numrin e grave në parlament: 101 ishin nga Partia Laburiste, 13 ishin konservatore dhe gjashtë erdhën nga parti më të vogla apo ishin të pavarura. Ky numër ra pak në zgjedhjet e vitit 2001, sepse partitë ishin më hezituese në zbatimin e kuotave, nga frika se mos rezultatet kontestoheshin në gjykatë.<sup>6</sup> Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005 gratë fituan 128 (20%) vende në parlament,<sup>7</sup> dhe shumica e grave përsëri ishin nga Partia Laburiste. Zgjedhjet e vitit 2010 rezultuan në parlamentin e parë “të varur”,

pra ku asnjë parti nuk kishte fituar shumicën absolute që nga viti 1974, dhe Partia Konservatore dhe Partia Liberal Demokrate shpallën në fund një qeveri të koalicionit. Në këto zgjedhje u zgjodhën gjithsej 143 gra. Numri i grave të zgjedhura të Partisë Konservatore u rrit në mënyrë të konsiderueshme nga 17 në 49,<sup>8</sup> në një masë të madhe në sajë të fushatës së Women2Win (Gratë për fitore).

Në MB partitë politike kanë ndërmarrë nisma për të nxitur pjesëmarrjen e grave si kandidate dhe si anëtare të partive politike dhe organizatave të tjera. Këto nisma përfshijnë trajnimin, këshillimin, lëvizjet që fokusohen tek rritja e numrit të grave anëtare dhe përdorimin e stimujve financiarë për të nxitur risi organizative.<sup>9</sup> Për shembull, Partia Laburiste ka zbatuar lista vetëm me gra kandidate, me qëllim që të promovojë mundësitë e grave për të siguruar emërimin e tyre si kandidate nga partia. Edhe Partia Konservatore ka zbatuar reforma në procedurat e saj të përzgjedhjes së kandidatëve.

Në vitin 2005, David Cameron u bë udhëheqës i Partisë Konservatore. Në një fjalim pas fitores së tij si udhëheqës i kësaj partie, Cameron tha se e ardhmja e Partisë Konservatore qëndronte “në mënyrë të konsiderueshme në zgjerimin e përfaqësimit tonë në Parlament. që të pasqyrojmë më mirë vendin të cilin dëshirojmë ta qeverisim.”<sup>10</sup> Duke ndryshuar procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, për ta bërë atë më përfshirës dhe të shumanshëm, Partia Konservatore shpresonte të bëhej më e afërt me brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të votuesve britanikë, ndër të cilët gratë, të rinjtë dhe pakicat etnike.

### Strategjitë e përdorura

#### A. SHTIMI I NUMRIT TË GRAVE DREJTUESE: GRATË PËR FITORE

Në vitin 2005, një grup anëtarësh konservatorë burra dhe gra themeluan **Gratë për fitore**, një nismë që synonte të rriste numrin e grave parlamentare konservatore, duke bërë fushatë që më shumë gra të vinin kandidaturën në zona elektorale “të fitueshme” apo në ato që tradicionalisht votonin për konservatorët. “Gratë për fitore” është “një grup i përzier burrash dhe grash nga e gjithë Partia Konservatore

që i bashkon me njëri-tjetrin pranimi i faktit se partia ka nevojë të jetë në ndryshim të vazhdueshëm me qëllim që të fitojë besimin dhe konfidencën e Popullit Britanik.<sup>11</sup>

“Gratë për fitore”, që ka edhe një faqe interneti me të njëjtin emër, luajti një rol aktiv në rekrutimin e kandidatëve të reja dhe për t’u dhënë atyre trajnimin, këshillimin dhe mbështetjen për të cilën kishin nevojë për të arritur sukses brenda partisë. Shumë nga gratë kandidatë të përzgjedhura deri tani kanë marrë mbështetje nga “Gratë për fitore”.<sup>12</sup> “Gratë për fitore” beson “se, kur balanca gjinore e kandidatëve pasqyron atë të Britanisë së sotme, mbështetja zgjedhore për Partinë Konservatore rritet në mënyrë të konsiderueshme – dhe, duke bërë përpjekje të bashkërenduara për arritjen e barazimit gjinore, zgjedhësit do t’i njohin përpjekjet pozitive që bëhen dhe kjo do të reflektohet në votën e tyre.”<sup>13</sup>

## B. KUOTA PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE

Pak javë pas themelimit të organizatës “Gratë për fitore”, u njoftuan procedura të reja për përzgjedhjen e kandidatëve, që synonin të rrisnin numrin e grave legjislatorë nga Partia Konservatore dhe nga pakicat etnike. Ato përfshinë zbatimin e një **Liste Prioritare** të kandidatëve “më të shkëlqyer dhe më të mirë”, të paktën gjysma e të cilëve duhet të ishin gra dhe 10 për qind pakica etnike. Shoqatat në zonat zgjedhore që votonin tradicionalisht për Partinë Konservatore, ose të cilat Partia Konservatore i kishte piketuar për t’i fituar në të ardhmen, duhet t’i zgjidhnin kandidatët nga kjo listë. Në janar të vitit 2007 u njoftuan ndryshime për të lejuar këdo në Listë që të aplikonte për çfarëdo vendi në parlament. Një raund tjetër ndryshimesh u dha zonave zgjedhore dy alternativa kryesore. E para, si pjesë e një “veprimtarie kryesore” çdo anëtar mund të kishte katër vota – dy për gra dhe dy për burra – për të

krijuar një listë të shkurtër me katër persona, ku gjysma duhet të ishin gra. Pastaj funksionarët ekzekutivë në zonat zgjedhore zhvillojnë një proces të thelluar intervistash dhe zgjidhnin kandidatin ose kandidaten përfundimtare. Sipas alternativës së dytë, çdo njeri në regjistrin zgjedhor në zonën zgjedhore mund të votonte për një listë të shkurtër e cila nuk ishte e detyruar të plotësonte kërkesat gjinore. Reformat e mëvonshme kërkonin një balancë gjinore prej 50 për qind për individët që shqyrtoheshin në çdo fazë të procesit, pavarësisht nga qasja (alternativa) që përdorej në zonën zgjedhore.<sup>14</sup>

## Rruga përpara

Politika e ndryshuar e përzgjedhjes së kandidatëve, argumentojnë përkrahësit e saj, ka dhënë prova se jo vetëm është efektive në rritjen e numrit të grave që përfshihen në listën e shkurtër dhe përzgjidhen, por ka ndihmuar gjithashtu për të zgjeruar fuqinë tërheqëse të Partisë Konservatore. Sigurisht që ndryshimet në përzgjedhjen e kandidatëve patën një ndikim. Në zgjedhjet e vitit 2010, numri i grave deputete në grupin e Partisë Konservatore në parlament u rrit nga 17 në 49.

Megjithatë, ky numër përfaqëson vetëm 16% të të gjithë grupit konservator. “Gratë për fitore” e pranon nevojën “për të vazhduar rritjen e numrit të grave deputete konservatore duke u dhënë mbështetje, këshilla dhe trajnim grave që dëshirojnë të futen në parlament”.<sup>15</sup>

Kjo sfidë vlen gjithashtu edhe për postet në kabinetin qeveritar; nga 24 poste të kabinetit të qeverisë së vitit 2010, vetëm katër ishin gra. Gratë ende përballen me pengesa kur vjen fjala për marrjen e posteve udhëheqëse në parti. Në gjithë historinë e saj, Partia Konservatore ka pasur vetëm një grua udhëheqëse, dhe tendenca të ngjashme ka edhe në parti të tjera politike në MB.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet jo domosdoshmërisht reflektojnë mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Center for Women and Democracy (Qendra për gratë dhe demokraci). (2010). "Derisory' Increase in Number of Women MPs (Rritja 'qesharake' në numrin e grave deputete)(2010)." Gjetur në <http://www.cfwd.org.uk/news/28/61/Derisory-increase-in-number-of-women-MPs>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Norris, P., J. Lovenduski, and R. Campbell. (2004). Gender and Political Participation (Gjinia dhe pjesëmarrja politike). Komisioni zgjedhor, gjetur në <http://www.hks.harvard.edu/fs/pnorris/ Acrobat/Electoral%20Commission%20gender%20report.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> The Fawcett Society (Shoqëria Fawcett). (2010). "Fawcett BBC News 27 prill 2010." Gjetur në <http://www.youtube.com/watch?v=HcQaLX4jzGQ>, parë në janar 2012.

<sup>6</sup> The British Council (Këshilli Britanik). (2002). Women's Political Participation in the UK (Pjesëmarrja politike e grave në MB). Gjetur në <http://www.britishcouncil.org/china-society-publication-lawandgovernance-2002-en.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>7</sup> Inter-Parliamentary Union (Bashkimi Ndër-Parlamentar) (IPU). (2010). "United Kingdom (House of Commons): Elections in 2005." (Mbretëria e Bashkuar (Dhoma e Përfaqësuesve): Zgjedhjet 2005) Gjetur në [http://www.ipu.org/parline-e/reports/arc/2335\\_05.htm](http://www.ipu.org/parline-e/reports/arc/2335_05.htm), parë në janar 2012.

<sup>8</sup> Women2Win (Gratë për të fituar). (2011). "Our Organization." (Organizata jonë) gjetur në <http://www.women2win.com/text.aspx?id=5>, parë në janar 2012.

<sup>9</sup> Norris, Lovenduski, and Campbell, 2004.

<sup>10</sup> Cameron, D. (2005) "Cameron: Until we're represented by men and women in the country, we won't be half the party we could be." (Cameron: Deri kur të përfaqësohemi nga burrat dhe gratë në vend, ne nuk mund të jemi gjysma e partisë që mund të jemi) Conservatives (Konservatorët). Gjetur në [http://www.conservatives.com/News/Speeches/2005/12/Cameron\\_Until\\_were\\_represented\\_by\\_men\\_and\\_women\\_in\\_the\\_country\\_we\\_wont\\_be\\_half\\_the\\_party\\_we\\_could\\_be.aspx](http://www.conservatives.com/News/Speeches/2005/12/Cameron_Until_were_represented_by_men_and_women_in_the_country_we_wont_be_half_the_party_we_could_be.aspx), parë në janar 2012.

<sup>11</sup> Women2Win, 2011.

<sup>12</sup> Ashiagbor, S. (2008). Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspectives: Selecting Candidates for Legislative Office (Partitë politike dhe demokracia në perspektiva teorike dhe praktike: Përzgjedhja e kandidatëve për detyrë legislative). National Democratic Institute for International Affairs (Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet Ndërkombëtare). Gjetur në [http://www.accessdemocracy.org/files/2406\\_polpart\\_report\\_engpdf\\_100708.pdf](http://www.accessdemocracy.org/files/2406_polpart_report_engpdf_100708.pdf), parë në janar 2012.

<sup>13</sup> Women2Win, 2011.

<sup>14</sup> Ashiagbor, 2008.

<sup>15</sup> Women2Win, 2011.



## MEKSIKA: MBËSHTETJA E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE PËRMES KUOTAVE DHE FONDEVE SHTETËRORE PËR TRAJNIME<sup>1</sup>

### Pak informacion

Kongresi Meksikan është organ legjislativ me dy dhoma, që përbëhet nga Senati dhe nga Dhoma e Deputetëve. Që të dyja dhomat zgjidhen përmes një sistemi të përzier, që kombinon përfaqësimin proporcional dhe mandate nga zona me një deputet. Në Meksikë nuk mund të rizgjidhesh, gjë që e bën elektoratin të ketë besnikëri dhe lidhje më të forta me partinë se sa me kandidatët individualë, dhe kjo ushtron një trysni edhe më të madhe tek zyrtarët e zgjedhur për të zbatuar platformat e tyre brenda kohës së mandatit të tyre të vetëm.

Meksika ka një sistem shumë-partiak konkurrues me tri parti kryesore: Partia Revolucionare Institucionale (PRI), Partia e Revolucionit Demokratik (PRD), dhe Partia e Veprimt Kombëtar (PVN). Përveç këtyre, ka edhe një numër partish të tjera të vogla që konkurrojnë me njëra

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga PVN-ja për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve. Megjithatë nuk është e vetmja parti politike meksikane që punon për të zgjeruar bazën e elektoratit të saj duke tërhequr më shumë gra, ajo është një nga të paktat parti me tendenca të djathta që kanë miratuar kuota të brendshme partiake. Ky studim përqendrohet tek pjesëmarrja e grave në nivel federal.



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave

Financimi i kandidateve

Kuota të brendshme partiake

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: MEKSIKA

Emri i parlamentit	Kongresi i Bashkimit
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Senati dhe Dhoma e Deputetëve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Sistem i përzier proporcional-me një deputet Dhoma e Deputetëve
Zgjedhjet legjislative	Korrik 2009
Numri i grave të zgjedhura	141 nga 500 (28.2%)

tjetrën për të marrë pushtet në të gjitha nivelet të cilat, pavarësisht se kanë elementë të marrëdhëniesve padron-klient, vazhdojnë të mbajnë platformat e tyre që mbështeten tek ideologjia partiake. Krahasuar me disa nga fqinjët e tyre latino-amerikanë, Meksika në përgjithësi ka mbetur mbrapa për sa i përket pjesëmarrjes së grave në parlament. Megjithatë, partitë politike po marrin gjithnjë e më shumë masa për të promovuar fuqizimin politik të grave.

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Trysnia për ta rritur pjesëmarrjen e grave e ka origjinën tek vetë gratë në partitë e mëdha politike si edhe nga aktorë të shoqërisë civile dhe organizatat e grave që po vëzhgonin me kujdes sukseset e vendeve fqinje latino-amerikane në fushën e vendosjes së kuotave gjinore. Pas zgjedhjeve historike të vitit 2000 dhe transferimit të pushtetit nga presidenca e PRI-së, për herë të parë pas më shumë se shtatëdhjetë vjetësh, partitë politike nuk kishin më si ta shpërfillnin mjedisin gjithnjë e më konkurrues politik në Meksikë, Në rastin e PVN-së, udhëheqësit politikë të saj e kuptuan rëndësinë e grave votuese për konsolidimin e fitoreve të sapo-arritura të partisë.

Me mbështetjen e njëzëshme të një projekt propozimi për kuotat nga ana e grave të PVN-së dhe nga gratë e partive të tjera, u krijua masa e nevojshme kritike për t'i bindur udhëheqësit e PVN-së që ta mbështetnin këtë mocion. Gratë veprimtare nga fusha e politikës punuan së bashku me aktorë të shoqërisë civile që në ligjin zgjedhor të Meksikës “Kodi Federal për Institucionet dhe Procedurat Zgjedhore” (i njohur edhe me akronimin COFIPE), të përfshihej **një kuotë gjinore e detyruar me ligj**. Kuota u përfshi në Nenin 219 të COFIPE-s, dhe parashikon se partive politike u kërkohet të garantojnë që gratë të përbëjnë të paktën 40 për qind të kandidatëve, që duhet të zbatohet si për listat e kandidatëve për zgjedhjet në parti, ashtu edhe për kandidatët në zonat zgjedhore.<sup>2</sup> Neni 220 i COFIPE-s gjithashtu kërkon që të paktën dy nga 5 kandidatë të listave të partisë të jenë gra, me renditje burrë-grua-burrë.

Ndonëse vendosja e kuotave ishte një hap pozitiv dhe

u shoqërua me mekanizma më të forta detyruese se sa politikat partiake dhe ligjore, në sistemin zgjedhor të përzier të Meksikës ato ishin të pamjaftueshme si zgjidhje e vetme për sfidat e shumëfishta me të cilat përballen gratë kur kërkojnë barazi në politikë. PVN-ja, që është një nga partitë me orientim qendror të djathtë, që bëri mjaft avokaci për kuota në rang kombëtar dhe u përpoq të zbatonte nisma partiake shtesë për të zgjidhur problemin e pengesave që ekzistojnë për pjesëmarrjen e grave në politikë.

### Strategjitë e përdorura

#### A. KRIJIMI I ALEANCAVE STRATEGJIKE PËR TË BËRË REFORMË

Duke ndërtuar mbi një themel të fortë të veprimtarive aktiviste të grave në parti, gratë e PVN-së krijuan **aleanca strategjike** me aktorë të tjerë partiakë dhe të shoqërisë civile për të marrë mbështetjen e PVN-së për kuotat gjinore dhe për ligjin për financimin publik të partive, që do të bënte të mundur trajnimin e grave kandidatë si dhe për të vendosur kuotat e brendshme partiake, me qëllim që gratë anëtare të ishin në një pozitë më të mirë për të shfrytëzuar mundësitë që do të krijonin këto reforma kombëtare.

Ligji për kuotat kombëtare në Meksikë ishte rezultat i **një fushate shumë-partiake** nga OSHC-të meksikane si dhe nga gra aktiviste dhe deputete nga partitë kryesore, që u zhvillua në periudhën nga viti 1991 deri në 2008. Kjo aleancë ishte e bashkuar rreth synimit parësor për të zgjedhur më shumë gra në Kongres. Përpjekjet e avokacisë të bëra nga këto gra arritën pika kulmore në vitet 1992, 1996, dhe 1998, dhe çuan në rezultate fillestare të moderuara, me një varg reformash të dobëta në vitet 1993 dhe 1996. Kuota gjinore prej 30 për qind më në fund “fitoi kthetra” me anë të Nenit 175 të COFIPE-s të vitit 002, dhe u forcua edhe më tej në vitin 2007, në formën e tanishme prej 45 për qind.

Gratë deputete anëtare të Komisionit Parlamentar për Barazinë dhe Çështjet Gjinore, përfaqësuese të të gjitha partive, u përfshinë në reformat zgjedhore të vitit 2007 dhe luajtën një rol kyç në shtrimin e kësaj çështjeje për zgjidhje. Shumë nga të njëjtat gra aktiviste të partive që ndihmuan

në gjenerimin e kuotave të COFIPE-s të vitit 2007, u përfshinë edhe në kërkimin e kuotave të brendshme në partitë e tyre përkatëse, dhe ishin të vetëdijshme për nevojën e **krijimit të mekanizmave të zbatimit** që të mos lejonin që gratë të fshiheshin në fund të listave partiake, siç kishte ndodhur me ligjet e viteve 1996 dhe 2002. Si rezultat, ligji i vitit 2007 parashikon se partitë që nuk kanë plotësuar kuotën e tyre të grave kandidatë kanë 48 orë për t'i korrigjuar listat përpara se të qortohen publikisht; 24 orë pas qortimit, Këshilli i Përgjithshëm i Institutit Zgjedhor Federal (IFE) nuk do të pranonte ta regjistronte atë listë (COFIPE, Neni 221), nëse nuk i ishin bërë ndryshime.

Gratë drejtuese të partive punuan jashtëzakonisht shumë për të edukuar dhe për të fituar përkrahjen e kolegëve të tyre meshkuj që t'i mbështesnin reformat e vitit 2007, duke fituar përkrahjen e German Martinez Cazares, i cili në atë kohë ishte kryetari i PVN-së, i cili luajti një rol shumë të rëndësishëm në bashkimin e radhëve të partisë. Pasi kishin arritur tashmë të vendoseshin në poste të larta në Kongres dhe në udhëheqjen e partisë, gratë drejtuese të PVN-së kishin më tepër mundësi ta bënin zërin e tyre të dëgjohej nga Cazares-i dhe ishin mjaft të besueshme në lobingun që bëjnë për të fituar përkrahjen e partisë.

Në rrugën e tyre drejt **fitimit të mbështetjes së brendshme të partisë** për kuotat, gratë aktiviste të PVN-së shfrytëzuan historinë e gjatë të frymës aktiviste të grave në PVN. Roli i grave në parti ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e viteve. Gjatë viteve të para të partisë, Komisioni për Promovimin e Grave në PVN kishte përgjegjësi si organizimi i ushqimit dhe akomodimit në aktivitetet partiake dhe puna vullnetare në fushata të ndryshme politike. Kohët e fundit, gratë e reja në parti janë pjesë e “një brezi anëtarësh të rinj të PVN-së që janë agresivë, të freskët, dhe pa asnjë mëdyshje për marrjen e role me pushtet.”<sup>3</sup>

## B. KUOTA E BRENDSHME NË PARTI

PVN-ja ka miratuar gjithashtu një sërë politikash për të siguruar që gratë të jenë të përfaqësuara në të gjitha strukturat e partisë. Dy organet më të fuqishme vendimmarrëse të partisë janë Këshilli Kombëtar dhe

Komiteti Ekzekutiv Kombëtar, dhe që të dy këto organe kanë 30 për qind ose më shumë gra anëtare në to. PVN-ja ka zbatuar një **kuotë të brendshme prej 40 për qind** për CEN, si dhe për komitetet në rang shteti dhe rrethi, por është përballur me vështirësi në zbatimin e plotë të këtij standardi. Edhe parti të tjera në Meksikë kanë zbatuar kuotat e tyre të brendshme, si për shembull PRI-ja dhe PRD-ja. Në vitin 2001, PRI-ja reformoi Nenin 38 të nën-ligjeve të brendshme të partisë për të përfshirë aty barazinë gjinore në emërimin e kandidatëve, dhe në vitin 1993 PRD-ja miratoi një kuotë të brendshme vullnetare të partisë.

Zgjedhja e komiteve të PVN-së në rrethe me votim të drejtpërdrejtë nga anëtarët e partisë, po kështu ka ndihmuar në përfshirjen e më shumë grave në strukturat partiake në nivel vendor. Gratë që njiheshin për rolin e tyre drejtues nëpër komunitetet e tyre, kanë pasur më shumë sukses në tërheqjen e vëmendjes së anëtarëve të tjerë të partisë në nivel vendor, se sa në nivelin e Komitetit Ekzekutiv Kombëtar apo të komiteve të shteteve, anëtarët e të cilëve emërohen nga këshillat shtetërore dhe kombëtare të PVN-së.

Megjithëse kuotat dhe praktika e zgjedhjes së drejtpërdrejtë nuk garantojnë përfaqësim të barabartë të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, ka gra që janë të pranishme në organet vendimmarrëse të PVN-së të cilat ushtrojnë ndikimin e tyre në politikat, platformat, dhe vendimet partiake. Për më tepër, projekti i platformës së partisë i jepet edhe sekretares së forumit të grave të partisë, në mënyrë që ajo ta shohë atë me thjerrëzën gjinore përpara se të marrë formë përfundimtare, duke siguruar kështu që aty të reflektohen çështjet që janë shqetësim ose që kanë rëndësi për gratë e PVN-së. Sipas një zyrtareje, “Gratë janë të rëndësishme për platformën, për projektet, politikat, mendimet, dhe në konsultimet publike... (ndaj edhe) merret mendimi i tyre për mënyrën se si bëhen gjërat.”<sup>4</sup>

## C. FINANCIMI PUBLIK I PARTIVE POLITIKE

PVN-ja dhe parti të tjera luajtën rol në miratimin dhe janë përpjekur të përdorin në favor të tyre të ashtuquajturin “Ligj i Dy Përqindëshit”, që parashikohet në Nenin 78 të COFIPE-s. Ky nen shpreh detyrimin se **të paktën**

**dy për qind të financimeve publike të partive politike** duhet të përdoret posaçërisht për programe që synojnë trajnimin, promovimin, dhe zhvillimin e rolit udhëheqës të grave në politikë. Ndonëse shumica e parave nuk është e mjaftueshme për të plotësuar të gjitha nevojat politike të grave, ky ligj i detyron partitë që të caktojnë një pjesë të caktuar të burimeve të tyre financiare për trajnimin e grave në parti dhe për t'i ndihmuar ato të forcojnë pozitën e tyre brenda partisë. Fondet shtetërore mund të përdoren për një sërë nevojash të grave, si për shembull për zhvillimin e seminareve trajnuese, apo blerjen e pajisjeve për degët e forumit të grave të partisë. Vendimi se si do të përdoren këto fonde shtetërore në fillim merret nga zyra qendrore e partisë, dhe pastaj nga degët e forumit të grave në degët shtetërore të partisë. Megjithatë, zyra qendrore e partisë mund të marrë masa të tjera për të siguruar që paratë të caktohen dhe të përdoren në mënyra të përshtatshme si për shembull duke i kërkuar komiteteteve shtetërore të PVN-së që të dorëzojnë plane pune të trajnimeve. Disa nga sekretarët e thesarit të degëve shtetërore të partisë që nuk i kishin përdorur këto para në mënyrën e duhur, u hoqën nga posti.

## Rezultatet

Dispozitat për kuotat të parashikuara nga COFIPE kanë luajtur rol të rëndësishëm për t'i sjellë gratë meksikane në politikë. Në vitin 2000, përpara se të miratoheshin kuotat, gratë kishin 18 për qind të vendeve në të dyja dhomat e Kongresit Meksikan; në zgjedhjet e vitit 2009, 28 për qind e deputetëve të zgjedhur ishin gra.<sup>5</sup>

Brenda PVN-së, pjesëmarrja e grave në zyrat vendore të partisë ka ndihmuar që gratë anëtare të partisë të fitojnë më shumë besim në vetvete dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre politike, që ka pasur një ndikim gradual në pjesëmarrjen e grave në nivel shtetëror dhe kombëtar. Gratë aktualisht përbëjnë 24,3 për qind të deputeteve të PVN-së, një shifër që është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 21,4 për qind.<sup>6</sup> Përveç kësaj, një aktiviste e partisë shprehet se tani ka më shumë gra aktiviste vullnetare në nivel vendor që po futen në garë për t'u zgjedhur në poste në nivel vendor, duke ndihmuar kështu që gratë të shndërrohen nga "thjesht

vullnetare në persona që mësojnë të marrin vendime". Ligji i Dy Përqindëshit gjithashtu mendohet se do të nxisë furnizimin me një numër të madh grash të trajnuara nga nën-nivelet e ndryshme të qeverisë në skenën politike kombëtare; megjithatë, duke qenë se ky është një ligj ende i ri, efektiviteti i tij ende nuk është përcaktuar me saktësi.

## Sfidat dhe rruga përpara

Ligji për kuotat i COFIPE-s zbatohet vetëm për pjesën e listave zgjedhore të partive dhe jo për emërimin e kandidatëve në nivelet vendore. Në Kongresin Meksikan ka pasur edhe një tendencë tjetër, që gratë ua kanë lënë vendet e tyre në kongres meshkujve që i kanë zëvendësuar pas fitimit të vendit në parlament. Në javët që vijuan pas zgjedhjeve të korrikut 2009 dhe përpara se të bëhej betimi i deputetëve, 11 gra dhanë dorëheqjen nga Kongresi dhe në vend të tyre u vunë burra. Kjo praktikë e zëvendësimit të grave të zgjedhura u dokumentua dhe denoncua nga gratë aktiviste, akademike, dhe zyrtare publike jo-partiake anembanë Meksikës. Këto aktore nga sfera jashtë politikës kanë kërkuar që të vendosen rregulla më të forta dhe të bëhet një mbikëqyrje më rigoroze, si në lidhje me zbatimin e kuotave, ashtu edhe për sa i përket Ligjit të Dy Përqindëshit.

Që nga viti 2009, 18 nga 32 shtetet meksikane kanë miratuar ligje për kuotat në organet legjislative shtetërore; shtetet e para që e përqafulan këtë nismë ishin Chihuahua, Oaxaka, Sonora dhe Sinaloa, në vitin 2000. Megjithatë, u identifikuan një sërë të metash me kuotat në nivelin nën-kombëtar dhe në vitin 2006, shteti i Sonoras shkoi deri aty sa t'i braktiste kuotat që kishte caktuar, duke pranuar se mënyra se si ishte formuluar ligji po e pengonte pjesëmarrjen e grave.<sup>7</sup> Po kështu, gratë që kishin arritur të caktoheshin në funksione të ndryshme në zyrat e degëve bashkiake të partisë, nuk kanë pasur ndonjë sukses të krahueshëm në fitimin e funksioneve publike vendore, dhe gratë vazhdojnë të përfaqësojnë më pak se pesë për qind të kryetarëve të bashkive në Meksikë.

Kuotat e brendshme partiake në Meksikë kanë sjellë rezultate shumë të paqëndrueshme për gratë. Megjithëse

PRD-ja ishte partia e parë në Meksikë që i miratoi kuotat, ajo vetëm një herë ka mundur të arrijë përqindjen e caktuar të kuotave, në vitin 1997. Komiteti Shtetëror i PVN-së për Shtetin e Meksikës ka vetëm shtatë gra në përbërjen e tij, nga 107 anëtarë që ka gjithsej.<sup>8</sup> Mungesa e grave në këtë nivel sjell nga ana e saj një kufizim të mundësive të grave për t'u përfaqësuar në nivelet më të larta të partisë. Një e intervistuar përmendi edhe një tendencë tjetër, atë që gratë që janë shumë aktive në PVN, janë "ose beqare, ose të veja, ose të divorcuara."<sup>9</sup> Kjo sugjeron se PVN-ja nuk i ka zbatuar sa duhet praktikatat e ndjeshme gjinore për të lejuar gratë që kanë përgjegjësinë kryesore të përkujdesit për të tjerët në familje, që të balancojnë siç duhet jetën familjare me atë politike, dhe në këtë mënyrë i kanë penguar ato të ndjekin karrierën politike.

Ligjet e ndryshme për kuotat, po kështu, nuk kanë garantuar diversifikimin e kontingjentit të grave që tërhiqen për të plotësuar këto kuota. Në Meksikë, shumica e grave politike zakonisht janë nga qytetet dhe janë të mirë-arsimuara, ndërsa gratë nga zonat rurale, që janë më pak të arsimuara dhe kanë më pak mjete dhe burime në dispozicion, ende përballen me pengesa të mëdha për të hyrë në mjedisin politik zyrtar, dhe si rezultat, aftësitë dhe talentet e tyre në përgjithësi nuk janë të pranishme kur merren vendime apo kërkohen zgjidhje për probleme vendore apo kombëtare.

Përveç kësaj, ligjet dhe politikatat e tanishme për kuotat gjinore duhet të harmonizohen me nevojat e 12 milion banorëve indigjenë të Meksikës. Ligjet e "Dokeve dhe Zakoneve" që janë në fuqi në shtetet përbërëse të Meksikës që kanë përqindje të larta popullatash indigjene, të cilat mbrojnë strukturat dhe praktikatat indigjene të qeverisjes

dhe paraqesin një sfidë tjetër për gratë, sepse roli i tyre në shoqëritë indigjene përkufizohet jashtë strukturave vendimmarrëse.

Në përgjithësi, rasti i Meksikës tregon se kuotat janë vetëm një pikënisje për trajtimin e çështjeve të përfaqësimit të grave. Ato kërkojnë si mekanizma zbatimi reale, ashtu edhe masa shtesë nga ana e partisë që të zgjidhin problemet e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme që gratë të zgjidhen de të qeverisin në mënyrë efektive, qoftë individualisht apo në mënyrë kolektive, sidomos duke pasur parasysh sistemin zgjedhor meksikan që lejon të zgjidhesh vetëm një herë.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> IDEA, Universiteti i Stokholmit dhe IPU. (2010). "Mexico." Global Database of Electoral Quotas for Women (Baza Globale e të Dhënave për Kuotat Zgjedhore të Grave). Gjendet në <http://www.quotaproject.org/uid/countryview.cfm?country=157>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Intervistë me një aktiviste të partisë PVN, gusht 2009.

<sup>4</sup> Intervistë me një zyrtare të partisë PVN, gusht 2009.

<sup>5</sup> Globalis. "Mexico: Seats in Parliament Held by Women." (Meksika: Vendet e zëna nga gratë në parlament) Gjendet në [http://globalis.gvu.unu.edu/indicator\\_detail.cfm?IndicatorID=63&Country=MX](http://globalis.gvu.unu.edu/indicator_detail.cfm?IndicatorID=63&Country=MX), parë në janar 2012.

<sup>6</sup> Statistika të dhëna nga një aktiviste e partisë PVN.

<sup>7</sup> IDEA, Universiteti i Stokholmit dhe IPU, 2010.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Intervistë me një aktiviste të partisë PVN, gusht 2009.

## KUTI

## PERUJA: VEPRIMTARI AVOKACIE PËR KUOTAT NGA FORUMI I GRAVE

“  
FORUMI I GRAVE ARRITI TË SHFRYTËZONTE KUOTAT E REJA QË PO PËRDORESHIN NË RAJON SI MBËSHTETJE NË KËRKIMIN E NJË KUOTE KOMBËTARE.”

Siç u tregua edhe në rastin e Meksikës, në vitet 1990 pati një rritje të ndërgjegjësimit në Amerikën Latine për nevojën e krijimit të mundësive më të mëdha politike për gratë dhe, që solli si rezultat miratimin e një vargu ligjesh për kuotat, si dhe të vetë kuotave. Në vitin 1994, një koalicion organizatash të grave në Peru, i quajtur Forumi i Grave, arriti t'i shfrytëzonte këto kuota të reja të miratuara në rajon si mbështetje për të kërkuar një kuotë kombëtare dhe, me mbështetjen

e disa grave aktiviste të njohura në parti, mundën t'ia mbushin mendjen ish-presidentit Fujimori që të jepte mbështetjen e partisë së tij për diskutimin e një ligji për kuotat në parlament.

Në vitin 1997, përpjekjet e bashkërenduara të grave drejtuese në shoqërinë civile dhe në partitë politike sollën miratimin me sukses të ligjit të kuotës prej 25 për qind për listat e partive, që u ndoq nga një kuotë ligjore e zgjeruar prej 30 për qind për zgjedhjet kombëtare, bashkiake dhe vendore. Nëse nuk e zbatojnë kuotën, partitë përballen me mospranimin e listës së tyre. Megjithëse mekanizmi zbatues i kuotës ende nuk është përdorur, miratimi i kuotave hapi rrugën për një rritje të konsiderueshme të numrit të grave në parlament, nga 11 në 29 për qind në zgjedhjet e vitit 2006.

## RUANDA: PËRDORIMI I KUSHTETUTËS PËR TË INSTITUCIONALIZUAR ARRITJET E GRAVE NË PERIU DHËN PAS KONFLIKTIT<sup>1</sup>

### Pak informacion

Ruanda përjetoi një luftë civile në fillimet e viteve 1990 dhe gjenocid në vitin 1994. Fronti Patriotik i Ruandës (FPR), që tani është kthyer në një parti politike, ka sjellë stabilitet në Ruandë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në detyrën e vështirë dhe të vazhdueshme të rindërtimit të vendit. Në vitin 2003, u zgjodh Presidenti Kagame nga zgjedhjet e para presidenciale që nga koha e gjenocidit, dhe ai ka vazhduar ta mbajë këtë post si Kryetar Shteti.

Në vitin 2008, Ruanda u bë i pari vend në botë që zgjodhi më shumë gra se sa burra si përfaqësuese në dhomën e ulët të parlamentit, ku gratë morën 56 për qind të vendeve.<sup>2</sup> Kjo arritje ishte rezultati i përpjekjeve të qëllimshme pas gjenocidit për të nxitur pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe për të zbatuar kuotat e garantuara në

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Fronti Patriotik i Ruandës për promovimin e fuqizimit politik të grave. Ai tregon se si përpjekjet e përbashkëta dhe të harmonizuara të grave aktiviste dhe mbështetja e udhëheqësve meshkuj çoi në miratimin e vendeve të rezervuara për gratë dhe në zbatimin e kuotave të brendshme të partive. Si rezultat, Ruanda ka përqindjen më të lartë të grave në dhomën e ulët të parlamentit në rang botëror.



### FJALË KYÇE

Kuotat vullnetare dhe të përcaktuara me ligj  
Mobilizimi i grave

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: RUANDA

Emri i parlamentit	Parlamenti i Ruandës
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Senati dhe Dhoma e Deputetëve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional dhe vende të rezervuara (Dhoma e ulët)
Zgjedhjet legjislative	Shtator 2008
Numri i grave të zgjedhura	45 nga 80 (56%)

kushtetutë. Megjithatë, roli pararojë i Ruandës në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë duhet kuptuar në kontekstin e sfidave të mëdha të vendit për konsolidimin e demokracisë.

### Baza arsyetuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave

Mbështetja për pjesëmarrjen e grave në politikë i ka fillimet e saj në periudhën e çlirimit, 1993-2204. Gjatë tranzicionit, deputetët në parlament caktoheshin nga partitë politike dhe nuk zgjidheshin me votim të drejtpërdrejtë. FPR rregullisht emëronte gra në rreth 50 për qind të vendeve të caktuara për të në parlament.<sup>3</sup> Këto aktiviste partiake u mënjanuan nga politika pas ardhjes në fuqi të lëvizjes rebelë.<sup>4</sup> Në këto kushte, në vitin 2003 gratë u organizuan për të mos e lënë Ruandën të vazhdonte në atë rrugë dhe arritën të bënin avokaci të suksesshme për një kuotë 30 për qind, e cila do të sanksionohej edhe në Kushtetutën e Ruandës.<sup>5</sup>

Gjenocidi dhe pasojat e rënda që la ai, patën ndikim edhe tek promovimi që i bëri qeveria e Ruandës rolit drejtues të grave. Në periudhën menjëherë pas gjenocidit pati lëvizje të fuqishme shoqërore dhe gratë përbënin pjesën më të madhe të të mbijetuarve. Gratë ndërmorën role të reja ekonomike dhe shoqërore, dhe punuan për rindërtimin e familjeve dhe të kombit të tyre, me plot kuptimin e fjalës. Ishte e pashmangshme që gratë të merrnin edhe role publike dhe ta thoshin fjalën e tyre në përcaktimin e përparësive politike. Pjesëmarrja e grave në qeverisje ishte një rrjedhojë e këtyre roleve të reja që po përmbushnin gratë në Ruandën e pas-gjenocidit.

Të vejat e gjenocidit, që punuan së bashku me gratë e autorëve të krimeve për të rindërtuar komunitetet pas dhunës, u përshëndetën dhe respektuan si shembuj model për kombin. institucione kyçe që ishin krijuar për të trajtuar problemin e gjenocidit, p.sh., Komisioni i Bashkimit dhe Pajtitimit, dhe Gjykatat e Gakakas, drejtoheshin nga gratë. Lufta, dhuna dhe zhvendosjet e banorëve, që mund të shkatërrojnë përbërjen sociale të një vendi, mund të ofrojnë gjithashtu edhe dritare mundësie për ndryshime shoqërore. Kjo ishte edhe çka ndodhi me gratë në Ruanda.

## Strategjitë e përdorura

### A. MOBILIZIMI I GRAVE

Gjatë tranzicionit të vendit drejt paqes, gratë aktiviste të Ruandës punuan **për të institucionalizuar përkushtimin e shprehur të drejtuesve politikë** dhe për të siguruar që gratë të vazhdonin të kishin mundësi të barabarta përfaqësimi në institucionet politike në të gjitha nivelet. FPR i mbështeti kuotat dhe iu përkushtua ndërtimit të përvojave të grave në për të qenë udhëheqëse politike dhe për ta mësuar elektoratin që të votojë për gratë kandidatë.

Përkushtimi i drejtuesve politikë të Ruandës për barazi politike për gratë e bri të mundur që kuotat të përfshiheshin në kushtetutë dhe që gratë të viheshin në poste me pushtet politik. Qëndrimi pro-grave i FPR-së bëri që edhe partitë e tjera ta ndienin se duhet të bënin të njëjtën gjë, sidomos duke pasur parasysh numrin më të madh të elektoratit femëror në vend. Nëse partitë e tjera do t'i kishin kundërshtuar këto reforma ose nuk do të kishin pranuar të vinin gra në pozicione kyçe, ato do të kishin rrezikuar një mënjanim edhe më të madh politik.

Roli udhëheqës politik i Kagames dhe i FPR-së për këtë çështje u shoqërua me një **fushatë advokacie**, nga organizatat e grave të nivelit të bazës dhe gratë brenda partive politike. Lëvizja e grave donte të siguronte që gratë që kishin luajtur role kaq të rëndësishme në rindërtimin e vendit pas gjenocidit, do të ishin pjesë e sistemit të ri politik. Organizatat e grave e kuptuan se, megjithëse mbështetja e Kagames ishte e vlefshme, nuk mund të merrej si e qenësishme se udhëheqja e vendit do t'i mbështeste gjithmonë politikat e barazisë gjinore, ndaj edhe ato bënë trysni që të drejtat e grave të parashikoheshin me ligj. Organizatat e grave në Ruanda përfaqësohen më së miri nga një organizatë gjithëpërfshirëse që quhet *Pro Femmes/Twese Hamwe* e cila ka lidhje të ngushta pune me qeverinë dhe me gratë në poste drejtuese. Drejtueset gra të organizatave të shoqërisë civile kanë punuar për shumë nga ndryshimet që janë arritur kohët e fundit dhe kanë përmirësuar pozitat ligjore të grave në Ruandë, si për shembull përmes ligjit për trashëgiminë, kriminalizimin e përdhunimit dhe të dhunës



me bazë gjinore, si dhe kuotat kushtetuese të vitit 2003.

## B. KRIJIMI I MEKANIZMAVE SHTETËRORE PËR PJESË-MARRJEN E GRAVE

Qeveria e parë që erdhi në fuqi pas gjenocidit krijoi mekanizma që hodhën themelet për pjesëmarrjen e grave në qeveri në të gjitha nivelet. **U krijua një sistem i këshillave të grave** në secilin prej niveleve të shumta të qeverisjes, që nga lagjet e deri në nivelet më të larta kombëtare. Në fillim, një përfaqësuese nga këshillat e grave të çdo niveli kishte një vend të rezervuar në këshillin zyrtar të atij niveli, duke krijuar kështu një lidhje ndërmjet këshillave të grave dhe organeve të qeverisjes. Këshillat e grave u ofronin grave mundësi që të zhvillonin aftësitë e tyre drejtuese dhe të krijonin mbështetje në komunitete të ndryshme. Në vitin 2003 kur u miratuan kuotat kushtetuese dhe 30 për qind të vendeve në parlament u rezervuan për gratë, këto vende u plotësuan me gra që ishin anëtare të sistemit ekzistues të këshillave të grave.

Përveç këshillave të grave, Ruanda përdori edhe **mekanizma të tjerë zgjedhorë novatorë** që kishin për qëllim të sillnin gratë në poste politike. Gjatë zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor në vitet 2001 dhe 2006, për shembull, çdo votues mori tri fletë votimi: një fletë votimi të përgjithshme, një fletë votimi për rininë dhe një fletë votimi për gratë. Ky sistem garantoi që disa gra të zgjidheshin në këshillat bashkiakë, si dhe u krijoi votuesve përvojën e të votuarit për candidate gra, duke e bërë këtë një pjesë të pranueshme të procesit politik në një vend që historikisht nuk i kishte nxitur gratë të konkurronin për role udhëheqëse në politikë.

## C. KUOTAT KUSHTETUESE

Kushtetuta e Ruandës është e mirënjohur për faktin se ajo citon CEDAW dhe përcakton kuota për përfaqësimin e grave. **Kushtetuta e bën të detyruar pjesëmarrjen e grave** në nivelin 30 për qind në të gjitha organet vendimmarrëse. Kuotat zbatohen jo vetëm për parlamentin, por edhe për kabinetin presidencial, gjyqësorin dhe qeverisjen vendore.

Kjo dispozitë kushtetuese çoi në rezervimin e 24 vendeve, nga 80 gjithsej në dhomën e ulët të parlamentit, për gratë.

Këto vende u plotësuan përmes një liste zgjedhore të veçantë vetëm për gra. Përveç vendeve të rezervuara, **partitë politike miratuan edhe kuotat e tyre vullnetare**, për të siguruar që 30 për qind e candidateve në listën e partisë së tyre të ishin gra. Kombinimi i vendeve të rezervuara me kuotat vullnetare të partive solli rezultate dramatike, duke bërë që gratë të merrnin 48.8 për qind të vendeve në parlament në vitin 2003 dhe 56 për qind në zgjedhjet e vitit 2008.

## Rezultatet

Ndikimi i grave të Ruandës nuk kufizohet vetëm në rolin e tyre në parlament, por shtrihet edhe në organet vendimmarrëse. Më se 30 për qind e anëtarëve të këshillave bashkiake, kryetarëve dhe zëvendës kryetarëve të bashkive janë gra. Ministrat e Tregtisë, arsimit, të Komunitetit afrikano-lindor, e të tjera, janë përfshirë edhe kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Kryetaren e Gjykatës së Lartë, dhe Kryetaren e Gjykatave Gakaka, si dhe Shefa e Policisë në detyrë, kanë qenë gra. Një nga të intervistuarat komentoi se “Ruanda ka mësuar të respektojë autoritetin e grave... në të gjitha institucionet që janë vërtet zemra e këtij vendi, do të gjesh gra.”<sup>6</sup>

Ndonëse ishte FPR ajo që ka luajtur një rol vendimtar në krijimin e kuotave, edhe partitë e tjera i janë pëmbajtur kërkesave ligjore dhe kanë emëruar dhe zgjedhur gra në parlament. Gratë nga partitë e pakicës kanë shërbyer në poste të larta qeveritare si pjesë e koalicionëve me FPR-në.

Numri i madh i grave në parlament ka bërë që të krijohet një grup parlamentar aktiv të grave, i cili, kur u krijua në vitin 1996, ishte i vetmi grup ndër-partiak në parlamentin e Ruandës. Sipas një prej themeluesve të saj, Forumi i Grave Parlamentare kishte për synim të “mbronte interesat e grave pa marrë parasysh se nga vinin ato, pa ndarje, pa diskriminim me bazë racore apo përkatësie politike.”<sup>7</sup> Sidomos gjatë periudhës së tranzicionit, gratë parlamentare shpesh i kapërcenin vijat e ndarjeve partiake nëse ndienin që kërcënoheshin interesat e grave në Ruanda. Duke pasur shumicën në parlament, gratë deputete ishin garanci që interesat e grave të merreshin seriozisht në legjislaturë.

Disa ligje kyçe të miratuara në Ruandë mund t'i atribuohen niveleve të larta të përfaqësimit të grave dhe fuqisë e autoritetit të Forumit të Grave Parlamentare.<sup>8</sup> Ndër to përfshihen ligji për trashëgiminë pasurore (1999), ligji për mbrojtjen e fëmijëve (2001), dhe ligji për dhunën me bazë gjinore (2008). Gratë gjithashtu kanë ushtruar ndikimin e tyre për të siguruar që edhe ligjet e tjera të jenë të ndjeshme nga pikëpamja gjinore dhe të marrin parasysh të drejtat e fëmijëve, si ligji për shtetësinë, klasifikimi i krimeve të gjenocidit, dhe mbrojtja e dëshmitarëve.

### Sfidat dhe rruga përpara

Përvoja e Ruandës tregon se përparimi i grave në politikë përmes kuotave apo mjeteve të tjera mund të jetë veçanërisht i suksesshëm nëse kodifikohet gjatë hartimit të kushtetutës. Përfshirja e kuotave në kushtetutë ishte një qasje e parapëlqyer, në krahasim me alternativën tjetër që çështja t'i lihej në duar partive politike, sepse në këtë mënyrë detyroheshin të gjitha partitë që t'i zbatonin ato.

Gratë në poste drejtuese janë përballur me disa vështirësi e sfida, sidomos për sa i përket balancimit të roleve të tyre publike dhe private. Ndonëse nga gratë pritet që të marrin pjesë në jetën publike, nuk ka pasur ndonjë lëvizje paralele për të pakësuar numrin e përgjegjësive të tyre në jetën familjare dhe shtëpiake. Pranimi publik i rolit udhëheqës të tyre ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore, por pritshmëritë tradicionale për rolet e tyre në familje dhe shoqëri nuk kanë ndryshuar, dhe gratë shpesh janë dyfish të ngarkuara me punë.

Në të njëjtën kohë, gratë parlamentare kanë qenë objekt i kritikave publike, në një shkallë më të madhe se burrat. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2008, për shembull, një kryeartikull në gazetën më kryesore të vendit në gjuhën angleze, bënte pyetjen se çfarë kishin bërë gratë për vendin që nga viti 2003.

Ky kryeartikull nuk ngrinte pyetjen se çfarë kishin bërë burrat parlamentarë për vendin gjatë së njëjtës periudhë. Gratë janë veçanërisht të dukshme në rolet e tyre të reja dhe ndonjëherë prej tyre kërkohen standarde më të larta se sa për kolegët e tyre meshkuj. Si anëtare të një brezi pionier, gabimet dhe të metat e grave në poste publike në Ruandë shihen me një thjerrëzë shumë të imët. Konsolidimi i demokracisë dhe vazhdimi i arritjeve pas suksesit historik si vendi i parë në botë me shumicë grash në legjislaturën kombëtare, janë pengesat kyçe politike me të cilat përballen gratë në Ruanda.

### Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). (2008). "IPU Applauds Rwanda as First Parliament to Elect a Majority of Women Members (2008)." (IPU përgëzon Ruandën si parlamenti i parë që zgjodhi një shumicë grash deputete). Gjetet në <http://www.ipu.org/press-e/gen311.htm>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Powley, E. (2003). "Strengthening Governance: The Role of Women in Rwanda's Transition." (Forcimi i qeverisjes: Roli i grave në tranzicionin e Ruandës). Hunt Alternatives. Gjetet në [http://www.huntalternatives.org/download/10\\_strengthening\\_governance\\_the\\_role\\_of\\_women\\_in\\_rwanda\\_s\\_transition.pdf](http://www.huntalternatives.org/download/10_strengthening_governance_the_role_of_women_in_rwanda_s_transition.pdf), parë në janar 2012.

<sup>4</sup> Intervistë me një eksperte të shoqërisë civile, nëntor 2009.

<sup>5</sup> Ministria e Mbrojtjes e Ruandës. "Constitution of the Republic of Rwanda (2003)." (Kushtetuta e Republikës së Ruandës) Gjetet në [http://www.cjcr.gov.rw/eng/constitution\\_eng.doc](http://www.cjcr.gov.rw/eng/constitution_eng.doc), parë në janar 2012.

<sup>6</sup> Intervistë me një grua aktiviste, 2009.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Powley, E. (2008) "Defending Children's Rights: The Policy Priorities of Rwandan Women Legislators." (Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve: Përparësitë politike të grave deputete të Ruandës. Gjetet në [http://www.huntalternatives.org/pages/7859\\_defending\\_children\\_s\\_rights\\_the\\_legislative\\_priorities\\_of\\_rwandan\\_women\\_parliamentarians.cfm](http://www.huntalternatives.org/pages/7859_defending_children_s_rights_the_legislative_priorities_of_rwandan_women_parliamentarians.cfm), parë në janar 2012.

## SALVADORI: STRATEGJI PËR PROMOVIMIN E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË PAS ÇLIRIMIT TË VENDIT<sup>1</sup>

### Pak informacion

Që nga përfundimi i luftës civile që zgjati nga viti 1979 deri në vitin 1992, Salvadori ka bërë hapa të mëdhenj përpara drejt konsolidimit të demokracisë në vend, megjithëse zgjedhjet e kohëve të fundit u zhvilluan nën hijen kërcënuese të një dhune të mundshme. Në zgjedhjet legislative të vitit 2009 Fronti Farabundo Marti për Çlirim Kombëtar (FMÇK) fitoi një shumicë votash prej 43 për qind, ndërsa Aleanca Nacionaliste Republikane doli e dyta në garë, me një diferencë shumë të vogël. Tri parti të vogla, Partia Kristiandemokrate, Partia e Pajtimin Kombëtare dhe Ndryshimi Demokratik, gjithashtu fituan vende në Asamblenë Legjislative Kombëtare. Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2009, FMÇK-ja fitoi për herë të parë që nga koha e krijimit të tij si parti, pas njëzet vjetësh të një qeverisjeje nga shumica ARENA.

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga FMÇK për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda strukturave të partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve. Ai paraqet gjithashtu një pjesë të punës së bërë nga Shoqata e Grave Parlamentare dhe Ish-Parlamentare Salvadoriane (ASPARLLEXAL), një organizatë jopartiake që ka për qëllim të forcojë zërin e grave në politikë, si brenda ashtu edhe jashtë parlamentit.

“

NË SALVADOR, GRATË UDHËHEQËSE POLITIKE E KUPTUAN SE DO TË KISHIN SHUMË MË TEPËR SUKSES PËR TË KAPËRCYER VËSHTIRËSITË DHE SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLESHTIN GRATË NË ARENËN POLITIKE PO TË PUNONIN SË BASHKU ME NJËRA TJETRËN PËRTEJ NDARJEVE PARTIAKE, SE SA PO TË PUNONIN TË IZOLUARA NGA NJËRA TJETRA.

”

### FJALË KYÇE

Organizimi i brendshëm i partisë

Kuotat vullnetare në parti

Forum i grave

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Fronti Farabundo Marti për Çlirim Kombëtar (FMÇK)

### SHEMBULL TJETËR

Shoqata e Grave Parlamentare dhe Ish-Parlamentare Salvadoriane (ASPARLLEXAL)

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: SALVADORI

Emri i parlamentit	Asambleja Legjislative
Struktura e parlamentit	Një-dhomëshe
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim Proporcional me Lista
Zgjedhjet legislative	Janar 2009
Numri i grave të zgjedhura	16 nga 84 (19,1%)

Historia e arritjeve në fushën e përfaqësimit dhe përfshirjes së grave në politikë në Salvador është me ulje dhe ngritje. Në parlament, 19 për qind e deputetëve janë gra, që e rendit vendin diku nga mesi,, si në rang global, ashtu edhe në rang rajoni, për sa i përket përfaqësimit të grave.<sup>2</sup> Megjithatë, kabineti qeveritar mbetet i dominuar nga meshkujt, sepse 13 nga 15 ministrat e qeverisë janë meshkuj. Përveç kësaj, në nivel vendor, vetëm rreth 11 për qind e kryetarëve të bashkive në rang vendi janë gra.<sup>3</sup>

### Baza arsyetuese për shtimin e pjesëmarrjes së grave

Rrënjët e ndikimit të grave në FMÇK kanë filluar që me historinë e krijimit të partisë si lëvizje guerile gjatë luftës civile si dhe tek filozofia e saj e asaj kohe, që përfshinte barazinë gjinore si një nga objektivat “thelbësore të partisë”. Siç u shpreh edhe një aktiviste e FMÇK-së “Gjatë luftës, gratë kishin mundësi të ishin ‘bose’; autoriteti ynë njihej dhe pranohej; ne nuk ishim thjesht patriote, apo luftëtare, apo infermiere.”<sup>4</sup> Gratë ishin të pranishme në udhëheqjen e FMÇK-së gjatë gjithë kohës së luftës civile. Edhe gjatë negociatave për marrëveshjen e paqes, gratë përbënin 35 për qind të delegacionit të FMÇK-së.<sup>5</sup> Kur FMÇK-ja filloi të shndërrohej në një parti politike pas mbarimit të luftës civile, roli i grave në përgjithësi dhe i disa grave të caktuara në veçanti ishte tashmë i përcaktuar, gjë që krijoi një standard të rëndësishëm për pjesëmarrjen e grave gjatë kohës që partia ishte në zhvillim e sipër. Megjithëse kjo nuk garantonte se gratë do të mbeteshin të përfaqësuara në udhëheqjen e FMÇK-së, ishte krijuar një lloj pragu apo baze për gratë që donin të kërkonin të drejtat e tyre brenda organizatës. Ndërkohë, vullneti politik i udhëheqësve meshkuj të partisë për t’i mbajtur ato vende të hapura për gratë, shoqëruar me angazhimet më të gjera ideologjike të partisë, bënë që gratë të ruanin një farë niveli udhëheqjeje edhe pas tranzicionit në paqe.

Në vitet e para pas luftës, gratë udhëheqëse politike e kuptuan se do të mund të arrinin shumë më tepër suksese në kapërcimin e vështirësive dhe sfidave me të cilat përballeshin gratë në arenën politike po të punonin së bashku me njëra tjetrën përtej ndarjeve partiake, se sa po të punonin të izoluar nga njëra tjetra. Duke pasur

parasysh se gratë ende nuk kishin krijuar një masë kritike brenda Asamblesë Legjislativë, ato vendosën të krijonin një shoqatë jo-partiake të grave parlamentare dhe ish-parlamentare e cila do të shërbente si një forum i përbashkët i grave udhëheqëse politike nga parti të ndryshme por edhe nga cikle legjislativë të ndryshme.

### Strategjitë e përdorura

FMÇK-ja, mbështetur në propozimin e grave anëtare të saj, krijoi një kornizë për pjesëmarrjen e grave në politikë përmes trajtimit të çështjeve të barazisë gjinore në nënligjet e tyre, miratimit të një kuote të brendshme, dhe ndërtimit të strukturave partiake që kishin për qëllim të mbështesnin më mirë anëtarët e tyre gra, si degën e grave, komitetin këshillimor për politikën e grave, dhe një konferencë vjetore të grave. Ndërkohë, gratë salvadoriane nga të gjitha partitë politike i bashkuan forcat e tyre për të trajtuar një brez të ri grash udhëheqëse politike.

#### A. ORGANIZIMI I BRENDSHËM: KUOTAT VULLNETARE

Si pasqyrim i punës që ishte bërë nga gratë në forcat guerile, barazia gjinore u përfshi që në deklaratën e parë të misionit dhe në kodin e etikës së FMÇK-së, që mbanin një qëndrim të fuqishëm kundër diskriminimit të grave dhe dhunës ndaj tyre. Përveç kësaj FMÇK-ja e institucionalizoi më tej rolin e grave duke miratuar **një kuotë të brendshme vullnetare** e cila kërkonte që gratë të përfaqësoheshin në nivelin 35 për qind ose më shumë në të gjitha veprimtaritë e partisë. Kuotat përfshinin të gjitha listat e kandidatëve si dhe të gjitha bordet, komitetet dhe strukturat e tjera të partisë. Kjo kuotë u propozua në vitin 1993 dhe u miratua në vitin 1995, mbi bazën e pranimit të faktit se gjatë luftës civile gratë përbënin 35 për qind të forcave të armatosura të FMÇK-së. Ndonëse FMÇK-ja kishte një histori të gjatë të përfshirjes dhe angazhimit të grave në mënyra shumë të rëndësishme, kuota e propozuar në fillim u prit me kundërshtime nga disa burra në parti, por megjithatë, në fund të fundit u miratua me mbështetjen e burrave në poste udhëheqëse në parti.

Vetëm vendosja e kuotave të brendshme partiake në vetvete, rrallë është e mjaftueshme për të siguruar një pjesëmarrje

domethënëse të grave, por në kontekstin e FMÇK-së dhe të historisë së saj politike, kuota sanksionoi zyrtarisht ato rryma të qarta që kishin qenë të pranishme në parti me kohë. Nuk u caktuan dënime zyrtare për strukturat e partisë nëse ato nuk i arrinin kuotat, por Sekretariati i Grave (Forumi i Grave në parti) dhe udhëheqëse të tjera në parti e mbikëqyrin zbatimin e kuotave. Ky rol i Sekretariatit të Grave për kontrollin e zbatimit të kuotave parashikohet zyrtarisht në statutet e partisë.

Po kështu, edhe Statuti i Sekretariatit të Grave bën thirrje për një **konferencë vjetore të grave drejtuese në parti**. Në këtë konferencë mbledhen gratë e zgjedhura në funksione të larta të partisë, anëtarët e bordit ekzekutiv, dhe gra të tjera, për të diskutuar dhe formuluar strategji për çështje mbi politike që janë me rëndësi për gratë në parti. Konferenca vjetore gjithashtu u jep grave mundësinë të vlerësojnë nevojat e grave, dhe Sekretariati ka arritur të ndërtojë mbi to për të bërë trajnime të grave anëtare të partisë në lidhje me punën në fushata zgjedhore. FMÇK-ja i jep fonde të drejtpërdrejta Sekretariatit të Grave për këto trajnime dhe programe të tjera të ngjashme, duke garantuar kështu një farë autonomie të veprimtarive të Sekretariatit të Grave.

FMÇK-ja gjithashtu ka zbatuar strategji për t'i kushtuar një vëmendje më të madhe mënyrës se si ndikojnë platforma e partisë dhe proceset për hartimin e politikave tek gratë. Partia ka krijuar një **komision këshillimor** që merr në shqyrtim platformat e propozuara nën këndvështrimin e grave dhe të përparësive të tyre politike. Përveç kësaj, gratë janë të pranishme edhe në komisionet e hartimit të platformave, si dhe përfaqësuese nga Sekretariati i Grave marrin pjesë edhe në vendimarrjet që lidhen me këto platforma.

## B. FORUMI I GRAVE: ASPARLEXAL

Suksesi i FMÇK-së në promovimin e grave në politikë është mbështetur fuqishëm edhe nga nisma dhe përpjekje të tjera jo-partiake dhe shumë-partiake në Salvador. Një nga organizatat kyçe që ka punuar për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë në Salvador është Shoqata e Grave Parlamentare dhe Ish Parlamentare Salvadoriane, që njihet me akronimin ASPARLEXAL. ASPARLEXAL është

një organizatë jo-partiake që synon të forcojë zërin e grave në politikë, si brenda ashtu edhe jashtë parlamentit. Ideja fillestare për krijimin e një **shoqate grash udhëheqëse politike** u propozua në fillim nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë që punonin në Salvador, të cilët e ngritën dhe diskutuan këtë çështje me gratë parlamentare. Politikane të rëndësishme, sidomos nga ARENA, që e kuptuan potencialin e kësaj ideje, punuan që të sillnin së bashku, në fillim në mënyrë informale, pastaj në formë më të institucionalizuar, të gjitha gratë deputete nga partitë kryesore të përfaqësuara në parlamentin aktual, për t'i bindur ato për përfitimet që kishte puna së bashku, përtej ndarjeve politike.<sup>6</sup> Udhëheqja e ASPARLEXAL-it përbëhet nga gra drejtuese nga parti politike si ARENA, FMÇK, dhe disa parti më të vogla.

Qëllimi kryesor i ASPARLEXAL-it nuk është vetëm që gratë të përfshihen më shumë në politikë, por edhe për t'i bërë ato më efektive në qeveri. Në përputhje me këtë, ASPARLEXAL-i, nëpërmjet partnerit të saj Fondacionit të Biznesit për Zhvillim Arsimor, ofron **trajnime dhe seminare për aftësitë e komunikimit dhe organizimit**, që i ndihmojnë gratë të bëhen më efektive në punën e tyre politike, si dhe për tema që janë të lidhura në mënyrë më të drejtpërdrejtë me qeverisjen, si marrëdhëniet ndërmjet degëve të ndryshme të qeverisë dhe hartimi i politikave.

ASPARLEXAL-i është i përkushtuar që ta ruajë statusin e vet jo-partiak dhe synon t'u ofrojë mundësi të barabarta grave nga të gjitha partitë e ndryshme. Ndonëse të gjitha gratë anëtare të ASPARLEXAL-it janë aktiviste partiake, u mor një vendim i vetëdijshëm që në fillimet e para të organizatës, që gratë të mos konsultoheshin me udhëheqjen e partive të tyre dhe të mos merrnin leje nga partia për ta krijuar këtë grup. Në vend të kësaj, si pjesë e kuadrit të shoqatës, të gjitha anëtarëve iu kërkua që ta vinin identitetin e tyre si gra mbi identitetin e tyre si anëtare partie, në mënyrë që, pavarësisht se cila parti ndërmerre ndonjë veprim për çështje që kishin të bënin me gratë, të gjitha gratë e grupit do ta mbështesnin dhe do ta pranonin që nga përpjekjet e kësaj partie do të kishin përfitim të gjitha gratë. Ndonëse ASPARLEXAL punon për ta ruajtur karakterin e saj si shoqatë jo-partiake, grupi

u kërkon partive që të identifikojnë pjesëmarrëse për programet e ndryshme që ofron shoqata, me qëllim që këto pjesëmarrëse të mund t'i përdorin aftësitë e fituara në trajnime në parti, pasi të kenë përfunduar trajnimi.

## Rezultatet

Gratë në FMÇK kanë përfituar nga suksesi që pati partia në zgjedhjet e fundit: në vitin 2009, 75 për qind e grave të zgjedhura në parlament ishin nga FMÇK-ja. Pra, 13 nga 35 deputetëve që kishte FMÇK-ja në parlament ishin gra, duke përfaqësuar kështu raportin më të lartë gra : burra nga çdo parti tjetër në parlament.

Ndërkohë, qasja jo-partiake e ASPARLEXSAL-it i ka ndihmuar ato të fitojnë dhe të vazhdojnë të kenë qasje në të gjitha partitë politike përkatëse. ASPARLEXSAL-i, duke e kuptuar rëndësinë që ka dukshmëria e organizatës, siguroi një seli zyrtare në ndërtesën e Asamblesë Legjislative të vendit. Vendosja aty e shoqatës bën të mundur që gratë deputete ta kenë më të lehtë të përdorin burimet e saj dhe, nga ana tjetër, ia bën më të lehtë ASPARLEXSAL-it të përfshihet në vendimmarrje legjislative, sidomos në rastet kur këto kanë ndikim tek gratë. Precedenti i krijuar nga ASPARLEXSAL që gratë të punojnë me njëra tjetrën pavarësisht nga ndarjet partiake, ka çuar në një përpjekje për të krijuar një shoqatë të përhershme gjithëpërfshirëse të grave në Asamblenë Legjislative, që të jetë në gjendje të ndikojë tek agjenda legjislative në mënyrë të drejtpërdrejtë.

ASPARLEXSAL-i ka trajnuar gjithashtu edhe 160 gra me anë të programeve intensive gjashtëmuajore, si dhe qindra të tjera me anë të kurseve një ose dy ditore. Një numër grash që kanë marrë pjesë në programet e ASPARLEXSAL-it, janë zgjedhur në funksione të ndryshme, përfshirë edhe në institucione si parlamenti dhe organet e qeverisjes vendore, dhe gratë pjesëmarrëse në programet e tyre janë bërë nismëtare për krijimin e rrjeteve të tjera shumë-partiake të grave.

## Sfidat dhe rruga përpara

FMÇK-ja dhe të gjitha partitë e tjera në Salvador ende përballen me disa vështirësi e sfida për sa i përket përfshirjes së grave. Kuota e vendosur nga FMÇK-ja për kandidatet

e partisë zbatohet në mënyrë shumë rigorozë në nivel kombëtar, gjë që bën që gratë të jenë më të përfaqësuara në parlament se sa në bordet në nivel shtetëror dhe bashkiak apo komunal. Në nivelin shtetëror dhe bashkiak, raportet sugjerojnë se kuotat janë zbatuar në mënyrë të pabarabartë. Aktualisht, shtetet dhe bashkitë që dorëzojnë lista të cilat nuk i përmbushin kërkesat e kuotave gjinore, jo domosdoshmërisht kanë pasoja nga udhëheqja e partisë. Kjo ka bërë që në këto nivele të ketë një numër më të vogël grash të zgjedhura në funksione. Për shembull, vetëm 11 për qind e kryetarëve të bashkive të vendit janë gra.

Tranzicioni i pasluftës në Salvador ishte një mundësi për krijimin e një mjedisi më mundësues për pjesëmarrjen e grave në politikë. Ndonëse gratë kanë qenë pjesëmarrëse të rëndësishme në periudhën e tranzicionit, duhet bërë më shumë për të siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta në arenën e sotme politike, sidomos në Asamblenë Legjislative ku diskutohet dhe vendoset për politikën. Brezi i ri i grave politikane që po hyn në skenë, nuk vjen me “biografi” të forta si udhëheqëse gjatë kohës së luftës, ndryshe nga paraardhëset e tyre; kjo do të përbëjë vështirësi të mëtejshme dhe do të kërkojë strategji të reja dhe krijuese për promovimin e pjesëmarrjes së grave. Strategjitë e nënvizuara këtu nga FMÇK dhe ASPARLEXSAL kanë qenë hapa të rëndësishëm përpara për ta hapur arenën politike për gratë. Megjithatë, duhet të bëhet më shumë punë për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të grave në politikë në Salvador.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). “World Average: Women in National Parliaments” (Mesatarja Botërore: Gratë në Parlamentet Kombëtare). PARLINE Database. Gjetet në <http://www.ipu.org/wmn-e/world.html>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Intervistë me një aktiviste të FMÇK-së.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Intervistë me themeluesen e ASPARLEXSAL, korrik 2009.

KUTI

## SERBIA: MOBILIZIMI I FORUMIT TË GRAVE PËR NDRYSHIME POLITIKE<sup>1</sup>

Serbia është një republikë ku, si qeveria, ashtu edhe Kuvendi Kombëtar i Serbisë (Narodna Skupština Republike Srbije) kanë fuqi legjislative. Në zgjedhjet e vitit 2008 gratë fituan 21,6 për qind të vendeve në Kuvendin Kombëtar. Duke pasur parasysh numrin e madh të aktorëve politikë që konkurrojnë për pushtet politik, partitë shpesh detyrohen të formojnë koalicione me qëllim që të ushtrojnë ndikim në agjendën e politikave të Asamblesë Kombëtare. G17 Plus është një parti politike liberal-konservatore që doli nga një OSHC e formuar prej një grupi prej 17 ekonomistësh të tregut të lirë. Partia G17 Plus e Serbisë ka një organizatë të fuqishme grash që ka ndihmuar si në rritjen e përfaqësimit të grave në delegacionin e G17 Plus në parlamentin serb, ashtu edhe në rritjen e pranisë së grave në pozicione me influencë brenda partisë. Gratë përbëjnë rreth 29,1 për qind të grupit parlamentar të G17 Plus.

Forumi i grave i partisë G17 Plus e ka origjinën tek një grup prej 15 grash me role drejtuese në parti, të cilat, duke filluar që nga koha e themelimit të partisë në vitin 2002, u përpoqën të sigurojnë që gratë të luanin një rol të rëndësishëm në parti. Ato ndërtuan mbi lidhjet ekzistuese që kishin me organizata ndërkombëtare që më parë kishin financuar trajnime, seminare dhe veprimtari të tjera për gratë serbe. Gratë e G17 Plus i angazhuan këto organizata ndërkombëtare, duke u kërkuar atyre trajnime për gratë anëtare të G17 Plus në një gamë fushash e çështjesh, si ngritja e ndërgjegjësimit, komunikimi dhe negociatat për çështjet gjinore.

“

VËNIA E NJË NUMRI MË TË MADH GRASH NË POSTE TË ZGJEDHURA DHE NË UDHËHEQJEN E PARTISË DO TË NDIHMOJË TË SIGUROJË MBËSHTETJEN E KËTYRE GRAVE DHE DO TË TËRHEQË MË SHUMË VOTUES TË MUNDSHËM PËR PARTINË.

”

Pas kryerjes së këtyre trajnimeve nga 100 gra të G17 Plus, 16 nga pjesëmarrëset më aktive u caktuan si bashkërenduese të rrjetit rajonal dhe u ngarkuan me detyrën për të rekrutuar një numër më të madh grash; këto gra ishin nismëtare të krijimit të forumit të grave të partisë. Kjo qasje krijoi një elektorat të fuqishëm në bazë që mbështeste forumin e grave, që ishte e dobishme për partinë dhe u dha grave një pozicion më të fuqishëm në marrëdhëniet me udhëheqjen përgjithësisht mashkullore të partisë.

Pas krijimit të forumit të grave, udhëheqja e Forumit e bindi G17 Plus që të reformonte rregulloren e partisë për ta pranuar forumin si strukturë zyrtare të partisë. Pak kohë më vonë, forumi i grave filloi të promovojë marrjen e masave të tjera për të siguruar që edhe më shumë gra të ishin të suksesshme në marrjen e posteve publike. Serbia ka të parashikuar me ligj një kuotë prej 30 për qind për të gjitha listat e partisë, por ligji i kuotave u konsiderua pa kuptim sepse ai nuk përmbante detyrimin për t'u kërkuar partive që t'i vendosnin gratë në pozicione ku mund të fitonin në listë. Prandaj, forumi i grave ushtroi ndikim të drejtpërdrejtë në parti për të





garantuar që kandidateteve gra t'u jepeshin pozicione të larta në lista.

Forumi i grave të G17 Plus u mbështet kryesisht në dy argumente për ta bindur udhëheqjen e partisë që të promovojë pjesëmarrjen politike të grave. Gratë aktiviste, të mbështetura fort në qëndrimin pro-evropian të G17 Plus, argumentuan se promovimi i barazisë gjinore ishte i domosdoshëm që G17 plus të perceptohej si parti "evropiane". Përveç kësaj, forumi argumentoi se, meqë gratë përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë dhe të paktën 40 për qind të anëtarësisë së partisë, ngritja e më shumë grave në poste të zgjedhura dhe në udhëheqjen e partisë do të ndihmojë të sigurojë mbështetjen e këtyre grave dhe të tërheqë më shumë votues të mundshëm për partinë. Përveç avokacisë për një përfaqësim më të madh të grave, forumi i grave është përpjekur aktivisht të financojë trajnime dhe seminare për gratë kandidatë dhe aktiviste. Ai ka mbështetur dhe ka paraqitur kandidatura të grave edhe në komisionet e barazisë gjinore që krijuan organet e qeverisjes vendore në të gjithë Serbinë me qëllim që të ndikojnë më shumë në politikat për prioritetet e grave në nivel vendor.<sup>2</sup>

#### SHËNIMET FUNDORE

<sup>1</sup> Kjo kuti nuk paraqet një analizë të gjithanshme të të gjitha iniciativave apo të të gjitha palëve të interesuara në vend që synojnë të promovojnë pjesëmarrjen politike të grave, por paraqet në hollësi vetëm veprimet konkrete të një partie.

<sup>2</sup> Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet Ndërkombëtare (NDI) (2008). "Assessing Women's Political Party Programs: Best Practices and Recommendations." (Vlerësimi i programeve të grave në partitë politike: Praktikrat më të mira dhe rekomandimet) Gjetet në <http://www.ndi.org/node/15121>, parë në janar 2012; Intervistë me Lidija Prokic, NDI Serbi, menaxhere e lartë programi, në vitin 2009.



## SPANJA: PUNA NË PARTNERITET ME BURRAT PËR TRANSFORMIMIN E MJEDISIT POLITIK PËR GRATË<sup>1</sup>

### Pak informacion

Spanja ka një parlament me dy dhoma, që përbëhet nga Kongresi i Deputetëve (Dhoma e Ulët) dhe Senati (Dhoma e Lartë). Skenën politike e dominojnë dy parti kryesore, Partia Socialiste e Punëtorëve (PSOE) dhe Partia Popullore. Përveç këtyre, në arenën politike spanjolle ka edhe një numër partish të vogla ndër të cilat, E Majta e Bashkuar, Konvergencë dhe Bashkim, Partia Nacionaliste Baske, E Majta Republikane e Katalunjës, Blloku Kombëtar i Galicisë, dhe Koalicioni i Kanarieve.<sup>2</sup>

PSOE-ja ka një përqindje të madhe grash në nivelet më të larta të udhëheqjes politike. Pas zgjedhjeve të vitit 2008, 47.6 për qind e grupit parlamentar të PSOE-së ishin gra. Përveç kësaj, gratë përbënin edhe shumicën në kabinetin qeveritar, me nëntë gra nga 17 anëtarë të kabinetit, madje edhe në poste shumë kyçe si mbrojtja, ekonomia,

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Socialiste për të promovuar pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe në kontekstin e zgjedhjeve, ndonëse ajo nuk është e vetmja parti politike në Spanjë që e ka bërë një gjë të tillë. Ai merr në shqyrtim se si përkrahja e udhëheqësve meshkuj ka shtuar dhe përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme mundësitë e grave në politikë brenda partisë, dhe ka çuar në miratimin e marrëveshjeve progresive për kuotat.



### FJALË KYÇE

Partneriteti me burrat

Kuotat e brendshme

Mobilizimi i grave

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Partia Socialiste e Punëtorëve (PSOE)

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: SPANJA

Emri i parlamentit	Parlamenti i Spanjës/ Cortes
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Kongresi i Deputetëve dhe Senati)
Lloji i sistemit zgjedhor	Përfaqësim proporcional (Dhoma e Ulët)
Zgjedhjet legjislative	Mars 2008
Numri i grave të zgjedhura	127 nga 350 (36%) <sup>3</sup>

punët publike, dhe një zëvendës kryeministre. Ministria e mbrojtjes, Carmen Chacon, ishte edhe ministria e parë shtatzënë e Spanjës, ndërsa ministria për barazi, Bibiana Aido, ishte ministria më e re e kabinetit – ajo ishte vetëm 31 vjeç kur u vu në atë post. Arritjet e PSOE-së në rritjen e qasjes së grave në politikë janë rezultat i disa politikave paralele.

### Baza arsyetuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave

Në vitin 2004, kur PSOE-ja po përpiqej të fitonte pushtet politik, udhëheqja e partisë ishte e hapur ndaj argumenteve të aktivisteve të partisë që sugjerorin se nëse partia bëhej e njohur si një parti që përkrahte dhe promovonte gratë, kjo do ta ndihmonte atë të ishte e suksesshme në zgjedhje. PSOE-ja paraqiti kandidate gra në mënyrë proaktive, dhe bëri fushatë për kuota gjinore të parashikuara me ligj dhe politika të barazisë gjinore. Gratë e shumta që ishin votuar si deputete në parlament dhe emëruar në qeverinë e Zapateros, mundën ta ndihmojnë PSOE-në që të plotësonte premtimet e bëra gjatë fushatës.

### Strategjitë e përdorura

Sekretariati i grave të PSOE-së ka luajtur një rol të rëndësishëm në futjen e një vargu kuotash të brendshme gjithnjë në rritje, që do të krijonin bazat e një kulture partiake të hapur ndaj promovimit të grave si drejtuese dhe që zbatonte një platformë të barazisë gjinore. Me daljen në krye të një udhëheqësi partie pro grave dhe zbatimin e një kuote gjinore në kabinet, PSOE-ja ishte në një pozitë shumë të mirë për ta shtrirë të njëjtën kornizë të barazisë gjinore që ishte zhvilluar brenda partisë, në të gjithë sistemin politik spanjoll, përmes miratimit të një varg politikash publike që trajtonin pabarazitë e ndryshme me të cilat përballeshin gratë në politikë, ekonomi dhe shoqëri.

#### A. KUOTAT E BRENDSHME NË PARTI

Përpjekjet e PSOE-së për të promovuar gratë brenda partisë e kanë origjinën në fundin e viteve 1970, kur Spanja po dilte nga regjimi totalitar dhe po shkonte drejt demokracisë. Gjatë asaj periudhe, u themelua sekretariati i grave të PSOE-së, i cili filloi të bënte avokaci për barazi

gjinore brenda partisë. Kuotat kanë qenë gjithmonë në qendër të punës së tyre të avokacisë, megjithatë në fillim kishte një lloj rezistence ndaj kuotave të brendshme në parti, si nga burrat ashtu edhe nga gratë, që argumentonin se kuotat do t'i jepnin një avantazh të padrejtë grave dhe do të bënë që të viheshin në dyshim njëfarësoj kualifikimet dhe aftësitë e të gjitha grave. Mbrojtëset e kuotave me bazë gjinore në PSOE e lidhën fushatën e tyre me çështjen e kuotave gjeografike, që ishin pjesë e një përpjekjeje që po bënte PSOE-ja për të siguruar një mbështetje me bazë të gjerë nga të gjitha shtetet dhe rajonet në Spanjë.<sup>4</sup> Më në fund, argumentet e sekretariatit të grave e bënë punën e tyre, dhe në vitin 1988, **PSOE-ja zbatoi një sistem të kuotave të brendshme për të gjitha listat partiake.** Kjo kuotë në fillim u caktua në nivelin 25 për qind, por u rrit në 40 për qind në vitin 1997 dhe u zbatua edhe në bordet dhe komitetet drejtuese partiake si dhe në listat e kandidatëve.

Për shkak të sistemeve të ndryshme të përdorura për zgjedhjen e deputetëve dhe senatorëve, kuota e brendshme e PSOE-së ka pasur gjithmonë një ndikim më të madh në Kongresin e Deputetëve (që zgjidhet me anë të listave të partive) se sa në Senat (që përdor një sistem të përzier elektoral që kombinon listat dhe zonat zgjedhore me një deputet të vetëm). Sidoqoftë, kuota e brendshme e bëri të mundur, madje edhe të nevojshme, që PSOE-ja të ndërtonte kapacitetet e grave kandidate në gjirin e saj dhe t'u krijonte mundësi grave anëtare të partisë që të fitonin përvojë në politikë në nivel kombëtar dhe vendor.

#### B. REFORMA NË FUSHËN E POLITIKAVE

Duke përfutur nga kuotat, prania e shtuar e grave në parti kontribuoi edhe në strategji të tjera, përfshirë edhe avokacinë e fuqishme në favor të grave nga vetë kryeministri Zapatero dhe miratimi i ligjit për barazinë, i vitit 2007. Përpara se të vinte në fuqi, Zapatero e kishte shpallur veten si përkrahës i lëvizjes femineiste dhe duke e bërë këtë, siç u shpreh edhe një e intervistuar, ai hoqi “tabunë” që lidhej me lëvizjen femineiste në Spanjë.<sup>5</sup> Në vitin 2004, partia bëri fushatë për miratimin e një ligji gjithëpërfshirës për barazinë gjinore që bënte thirrje për një kuotë prej 40 për qind për të gjitha listat e kandidatëve dhe për të gjitha legjislaturat. Lëvizja e parë politike e Zapateros pas zgjedhjes së tij si

kryeministër ishte bashkëndimi i kabinetit dhe i grupit të vet parlamentar në mbështetje të paraqitjes së një projektligji. Gjithashtu pranohet gjerësisht se ai luajti rol kyç në krijimin e kabinetit të parë qeveritar në Spanjë me shumicë grash në vitin 2008, si dhe që i dha shumicën numerike grave në kabinet duke krijuar Ministrinë e Barazisë.

Pas miratimit të barazisë gjinore, PSOE-ja kërkoi ta **përfshinte gjininë në të gjitha aspektet e hartimit të politikave**. Që nga viti 2004, PSOE-ja ka paraqitur ligje për reformën bujqësore, që gratë dhe burrat të mund të ndajnë titujt e pronësisë, dhe për kujdesin për personat në nevojë në familje, në mënyrë që Ministria e Administratës Publike të mund të mbështeste familjet me deri dy të tretat e shpenzimeve që lidheshin me kujdesin për personat në ngarkim (fëmijë, të moshuar, të sëmurë). Përveç ndikimit të tyre në parlament, gratë janë përfshirë edhe në hartimin e politikave, debatet e brendshme dhe proceset e tjera vendimmarrëse të PSOE-së. Siç e përshkroi një e intervistuar, gratë nuk shihen vetëm “zbukurim vitrinash” në politikë.<sup>6</sup> Disa të intervistuar u shprehën se gratë trajtoheshin në mënyrë të barabartë me burrat në parti dhe se pikëpamjet e tyre merreshin po aq parasysh sa edhe ato të kolegëve të tyre meshkuj.

## Rezultatet

Gjatë gjithë viteve 1980, ndërkohë që demokracia spanjolle po konsolidohej, përfaqësimi i grave në parlament vazhonte të ishte i ulët. Numri i grave nuk e kalonte 10 përqindëshin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të parlamentit, madje as të grupit parlamentar të PSOE-së në periudhën përpara vitit 1988, kur PSOE-ja miratoi kuotën e vet të brendshme. Në zgjedhjet e vitit 1989, të parat pas vendosjes së kuotës nga PSOE-ja, përqindja e grave në grupin parlamentar të saj shkoi nga 7 në 17 për qind.

Ligji për barazinë, për sa i përket kuotave, e ktheu politikën e brendshme të PSOE-së në një detyrim ligjor për të gjitha partitë. Partia Popullore i zbatoi kuotat e vendosura me ligj në zgjedhjet kombëtare të vitit 2008, dhe emëroi më shumë gra kandidatë se sa kishin pasur në të shkuarën. Ligji i barazisë po kështu parashikonte edhe dispozita të tjera të krahasueshme për një barazi më të madhe gjinore

në organet drejtuese në sektorin privat, një sektor tjetër ku gratë spanjolle ishin lënë mënjanë historikisht.

Spanja u përpoq gjithashtu të emalonte edhe jashtë vendit atë rol drejtues për çështjet gjinore që kishte zbatuar brenda vendit, duke bërë avokaci brenda BE-së për ligje që mbrojnë kundër dhunës gjinore dhe për krijimin e një direktive kundër diskriminimit.

## Sfidat dhe rruga përpara

Ndonëse kuotat e brendshme, përkrahja e drejtuesve meshkuj të partisë dhe ligji i barazisë mund të konsiderohen të gjitha si strategji të veçanta partiake, ato janë në të njëjtën kohë edhe të ndërvarura nga njëra-tjetra. Përvoja dhjetëvjeçare e PSOE-së me një politikë të brendshme për kuotat, e bëri të gjithë udhëheqjen e saj, si gratë edhe burrat, më të hapur ndaj vlerës së përfshirjes së grave në parti, dhe kishëte shtuar gjasat që kandidati i saj për kryeministër ta pranonte idenë e nevojës së fushatës për çështje të barazisë gjinore. Po kështu, gratë parlamentare të PSOE-së, që kishin përfituar nga kuotat dhe përbënin pothuaj gjysmën e grupit parlamentar të partisë së tyre, luajtën një rol të rëndësishëm në miratimin e projektligjit të Zapateros në parlament.

Megjithatë, Spanja dhe PSOE-ja ende kanë sfida përpara. Suksesi i PSOE-së në garantimin e përfaqësimit të grave në arenën politike kombëtare nuk është realizuar në të njëjtën masë edhe në nivelin vendor. Ndonëse gratë përbëjnë 36 për qind të anëtarëve të këshillave bashkiakë nga PSOE-ja, gratë përfaqësojnë vetëm 15 për qind të kryetarëve të bashkive nga PSOE-ja, që lë të kuptohet se ky post i zgjedhur, që nuk i nënshtrohet kuotave të listave, vazhdon të dominohet nga meshkujt. Përveç kësaj, në nivel kombëtar, burrat ri-zgjidhen më shpesh, dhe i mbajnë mandatet e tyre më gjatë se gratë. Duke i hedhur sytë tek e ardhmja, Spanja dhe PSOE-ja duhet të marrin në shqyrtim strategji që do t'i lejojnë të ruajnë suksesin që kanë arritur, t'u përgjigjen faktorëve që mund të pengojnë një grup më të shumëllojshëm grash të hyjnë në sferën politike spanjolle, dhe të nxisin institucione politike me ndjeshmëri gjinore në mënyrë që gratë të kenë mundësi të barabarta për të ndjekur karrierën e tyre në politikë.

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet jo domosdoshmërisht reflektojnë mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> Ky rast studimi u shkrua gjatë viteve 2009-2010, dhe informacioni përmban referenca për zgjedhjet e vitit 2008. Në maj të vitit 2011 u mbajtën zgjedhje në të cilat gratë përsëri fituan 36 për qind të vendeve në parlament.

<sup>3</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU). PARLINE Database. Gjetet në [http://www.ipu.org/parline-e/reports/2293\\_E.htm](http://www.ipu.org/parline-e/reports/2293_E.htm), parë në janar 2012.

<sup>4</sup> Dahlerup, D. dhe L. Freidenvall. (2008). "Electoral Gender Quota Systems and Their Implementation in Europe." (Sistemet e kuotave gjinore zgjedhore dhe zbatimi i tyre në Evropë). Universiteti i Stokholmit, International IDEA, dhe Women in Politics Research Center. Gjetet në <http://5050campaign.files.wordpress.com/2009/03/ep-quota-report.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> Intervistë me një funksionare të PSOE-së, shtator 2009.

<sup>6</sup> Po aty.

## SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS: RRJETET PËR MBLEDHJEN E FONDEVE DHE POLITIKA E BARAZISË GJINORE PËR KONVENTAT PARTIAKE<sup>1</sup>

### Pak informacion

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) janë një republikë kushtetuese federale dhe, që nga vitet 1850, në politikën amerikane kanë mbizotëruar dy parti politike: Demokratët e qendrës së majtë dhe Republikanët e qendrës së djathtë. Disa parti të tjera të treta arrijnë herë pas here të përfaqësohen në numër të vogël në nivelet kombëtare dhe shtetërore. Ekzistojnë pak ligje që rregullojnë organizimin politik dhe, si rrjedhim, partitë politike kanë pasur dorë të lirë në zhvillimin e sistemeve të tyre të organizimit. Konventa kombëtare është autoriteti më i lartë i partive Demokratike dhe Republikane dhe përbëhet nga një seri mbledhjesh apo konventash (që quhen konventa për emërim kandidatësh) të delegatëve të partisë në vitet e zgjedhjeve presidenciale, për të emëruar kandidatët e partisë për president dhe zëvendës-president si dhe për të miratuar platformën

Ky rast studimi paraqet disa nga strategjitë e ndërmarra nga Partia Demokratike për të promovuar pjesëmarrjen e grave. Megjithëse Statuti i Partisë Demokratike e ndalon përdorimin e kuotave gjinore, Partia Demokratike zbaton një kuotë të ashtu-quajtur "të butë" në strukturat dhe proceset e partisë, që sanksionon një përfaqësim në parti "sa më afër të barabartës që është e mundur në praktikë". Ky rast studimi fokusohet tek pjesëmarrja e grave në nivel federal.



### FJALË KYÇE

Mobilizimi i grave  
Rrjetet e financimit  
Organizimi i partisë

### SHEMBULL PARTIE POLITIKE

Partia Demokratike

### NJË VËSHTRIM I SHPEJTË: SHBA

Emri i parlamentit	Kongresi
Struktura e parlamentit	Dy-dhomëshe (Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve)
Lloji i sistemit zgjedhor	Pluralist/Maxhoritar
Zgjedhjet legjislativ	Nëntor 2008
Numri i grave të zgjedhura	73 nga 435 (16,8%)

e partisë. Komitetet Kombëtare Demokratike dhe Republikane kanë përgjegjësi të përgjithshme mbi punët e partive të tyre përkatëse në periudhën midis konventave për emërimin e kandidatëve, dhe çdo degë shtetërore ka statutin dhe rregullat e veta.

SHBA-ja ka një Kongres me dy dhoma: një Dhomë të Përfaqësuesve dhe Senatit. Gratë përbëjnë 17 për qind të Senatit dhe 16 për qind të Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin e 112-të.<sup>2</sup> Kandidatët që dëshirojnë të konkurrojnë si demokratë ose republikanë për një post të zgjedhur, thjesht duhet të deklarojnë përkatësinë e tyre në një parti dhe, nëse munden të sigurojnë votat e mjaftueshme në procesin e vënies së kandidaturës, mund të bëhen kandidat zyrtar i partisë. Në praktikë, komitetet shtetërore të partisë rekrutojnë dhe miratojnë kandidatët e tyre të përzgjedhur, por proceset zgjedhore ndryshojnë nga shteti në shtet si dhe nga zona në zonë brenda shteteve.<sup>3</sup>

### **Baza arsyetuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave**

Që në vitin 1948, gratë aktiviste thirrën në Seneca Falls të Nju Jorkut Konventën e parë të drejtave të grave në Shtetet e Bashkuara dhe hartuan një Deklaratë të Mendimeve të tyre, duke kërkuar të drejtën e votës për gratë. Megjithëse gjatë një shekulli mbështetja për pjesëmarrjen politike të grave ka ardhur duke u rritur, përfitimet për gratë aktiviste amerikane brenda Partisë Demokratike kanë qenë me ulje-ngritje. Në vitin 1953 udhëheqësit demokratë vendosën ta shpërndajnë Organizatën e Grave të partisë dhe mbështetjen integrimin e grave aktiviste në të gjitha komitetet dhe rolet udhëheqëse. Megjithëse hasi në kundërshtimin e grave në parti, kjo qasje neutrale ndaj gjinisë vazhdoi për disa dekada dhe gratë në përgjithësi i braktisën strategjitë kolektive për të ndikuar në politikat si një grup zgjedhor.<sup>4</sup> Megjithatë, si rezultat i organizimit të grave brenda dhe jashtë partisë, gratë demokrate filluan më vonë të bënin avokaci që të kishin ndikim brenda partisë. Me fillimin e mobilizimit të grave në të gjithë sektorët, Partia Demokratike u bë më reaguese ndaj thirrjes së grave për përfaqësim më të madh të tyre, duke

pranuar ndikimin që mund të kishin gratë në suksesin zgjedhor të partisë. Përveç kësaj, udhëheqja e partisë i njohu gratë si një nga grupet e saj kryesore zgjedhore, meqë që nga vitit 1980 gratë votonin në përqindje më të lartë se burrat dhe përbënin një numër më të madh ndër votuesit e pavendosur apo që mund të ndërronin partitë.<sup>5</sup>

## **Strategjitë e përdorura**

### **A. MOBILIZIMI I GRAVE**

Gratë aktiviste të lidhura me Partinë Demokratike punuan si brenda ashtu edhe jashtë partisë në mbështetje të reformave, duke kërkuar nga udhëheqja e partisë që të arrinte objektiva të rëndësishme për gratë në politikë, përfshirë përfaqësimin e barabartë në konventat kombëtare, ndarjen e barabartë të posteve udhëheqëse të partisë në nivel shtetëror dhe vënien e kandidaturës së një gruaje në listën e kandidatëve për president.

Ndërkohë, u krijuan edhe organizata të jashtme grash. Në vitet 1960 dhe 1970 u krijuan disa OSHC dhe komitete grash të veprimit politik me misionin e posaçëm për të forcuar pjesëmarrjen e plotë politike të grave, duke argumentuar se politika amerikane përfaqësonte një “klub të vjetër, vetëm për djem”.<sup>6</sup> Disa nga këto organizata kanë mundur të krijojnë një fizionomi të dallueshme si brenda ashtu edhe jashtë partive kryesore politike, si Organizata Kombëtare për Gratë (NOW), Grupi Politik Kombëtar i Grave (NWCP), Federata Kombëtare e Grave Demokrate (NFDW), Fondi i Fushatës së Grave dhe Lista EMILY. Këto organizata synonin të rrisin qasjen e grave në pushtet politik nëpërmjet rekrutimit dhe trajnimit si dhe dhënies së donacioneve financiare për gratë candidate në nivelet shtetërore dhe kombëtare.

Teksa numri i anëtareve dhe mbështetja për këto organizata shtohet gjithnjë e më shumë, ato filluan të ushtrorin presion ndaj institucioneve politike për të garantuar hapësirë dhe mundësi të barabarta politike për gratë. Me organizimin e valës së mitingjeve feministe pas miratimit të Amendamentit për të Drejtat e Barabarta (ERA) – një amendament në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara që

## RRJETET E MBLEDHJES SË FONDEVE: LISTA EMILY

Në vitet 1980, 25 “nënat themeluese” të Listës EMILY konstatuan se gratë kandidate nuk po siguronin paratë e nevojshme fillestare për fushatat e tyre që të merreshin seriozisht si kandidate konkurrenente ndaj burrave.<sup>1</sup> Duke shfrytëzuar rrjetet ku bënin pjesë ose me të cilat kishin lidhje, themelueset i hynë një fushate shkrimi letrash për të rritur ndërgjegjësimin për rrjetin e tyre të ri dhe për t’i nxitur gratë të jepnin para për gratë kandidate, duke argumentuar se edhe donacione sado të vogla mund t’i ndihmonin fushatat e grave.<sup>2</sup>

Lista EMILY përgatiti strategji për mbledhjen e fondeve bazuar në një kuptim të sistemit dhe ligjeve të financimit të fushatës në Shtetet e Bashkuara. Grupi e dinte se, si komiteti veprimi politik, ai ishte i kufizuar në një kontribut prej 5 000 dollarësh për kandidate në një cikël zgjedhor, por mund të grumbullonte një sasi të pakufizuar kontributesh individuale<sup>3</sup> nga anëtarët e tij. Me anë të një procesi rigoroz përzgjedhjeje, Lista EMILY identifikon kandidatet më të mira demokrate dhe ua rekomandon ato anëtarëve kontribuues të Listës EMILY në gjithë vendin. Lista EMILY i kërkon anëtarëve të saj që të japin fonde në mënyrë të drejtpërdrejtë për fushatat e këtyre grave, duke u ofruar atyre profile dhe informacione të hollësishme për pikëpamjet e secilës kandidate, dhe duke bërë fushata me qëllim që ata të marrin vendime të mbështetura në informacionet që kanë. Njëqind për qind e kontributeve të anëtarëve shkojnë drejtpërdrejt për fushatat, me qëllim që t’u ofrojnë një mbështetje më të madhe në para grave kandidate.<sup>4</sup>

Me rritjen e numrit të anëtarëve dhe anëtareve të Listës EMILY dhe të kapaciteteve të saj për të mbledhur fonde, Partia Demokratike e kuptoi edhe përkushtimin e këtij grupi ndaj grave kandidate pro-zgjedhjes (pro abortit) dhe se, si rezultat i përfshirjes së tyre në rrjetin e Listës EMILY, gratë kandidate mund të mblidhnin fonde më të mëdha për fushatat e tyre. Udhëheqja e partisë dhe grupi i grave i mirëpritën sistemet e ngritura nga Lista EMILY, por as partia as Lista EMILY nuk parashikuan se mund të arriheshin suksese të ngjashme nga brenda strukturave të partisë.<sup>5</sup>

Që nga themelimi i saj, Lista EMILY është rritur e zgjeruar dhe tani ka në gjirin e saj më shumë se 100 mijë anëtarë; ajo ka mbledhur miliona dollarë për kandidatet, dhe ka ndihmuar në zgjedhjen e 80 grave anëtare demokrate pro-zgjedhjes në Kongres, 15 senatoreve, 9 guvernatoreve dhe qindra grave në funksione shtetërore dhe vendore.<sup>6</sup> Lista EMILY ka frymëzuar dhe mbështetur replikimin e strategjive të saj nga organizata demokrate në nivel shtetëror, si Lista Annie në Teksas, dhe nga partitë e tjera, me krijimin e Listës së Dëshirave (Wish List) dhe Listës Susan B. Anthony për kandidatet republikane.

### SHËNIME

<sup>1</sup> Paratë fillestare janë financimet e para që kërkohen për të filluar një fushatë për të fituar emërimin si kandidate nga partia. Si i tillë akronimi Lista EMILY qëndron për “Early Money Is Like Yeast - Paratë fillestare janë si majaja” – ajo e bën brumin (d.m.th. fondet për fushatën) të vijë. (Intervistë me themelueset e Listës EMILY, janar 2010).

<sup>2</sup> EMILY’s List. “Our History,” (Historia jonë) <http://emilyslist.org/who/history/>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Tani, individët mund të kontribuojnë vetëm një maksimum prej 2 400 dollarësh për zgjedhje për kandidat për funksion federal.

<sup>4</sup> EMILY’s List. “Our History,” (Historia jonë) <http://emilyslist.org/who/history/>, parë në janar 2012.

<sup>5</sup> Intervistë me një nga themelueset e Listës EMILY, janar 2010.

<sup>6</sup> Po aty.

do të garantonte që të drejtat e barabarta sipas çdo ligji federal, shtetëror apo vendor nuk do të mohoheshin për shkak të gjinisë – organizata grash si NWPC-ja ushtruan ndikim strategjik mbi udhëheqjen e Partisë Demokratike për të ri-konfirmuar platformën e partisë pro-ERA-s në konventën e saj të vitit 1972.

### B. RREGULLAT E BRENDSHME PËR KONVENTAT PARTIAKE

Si rezultat i rënies së përfaqësimit të grave në radhët e delegatëve në Konventën e vitit 1976, NWCP-ja, NOW dhe grupi i grave u bashkuan për të propaganduar futjen në statutin e partisë të formulimeve që do të garantonin një përfaqësim 50:50 të grave dhe burrave në Konventat

e Partisë Demokratike. Në periudhën para konventës së vitit 1980, aktivistet arritën ta bindnin Presidentin Jimmy Carter që ta mbështeste këtë nismë, duke shfrytëzuar shqetësimin e tij se, nëse nuk e bënte këtë, gratë do të votonin për konkurrentin e tij kryesor në garën për emërimin e kandidatit demokrat për president.<sup>7</sup> Si rezultat, konventa e Partisë Demokratike e vitit 1980 shënoi herën e parë në historinë e SHBA-së që delegatët e një partie në konventën për emërimin e kandidatit për president përfshinin një numër të barabartë burrash dhe grash. Anëtarët e NWPC-së dhe NOW-s përbënin 20 për qind të grave delegate në konventë.<sup>8</sup>

Partia Demokratike votoi gjithashtu për të ndryshuar statutin e saj, për të garantuar që në të ardhmen konventat kombëtare të përbëheshin nga një numër i barabartë delegatësh burra dhe gra. Përveç kësaj, statuti tani kërkon që strukturat e partisë të ndahen në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave, përfshirë DNC-në (Komitetin Kombëtar Demokrat), komitetin ekzekutiv, grupet rajonale dhe komitetet qendrore të shteteve, dhe i jep NFDW-së dhe grupit të grave vende në DNC dhe në komitetin ekzekutiv të partisë. Organizatave shtetërore të partisë u kërkohet po ashtu që të ndërmarrin “hapa pozitive të verifikueshme” për të zbatuar dispozitat e statutit në lidhje me ndarjen e barabartë gjinore,<sup>9</sup> dhe pjesa më e madhe e rregulloreve të Partisë Demokratike në shtete parashikon që zëvendës-kryetari i partisë në shtet duhet të jetë i seksit të kundërt nga kryetari.<sup>10</sup>

Grupi i grave përfaqësuese në kongres dhe organizatat e grave të lidhura me të punojnë për furnizimin e politikës me gra udhëheqëse që nga niveli i bazës deri në atë kombëtar. Kjo punë i ka bazat tek strategjitë për rekrutimin e grave udhëheqëse në nivelin vendor, për të nxitur kandidatura grash, veçanërisht në vende të hapura ku të zgjedhurit ekzistues të Partisë Demokratike nuk kanë ndërmend të konkurrojnë,<sup>11</sup> dhe për të nxitur kandidatët të përfshijnë imazhe grash në reklamën televizive të fushatës së tyre.<sup>12</sup>

## Rezultatet

Që nga vitet 1980 Partia Demokratike ka ruajtur balancën gjinore në konventat kombëtare të partisë. Gratë që marrin

pjesë në konventat e partisë kanë pasur mundësinë të krijojnë lidhje dhe të mbledhin fonde që kanë qenë të rëndësishme për karrierat e tyre politike. Shumë gra që duan të venë kandidaturën për poste zyrtare për herë të parë kanë qenë më parë delegate të partisë, gjë që i ka lejuar ato të forcojnë marrëdhëniet e krijuara nëpërmjet pjesëmarrjes në konventat e partisë. Për t’iu përgjigjur përpjekjeve të Partisë Demokratike për institucionalizimin e rolit të grave në konventat e tyre përmes ndryshimeve në statut, edhe Partia Republikane ka punuar për të promovuar një përqindje më të madhe të grave pjesëmarrëse në konventat e saj, dhe në vitin 1980 gratë përbënin 48 për qind të pjesëmarrësve.<sup>13</sup>

## Sfidat dhe rruga përpara

Me gjithë përfitimet reale në përfaqësim dhe në mbështetjen për prioritetet politike të grave në Partinë Demokratike, përvoja ka treguar se këto politika të konventave kanë pasur një rol të kufizuar për sa i përket zgjedhjes së grave në poste zyrtare. Gratë që duan të venë kandidaturën për poste politike në të gjitha nivelet në Shtetet e Bashkuara shpesh i kanë anashkaluar qendrat tradicionale të mbështetjes së kandidatëve dhe në vend të tyre kanë marrë mbështetje nga një rrjet organizatash politike të grave që ofrojnë ndihmë financiare, studime, informacion dhe personel, dhe në përgjithësi nxisin pjesëmarrjen aktive të grave demokrate në procesin politik.<sup>14</sup>

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë zgjedhjet presidenciale për partitë, gratë aktiviste partiake dhe të shoqërisë civile kanë vazhduar të bëjnë avokaci që Partia Demokratike të përzgjedhë një grua kandidate për presidente. Megjithatë, fokusi tek politikën presidenciale ka bërë që aftësia e aktivisteve për fituar momentum në lëvizjen drejt paritetit në përfaqësimin e grave në nivelet e ndryshme të qeverisë të jetë e kufizuar. Përveç kësaj, sukcesi i Listës EMILY i ka dhënë Partisë Demokratike pretekstin për të mos ngritur një organizatë më të fuqishme grash brenda partisë. Gratë në Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të përballen me pengesa dhe nuk kanë mundur të shkojnë përtej 17 përqindëshit të përfaqësimit të tyre në Kongres dhe, që nga viti 2010, zënë vetëm 22,9 për qind të



posteve ekzekutive shtetërore,<sup>15</sup> 24 për qind të numrit të legjislatorëve në shtete<sup>16</sup> dhe 17,6 për qind të kryetarëve të bashkive.<sup>17</sup>

## Shënime

<sup>1</sup> Ky rast studimi nuk përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha nismave apo të të gjitha organizatave në vend që kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë, por ai shërben si një shembull i veprimeve konkrete të një organizate në hollësi. Analiza dhe rekomandimet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it dhe të NDI-së.

<sup>2</sup> "Facts on Women in Congress 2010." (Fakte për gratë në Kongres 2010) Center for American Women and Politics (Qendra për gratë dhe politikën amerikane). [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/levels\\_of\\_office/Congress-CurrentFacts.php](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/levels_of_office/Congress-CurrentFacts.php), parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Ulloa, F. "The Electoral System of the United States." (Sistemi zgjedhor në Shtetet e Bashkuara) Mundo Electoral, <http://174.36.232.8/html/index.php?id=98>, parë në janar 2012.

<sup>4</sup> Brodtkin, K. (2007). "We Are Neither Male nor Women Democrats: Gender Difference and Women's Integration Within the Democratic Party." (Ne nuk jemi as demokratë burra as gra: Ndryshimet gjinore dhe integrimi i grave brenda Partisë Demokratike) *Journal of Women's History*, 19(2): 111-137.

<sup>5</sup> "The Gender Gap and the 2004 Women's Vote: Setting the Record Straight." (Hendeku gjinor dhe vota e grave në vitin 2004: Ta paraqesim gjendjen siç është.) Center for American Women in Politics (Qendra për gratë amerikane në politikë), [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/voters/documents/GenderGapAdvisory04.pdf](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/voters/documents/GenderGapAdvisory04.pdf), parë në janar 2012.

<sup>6</sup> Intervistë me një aktiviste të Partisë Demokratike, janar 2010.

<sup>7</sup> Gelb, J. (1989). "Feminism and Politics: A Comparative Perspective." (Feminizmi dhe politika: Një perspektivë krahasuese) Berkeley, USA: University of California Press.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Center for American Women and Politics (Qendra për gratë amerikane në politikë). "Firsts for Women in U.S. Politics," (Gjëra që ndodhin për herë të parë për gratë në politikën amerikane) [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/resources/Firsts.php](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/resources/Firsts.php), parë në janar 2012.

<sup>10</sup> The Democratic National Committee (Komiteti Kombëtar Demokrat). "The Charter and Bylaws of the Democratic Party of the United States," (Statuti dhe rregullat e Partisë Demokratike të Shteteve të Bashkuara) [http://s3.amazonaws.com/apache3cdn.net/58e635582dc516dd52\\_5wsmvyn09.pdf](http://s3.amazonaws.com/apache3cdn.net/58e635582dc516dd52_5wsmvyn09.pdf), parë në janar 2012.

<sup>11</sup> Intervistë me një aktiviste të Partisë Demokratike, janar 2010.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Gelb, J. (1989). "Feminism and Politics: A Comparative Perspective." (Feminizmi dhe politika: Një perspektivë krahasuese) Berkeley, USA: University of California Press, p. 64.

<sup>14</sup> Gelb, J. (1989) "Feminism and Politics: A Comparative Perspective." (Feminizmi dhe politika: Një perspektivë krahasuese) Berkeley, USA: University of California Press, p. 67.

<sup>15</sup> Center for American Women and Politics. (Qendra për gratë amerikane në politikë) "Facts on Women in Stateside Elective Executive Office 2010." (Fakte për gratë në Zyrën Ekzekutive Zgjedhore Shtetërore 2010) gjetur në at [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/levels\\_of\\_office/Statewide-CurrentFacts.php](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/levels_of_office/Statewide-CurrentFacts.php), parë në janar 2012.

<sup>16</sup> Center for American Women and Politics. (Qendra për gratë amerikane në politikë) "State Legislature." (Legjislatura shtetërore). Gjetur në [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/levels\\_of\\_office/state\\_legislature.php](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/levels_of_office/state_legislature.php), parë në janar 2012.

<sup>17</sup> Center for American Women and Politics. (Qendra për gratë amerikane në politikë) "Women Mayors in U.S. Cities 2009." (Kryetaret e bashkisë gra në qytetet amerikane 2009). Gjetur në [http://www.cawp.rutgers.edu/fast\\_facts/levels\\_of\\_office/Local-WomenMayors.php](http://www.cawp.rutgers.edu/fast_facts/levels_of_office/Local-WomenMayors.php), parë në janar 2012.

## TIMORI LINDOR: KRIJIMI I STIMUJVE PËR AVANCIMIN E REKRUTIMIT TË GRAVE KANDIDATE

Timori Lindor e fitoi pavarësinë në vitin 2002. Si një shtet i ri dhe vend pas konfliktit, përpjekjet e suksesshme për t'i sjellë gratë në jetën politike në Timorin Lindor nënvizuan vlerën e trajtimit të pjesëmarrjes politike të grave që herët në zhvillimin e një vendi.

Në vitin 2001, Administrata Tranzitore e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (*United Nations Transitional Administration in East Timor - UNTAET*) u përpoq të siguronte që gratë të përfshiheshin në zgjedhjet e para të vendit për kuvendin kushtetues, që ishte organi i ngarkuar për hartimin e kushtetutës, si mënyrë për të pranuar zyrtarisht rëndësinë që kishte e përfshirja e grave dhe sanksionimi i parimit të barazisë në kushtetutë. UNTAET punoi për të forcuar pjesëmarrjen e grave në aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Në vitin 2001 Timori lindor kishte një sistem zgjedhor të përzier, që kombinonte zonat zgjedhore me një anëtar me një listë kombëtare për të zgjedhur 88 deputetët në parlamentin e tij.<sup>1</sup>

UNTAET mbështeti një strategji për të siguruar qasje në media për gratë candidate, shumë prej të cilave ishin candidate për herë të parë dhe u duhej kjo qasje për të krijuar bazën e votuesve të tyre. Si candidateve gra, ashtu edhe partive që vendosnin gra në pozicione ku mund të fitonin në listat e partive të tyre, iu vu në dispozicion kohë në **media**. Kjo taktikë e fundit krijoi një stimul të fortë që partitë të mbështesnin gratë candidate. Qasja në media përfshinte kohë në televizion dhe radio si dhe hapësirë për reklama në gazeta.

Përveç kësaj, u bënë përpjekje për të siguruar që gratë të përfaqësoheshin edhe në ekipet për organizimin e fushatës dhe në nivele të tjera të qeverisjes. Megjithatë dispozitat ligjore nuk parashikojnë kuota, zyrat e fushatës të partive politike vendosën **një kuotë prej 30 për qind gra** dhe një kuotë e ngjashme u vendos për gratë në poste në administratën publike. UNTAET kontribuoi

“SIGURIMI I PJESËMARRJES SË BARABARTË TË GRAVE NË STRUKTURAT VENDIMMARRËSE TË PARTISË KA RËNDËSI THELBËSORE PËR PROMOVIMIN E BARAZISË GJINORE MES TYRE – DHE, NË FUND TË FUNDIT, NË MESIN E SHOQËRISË SI E TËRË.”

për vendosjen e një kuote për Komisionin Kombëtar të Zgjedhjeve, për të siguruar që të paktën katër nga 15 anëtarët e komisionit të ishin gra. Këto nisma kontribuuan që gratë të merrnin 26 për qind të vendeve në asamblenë kushtetuese të vitit 2001. Gratë anëtare të asamblesë vazhduan të luajnë një rol kyç në miratimin e Nenit 17 të Kushtetutës që thotë se “gratë dhe burrat do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyra në të gjitha fushat e jetës familjare, politike, ekonomike dhe kulturore.”<sup>2</sup> Që nga vitit 2001 vendi ka ndërmarrë politika të tjera për të siguruar përfaqësimin e grave në jetën politike.

Kohët e fundit Timori Lindor ka miratuar **një kuotë për gratë candidate** në ligjin zgjedhor. Partitë politike duhet të garantojnë që gratë të përbëjnë 25 për qind të kandidatëve në listat e partisë dhe që një në çdo katër kandidatë të jetë grua. Partitë që nuk e plotësojnë këtë kuotë duhet të ndryshojnë listat e tyre të kandidatëve, që të regjistrohen për zgjedhje.<sup>3</sup>

### SHËNIME

<sup>1</sup> Më vonë, në periudhën menjëherë para zgjedhjeve të vitit 2007, vendet e distrikteve u eliminuan dhe numri i vendeve në parlament u zvogëlua, dhe parlamenti i ri me 65 anëtarë u zgjodh me anë të një listë të vetme.

<sup>2</sup> East Timor and Indonesia Action Network (Rrjeti i veprimtari të Timorit Lindor dhe Indonezisë). “Constituent Assembly: East Timor” (Asambleja kushtetuese: Timori Lindor). Gjendet në <http://www.etan.org/etanpdf/pdf2/constfnen.pdf>, parë në janar 2012.

<sup>3</sup> Shihni Të dhënat globale të kuotave për gratë në <http://www.quotaproject.org/uid/countryview.cfm?country=22>, parë në janar 2012.



“  
SIGURIMI I PJESËMARRJES SË BARABARTË  
TË GRAVE NË STRUKTURAT VENDIMMARRËSE  
TË PARTIVE ËSHTË THELBËSORE PËR PROMOVIMIN  
E BARAZISË GJINORE BRENDA TYRE -  
DHE, NË FUND TË FUNDIT,  
NË KUADËR TË SHOQËRISË NË TËRËSI.”



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara  
Byroja për Politikën e Zhvillimit  
One United World Plaza  
New York, NY, 10017 USA  
Tel. +1 212 906 6305

Për më shumë informacion  
[www.undp.org/governance](http://www.undp.org/governance)



Instituti Demokratik Kombëtar  
për Çështjet Ndërkombëtare  
455 Massachusetts Ave, NW, 8<sup>th</sup> Floor  
Washington, DC 20001-2621  
Tel. +1 202 728 5500

Për më shumë informacion  
<http://www.ndi.org>

ISBN 978-0-9848059-5-2



9